<p>30</p>	<p>Të lexuarit e teksteve letrare</p>	<p>Një vullkan i bërë vetë</p>	<p>*Nxënësit/ et tregojnë se ç' dinë për vullkanet. *Një tekst udhëzues në jetën e përditshme.</p>	<p>-stuhi -mendimesh; -lexo-komento; -lexo-vepro; -diskutim; -analizë; -bashkëbisedim; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.</p>	<p>Për: -leximin e tekstit udhëzues duke dalluar elementet kryesore të tij; -demonstrimin në praktikë të përdorimit të një teksti udhëzues; -dallimin që bën ndërmjet udhëzimeve dhe këshillave; -demonstrimin e të kuptuarit të përmbajtjes së tekstit udhëzues, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij; -grykimin se pse nuk mund të ndryshohet radha e udhëzimeve që jepet në një tekst udhëzues; -analizën e gjuhës së përdorur në tekstet udhëzuese; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.</p>	<p>-njohuritë dhe shkathhtësitë -paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -tekste të ndryshme udhëzuese; -informacione nga interneti për vullkanet; -mjete shkrimi; -lapustila; -fletore; -fletë A4.</p>
<p>31</p>	<p>Të folurit për të komunikuar dhe mësuar</p>	<p>Dita pa makina</p>	<p>Dita pa Makina në qytetin tonë.</p>	<p>-shikim i organizuar; -imagjinatë e drejtuar; -diskutim paraprak; -vëzhgo-diskuto; -trego-diskuto; -lexo-diskuto; -bashkëbisedim; -krijim i një posteri; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.</p>	<p>Për: -diskutimin në grupe për temën "Dita pa Makina"; -demonstrimin e sigurisë kur flet në klasë; -shprehjen e opinionëve, mendimeve dhe ndjesive të tij/saj rreth rëndësisë që ka kjo ditë në promovimin e alternativave mjedisore në transport, me një gjuhë të saktë e të kuptueshme; -nxitjen e të tjerëve të bashkëbisedojnë për ndërgjegjësimin që bën kjo ditë për pasojat negative që shkakton përdorimi i automjeteve në mjedis dhe ngrohjen globale; -përdorimin e një fjalori të përshtatshëm rreth temës; -respektimin e rregullave të të folurit gjatë komunikimit me të tjerët; -bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.</p>	<p>-njohuritë dhe shkathhtësitë -paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -pamje nga qytetet me një trafik të rënduar të makinave; -foto që nxënësit/et kanë bërë me biçikleta në Ditën pa Makina; -informacione nga interneti për Ditën pa Makina; -mjete shkrimi; -lapustila; -fletore; -tabakë letre; -fletë A4.</p>

32	Të lexuarit e teksteve letrare	T'i vijmë në ndihmë Tokës	Nga se kërcënohet natyra dhe mjedisi ynë?	-stuhi mendimesh; -lexo-diskuto; -mendo-nxirr përfundim; -analizë; -bashkëbisedim; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -leximin e tekstit udhëzues duke dalluar elementet kryesore të tij; -vënien në dukje të rëndësishë që ka kultivimi i bimëve dhe i drurëve për mbrojtjen e tokës dhe mjedisit në përgjithësi; -tregimin e shembujve nga jeta e përditshme për mbrojtjen e mjedisit dhe të natyrës; -vlerësimin e përgjegjësisë që kemi në familje dhe komunitet për mbrojtjen e mjedisit dhe të natyrës; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.	-njohuri të dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -pamje të ndryshme të planetit tonë; -informacione nga interneti për kërcënimet që i vijnë mjedisit dhe natyrës nga ndotësit e ndryshëm; -postera sensibilizues për mbrojtjen e mjedisit; -mjete shkrimi; -lapustila; -fletore; -fletë A4.
33	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Në mbrojtje të mjedisit	Si të shkruajmë një plan javor për një veprimtari të caktuar.	-diskutim paraprak: -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale; -punë në dyshe; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -ndërtimin e fjalive për mbrojtjen e mjedisit, duke zgjedhur nga fjalët dhe grupet e fjalëve të dhëna si dhe duke u mbështetur në foto; -zbatimin e udhëzimeve të dhëna për të shkruar një plan javor për mbrojtjen e mjedisit; -plotësimin e tabelës së një plani javor “Në mbrojtje të mjedisit”; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit; -qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.	-njohuri të dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor, -foto që pasqyrojnë ndotjen e mjedisit nga faktorë të ndryshëm; -foto, postera që evidentojnë rolin e fëmijëve në mbrojtjen e mjedisit; -video, informacione nga interneti; -mjete shkrimi; -lapustila; -fletore; -tabakë letre; -fletë A4.

34	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Në mbrojtje të mjedisit	Shkruajmë një plan javor për një temë të caktuar.	-diskutim; -shkrim i drejtuar; -konkurs; -punë në dyshe; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	<p>Për:</p> <ul style="list-style-type: none"> -tregimin e hapave për realizimin e një plani javor; -zbatimin e udhëzimeve të dhëna për të shkruar një plan javor për një temë të caktuar; -shkrimin e një plani javor për një temë të caktuar, duke u bazuar në modele; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të shkruarit; -qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve. 	<p>-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit; -teksti shkollor; -modeli i një plani javor; -njete shkrimi; -tabakë letre; -lapustila; -fletë A4.</p>
35	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	Sjelljet e mira	Çfarë e dallon një sjellje të mirë?	-diskutim paraprak; -veprimtari e dëgjimit dhe mendimit të drejtuar; -diskuto-argumento; -krijim; -debat i argumentuar; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	<p>Për:</p> <ul style="list-style-type: none"> -ndjekjen me vëmendje të tekstit që dëgjon, duke mbajtur shënime për çëshjet më interesante; -demonstrimin e të dëgjuarit të qëllimshëm në kryerjen e detyrave; -diskutimin rreth pjesës që dëgjon, duke u mbështetur në shënime e mbajtura prej tij/saj; -tregimin për rregullën më të lehtë dhe më të vështirë për t'u zbatuar që të ndihesh mirë, duke argumentuar mendimin e tij/saj; -krijimin e librit të rregullave të klasës, duke ndjekur udhëzimet; -vlerësimin e rëndësisë së zbatimit të rregullave në shtëpi, shkollë, komunitet, shoqëri etj; -bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave. 	<p>-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësues; -rregulloja e shkollës dhe e klasës; -CD, magnetofon; -njete shkrim; -lapustila; -fletore; -fletë A4.</p>

36			Diskutim: Rëndësia e rregullave të lojës.	-pyetja sjell pyetjen; -lexo-komento; -lexo-përmblihd në dyshe; -rishikim në dyshe; -analizë; -bashkëbisedim; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -leximin e tekstit udhëzues duke dalluar elementet kryesore të tij; -demonstrimin e të kuptuarit të përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth organizimit dhe zhvillimit të lojës së stafetës; -shpjegimin e domethënies së fjalëve “njëra skuadër është më e shpejtë se tjetra”; -demonstrimin në praktikë të përdorimit të një teksti udhëzues, gjatë ekzekutimit të lojës së stafetës; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.	-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -foto të fëmijëve duke zhvilluar stafetë; -mjete shkrimi; -lapustila; -fletore; -fletë A4
37	Të lexuarit e teksteve letrare	Stafeta	Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar dialektet e gjuhës shqipe.	-dëgjim i drejtuar; -diskutim në dyshe; -dallo-emërto-lidh; -rishikim në dyshe; -punë individuale; -punë në dyshe; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -dallimin e dy dialekteve të gjuhës shqipe dhe lidhjen e tyre me zonën që i përkasin; -shndërrimin e fjalëve nga njëri dialekt në tjetrin; -lidhjen e gjuhës së folur nga familja e ti/saj me njërin nga dialektet apo gjuhën standarde shqipe; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e dialekteve si pasuri e gjuhës shqipe; -vlerësimin e punës së të tjerëve; -demonstrimin e besimit në forcat e veta, respektit dhe tolerancës brenda grupit.	-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -incizime të pjesëve nga tekste letrare në dialekte të ndryshme dhe në gjuhën letrare; -mjete shkrimi; -lapustila;\
38	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Rregullat e detit	Diskutim me nxënësit/et për rëndësinë e zbatimit të rregullave në jetën e përditshme.	-imagjinatë e drejtuar-diskutim; -vëzhgo-komento; -ditar dypjesësh; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -leximin e rregullave të tekstit me intonacionin e duhur; -plotësimin e fjalëve mungesore në tekst; -diskutimin rreth rregullave të plazhit; -vlerësimin e rëndësinë së zbatimit të rregullave kur je në plazh; -paracitjen e komunikimit e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj; -demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup; -vlerësimin që i bëjnë punës së shokëve e të shoqeve.	-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi; -lapustila; -fletore; -fletë A4.

39		Bora e parë	Ndërtimi i një historie duke u mbështetur në terma paraprakë.	-parashikim me terma paraprakë; -diskutim për njohuritë paraprake; -lexim dhe pyetje; -diskutim; -hulumtim; -bashkëbisedim; -punë individuale; -punë me gjithë klasën; -punë në dyshe; -punë në grup.	Për: -shprehjen e mendimeve personale rreth një teksti-ditar; -rëndijen sipas rrjedhës së shkrimit të ditarit të fjalive përmbledhëse të tekstit; -leximin e tekstit në mënyrë të rrjedhshme dhe me intonacionin e duhur; -shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve rreth ditarit; -tregimin e llojit të tekstit që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij; -përgjigjet për pyetjet rreth përmbajtjes së ditarit; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.	-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor, -mjete shkrimi, -lapustila; -fletore; -flete A4
40	Të lexuarit e teksteve letrare		Manipulime me fjalë e fjali për të shkruar drejt fjalët mohuese.	-tryezë rrethore; -diskutim në dyshe; -rishikim në dyshe; -diskutim; -punë individuale; -punë në dyshe; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -dallimin e fjalëve mohuese në fjali; -drejtshkrimin e fjalëve mohuese; -përdorimin drejt të fjalëve mohuese në fjali; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së të tjerëve; -demonstrimin e besimit në forcat e veta, respektit dhe tolerancës brenda grupit.	-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi; -lapustila; -fisha; -fletore; -tabakë letre; -fletë A4.
41	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Shkrimi i fjalëve mohuese	Manipulime me fjalë e fjali për të shkruar drejt fjalët mohuese.	-lexim-diskutim; -rishikim në dyshe; -diskutim; -punë individuale; -punë në dyshe; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -dallimin e fjalëve mohuese në fjali; -drejtshkrimin e fjalëve mohuese; -përdorimin drejt të fjalëve mohuese në fjali; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së të tjerëve; -demonstrimin e besimit në forcat e veta, respektit dhe tolerancës brenda grupit.	-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi; -lapustila; -fisha; -fletore; -tabakë letre; -fletë A4.
	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Shkrimi i fjalëve mohuese				

42	Të lexuarit e teksteve letrare	Duhet kohë për të qenë fëmijë	Si e kaloni kohën e lirë? Si e mbushni atë?	-diskutim paraparak; -lexo-përmbledh në dyshe; -diskutim; -harta e personazheve; -bashkëbisedim; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; -tregimin se si ndikojnë ilustrimet për ta kuptuar më mirë përmbajtjen e tekstit; -tregimin e llojit të tekstit që lexon duke vënë në dukje disa karakteristika të tij; -shpjegimin e fjalët të reja, duke ndërtuar fjali me to; -përshkrimin e personazhit, duke e ilustruar me pjesë nga teksti; -paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj; -vlerësimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimet që i bëjnë njëri-tjetrit.	-njohuritë dhe shkathësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi; -lapustila; -fletore; -fletë A4.
43	Të lexuarit e teksteve letrare	Plaku dhe mbreti	Flasim për teatrin.	-diskutim paraparak; -ndërveprim me tekstin; -rishikim në dyshe; -analizë; -lexim sipas roleve; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët dhe shprehjet që i duken interesante, më të rëndësishme; -tregimin e llojit të pjesës që lexon duke vënë në dukje disa karakteristika të saj; -përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit; -demonstrimin e të kuptuarit të përmbajtjes së tekstit teatror, duke dalluar alternativat e vërteta dhe të gabuara; -dallimin e ndryshimeve midis dy personazheve të pjesës teatrorë.	-njohuritë dhe shkathësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tekste teatrorë të ndryshme; -mjete shkrimi, fletë A4.

44	Të lexuarit e teksteve letrare	Plaku dhe mbreti	Nxënësit/et lexojnë në role pjesën.	-lexim sipas roleve; -harta e personazheve; -ditari dypjesësh; -bashkëbisedim; -lojë në role; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -leximin e tekstit sipas roleve; -tregimin e përmbajtjes së pjesës duke u mbështetur në pyetjet në tekst; -analizën e personazheve mbi bazën e veprimeve të tyre; -interpretimin e pjesës në role; -vlerësimin e rolit të brezave për krijimin e të mirave materiale dhe investimin për brezat e ardhshëm; -lidhjen e kontributit të plakut me shembuj nga jeta e tij/saj kur ka bërë diçka që do t'u vlejë edhe të tjerëve; -vlerësimet për interpretimet e shokëve/shoqeve.	-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -veshje të përshtatura për personazhet; -mjete shkrimi; -fletë A4.
45	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Plotësojmë pyetësorë	Plotësimi dhe diskutimi i pyetësorëve të thjeshtë.	-shkrim i drejtuar-diskutim; -shkrim i lirë;-diskutim; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -plotësimin e pyetësorëve duke zgjedhur disa prej alternativave; -plotësimin e pyetësorëve duke shpjeguar me shkrim zgjedhjen e bërë; -vënien në dukje të preferencave dhe aftësive në lidhje me të lexuarit dhe të folurit; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit; -qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es; -vlerësimin e punës së shokëve dhe të shoqeve.	-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit; -teksti shkollor; pyetësorë të ndryshëm; -mjete shkrimi; -lapustila; -fletë A4.

46	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Plotësimi dhe diskutimi i pyetësorëve të thjeshtë.	-diskutim; -shkrim i lirë; -shkrim i drejtuar-diskutim; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -plotësimin e pyetësorëve duke zgjedhur disa prej alternativave; -plotësimin e pyetësorëve duke shpjeguar me shkrim zgjedhjen e bërë; -vënien në dukje të preferencave dhe aftësive në lidhje me të lexuarit dhe të folurit; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të shkruarit; -qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es; -vlerësimin e punës së shokëve dhe të shoqeve.	-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit; -teksti shkollor; pyetësorë të ndryshëm; -mjete shkrimi; -lapustila; -fletë A4.
47	Të lexuarit e teksteve letrare	Pse mund të jetë mërzitur telefoni?	-parashikim me anë të titullit dhe ilustrimeve; diskutim; -veprimtari e leximit të drejtuar; -shkrim i shpejtë; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -parashikimin rreth përmbajtjes së pjesës duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe pyetja fillestare; -leximin e përrallës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; -dallimin e llojit të pjesës mbi bazën e karakteristikave të saj; -përgjigjet e pyetjeve rreth pjesës; -paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.	-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -mjete shkrimi; -lapustila; -fletore; -tabakë letre; -fletë A4.
48	Të lexuarit e teksteve letrare	Diskutim rreth karakteristikave të interpretimit të një pjese teatrore.	-diskutim rreth njohurive paraprake; -veprimtari e leximit në role; -pyetje-përgjigje; -lojë në role; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -dallimin e llojin të tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij; -diskutimet rreth pjesës teatrore; -leximit sipas roleve të pjesës teatrore; -interpretimit sipas roleve të pjesës teatrore; -demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.	-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -veshje të përshaturore për personazhet; telefon; etj. -mjete shkrimi; -lapustila; -fletore; -tabakë letre; -fletë A4.

49	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Shenjat e pikësimit në dialog	Manipulime me fjalë e fjali për të përdorur drejt shenjat e pikësimit në dialog.	-vëzhgo-zbulo-diskuto; -lexo, përmbledh në dyshe; -rishikim në dyshe - diskutim; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -dallimin e shenjave të pikësimit në dialog; -vendosjen drejt të shenjave të pikësimit në dialog; -përdorimin drejt të fjalëve mohuese në fjali; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së të tjerëve; -demonstrimin e besimit në forcat e veta, respektit dhe tolerancës brenda grupit.	-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi; -lapustila; -fisha; -fletore; -tabakë letre; -fletë A4.
50	Të lexuarit e teksteve letrare	Çufoja gëzon shokët dhe mësuesen	Shikim i disa sekuencave nga seriali vizatimor “Ndodhitë e Çufos”, me skenar të Gaqo Bushakës.	-shikim i organizuar; -ndërveprim me tekstin; -rishikim në dyshe; -analizë; -lexim sipas roleve; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -leximin e tekstit duke mbajtur shënime për dialogët që i duken interesante; -tregimin se si ndikojnë ilustrimet për ta kuptuar më mirë përmbajtjen e tekstit; -përgjigjet e pyetjeve rreth pjesës teatrale; -tregimin e llojit të pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj; -leximin me intonacion të pjesës teatrale; -demonstrimin e të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit teatror, duke dalluar alternativat e vërteta dhe të gabuara.	-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -libri “Çufoja dhe Bubi kaçurrel” i autorit Gaqo Bushaka; -videoprojektor; -material filmik nga seriali vizatimor “Ndodhitë e Çufos”; -mjete shkrimi; -fletë A4.
51	Të lexuarit e teksteve letrare	Çufoja gëzon shokët dhe mësuesen	Nxënësit/et lexojnë në role pjesën.	-veprimtari e leximit me role; -harta e personazheve; -bashkëbisedim; -lojë në role; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -leximin e pjesës teatrale sipas roleve; -tregimin e përmbajtjes së pjesës teatrale me fjalët e tij/saj; -analizën e personazheve mbi bazën e veprimeve të tyre; -lidhjen e pjesës teatrale që lexon me ngjarje nga jeta e tij/saj, kur shokët apo shoqet e klasës i kanë ofruar ndihmë atyre apo kur ata u kanë dhënë ndihmë; -interpretimin e pjesës teatrale në role; -vlerësimet për interpretimet e shokëve/shoqeve.	-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -veshje të përshatura për personazhet; -mjete shkrimi; -fletë A4.

54	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Vlerësim njohurish 3	Vlerësim njohurish	-bisedë; -punë individuale e pavarur.	-bisedë; -diskutim; -hulumtim; -tryezë rrethore; -punë në grup.	Për: -plotësimin e kërkesave të ushtrimeve në tekst; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.	-njohuri të dhe shkathësitë paraprake të nxënësit/es; -fletët e testit; -mjetet e shkrimit.
55	Të folurit për të komunikuar dhe mësuar	Projekti 3 "Teatri ynë"	Si mund të luajmë një pjesë teatrore?	-bisedë; -diskutim; -hulumtim; -tryezë rrethore; -punë në grup.	-bisedë; -diskutim; -hulumtim; -tryezë rrethore; -punë në grup.	Për: -interpretimin e pjesës sipas roleve; -përzgjedhjen e fjalorit të duhur gjatë të folurit; -shprehjen saktë dhe kuptueshëm të mendimit; bashkëpunimin në grup.	-libra për fëmijë; -filme nga shfaqje me kukulla.
56	Të lexuarit e teksteve letrare	Projekti 3 "Teatri ynë"	Si mund të luajmë një pjesë teatrore?	-bisedë; -diskutim; -hulumtim; -tryezë rrethore; -punë në grup.	-bisedë; -diskutim; -hulumtim; -tryezë rrethore; -punë në grup.	Për: -leximin sipas roleve; -interpretimin e pjesës sipas roleve; -përzgjedhjen e fjalorit të duhur gjatë të folurit; -shprehjen saktë dhe kuptueshëm të mendimit; bashkëpunimin në grup.	-libra për fëmijë; -filme nga shfaqje me kukulla. -maska ose veshje për personazhet; -blllok shënimesh; -karton letër; -lapustila.
57	Të lexuarit e teksteve letrare	Projekti 3 "Teatri ynë"	Si mund të luajmë një pjesë teatrore?	-bisedë; -diskutim; -lojë me role; -punë në grup.	-bisedë; -diskutim; -lojë me role; -punë në grup.	Për: -leximin sipas roleve; -interpretimin e pjesës sipas roleve; -përzgjedhjen e fjalorit të duhur gjatë të folurit; -shprehjen saktë dhe kuptueshëm të mendimit; -bashkëpunimin në grup.	-maska ose veshje për personazhet; -blllok shënimesh; -foto videoprojektor; -karton letër; -lapustila; -CD, magnetofon; -skenë e improvizuar.
58	Të lexuarit e teksteve letrare	Projekti 3 "Teatri ynë"	Si mund të luajmë një pjesë teatrore?	-bisedë; -diskutim; -lojë me role; -punë në grup.	-bisedë; -diskutim; -lojë me role; -punë në grup.	Për: -leximin sipas roleve; -interpretimin e pjesës sipas roleve; -përzgjedhjen e fjalorit të duhur gjatë të folurit; -shprehjen saktë dhe kuptueshëm të mendimit; -bashkëpunimin në grup.	-maska ose veshje për personazhet; -blllok shënimesh; -foto videoprojektor; -karton letër; -lapustila; -CD, magnetofon; -skenë e improvizuar.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Flasim Librat e pushimeve verore		Situata e të nxënit Nxënësit/et flasin rreth librave që kanë lexuar gjatë pushimeve verore.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • diskuton për librat që ka lexuar gjatë pushimeve verore; • u përgjigjet pyetjeve që kanë të bëjnë me leximin e librave jashtëshkollorë dhe bibliotekës së tij/saj personale, duke u shprehur saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota; • përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës; • tregon rreth librit të fundit që ka lexuar; • nxit të tjerët të bashkëbisedojnë për librat që kanë lexuar gjatë pushimeve verore; • vlerëson rolin e librit në formimin kulturor të tij/saj; • respekton rregullat e të folurit gjatë komunikimit me të tjerët. 		Fjalë kyçe: -pushime verore; -libra; -balona; -bibliotekë.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -libra që nxënësit/et kanë lexuar gjatë pushimeve verore; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -plotëso-trego; -bashkëbisedim; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -bisedë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Plotëso-trego:</i> Mësuesi/ja, u shpërndan nxënësve/eve fleta A4, në të cilat janë vizatuar balonat e tregimeve, të përrallave dhe të poezive. Nxiten nxënësit/et të shkruajnë në to titujt e librave, që kanë lexuar gjatë pushimeve verore sipas llojeve të tyre (tregime, përralla dhe poezi). Secili nxënës/e, prezanton para klasës titujt e librave që ka lexuar, duke veçuar librin që u ka pëlqyer më shumë. Ata/ato vënë në dukje preferencat e njëjta që mund të kenë për librat, me shokët apo shoqet e tyre, duke dhënë mendimin e tyre pse ndodh kjo. • Veprimtaria e dytë <i>Bashkëbisedim:</i> Ushtrimi2. Nxiten nxënësit/et të bashkëbisedojnë rreth veprimtarive që kanë zhvilluar në pjesën më të madhe të kohës, gjatë pushimeve verore, duke përzgjedhur njërin nga alternativat: a) <i>luajte me shokët dhe shoqet;</i> b) <i>lexove libra;</i> c) <i>shëtite;</i> d) <i>tjetër.</i> • Veprimtaria e tretë <i>Marrëdhënie pyetje-përgjigje:</i> Ushtrimi3. Mësuesi/ja, orienton nxënësit/et të komentojnë ilustrimin dhe të lexojnë tekstin. Nxiten ata/atot u përgjigjen pyetjeve: -Po ti, cilët libra pëlqen për të lexuar? Pse? -Nëç periudhë të vitit lexon më shumë? Pse? -A të ka ndodhur ndonjëherë të mos shkëputesh nga leximi deri kur ke mbërritur në fund të librit? Na trego më shumë për këtë rast! 			

- **Veprimtaria e katërt**

Plotësim i pyetësorit: Ushtrimi 4. Nxënësit/et plotësojnë individualisht pyetësorin dhe krahasojnë rezultatin e tyre me atë të shokëve e shoqeve, duke vlerësuar vendin që ka zënë leximi në ditët e tyre të pushimeve verore.

- **Veprimtaria e pestë**

Bisedë: Ushtrimi 5. Secili nga nxënësit/et tregon shkurtimisht diçka për librin e fundit që ka lexuar, duke iu përgjigjur pyetjeve:

-Ku e gjete?

-Pse e zgjodhe?

-Çfarë të bëri përshtypje?

Ftohen nxënësit/et të tregojnë shkurtimisht përmbajtjen e tij.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-diskutimin për librat që ka lexuar gjatë pushimeve verore;

-përgjigjet e pyetjeve që kanë të bëjnë me leximin e librave jashtëshkollorë, për bibliotekën e tij/saj personale, duke u shprehur saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota;

-përdorimin e një fjalori të përshtatshëm rreth temës;

-diskutimin rreth librit të fundit që ka lexuar;

-nxitjen e të tjerëve të bashkëbisedojnë për librat që kanë lexuar gjatë pushimeve verore;

-vlerësimin e rolit të librit në formimin kulturor të tij/saj;

-respektimin e rregullave të folurit gjatë komunikimit me të tjerët.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Lexojmë Një mirëseardhje e ëmbël		Situata e të nxënit Si mendoni, çfarë fshihet pas titullit „Një mirëseardhje e ëmbël?”	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tregimin rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit; • tregon llojin e pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj; • pyet dhe përgjigjet rreth përmbajtjes së tregimit; • tregon përmbajtjen e tregimit duke u mbështetur te pyetjet; • formulon mesazhin që përcjell tregimi; • lidh idetë dhe informacionin e librit me përvojën vetjake në lidhje me ditën e parë të shkollës; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • pranon me respekt mendimet dhe idetë e të tjerëve; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. 		Fjalë kyçe: -mirëseardhje; -dita e parë e shkollës; -vit shkollor; -i veçantë.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -foto, apo filmime të nxënësve/eve në ditën e parë të shkollës; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve

- **Metodologjia:**

- diskutim;
- procedura:pyet sërish;
- marrëdhënie pyetje-përgjigje;
- ditari dypjesësh;
- mendo-nxirr mesazhin;
- bashkëbisedim;
- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

Veprimtaritë e nxënësve

- **Veprimtaria e parë**

Diskutim: Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit.

Nxiten nxënësit/et të diskutojnë rreth titullit të tregimit “Një mirëseardhje e ëmbël”.

*Koment nga nxënësit/et i ilustrimit në libër.

- **Veprimtaria e dytë**

Procedura:pyet sërish: Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tregimin në paragrafë. Nënvizojnë fjalët dhe shprehjet që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që u duken më interesante e më të rëndësishme.

*Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et diskutojnë në dyshe: njëri/a prej tyre ndërton dy pyetje rreth fjalive më interesante në paragrafin e parë dhe tjetri/a i përgjigjet pyetjeve.

Për çdo paragraf të ri nxënësit/et ndërrojnë rolet.

*Në përfundim të punimit të të gjithë pjesës, nxënësve/eve u lihet kohë për ta rilexuar, për ta kuptuar më mirë.

*Nxënësit/et diskutojnë ndërmjet tyre dhe tregojnë llojin e pjesës (tregim), duke vënë në dukje disa nga karakteristikat.

*Lexohet tregimi nga nxënësit/et zinxhir.

- **Veprimtaria e tretë**

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën, për t’iu përgjigjur pyetjeve:

- Për cilënditë bën fjalë ky tregim?
- Çfarë kishte veshur Karolina në ditën e parë të shkollës?
- Kush e shoqëronte atë?
- Pse Karolina shtrëngonte dorën e mamit?
- Si e mirëpriti shoku i bankës Karolinën?
- *Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen duke u mbështetur te pyetjet.

- **Veprimtaria e katërt**

Ditari dypjesësh: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et të lexojnë me vëmendje fjalinë dhe të zbërthejnë kuptimin e saj.

Nxënësit/et në grupe, do të plotësojnë ditarin dypjesësh, ku do të japin komentën e tyre rreth fjalisë.

Fjalja	Komenti
Hapat kumbonin dhe aty brenda ndihej në aromë e çuditshme, aromë serioziteti.	Karolina teksa kishte hyrë në oborrin e shkollës, në ditën e parë të shkollës, kishte lënë pas periudhën e shkujdesur të pushimeve verore për t’iu drejtuar shkollës, ku ajo bashkë me shokët e shoqet e klasës, do të fillonte vitin e ri shkollor, i cili do të ishte me rregulla, me disiplinë, me orar dhe me gjithë seriozitetin që ka shkolla, prandaj ndihej edhe “aroma“ e këtij serioziteti.

Nxënësit/et dëgjojnë dhe vlerësojnë komentet e shokëve/shoqeve të tyre.

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e pestë <i>Mendo-nxirr mesazhin: Nxiten nxënësit/et të lexojnë fjalinë: Dhe Karolina hëngri mollën më të shijshme që kishte provuar ndonjëherë, duke menduar se ky vit shkollor do të ishte vërtet i veçantë.</i> Në grupe, ata/atonxjerrin mesazhin e përcjellë prej saj. Mesazhi: <i>Mirëseardhja në shkollë, ngadonjëherë shprehet edhe me gjeste të thjeshta njerëzore, siç është një mollë e dhuruar nga shoku i klasës, me plot domethënie për një vit të mbarë.</i> Përfaqësuesit e çdo grupi, lexojnë mesazhet e formuluarat. • Veprimtaria e gjashtë <i>Bashkëbisedim:</i> Punohet rubrika “Reflektoj“. Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve dhe tregojnë për mbresat dhe emocionet që kanë përjetuar në ditën e parë të vitit shkollor. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. • Vlerësimi bëhet për: -leximin e rrjedhshëm të tregimit, duke respektuar shenjat e pikësimit; -tregimin e llojit të pjesës që lexon, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj; -pyetjet dhe përgjigjet e dhëna rreth përmbajtjes së tregimit; -tregimin e përmbajtjes duke u mbështetur te pyetjet; -formulimin e mesazhit që përcjell tregimi; -lidhjen që i bën ideve dhe informacionit të librit me përvojën e tij/saj vetjake, në lidhje me ditën e parë të shkollës; -paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimit të tij/saj; -bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre; -vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit. • Detyrë shtëpie Rubrika “Shkruaj“ 			
Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Shkruajmë Libri më i bukur i pushimeve		Situata e të nxënët *Diskutim me nxënësit/et për librin më të bukur që kanë lexuar gjatë pushimeve verore. *Konceptimi i një skede të thjeshtë.	
Rezultatet e të nxënët Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • tregon titujt e librave që ka lexuar gjatë pushimeve verore; • veçon librin që i ka pëlqyer më shumë; • dallon elementet e një skede libri; • sistemon sipas rrjedhës logjike, skedën e një libri; • plotëson skedën e një libri; • vlerëson rolin e skedës për një lexim të suksesshëm dhe seleksionim të vlerave të librit; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -libri më i bukur; -lexoj; -pushime verore; -skedë e librit; -titull i librit; -autori; -personazhe kryesore; -data e fillimit dhe e mbarimit të leximit; -hyrja e tregimit; -përmbajtja në mënyrë të përmbledhur; -mbylla e tregimit.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -libra që nxënësit/et kanë lexuar gjatë pushimeve verore; -modele skedash të librave të plotësuara; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve

- **Metodologjia:**

- diskutim paraprak;
- diskutim;
- shkrim i drejtuar;
- bashkëbisedim;
- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

Veprimtaritë e nxënësve

- **Veprimtaria e parë**

Diskutim paraprak: Mësuesi/ja u drejton pyetjet nxënësve/eve:

- Çfarë librash keni lexuar gjatë pushimeve verore?
- Cili prej tyre ju ka lënë më shumë mbresa?

Nxiten nxënësit/ettëjapin përshtypjet e tyre rreth librave që u kanë pëlqyer më shumë.

- **Veprimtaria e dytë**

Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit. Ftohen nxënësit/et të hapin tekstin dhe të vërejnë ilustrimet në të. Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën, diskutojnë rreth ilustrimeve.

Diskutim: Punë në grupe: Ushtrimi 1. Orientohen nxënësit/et, që në grupe të sistemojnë skedën e librit të Ivit, duke lidhur me shigjetë.

Pas përfundimit të punës lexohet nga nxënësit/et dhe diskutohet skeda e sistemuar nën drejtimin e mësuesit/es. Diskutimi orientohet rreth pyetjeve:

- Cilat janë elementet e skedës së Ivit?
- Duke u bazuar në përmbajtjen e përmbledhur të tregimit „Shigjeta e kaltër“, po juve, a do t’ju pëlqente t’i bënit të tjerët të lumtur, ashtu siç e bënte lodrat Françeskon?
- A ju ka ndodhur të dhuroni lodra për bashkëmoshatarët tuaj në nevojë?

- **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 2. Individualisht nxënësit/et do të plotësojnë skedën e librit të Ivit, tashmë të organizuar dhe në vendin e duhur. Në përfundim, nxënësit/et lexojnë skedën e plotësuar.

- **Veprimtaria e katërt**

Bashkëbisedim: Zhvillohet një bashkëbisedim me nxënësit/et në minutat e fundit.

- Pse është mirë që të mbajmë shënime gjatë leximit të një libri të ri?
- A do t’ju shërbente më mirë mbajtja e shënimeve rreth librave të lexuar në formën e skedës? Pse mendoni kështu?

-Po ju, a keni krijuar skeda të tilla si Ivi?

-Çfarë mund t’i shtojë ti kësaj skede?

Nxiten nxënësit/et, që të japin mendimet e tyre, duke shtuar qoftë edhe ndonjë element tjetër të skedës.

Nxënësit/et vlerësojnëpunën e shokëve/shoqeve.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e elementeve të një skede libri;
- vlerësimin e rolit të skedës për një lexim të suksesshëm dhe seleksionim të vlerave të librit;
- sistemimin sipas rrjedhës logjike të skedës së një libri;
- plotësimin e skedës së një libri;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës sëshokëve/shoqeve.

- **Detyrë shtëpie** Ushtrimi 3

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Përdorimi i shkronjës së madhe(ora I)		Situata e të nxënit Identifikimi i rasteve të përdorimit të shkronjës së madhe.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • identifikon raste të përdorimit të shkronjës së madhe; • përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe në emrat e përveçëm; • zbaton rregullat drejtshkrimore në shkrimin e titujve të librave, filmave, këngëve, të emrave të shkollave, rrugëve, institucioneve etj; • shkruan fjali në të cilat përdor fjalë që tregojnë tituj librash, filmash dhe emërtime shkollash, rrugësh, sheshesh, institucioneve etj; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalët kyçe: -shkronjë e madhe; -emra të përgjithshëm; -emra të përveçëm; -tituj librash, filmash, këngësh; -emra rrugësh, institucioneve; -thonjëza.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me fjalë e fjali, ku jepen rastet e përdorimit të shkronjës së madhe; -fisha me emërtime shkollash, rrugësh, institucioneve etj; -fisha me tituj librash, këngësh, filmash etj; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim për njohuritë paraprake; -analizë; -rishikim në dyshe; -lojë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Mësuesi/ja u shpërndan nëçdo dyshe nga një fletë në të cilën është shkruar një fjali. Nxiten nxënësit/et të lexojnë fjalitë dhe të identifikojnë rastet e përdorimit të shkronjës së madhe në to. Zhvillohet një diskutim në klasë rreth njohurive që nxënësit/et kanë për përdorimin e shkronjës së madhe, duke u mbështetur edhe në rubrikën „Kujtoj“. Mësuesi/ja prezanton temën e mësimiit. 			


• **Veprimtaria e dytë**

Analizë: Lexohet rubrika “Mbaj mend”, e cila në mënyrë të përmbledhur, i njih nxënësit/et me përdorimin e shkronjës së madhe.


*Diskutohen raste të përdorimit të shkronjës së madhe, të dhëna në libër, të cilat edhe mësuesi/ja i ka paraqitur në tabelë:

- *Titujt e librave, filmave, këngëve, etj... shkruhen me shkronjë të madhe.*


Këtë verë lexova librin „Kopshti zoologjik i përrallave“



- *Emrat e rrugëve, institucioneve, shkruhen me shkronjë të madhe.*



Ministria e Mbrojtjes shkruhet me shkronjë të vogël.



Fjalët fillojnë me shkronjë të madhe.

• **Veprimtaria e tretë**

Rishikim në dyshe: Nxënësit/etdo të punojnë ushtrimin 1, i cili synon shkrimin e emrave të përveçëm të njerëzve, kafshëve e vendeve.

Ushtrimin 2 synon shkrimin e saktë të emërtimeve të vendeve.

Ushtrimin 3 synon gjetjen dhe rishkrimin e fjalëve, që duhet të shkruhen me shkronjë të madhe.

Nxënësit/et do të punojnë individualisht. Pas përfundimit të punës, shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve.

• **Veprimtaria e katërt**

Lojë: Me nxënësit/et në minutat e fundit mund të zhvillohet një lojë. Nxiten ata/ato të shkruajnë në fleta fjalë e fjali ku nuk është përdorur saktë shkronja e madhe dhe t'i shkëmbejnë me shokët/shoqet që kanë fqinjë, për t'i korrigjuar. Diskutohet me gjithë klasën rreth tyre.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

• **Vlerësimi bëhet për:**

- identifikimin e rasteve të përdorimit të shkronjës së madhe;
- përdorimin e shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe në emrat e përveçëm;
- zbatimin e rregullave drejtshkrimore në shkrimin e titujve të librave, filmave, këngëve dhe emrave të shkollave, rrugëve, institucioneve etj;
- shkrimin e fjalive, në të cilat përdor fjalë që tregojnë tituj librash, filmash dhe emërtime shkollash, rrugësh, sheshesh, institucioneve, etj...;
- qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

• **Detyrë shtëpie**

Shkruaj 5 emra rrugësh, institucioneve. Shkruaj 5 tituj librash, filmash.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Përdorimi i shkronjës së madhe (ora II)		Situata e të nxënët Identifikimi i rasteve të përdorimit të shkronjës së madhe.	
Rezultatet e të nxënët Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • identifikon raste të përdorimit të shkronjës së madhe; • përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe në emrat e përveçëm; • zbaton rregullat drejtshkrimore në shkrimin e titujve të librave, filmave, këngëve dhe emrave tëshkollave, rrugëve, institucioneve, etj...; • shkruan një tekst të shkurtër, në të cilin përdor fjalë që tregojnë emra shkollash, rrugësh, sheshesh, institucioneve etj...; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalët kyçe: -shkronjë e madhe; -emra të përgjithshëm; -emra të përveçëm; -tituj librash, filmash, këngësh; -emra rrugësh, institucioneve; -thonjëza.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me fjalë e fjali, ku jepen rastet e përdorimit të shkronjës së madhe; -fisha me emra rrugësh, institucioneve, shkollash, etj...; -fisha me tituj librash, këngësh, filmash etj; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkrim i shpejtë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi fillon me leximin nga disa nxënës/e, të detyrave të shtëpisë dhe diskutimin rreth tyre, duke vënë në dukje rregullat drejtshkrimore të zbatuara në shkrimin e titujve të librave, filmave dhe emrat e rrugëve, institucioneve, etj... <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 4, i cili synon që nxënësit/et, të plotësojnë fjalitë me emra të përveçëm. Ushtrimi 5 synon që nxënësit/et të lexojnë tekstin dhe të vendosin shkronjën e madhe aty ku duhet. Nxënësit/et do të punojnë individualisht. Pas përfundimit të punës, shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve. • Veprimtaria e tretë <i>Shkrim i shpejtë:</i> Nxiten nxënësit/et të bëjnë një shkrim me 6-7 fjali me temë “Qyteti im“, duke përdorur fjalë që tregojnë emra shkollash, rrugësh, sheshesh, institucioneve, etj... Lexohen shkrimet nga nxënësit/et me zë para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime të thjeshta drejtshkrimore. Nxiten nxënësit/et të vlerësojnë punën e njëri-tjetrit. <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimibëhet për: -identifikimin e rasteve të përdorimit të shkronjës së madhe; -përdorimin e shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe në emrat e përveçëm; -zbatimin e rregullave drejtshkrimore në shkrimin e titujve të librave, filmave, këngëve dhe emrave të rrugëve, institucioneve, etj...; -shkrimin e një teksti të shkurtër, në të cilin përdor fjalë, që tregojnë emra shkollash, rrugësh, sheshesh, institucioneve, etj...; -qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es; -demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës sëshokëve/shoqeve. • Detyrë shtëpie Shkruaj ushtrimin 5 në fletore. 			

Fusha; Gjuhët dhe komunikimi	Lënda; Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Djali i vogël me ëndërr të madhe (ora I)		Situata e të nxënit Diskutim rreth fotove ku nxënësit/et kanë dalë duke lozur me balona.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexontregiminrrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit; • pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tregimit; • tregon llojin e pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj; • shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth tregimit, me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es; • tregon përmbajtjen e tregimit; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj, rreth ëndrrës së Mirit të vogël; • lidh pjesën që lexon me ngjarje nga jeta e tij/saj, në lidhje me festimin e ditës së balonave; • vlerëson ndihmën e më të rriturve për suksesin e djalit, për ndërtimin e balonave; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • pranon me respekt idetë dhe mendimet e të tjerëve. 		Fjalë kyçe: -dita e balonave; -balona shumëngjyrëshe; -ëndërr e madhe; -të mahnitur.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -foto të nxënësve/eve ku kanë dalëduke lozur me balona; -mjete shkrimi,lapustilë, fletore,fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -vëzhgo-diskuto; -diskutim; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -shkrim i shpejtë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Vëzhgo-diskuto:</i> Nxënësit/et paraqesin fotot ku kanë dalë duke lozur me balona me shokët, shoqet e tyre, për të cilat janë porositur nga mësuesi/ja, një orë më parë. Diskutim me nxënësit/et rreth tyre. -Komentoni fotot tuaja. -Ku keni dalë në këto foto? -Me kë keni dalë? -A ju pëlqen të luani me balona? -Po ju, a keni bërë ndonjëherë balona? Kush ju ka ndihmuar për përgatitjen e saj? • Veprimtaria e dytë <i>Diskutim:</i> Nxënësit/et njihen me titullin e pjesës “Djali i vogël me ëndërr të madhe” dhe autoren Adelina Mamaqi. Njihen nxënësit/et shkurtimisht me jetën dhe krijimtarinë e autores: <i>Adelina Mamaqi ka lindur në Tiranë (1939). Libri i saj i parë, është “Ëndrra vashërie”. Më pas, botoi librin me vjersha “Bubi i vogël”, përmbledhje me poezi e prozë si:</i> <ul style="list-style-type: none"> o <i>Orizi i milingonave (poemë)</i> o <i>Bregu i kaltër (vjersha)</i> 			

- o *Fishekzjarret (vjersha)*
- o *Kaltëroshi tekanjozi (poemë)*
- o *Një zog gëzimi (vjersha)*
- o *Goni trazovaçi (poemë)*
- o *Mësoi Adi shkronjën "A"*

*Ata/ato vëzhgojnë dhe komentojnë ilustrimin në libër.

*Orientohen nxënësit/et të lexojnë në heshtje pjesën dhe të nënvizojnë fjalët që nuk kuptojnë, si dhe fjalitë që u dukën më interesante.

*Nxënësit/et tregojnë llojin e pjesës, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj (tregim).

*Nxiten nxënësit/et të shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre rreth tregimit:

-A ju pëlqeu tregimi? Pse?

-Si u ndjetë pas leximit të këtij tregimi?

-Çfarë ju bën më tepër përshtypje në këtë tregim?

*Nxënësit/et lexojnë tregimin zinxhir.

- **Veprimtaria e tretë**

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika "Lexoj dhe kuptoj".

Nxiten nxënësit/et t'u përgjigjen pyetjeve rreth tregimit. Ata /ato diskutojnë në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën rreth përgjigjeve për pyetjet e dhëna:

-Për kë flitet në këtë pjesë?

-Pse u shqetësuan prindërit e Mirit?

-Çfarë ëndërronte Miri?

-Kush e ndihmoi atë për ta realizuar këtë ëndërr?

-Për kë përgatiti ai aq shumë balona?

-Si u ndien shokët e tij kur morën dhuratë nga një balonë?

*Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e tregimit mbi bazën e pyetjeve.

- **Veprimtaria e katërt**

Diskutim: Punohet rubrika "Analizoj". Nxiten nxënësit/et të punojnë në grupe, për t'i dhënë përgjigje pyetjeve për kohën kur zhvillohet ngjarja, duke treguar se ku duket kjo në tregim, si dhe të flasin se si e realizoi Miri ëndrrën e tij.

- **Veprimtaria e pestë**

Shkrim i shpejtë: Nxënësit/et shkruajnë individualisht një shkrim me 5-6 fjali me temë "Ëndrra ime e madhe".

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e tregimit në mënyrë të rrjedhshme dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;

-pyetjet që bën për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tregimit;

-tregimin e llojit të pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj;

-shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth tregimit, me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es;

-tregimin e përmbajtjes;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj, rreth ëndrrës së Mirit të vogël;

-lidhjen e pjesës që lexon me ngjarje nga jeta e tij/saj, në lidhje me festimin e ditës së balonave;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika "Shkruaj"


Fusha; Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Djali i vogël me ëndërr të madhe (ora II)		Situata e të nxënit Diskutim me nxënësit/et për ndjesitë dhe emocionet që kanë provuar në përmbushjen e njëëndrre sado të vogël (në letërsi, sport, arte, shkencë, etj...).	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Lexontregimin rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit; • jep mendimet dhe gjykimet e tij/saj rreth personazheve dhe veprimeve të tyre, duke e ilustruar me pjesë nga tregimi; • ndërton fjali përmbledhëse rreth tregimit; • tregon përmbajtjen mbi bazën e fjalive përmbledhëse të tregimit; • nxjerr mesazhin që përcjell tregimi; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj, rreth ëndrës së Mirit të vogël; • vlerëson ndihmën e më të rriturve për suksesin e djalit për ndërtimin e balonave; • gjykon se si mund të jetësohet njëëndërr; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • pranon me respekt idetë dhe mendimet e të tjerëve rreth tregimit. 		Fjalë kyçe: -dita e balonave; -balona shumëgjyreshe; -ëndërr e madhe; -të mahnitur.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -foto të nxënësve ku kanë dalë duke lozur me balona; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve • Metodologjia: -pyetja sjell pyetjen; -harta e personazheve; -lexo, përmblihdh në dyshe; -mendo, nxirr mesazhin; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Pyetja sjell pyetjen:</i> Mësuesi/ja u drejton nxënësve/eve pyetjet: -Si mundemi ne të përmbushim ëndrrat tona? -A gjejmë gjithnjë mirëkuptim dhe mbështetje nga prindërit dhe më të mëdhenjtë? -A duhet të heqim dorë nga ëndrrat tona edhe pse mund të ballafaqohemi me vështirësi dhe moskuptime? -Çfarë ndjesish keni provuar kur keni arritur të përmbushni një ëndërr sado të vogël (në letërsi, sport, arte, shkencë, etj...)? -A duhet ta ndajmë suksesin tonë me të tjerët? -Nisur nga shembulli i Mirit, çfarë keni bërë ju, apo ç'mund të bëni për të bërë të lumtur shokët e shoqet e klasës? 			

- **Veprimtaria e dytë**

*Nxënësit/et u drejtojnë pyetje njëri-tjetrit rreth përmbajtjes së tregimit.

*Lexohet tregimi nga të gjithë nxënësit/et nëpërmjet leximit zinxhir.

Punë në grup: Harta e personazheve: Nxënësit/et shkruajnë për personazhin kryesor dy cilësi. Për secilën cilësi, shkëputet nga një pjesë ilustruese nga teksti.



- **Veprimtaria e tretë**

*Me anë të teknikës “Lexo, përmblihdh në dyshe”, nxënësit/et në dyshe, ndajnë tregimin në pjesëza të vogla i lexojnë ato dhe i përmbledhin me një fjali.

1. *Djali i vogël, ëndërronte si rrallëkush.*
2. *Djali u tregoi prindërve, se ai ëndërronte balona shumëngjyrëshe që fluturojnë në qiell.*
3. *Prindërit i mundësuan Mirin mjetet e domosdoshme për përgatitjen e balonave.*
4. *Miri bashkë me motrën e tij, filluan përgatitjen e balonave.*
5. *Vëlla e motër, ua shpërndanë balonat moshatarëve të tyre.*
6. *Në ditën e balonave, 31 balona u ngritën në ajër nga fëmijët.*
7. *Miri i rritur tashmë, piktor, në ditën e balonave ngre balona me nipërit e mbesat e tij.*

*Tregohet përmbajtja nga disa nxënës/e, mbi bazën e fjalive përmbledhëse rreth tregimit.

- **Veprimtaria e katërt**

Mendo-nxirr mesazhin: Nxiten nxënësit të punojnë në grupe për të nxjerrë mesazhin e tregimit:

Pasioni, këmbëngulja dhe bashkëpunimi, bën që edhe ëndrrat më të largëta të bëhen realitet.

- **Veprimtaria e pestë**

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit/et të japin mendimet e tyre rreth pyetjeve të dhëna në libër që kanë të bëjnë me pëlqimet e tyre për ndërtimin e balonave dhe të ndajnë me shokët e shoqet e tyre, përvojat e tyre në lidhje me festimin e ditës së balonave.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetritin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e tregimit në mënyrë të rrjedhshme dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;
-mendimet dhe gjykimet e dhëna rreth personazheve dhe veprimeve të tyre, duke i ilustruar me pjesë nga tregimi;

-ndërtimin e fjalive përmbledhëse rreth tregimit;

-tregimin e përmbajtjes mbi bazën e fjalive përmbledhëse të tregimit;

-formulimin e mesazhit që përcjell tregimi;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimit të tij/saj, rreth ëndrrës së Mirin të vogël;


-gjykimin se si mund të jetësohet një ëndërr;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj në fletore pjesën që të pëlqen më shumë duke treguar edhe arsyet e përzgjedhjes.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Shkruajmë Një ditë e veçantë(ora I)		Situata e të nxëniet Shkruajmë një tregim bazuar në një ngjarje të vërtetë.	
Rezultatet e të nxëniet Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> tregon karakteristikat që ka hyrja, zhvillimi dhe mbyllja e tregimit; u përgjigjet pyetjeve të bëra në fazën e hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes të tregimit për ditën e balonave, duke përzgjedhur alternativat e përshtatshme; shkruan tregimin sipas strukturës hyrja-zhvillimi-mbyllja, duke pasur parasysh karakteristikat që kanë ato; respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -ditë e veçantë; -tregim; -hyrje; -zhvillim; -mbyllje; -personazhe; -ngjarje.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -skema e ndërtimit të tregimit; -foto të nxënësve/eve kur kanë dalë në ditën e balonave; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore; -mjedisi.	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <ul style="list-style-type: none"> Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -harta e konceptit; -shkrim i drejtuar; -shkrim i lirë; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. <p>Veprimtaritë e nxënësve</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaria e parë <i>Harta e konceptit:</i> Nxiten nxënësit/et, të tregojnë se ç' dinë për ndërtimin e tregimeve. Ata/ato punojnë në grupe, për të plotësuar hartën e konceptit. <div style="text-align: center;">  </div> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaria e dytë Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit. <i>Shkrim i drejtuar:</i> Ushtrimi 1. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të shkruajnë një tregim për ditën e balonave duke iu përgjigjur pyetjeve të bëra në fazën e hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes së tregimit, duke përzgjedhur alternativat e përshtatshme të dhëna në tekst. Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim të punës, nxiten nxënësit/et të lexojnë përgjigjet e pyetjeve sipas hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes së tregimit. Veprimtaria e tretë <i>Shkrim i lirë:</i> Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et, të shkruajnë të plotë tregimin për ditën e balonave, sipas strukturës hyrja-zhvillimi-mbyllja. Nxënësit/et, punojnë individualisht në fletore. Në përfundim të punës, nxiten nxënësit/et të lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime të thjeshta drejtshkrimore. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. 			

Një variant i plotë i tregimit, mund të jetë si më poshtë:

Një ditë e veçantë

Ishte data 21 prill, dita e balonave. Unë bashkë me shokët dhe shoqet e klasës kishim shkuar me gëzim në shkollë.

Mësuesja na kishte porositur të merrnim mjete me vete. Do t'i përgatitnim vetë balonat dhe do të dilnim në oborrin e shkollës për t'i lëshuar ato.

Mësuesja na ndau në grupe me nga pesë nxënës. Secili kishte detyrën e tij në grup.

Unë bashkë me Edlirin, do të bëja skeletin e balonës me kallama të prerë hollë. Për t'i dhënë formën gjeometrike e për t'i lidhur me fije kallamat, do të na ndihmonte dhe Zana, ndërsa Arjana, do të priste letrat me ngjyra dhe bashkë me Zanën, do të bënin ngjitjen e tyre. Bishtin e balonës me letra shumëngjyrëshe e mori përsipër Jeta. Të gjithë grupet, pasi mbaruan balonën e tyre, nxituan për në oborrin e shkollës. Njëra balonë dukej më e bukur se tjetra. Ne i kalonim dorë më dorë. Me një komandë të mësueses i lëshuam në qiell. Të gjithë me kokën lart, shikonim si fluturonin ato lart e më lart. Për një çast, dëshirova të isha balonë dhe të fluturoja dhe unë në qiellin e kaltër.

• **Vlerësimi bëhet për:**

- tregimin e karakteristikave që ka hyrja, zhvillimi dhe mbyllja e tregimit;
- përgjigjet e pyetjeve të bëra në fazën e hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes të tregimit për ditën e balonave, duke përzgjedhur alternativat e përshtatshme;
- shkrimin e tregimit sipas strukturës hyrja-zhvillimi-mbyllja, duke pasur parasysh karakteristikat që ato kanë;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Shkruajmë Një ditë e veçantë(ora II)		Situata e të nxënës Shkruajmë një tregim të shkurtër për një ndodhi personale.	
Rezultatet e të nxënës Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon në një tregim hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen, duke treguar edhe veçoritë e tyre; • shkruan një tregim për një ndodhi personale sipas strukturës hyrja-zhvillimi-mbyllja; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -tregim; -hyrje; -zhvillim; -mbyllje; -personazhe; -ngjarje.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -skema e ndërtimit të tregimit; -fisha me tregime të shkruara; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore; -mjedisi.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

- **Metodologjia:**

-diskutim;

-shkrim i lirë;

-konkurs;

-punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

Veprimtaritë e nxënësve/eve

- **Veprimtaria e parë**

Diskutim: Punë në grupe: Mësuesi/ja u shpërndan fisha çdo grupi në të cilat ka shkruar nga një tregim.

Udhëzohen nxënësit/et ta lexojnë atë dhe të dallojnë hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e tregimit, duke treguar karakteristikat e secilës prej tyre.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e dytë**

Shkrim i lirë: Ushtrimi 2. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të shkruajnë një tregim për një ndodhi personale ku të zgjedhin një nga temat e dhëna: *Një shëtitje në park, Miq pushimesh, Një udhëtim i paharruar*, sipas strukturës hyrja-zhvillimi-mbyllja.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.

Në përfundim të punës, nxiten nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime të thjeshta drejtshkrimore.

- **Veprimtaria e tretë**

Konkurs: Një juri e përbërë nga mësuesi/ja dhe 2 nxënës/e, përzgjedhin shkrimet më të mira, duke i vlerësuar ato me pikë.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-dallimin në një tregim të hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes, duke treguar edhe veçoritë e tyre;

-shkrimin e një tregimi për një ndodhi personale sipas strukturës hyrja-zhvillimi-mbyllja;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;

-vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj një tregim për një ndodhi personale ku të zgjedhësh një temë tjetër nga ato të ushtrimit 2, sipas strukturës hyrja-zhvillimi-mbyllja.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Kryefjala (ora I)		Situata e të nxënët Manipulime me fjalë efjali për përcaktimin e kryefjalës.	
Rezultatet e të nxënët Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • identifikon kryefjalën në fjali; • përdor pyetjet <i>Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?</i> për të gjetur kryefjalën; • vë në dukje se kryefjala nuk gjendet gjithnjë në fillim të fjalisë; • tregon me se shprehet kryefjala (emër, përemër, numëror, një grup fjalësh); • gjen kryefjalën e nënkuptuar në fjali dhe e rishkruan fjalinë duke e shprehur kryefjalën; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij /saj; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -kryefjalë; -pyetjet <i>Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?</i> -pozicion në fjali; -kryefjalë e nënkuptuar.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me pyetjet për të gjetur kryefjalën; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim për njohuritë paraprake;
 - lexo-përmblihd në dyshe;Harta e konceptit;
 - rishikim në dyshe;
 - mendo-zbulo;
 - shkëmbe një problemë;
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

*Diskutim për njohuritë paraprake:*Nxënësit/et orientohen që në dyshe të krijojnë nga një fjali, t'i shkruajnë në fleta dhe t'i lexojnë ato.

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve që në fjalitë e tyre të tregojnë kryefjalën.

Nxënësit/et duke punuar në dyshe nënvizojnë kryefjalën në fjali dhe i tregojnë ato para klasës.


Mësuesi/ja nxit nxënësit/et, të kujtojnë se çfarë dinë për kryefjalën, duke lexuar dhe diskutuar rubrikën „Kujtoj“.

- **Veprimtaria e dytë**

Lexo- përmblihd në dyshe; *Harta e konceptit:*

Nxënësit/et lexojnë dhe përmbledhin në dyshe njohuritë e dhëna në rubrikën „Mbaj mend“ rreth kryefjalës.

Në grupe, ata/ato plotësojnë hartën e konceptit për kryefjalën, të cilën e përfaqësuesit/et e grupeve, e prezantojnë para klasës.



Nxiten nxënësit/et, të japin shembuj të fjalive ku kryefjala mund të shprehet me emër, përemër, numëror, ose një grup fjalësh.

- **Veprimtaria e tretë**

Rishikim në dyshe: Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 1, ku do të lidhin me shigjetë pjesët e fjalive, sipas shembullit të dhënë për të krijuar fjalitë dhe do të nënvizojnë kryefjalën nëçdo fjali. Ata/ato shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, vlerësojnë njëri-tjetrin dhe diskutojnë ushtrimin me gjithë klasën.

*Më tej, vazhdohet edhe me ushtrimin 2, ku do të rishkruajnë fjalitë duke u ndryshuar vendin kryefjalëve, pa prishur kuptimin e fjalive.

- **Veprimtaria e katërt**

Mendo-zbulo: Nën drejtimin e mësuesit/es, shqyrtohen rastet e fjalive ku kryefjala është e nënkuptuar.

*Shembull:*Besoj që ke të drejtë. (Unë besoj që ke të drejtë.)

Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 3, ku do të gjejnë kryefjalën e nënkuptuar në fjalitë e dhëna dhe do të rishkruajnë fjalitë duke e shprehur kryefjalën.

Zhvillohet një diskutim në klasë rreth ushtrimit nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e pestë**

Shkëmbe një problemë: Nxënësit/et do të punojnë në grupe. Secili grup do të shkruajë në fleta fjali dhe do t'ia japë grupit fqinjë për të përcaktuar kryefjalën, duke treguar pyetjen me të cilën gjendet, me se shprehet ajo dhe pozicionin e saj në fjali.

Nxiten grupet të vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**
 - identifikimin e kryefjalës në fjali;
 - përdorimin e pyetjeve Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat? për të gjetur kryefjalën;
 - gjetjen e kryefjalës së nënkuptuar në fjali dhe rishkrimin e fjalisë duke e shprehur kryefjalën;
 - paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
 - demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
 - respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
 - vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.
- **Detyrë shtëpie** Ushtrimi 4

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Kryefjala (ora II)		Situata e të nxëniet Manipulime me fjalë e fjali për përcaktimin e kryefjalës.	
Rezultatet e të nxëniet Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • identifikon kryefjalën në fjali, duke treguar se me se shprehet ajo; • shkruan fjali duke përdorur grupe fjalësh në rolin e kryefjalës; • plotëson fjalinë duke gjetur kryefjalën e përshtatshme për të; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj rreth përcaktimit të kryefjalës në fjali; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -kryefjalë; -pyetjet <i>Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?</i> -pozicion në fjali; -kryefjalë e nënkuptuar.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me pyetjet për të gjetur kryefjalën; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim; -dallos-diskuto; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi fillon me leximin dhe diskutimin rreth detyrave të shtëpisë, që nxënësve/eve iu është dhënë në orën e mëparshme. Nxënësit/et lexojnë fjalitë të ndara në dy grupe sipas kërkesës: G. 1 fjalitë që e kanë të shprehur kryefjalën G. 2 fjalitë që e kanë të nënkuptuar kryefjalën. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Dallo-diskuto:</i> Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të punojnë në dyshe. Mësuesi/ja shpërndan fisha ku janë shkruar fjali të ndryshme. Udhëzohen nxënësit/et të dallojnë në fjali kryefjalën, duke bërë pyetjen përkatëse për gjetjen e saj. Nxiten nxënësit/et të tregojnë me se shprehet ajo dhe çfarë vendi zë në fjali. Disa dyshe prezantojnë punën e tyre para klasës. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Shkrim i drejtuar:</i> Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 5, ku do të krijojnë fjali duke përdorur grupet e fjalëve të dhëna si kryefjalë. Më pas punohet ushtrimi 6, ku nxënësit/et do të plotësojnë fjalitë e dhëna me një kryefjalë të përshtatshme. Pas përfundimit të punës nxiten nxënësit/et, të lexojnë fjalitë dhe të diskutojnë rreth tyre. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Punë në grupe:</i> Nxënësit/et në 6 grupe, do të punojnë ushtrimin 7. Sipas kërkesës. ata/ato do të nënvizojnë në tregimin “Si gjithë të tjerët” kryefjalët dhe do të tregojnë se me se janë shprehur ato. <i>Grupi 1,2 do të punojë me paragrafin e parë të tregimit.</i> <i>Grupi 3,4 do të punojë me paragrafin e dytë të tregimit.</i> <i>Grupi 5,6 do të punojë me paragrafin e tretë të tregimit.</i> Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e tyre. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimibëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -identifikimin e kryefjalës në fjali, duke treguar se me se shprehet ajo; -shkrimin e fjalive duke përdorur grupe fjalësh në rolin e kryefjalës; -plotësimin e fjalive duke gjetur kryefjalën e përshtatshme për të; -paraqitjen dhe komunikimin lirshëm dhe saktë të mendimeve të tij /saj rreth përcaktimit të kryefjalës në fjali; -bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre; -demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve; -vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve. • Detyrë shtëpie Krijoni një tekst të shkurtër me 7-8 fjali të thjeshta me temë „Vjeshta“. Nënvizoni kryefjalën në fjali, tregoni me se shprehet. 			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Si gjithë të tjerët (ora I)		Situata e të nxënësve Nxënësit/et tregojnë rreth veprimtarisë që kanë zhvilluar bashkë me mësuesin/en për të ndihmuar fëmijët me nevoja të veçanta.	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tregimin duke mbajtur shënime për fjalët dhe fjalitë që i duken më interesante; • jep parashikimet e veta në lidhje me vazhdimin e tregimit; • tregon llojin e pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj; • komenton atmosferën që u krijua nga vizita e shokëve të Besit; • nxjerr mesazhin që përcjell tregimin; • gjykon rreth përkushtimit të djalit ndaj vëllait të sëmurë; • vlerëson sensibilizimin që i bënë fëmijët rastit të vëllait të Kelit (Besit), humanizmin, solidaritetin e fëmijëve me djalin e sëmurë; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -sëmundje e rëndë; -fëmijë me nevoja të veçanta; -janë gjithë merak; -karrocë me rrota; -dhurata të vogla; -atmosferë feste.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, tabakë letre, fletore, lapustilë, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore; -vendimmarrja morale.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -bisedë; -veprimtari e leximit të drejtuar; -hulumtim; rishikim në dyshe; -mendo-nxirr mesazhin; -ditari dypjesësh; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Nxënësit/et së bashku me mësuesin/en kanë hartuar një projekt, i cili synonte ndihmën ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta. Disa ditë më parë, ata kanë zbatuar projektin. Në këtë orë mësimi, ata do të tregojnë për ndihmën që kanë dhënë fëmijëve me nevoja të veçanta. Nxiten nxënësit/et të flasin rreth veprimtarisë së zhvilluar. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Veprimtari e leximit të drejtuar:</i> Nxënësit/et njihen me titullin e tregimit “Si gjithë të tjerët” dhe autoren e saj Mimoza Gjokutaj. Nxënësit/et njihen me jetën dhe krijimtarinë e Mimoza Gjokutaj. *Vëzhgim dhe koment i ilustrimit në libër nga nxënësit/et. *Lexim me ndalesa i tregimit nga nxënësit/et. Më pas iu përgjigjen pyetjeve të bëra nga mësuesi/ja rreth secilës pjesë. -Nisur nga titulli dhe figura, për çfarë mendoni se bën fjalë kjo pjesë? Ndalesa I Keli ka një vëlla.... deri te t'i qëndrojë afër vëllait. Pyetje: -Si ishte vëllai i Kelit? -Pse prindërit e Kelit janë në merak për djalin e tyre të vogël? -Çfarë e këshillojnë ata Kelin në lidhje me vëllanë e tij? -Si mendoni se do të vazhdojë pjesa? Ndalesa II Keli vazhdon.... deri tetë familjes. Pyetje:-A mërzitet Keli me vëllanë e tij? Çfarë mëson ai atij? 			

Ndalea III Një ditë.... deri tedo të zgjidhej.

Pyetje:-Pse e qortoi mësuesja Kelin?

-Çfarë i tregoi ai mësueses?

-Çfarë kërkese i bëri mësuesja Kelit për të vëllanë?

Ndalea IV Sapo u kthye..... deri te... e pushtoi të gjithin.

Pyetje:-Çfarë lajmi dha Keli në shtëpi dhe si u prit ai nga prindërit dhe Besi?

Ndalea V Pas disa ditësh..... deri te... një lumë falënderimesh.

-Ç'ngjarje ndodhi pas disa ditësh që do t'i ndryshonte jetën Besit?

-Çfarë po sillnin fëmijët?

-Si ua shprehën prindërit e Kelit mirënjohjen fëmijëve?

Ndalea VI Fëmijët e hipën Besin.... deri në fund.

-Cila ishte dhurata e fëmijëve qëe lumturoi më shumë Besin?

-Si mendoni, pse do të ndryshonte tashmë jeta e Besit?

-Si u ndjetë në fund të leximit të kësaj pjese?

*Nxiten nxënësit/et lexojnë në heshtje tregimin.

*Nxënësit/et tregojnë llojin e pjesës, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj(tregim).

*Lexim i tregimit zinxhir nga nxënësit/et.

• **Veprimtaria e tretë**

Hulumtim, Rishikim në dyshe: Punohet rubrika“Lexoj dhe kuptoj“. Nxiten nxënësit/et të lexojnë fjalitë e shkruara rreth tekstit dhe t'i rendisin ato sipas radhës së kryerjes së veprimeve.

*Nxënësit/et do të dallojnë fjalitë përmbledhëse të tregimit që i takojnë hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes, duke i ngjyrosur me ngjyrat e rekomanduara në libër.

Në përfundim, ata/ato shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Zhvillohet një diskutim në klasë rreth detyrës nën drejtimin e mësuesit/es.

*Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e tregimit, duke u mbështetur te fjalitë përmbledhëse.

• **Veprimtaria e katërt**

Mendo-nxirr mesazhin: Punohet rubrika“Analizoj“.Nxënësit/et plotësojnë analizën e bërë në tekst, duke përdorur fjalë dhe shprehje që kompletojnë kuptimin e fjalive.

Nxiten nxënësit/et, që në grupe të nxjerrin mesazhin që përcjell tregimi.

Mesazhi: *Solidariteti me njerëzit në nevojë, ua bën atyre jetën e lumtur duke i integruar në shoqëri.*

• **Veprimtaria e pestë**

*Ditari dypjesësh.*Nxënësit/et në grupe, do të plotësojnë ditarin dypjesësh ku do të japin komentin e tyre rreth fragmentit.

Fragmenti	Komenti
<p>Në orën 2 pasdreke, u dukën para pallatit disa fëmijë. Të gjithë mbanin në duar dhurata të vogla si: lule,çokollata, etj... Në fund të grupit, qëndronin dy nxënës që shtynin një karrocë me rrota, mbi të cilin kishin vendosur njëçantë shkolle të mbushur me libra. Kur hynë në shtëpinë e Kelit, prindërit u derdhën një lumë falënderimesh.</p>	<p>Shokët e klasës së Kelit arritën që ta zgjidhin rastin e Besit duke siguruar karrocën e nevojshme, të cilën ia sollën në shtëpi bashkë me çantën e shkollës dhe dhurata të tjera. Të gjithë ishin të lumtur, por posaçërisht prindërit e Besit të cilët „derdhën një lumë falënderimesh“.</p>

Nxënësit/et dëgjojnë dhe vlerësojnë komentet e shokëve/shoqeve të tyre.

• **Vlerësimibëhet për:**

-leximin e tregimit duke mbajtur shënime për fjalët dhe fjalitëqë u duken më interesante;

-parashikimet e dhëna në lidhje me tregimin;

-tregimin e llojit të pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj;

-grykimin rreth përkushtimit të djalit ndaj vëllait të sëmurë;


-komentimin e atmosferës që u krijua nga vizita e shokëve të Besit;

-formulimin e mesazhit që përcjell tregimi;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;


-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

• **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Si gjithë të tjerët (ora II)		Situata e të nxënët Bisedë me nxënësit rreth temës së solidaritetit njerëzor.	
Rezultatet e të nxënët Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tregiminrrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • dallon personazhet e tregimit duke vënë në dukje karakteristikat e tyre; • tregon përmbajtjen sipas rrjedhës së ngjarjes në tregim; • gjykon rreth përkushtimit të djalit ndaj vëllait të sëmure; • vlerëson gjestin humanitar të shokëve të klasës së Kelit ndaj vëllait të tij të sëmure; • ndan me të tjerët përvojat e tij kur ka pasur rastin të ndihmojë njerëz me nevoja të veçanta, duke treguar se si ka vepruar; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -sëmundje e rëndë; -fëmijë me nevoja të veçanta; -janë gjithë merak; -karrocë me rrota; -dhurata të vogla; -atmosferë feste;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi,lapustilë, fletore, tabakë letre,fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore; -vendimmarrja morale.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -bisedë; -diskutim; -harta e ngjarjes; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë: Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. <i>Bisedë:</i> Zhvillohet një bisedë me nxënësit/et rreth temës së ndihmës, mbështetjes dhe solidaritetit ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta. Nxiten nxënësit/et të sjellin shkurtimisht përvojat e tyre në familje, komunitet dhe shkollë, si edhe nga ato që kanë lexuar, që kanë parë në filma, etj... • Veprimtaria e dytë: Lexohet tregimi zinxhir nga të gjithë nxënësit/et. <i>Diskutim:</i> Nxiten nxënësit/et që në grupe të dallojnë personazhet në tregim dhe të diskutojnë rreth veprimeve të tyre.Nxënësit/et, në fillim diskutojnë brenda grupit, më pas me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es. • Veprimtaria e tretë <i>Harta e ngjarjes:</i>Nxënësit/et paraqesin ngjarjen me anë të hartës së ngjarjes, e cila është përgatitur më parë nga mësuesja në fletë A4. <div style="text-align: center;">  </div> <p>*Nxënësit/et tregojnë përmbajtjen sipas rrjedhës së ngjarjes.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Bashkëbisedim:</i> Punohet rubrika“Reflektoj“. Me nxënësit/et zhvillohet një bashkëbisedim ku ata ndajnë përvojat e tyre me të tjerët kur kanë pasur rastin të ndihmojnë fëmijë me nevoja të veçanta, duke treguar si kanë vepruar. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. 			

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -leximin e tregimit rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; -dallimin e personazheve të tregimit duke vënë në dukje karakteristikat e tyre; -tregimin e përmbajtjes sipas rrjedhës së ngjarjes; -grykimin rreth përkushtimit të djalit ndaj vëllait të sëmurë; -vlerësimin e gjestit humanitar të shokëve të klasës së Kelit, ndaj vëllait të tij të sëmurë; -ndarjen me të tjerët të përvojave të tij/saj, kur ka pasur rastin të ndihmojë njerëz me nevoja të veçanta, duke treguar se si ka vepruar; -paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj; -vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit. • Detyrë shtëpie Shkruaj përmbajtjen e tregimit në mënyrë të përmbledhur.

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Lulet e limonit (ora I)		Situata e të nxënit Bisedë rreth veprimtarisë së zhvilluar nga nxënësit/et për mbjelljen e një druri limoni në oborrin e shkollës.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tregimin duke mbajtur shënime për fjalët dhe fjalitëqë i duken më interesante; • i përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit; • tregon llojin e pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj; • dallon kohën e lulëzimit të limonit dhe të pjekjes së frutave të tij; • diskuton rreth dialogut tëgjyshes me Dorinën për kushtet e rritjes së limonit në ballkon dhe në natyrë; • vlerësonkujdesin e vajzës për bimëne limonit; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • vlerëson përpyjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -Dorina; -gjyshja; -lule limoni; -petale; -kanarina; -ballkon; -kujdes. 	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -foto, vizatime të pemës së limonit; -fakte dhe kuriozitete për limonin; -mjete shkrimi,lapustilë, fletore, tabakë letre,fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> -të drejtat e njeriut; -mjedisi. 	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -bisedë; -stuhi mendimesh; -veprimtari e leximit të drejtuar; -rishikim në dyshe; -hulumtim; -mendo-diskuto; -debat; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Disa ditë më parë,nxënësit/et e klasës kanë mbjellë njëdrulimoni në oborrin e shkollës.Nxiten nxënësit/et, të tregojnë rreth kësaj veprimtarie. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Stuhi mendimesh:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të tregojnë se çfarë dinë për limonin. Mendimet e tyre i paraqet me anë të një kllasteri në tabelë. 			



• **Veprimtaria e tretë**

Veprimtari e leximit të drejtuar: Nxënësit/et njihen me titullin e tregimit “Lulet e limonit”.

*Lexim me ndalesa i tregimit nga nxënësit/et. Më pas iu përgjigjen pyetjeve të bëra nga mësuesi/ja rreth secilës pjesë, duke u kujdesur të punohen edhe pyetjet e rubrikës “Lexoj dhe kuptoj”.

-Nisur nga titulli dhe figura, për çfarë mendoni se bën fjalë kjo pjesë?

Ndalesa I Gjyshe! Gjyshe!... deri te... i kujtuan fshatin.

Pyetje: -Pse u çudit Dorina kur doli në ballkon?

-Ku u ul gjyshja e Dorinës?

-Çfarë i kujtonin gjyshes lulet e limonit dhe këngët e kanarinës?

Ndalesa II Vajza u ul... deri te plot lule e kokrra.

Pyetje: -Përse e pyeti Dorina gjyshen?

-Nga e kishin sjellë limonin në ballkonin e Dorinës?

-Kush e kishte sjellë atë?

-Si ishte kujdesur xhaxhi Ahmeti për transportin e limonit?

Ndalesa III Dorina zbriti nga prehri... deri teMë ndihmo edhe ti gjyshe!

Pyetje: -Cila ishte kërkesa e Dorinës për limonin?

-Pse Dorina donte ta fuste në dhomën e saj natën limonin?

-Ç’përgjigje i dha gjyshja Dorinës? A mund të qëndronte limoni i tyre në ballkon natën?

-Si do të kujdeseshin ato për limonin kur të ishte shumë ftohtë?

-Pse vendosën ato t’i qepnin limonit një pallto prej plastmase?

Ndalesa IV -Të ndihmon gjyshjaderi në fund.

-Çfarë propozimi i bëri gjyshja Dorinës?

-Me çfarë i përcolli kanarina gjyshen dhe vajzën?

-Çfarë arome ndihej në ballkon?

*Nxiten nxënësit/et lexojnë në heshtje tregimin.

*Lexim i tregimit zinxhir nga nxënësit/et.

• **Veprimtaria e katërt**

Hulumtim: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et punojnë individualisht për të renditur saktë fjalitë përmbledhëse sipas radhës së kryerjes së veprimeve.

Ata/ato shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Zhvillohet një diskutim në klasë rreth ushtrimit, nën drejtimin e mësuesit/es.

*Nxiten nxënësit/et të tregojnë me fjalët e tyre ngjarjen që përmbledh secila fjali.

• **Veprimtaria e pestë**

Mendo-diskuto: Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me llojin e tregimit(real) dhe të tregojnëku duket në tregim se kur kishin çelur lulet e limonit.

• **Veprimtaria e gjashtë**

Debat: Nxënësit/et vendosen në skajet e një vije imagjinare sipas parapëlqimeve që kanë, për të mbajtur një limon, apo lule të ndryshme në ballkon.

Secili pozicionohet në skajet, jep argumentet e tij/saj gjatë debatit. Ata/ato ftojnë njëri-tjetrin t’u bashkohen argumenteve dhe të ndryshojnë pozicionin.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

• **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e tregimit duke mbajtur shënime për fjalët dhe fjalitë që i duken më interesante;

-përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;


-tregimin e llojit të pjesës që lexon, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;

-vlerësimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

• **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Lulet e limonit (ora II)		Situata e të nxënit Krijim i një posteri me temë“Mjedis i gjelbëruar, jetë e shëndetshme”.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përgatit një poster për gjelbërimin e mjedisit; • lexon dhe interpreton në role tregimin; • gjykon rreth personazheve mbi bazën e veprimeve të tyre në tregim; • tregon përmbajtjen e tregimit sipas rrjedhës së ngjarjes; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -Dorina; -gjyshja; -lule limoni; -petale; -kanarina; -kujdes; -ballkon.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -foto, vizatime të pemës së limonit; -fakte dhe kuriozitete për limonin; -pamje të mjediseve të gjelbëruara; -mjetë shkrimi,lapustilë, fletore, tabakë letre,fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -shkencat e natyrës; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -mjedisi.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -krijim i një posteri; -lexim në role; -diskutim; -harta e ngjarjes; -bashkëbisedim; -dramatizim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë, ku nxënësit/et tregojnë për shërbimet që ka nevojë një filiz i pemës së limonit që të rritet. <i>Veprimtari: Krijim i një posteri:</i> Mësuesi/ja ka porositur nxënësit/et disa ditë më parë, të grumbullojnë materialet e duhura për të përgatitur një poster me temë:“Mjedis i gjelbëruar, jetë e shëndetshme“. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të përgatisin posterin. Prezantohetposteri duke dhënë mesazhe sensibilizimi për shtimin e sipërfaqeve të gjelbëruara, për të pasur një jetë të shëndetshme. • Veprimtaria e dytë <i>Lexim në role:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë në role tregimin. Ndahen rolet nëçdo grup (Dorina, gjyshja, autori). • Veprimtaria e tretë <i>Diskutim:</i> Nxiten nxënësit/et, që në grupe të diskutojnë rreth veprimeve të personazheve kryesore të tregimit. • Veprimtaria e katërt Nxënësit/et paraqesin në grupe ngjarjen me anë të hartës së ngjarjes, e cila është përgatitur më parë nga mësuesja në fletë A4. <div style="text-align: center; margin: 10px 0;">  </div> <p>*Tregohet përmbajtja nga disa nxënës/e, sipas organizuesit grafik „Harta e ngjarjes“.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e pestë <i>Bashkëbisedim:</i> Punohet rubrika“Reflektoj“. Me nxënësit/et zhvillohet një bashkëbisedim ku ata/ato tregojnë për kujdesin që u kushtojnë bimëve të mbjella në vazo. 			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e gjashtë <i>Dramatizim:</i> Nxënësit/et në grupe bëjnë dramatizimin e tregimit. Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin për interpretimin. *Nxënësit/et lexojnë fakte dhe kuriozitete që kanë sjellë për agrumet në përgjithësi dhe limonin në veçanti. • Vlerësimi bëhet për: -përgatitjen e një posteri për gjelbërimin e mjedisit; -leximin dhe interpretimin në role të tregimit; -gjakimin rreth personazheve mbi bazën e veprimeve të tyre në tregim; -tregimin e përmbajtjes sipas rrjedhës së ngjarjes; -paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj; -vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit. • Detyrë shtëpie Shkruaj përmbajtjen e tregimit në mënyrë të përmbledhur.

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Kallëzuesi (ora I)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për përcaktimin e kallëzuesit.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • identifikon kallëzuesin në fjali; • përdor pyetjen ç ‘bën?’ për të gjetur kallëzuesin; • vë në dukje se kallëzuesi shprehet me folje; • plotëson fjalitë me kallëzuesin e përshtatshëm; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -kallëzues; -pyetjaçfarë bën? -folje.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me pyetjet për të gjetur kallëzuesin; -fisha me fjali; -mjete shkrimi,lapustilë, fletore, tabakë letre,fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim për njohuritë paraprake; -harta e konceptit; -rishikim në dyshe; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i>Nxënësit/etudhëzohen, që në dyshe, të krijojnë nga një fjali dhe t’i shkruajnë në fleta. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve, që në fjalitë e tyre të tregojnë kallëzuesin. Disa dyshe prezantojnë punën e tyre. *Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të kujtojnë se çfarë dinë për kallëzuesin, duke lexuar dhe diskutuar rubrikën „Kujtoj“. • Veprimtaria e dytë <i>Punë në grupe:</i> <i>Harta e konceptit:</i>Nxiten nxënësit/et të punojnë në grupe, për të përmbledhur njohuritë e tyre rreth kallëzuesit.Ata/ato, në tabakë letre, krijojnë hartën e konceptit për kallëzuesin dhe e prezantojnë para klasës. <p>Gjendet me pyetjen Çfarëbën? ← Kallëzuesi → Është fjalë kryesore në fjali.</p> <p>Tregon se çfarë bën kryefjala. ↓ Shprehet me folje.</p>			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Rishikim në dyshe:</i> Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 1, ku do të nënvizojnë kallëzuesit në fjalitë e dhëna, duke treguar edhe pyetjet e bëra për çdo rast. Ushtrimin 2, ku do të plotësojnë fjalitë e tekstit të dhënë me një kallëzues të përshtatshëm. Ata/ato shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, vlerësojnë njëri-tjetrin dhe diskutojnë rreth ushtrimeve me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es. • Veprimtaria e katërt <i>Shkëmbe një problemë:</i> Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të punojnë në grupe. Ata/ato do të shkruajnë në tabakë letre, 4 fjali dhe do t'i shkëmbejnë më grupin fqinjë. Orientohen nxënësit/et, të dallojnë kryefjalën dhe kallëzuesin. Ata/ato diskutojnë në grup dhe nënvizojnë me ngjyra të ndryshme kryefjalën dhe kallëzuesin. Përfaqësuesit/et e secilit grup, prezantojnë punën e grupit. Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e shoqeve të tyre. • Vlerësimi bëhet për: -identifikimin e kallëzuesit në fjali; -përdorimin e pyetjes <i>ç' bën?</i> për të gjetur kallëzuesin; -plotësimin e fjalive me kallëzuesin e përshtatshëm; -paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj; -demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup; -vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve. • Detyrë shtëpie Shkruaj 5 fjali ku të nënvizosh kallëzuesin e shprehur me folje.
--

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Kallëzuesi (ora II)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për përcaktimin e kallëzuesit.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • gjen kallëzuesin në fjali, duke përdorur pyetjen <i>çfarë bën?</i> • vë në dukje se kallëzuesi shprehet me folje; • shkruan një tekst të shkurtër me një temë të caktuar dhe nënvizon kryefjalën dhe kallëzuesin në fjalitë e tij; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • vlerëson punën e shoqeve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -kallëzues; -pyetja: <i>çfarë bën?</i> -folje.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me pyetjet për të gjetur kallëzuesin; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkrim i lirë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë Mësimi fillon me leximin dhe diskutimin rreth detyrave të shtëpisë, që nxënësve/eve iu janë dhënë në orën e mëparshme. Nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara prej tyre dhe tregojnë kallëzuesit në fjali. • Veprimtaria e dytë <i>Diskutim:</i>Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të punojnë në grupe. Ata/ato, dotë lexojnë fjalitë e shkruara në fishat e dhëna prej saj dhe do të dallojnë kryefjalën dhe kallëzuesin, duke bërë pyetjet përkatëse. Nxënësit/et diskutojnë me njëri-tjetrin në grup. Pas përfundimit të punës, përfaqësuesit e grupeve, prezantojnë punën e tyre. 			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Rishikim në dyshe:</i> Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 3, ku do të plotësojnë fjalitë e dhëna duke përdorur për çdonjëren kallëzues të ndryshëm. Pas përfundimit të punës, ata shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, vlerësojnë njëri-tjetrin dhe diskutojnë me gjithë klasën. • Veprimtaria e katërt <i>Shkrim i shpejtë:</i> Nxënësit/et do të punojnë individualisht një krijim me 5-6 fjali me temë “Mësuesja ime”, ku do të nënvizojnë kryefjalën dhe kallëzuesin në fjalitë e tekstit. Pas përfundimit të punës, disa nxënës/e lexojnë krijimet e tyre, duke treguar kryefjalën, kallëzuesin, në secilën fjali. Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit. • Vlerësimi bëhet për: -dallimin e kallëzuesit në fjali duke përdorur pyetjen <i>çfarë bën?</i> -shkrimin e një teksti të shkurtër me një temë të caktuar, duke nënvizuar kryefjalën dhe kallëzuesin në fjalitë e tij; -paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimit të tij/saj; -demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve; -vlerësimin të punës së shokëve e të shoqeve. • Detyrë shtëpie Shkruaj 5 fjali. Nënvizoj në to kryefjalën dhe kallëzuesin.


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Teatër në shkollë (ora I)		Situata e të nxënit Nxënësit/et shohin disa sekuenca nga teatri „Borëbardha dhe shtatë xhuxhat” dhe tregojnë se çfarë dinë për teatrin.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tregimin rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit; • tregon përmbajtjen e tregimit me ndihmën e pyetjeve; • nxjerr mesazhin që përcjell tregimi; • lidh tregimin me ngjarje nga jeta e tij/saj, kur ka luajtur një rol në një pjesë teatrore; • vlerëson dashamirësinë e Ajlës për t’i ofruar shoqes rolin e Borëbardhës; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalët kyçe: -teatër; -rol; -short; -Borëbardha dhe shtatë xhuxhat; -fustan princeshe; -interpretim; -aktor; -skenë; -regjisor; -skenografi; -protagonist; -kostume.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -videoprojektor; -pjesa teatrore „Borëbardha dhe shtatë xhuxhat“ -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - bisedë;
 - ndërveprim me tekstin;
 - marrëdhënie pyetje-përgjigje;
 - mendo-nxirr mesazhin;
 - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

Veprimtaritë e nxënësve/eve

- **Veprimtaria e parë**

Mësuesi/ja paraqet një video të shkurtër (në pamundësi foto), ku interpretohet pjesa teatrale „Borëbardha dhe shtatë xhuxhat“. Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të diskutojnë përvideon/foton dhe të tregojnë se çfarë dinë ata për teatrin. Përgjigjet e nxënësve/eve, mësuesi/ja i paraqet në tabelë.



*Mësuesi/ja nxit diskutimin:

- Po ju a keni luajtur ndonjë pjesë teatrale?
- Ç’rol keni luajtur?

- **Veprimtaria e dytë**

Ndërveprim me tekstin: Nxënësit/et njihen me titullin e pjesës “Teatri në shkollë”.

- *Nxënësit/et vëzhgojnë dhe komentojnë ilustrimin në libër.
- *Nxiten nxënësit/et të lexojnë pjesën në paragrafë në heshtje.
- *Ata/ato nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më të rëndësishme.
- *Punohet fjalori me fjalët e reja dhe nxënësit/et ndërtojnë fjali.
- *Nxënësit/et tregojnë llojin e tekstit (tregim) duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij.

- **Veprimtaria e tretë**

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”.

- Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve rreth tregimit.
- Cilët janë personazhet e këtij tregimi?
- Cilën përrallë njoftoi mësuesja se do të vinin në skenë nxënësit?
- Përse po diskutonin fëmijët?
- Çfarë mënyre propozon njëra nga nxënëset për të ndarë rolet?
- A u ranë fëmijëve rolet që dëshironin?
- Përse gjithë klasa qeshi kur roli i Borëbardhës i ra Ajlës?
- Pse Ajla ishte e kënaqur dhe e shqetësuar njëkohësisht?
- Pse ajo mendoi t’ia linte rolin e saj Sofisë?
- Çfarë tha mësuesja për ta siguruar atë?

Diskutohen përgjigjet e pyetjeve në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.

*Nxënësit/et tregojnë përmbajtjen duke u bazuar te pyetjet.

- **Veprimtaria e katërt**

Mendo-nxirr mesazhin: Punohet rubrika “Analizoj”.Nxënësit/et diskutojnë në dyshe rreth llojit të tregimit dhe përgjigjet e tyre më pas i ndajnë me gjithë klasën.

Nxiten nxënësit/et që në grupe të formulojnë mesazhin që përcjell tregimi.

Mesazhi: *Me besim dhe dëshirë të mirë, arrihet çdo gjë.*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et për:**

- leximin e tekstit rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;
- tregimin e përmbajtjes me ndihmën e pyetjeve;
- formulimin e mesazhit që përcjell tregimi;
- lidhjen e tregimit me ngjarje nga jeta e tij/saj, kur ka luajtur një rol në një pjesë teatrale;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruidj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Teatër në shkollë (ora II)		Situata e të nxënit Interpretim i pjesës në role.	
<p style="text-align: center;">Rezultatet e të nxënit</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lexon dhe interpreton tekstin sipas roleve; • ndërton fjali përmbledhëse rreth tregimit; • gjykon rreth personazheve të tregimit, mbi bazën e veprimeve të tyre; • tregon përmbajtjen e tregimit mbi bazën e fjalive përmbledhëse; • shpjegon kuptimin e fjalëve të dhëna që kanë lidhje me teatrin; • jep mendimin e tij/saj, për zgjidhjen që dha mësuesi/ja; • vlerëson dashamirësinë e Ajlës për t'i ofruar shoqes rolin e Borëbardhës; • flet për rolin që dëshiron të luajë në teatër dhe për pjesën teatrore që ata kanë zgjedhur të vënë në skenë së afërmi; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalët kyçe: -teatër; -rol; -short; -Borëbardha dhe shtatë xhuxhat; -fustan princeshe; -interpretim; -aktor; -skenë; -regjisor; -skenografi; -protagonist; -kostume.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -videoprojektor; -pjesa teatrore „Borëbardha dhe shtatë xhuxhat“ -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -lexim sipas roleve; -harta e personazheve; -lexo, përmbledh në dyshe; -bashkëbisedim; -mendo-diskuto; -dramatizim; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. <p style="text-align: center;">Veprimtaritë e nxënësve/eve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e parë <i>Veprimtari: Lexim sipas roleve:</i> Mësuesi/ja organizon klasën në grupe. Ai/ajo ndan rolet në çdo grup. Janëshkruar më parë në fisha me ngjyra emrat e çdo personazhi: <i>mësuesja, Ajla, Luka, autori.</i> Nxënësit/et tërheqin secili një fishë dhe lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës. Më pas nxënësit/et do të ushtrohen në lexim me zë sipas roleve. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë Mësimi vazhdon me pyetje rreth përmbajtjes së tregimit, pyetje të cilat nxënësit/et mund t'ia drejtojnë njëri-tjetrit. <i>Harta e personazheve:</i> Nxiten nxënësit/et, që në grupe, të analizojnë personazhet kryesore në tregim mbi bazën e veprimeve të tyre. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë *Me anë të teknikës “<i>Lexo, përmbledh në dyshe</i>”, nxënësit/et në dyshe, ndajnë tregimin në pjesëza, i lexojnë ato dhe i përmbledhin me njëfjali. *Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e tregimit. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Bashkëbisedim:</i> Punohet rubrika “<i>Reflektoj</i>”. Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me rolin që secili nxënës/e dëshiron të luajë në teatër, për pjesën teatrore që ata kanë zgjedhur të vënë në skenë së afërmi. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e pestë <i>Mendo-diskuto:</i> Nxiten nxënësit/et të tregojnë se si do të vepronin po të ishin në vendin e Ajlës. Ata/ato japin mendimin e tyre për zgjidhjen që dha mësuesja dhe ndajnë me të tjerët përvojën se si i caktojnë rolet në klasën e tyre. *Nxiten nxënësit/et nën drejtimin e mësuesit/es të shpjegojnë kuptimin e fjalëve që kanë lidhje me teatrin: <i>rol, aktor, regjizor, skenë, skenograf, kostume, protagonist.</i> 			

• **Veprimtaria e gjashtë**

Dramatizim: Nxënësit/et të ndarë në grupe, bëjnë dramatizimin e pjesës.

Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin për interpretimin.

• **Vlerësimi:** Mësuesi/ja vlerëson nxënësit për:

- leximin dhe interpretimin e tekstit sipas roleve;
- ndërtimin e fjalive përmbledhëse rreth tregimit;
- grykimin rreth personazheve të tregimit, mbi bazën e veprimeve të tyre;
- tregimin e përmbajtjes mbi bazën e fjalive përmbledhëse rreth tregimit;
- shpjegimin e kuptimit të fjalëve të dhëna që kanë lidhje me teatrin;
- mendimet e dhëna për zgjidhjen që dha mësuesja situatës;
- vlerësimin e dashamirësisë së Ajlës për t'i ofruar shoqes rolin e Borëbardhës;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën(ora I)		Situata e të nxënët Shqyrtimi i kryefjalës dhe kallëzuesit në fjali,për të parësi përshtatën ato.	
Rezultatet e të nxënët Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon kryefjalën dhe kallëzuesin në fjali, duke përdorur pyetjet përkatëse; • vë në dukje se në rast se ndryshon kryefjala, ndryshon edhe kallëzuesi; • përshtat kryefjalën me kallëzuesin në fjali; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij /saj; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -kryefjalë; -kallëzues; -përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me pyetjet për të gjetur kryefjalën dhe kallëzuesin; -fisha me fjali; -mjete shkrimi,lapustilë, fletore, tabakë letre,fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim; -mendo- zbuloj; -lojë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Diskutim:</i>Njihet nxënësit/et me temën e mësimin. Orientohen ata/ato të vërejnë figurat në libër dhe të diskutojnë rreth tyre. Në një tabak letre, mësuesi/ja ka shkruar fjalitë, të cilat nxënësit/et i kanë edhe në libër. Nxënësit/et të lexojnë fjalitë në heshtje dhe të dallojnë kryefjalën dhe kallëzuesin në to.<i>Vajza luan me top.</i></p> <p><i>Vajzat luajnë me top.</i></p> <p>Zhvillohet një diskutim me nxënësit/et:</p> <p>-Me se ështëshprehur kryefjala në fjalinë e parë?(<i>me emër në numrin njëjës</i>)</p> <p>-Po në fjalinë e dytë?(<i>me emër në numrin shumës</i>)</p> <p>-Me se ështëshprehur kallëzuesi në fjalinë e parë? (<i>me folje në vetën e tretë, numri njëjës</i>)</p> <p>-Po në fjalinë e dytë?(<i>me foljenë vetën e tretë, numri shumës</i>)</p> <p>*Lexohet rubrika „Mbah mend“, ku jepet kuptimi i përshtatjes së kallëzuesit me kryefjalën.</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë në dyshe, më pas me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es, se si përshtatet kryefjala me kallëzuesin, duke ilustruar me shembuj.</p>			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Punë në dyshe:</i> Nxënësit/et punojnë në dyshe ushtrimin 1, ku do të lidhin me shigjetë pjesët e fjalive dhe do të nënvizojnë kallëzuesit. Nxënësit/et diskutojnë rreth detyrës në dyshe dhe më pas me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es. • Veprimtaria e tretë <i>Mendo- zbullo:</i> Nxënësit/et do të punojnë ushtrimin 2, ku do të nënvizojnë kryefjalën dhe kallëzuesin në fjalitë e dhëna. Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të lexojnë fjalitë, të mendohen për disa çaste. Më pas, ata/ ato punojnë individualisht. Diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es, duke vënë theksin te përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën. • Veprimtaria e katërt Në minutat e fundit, nxënësit/et luajnë një lojë në grupe: <i>Gjej gabimin, korrigjo.</i> Nxënësit/et sipas grupeve do të shkruajnë 4-5 fjali jo të sakta, në të cilat nuk është përshtatur kallëzuesi me kryefjalën. Fjalitë do t'i shkëmbejnë me grupet fqinje, të cilët do të gjejnë gabimet dhe do t'i korrigjojnë ato, duke shpjeguar punën e tyre. Grupet vlerësojnë punën e njëri-tjetrit. • Vlerësimi bëhet për: -dallimin e kryefjalës dhe kallëzuesit në fjali, duke vënë në dukje se në rast se ndryshon kryefjala, ndryshon edhe kallëzuesi; -përshtatjen e kryefjalës me kallëzuesin në fjali; -paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj; -demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve. • Detyrë shtëpie Ushtrimi 3
--

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën (ora II)		Situata e të nxënit Shqyrtimi i kryefjalës dhe kallëzuesit në fjali, për të parë se si përshtaten ato.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • zëvendëson kryefjalën e shprehur me emër, me përemër vector në fjali; • përshtat kallëzuesin me kryefjalën në fjali; • shpjegon se si realizohet përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën në fjali; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -kryefjalë; -kallëzues; -përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me pyetjet për të gjetur kryefjalën dhe kallëzuesin; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim
 - rishikim në dyshe;
 - shkrim i drejtuar;
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Mësimi nis me leximin e detyrës, që u është dhënë nxënësve/eve në orën e mëparshme.

Nxënësit/et lexojnë fjalitë qëkanë krijuar, duke zëvendësuar kryefjalën e shprehur me emër, me përemër vetor në fjali, si edhetregojnë numrin e emrit, me të cilin është shprehur secila nga kryefjalët e fjalive.

- **Veprimtaria e dytë**

Punë në dyshe: Nxënësit/et punojnë në dyshe ushtrimin 4, ku do të ndërtojnë fjali sipas modelit të dhënë, duke konstatuar ndryshimet. Ata/ato do të zëvendësojnë në fjali kryefjalën e shprehur me emër me përemër vetor dhe do të përshtatin kryefjalën me kallëzuesin. Nxënësit/et diskutojnë me njëri-tjetrin në dyshe dhe më pas me gjithë klasën rreth detyrës, nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e tretë**

Rishikim në dyshe. Nxënësit/et do të punojnë ushtrimin 5, ku do tëshkruajnë si duhet, kallëzuesin e dhënë në kllapa duke e përshtatur atë, me kryefjalën në fjali.

Mësuesi/ja, i lë nxënësit/et të lirë të lexojnë fjalitë, të mendohen për disa çaste.Më pas ata/ato punojnë individualisht, shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrin. Diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es duke vënë theksin te përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve/shoqeve.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- zëvendësimin e kryefjalëssë shprehur me emër me përemër vetor në fjali;
- përshtatjen e kryefjalës me kallëzuesin në fjali;
- shpjegimin se si realizohet përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën në fjali;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

- **Detyrë shtëpie**

Në fjalitë e dhëna, shkruaj si duhet kallëzuesin qëështë në kllapa:

Fëmijët (vrapon) _____ në fushë. Vajzat (luan) _____ me top në breg të detit.

Ata (ngjitem) _____ në mal. Ne (shoh) _____ ndeshjen sportive.

Nxënësit (interpreton) _____ në teatrin e shkollës.

Ana (lexojnë) _____ një libër me tregime për fëmijë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda:Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Dëshira e fshehtë e Bubulinos (ora I)		Situata e të nxënit Shikim i një dokumentari të shkurtër për planetin Mars.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tregimin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i bëjnë më shumë përshtypje; • shpjegon fjalët dhe shprehjet e reja duke ndërtuar fjali me to; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit; • tregon llojin e pjesës që lexon, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj; • shpreh mendimet dhe ndjenjat e tij/saj në lidhje me tregimin; • tregon përmbajtjen duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse të tregimit; • lidh tregimin me informacionet qëka për planetin Mars dhe marsianët; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • pranon me respekt mendimet dhe idetë e të tjerëve. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -Bubulino; -dëshirë e fshehtë; -pasion; -ngurroj; -mos u druaj; -prisnin me frymën pezull; -befasuese; -revistë shkencore; -libra fantastiko-shkencorë; -marsianë; -afërdita; -vijoi. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -teksti shkollor; -pamje nga gjithësia, pamje tëplaneteve të sistemit tonë diellor dhe të Marsit; -informacione nga interneti dhe kuriozitete për planetin Mars; -libri „Eh, more Bubulino!“, i autorit Viron Koka; -revista shkencore; -videoprojektor; -dokumentar për planetin Mars; -mjete shkrimi,lapustilë, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës; -teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore. 	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -shikim i organizuar; -veprimtari e leximit të drejtuar; -hulumtim, rishikim në dyshe; -mendo-diskuto; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Shikim i organizuar:</i> Paraqitet me anë të videoprojektorit një dokumetar i shkurtër për planetin Mars. Mësuesi/ ja diskuton me nxënësit/et rreth dokumentarit. Pyetjet janë të këtij lloji: -Ku ndodhet planeti Mars? A ka jetë në të? (Në mungesë të shikimit të dokumentarit, nxënësit/et diskutojnë rreth fotove dhe informacioneve që kanë sjellë për planetin Mars). • Veprimtaria e dytë <i>Veprimtari e leximit të drejtuar:</i>Nxënësit/et njihen me titullin e pjesës “Dëshira e fshehtë e Bubulinos”, të autorit Viron Koka. Mësuesi/ja fton nxënësit/et tëvëzhgojnë dhe komentojnë ilustrimin në libër.Ai/ajo drejton pyetjen: -Nisur nga titulli dhe ilustrimi në libër, për çfarë mendoni se bën fjalë kjo pjesë? Fillon leximi me ndalesa: Ndalesa e parë:<i>Kam një pyetje... deri te...me frymën pezull.</i> Pyetje:-Për çfarë e pyeti gazetari Bubulinon? -Për çfarë e nxiti mësuesja Bubulinon? 			

Ndalesa e tretë: Të gjithë në klasë...deri te... përgëzimet e shokëve.

Pyejte: -Pse nxënësit dhe gazetari mbetëngojëhapur nga dëshirat e djalit?

-Si ndihej Bubulino nga përgëzimet e shokëve?

Ndalesa e katërt: Përse të tërheq... deri te...ulur në Mars.

Pyejte: -Për çfarë e pyeti mësuesja Bubulinon lidhur me planetin Mars? Si i përgjigjet Bubulino?

Ndalesa e pestë: Bubulino ka njerëz në Mars?... deri te...u dëgjuan duartrokitje.

Pyejte: -Për çfarë e pyeti Bubulinon shoku i bankës?

-Çfarë dinte Bubulino për jetën në Mars?

Ndalesa e gjashtë: Bubulino... deri në fund.

Pyejte: -Çfarë do t'i dhuronte Bubulinoja marsianëve, kur të shkonte në Mars?

-Çfarë do t'u tregonte Bubulinoja marsianëve me anë të luleve?

-A ju pëlqeu pjesa?

-Ç'gjëju bëri përshtypje?

- Si do ta vijoje ti më tej atë?

*Punohen fjalët e fjalorit dhe nxënësit/et ndërtojnë fjali me to.

*Nxënësit/et tregojnë llojin e pjesës, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj(tregim).

*Lexohet tregimi nga nxënësit/et zinxhir.

- **Veprimtaria e tretë**

Hulumtim, rishikim në dyshe: Punohet rubrika "Lexoj dhe kuptoj". Mësuesi/ja orienton nxënësit/et, të punojnë individualisht për të dalluar fjalitëpërmbledhëse tësakta dhe ato tëgabuar rreth tregimit.

*Nxiten ata/ato të ndërtojnë saktë fjalitë e gabuara si dhe të dallojnë fjalitë përmbledhëse që i përkasin hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes së tregimit, duke i ngjyrosur me ngjyrat e rekomanduara në libër.

Pas përfundimit të punës, ata shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Zhvillohet një diskutim në klasë rreth detyrës nën drejtimin e mësuesit/es.

*Disa nxënës/e tregojnë ngjarjen duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse.

- **Veprimtaria e katërt**

Punë në grupe: Mendo-diskuto: Punohet rubrika "Analizoj". Nxënësit/et japin mendimet e tyre rreth protagonistit të këtij tregimi.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi: Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et për:**

-leximin e tregimit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i bëjnë më shumë përshtypje;

-shpjegimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja duke ndërtuar fjali me to;

-përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;

-tregimin e llojit të pjesës që lexon, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj;

-shprehjen e mendimeve dhe ndjenjave të tij/saj në lidhje me tregimin;

-tregimin e përmbajtjesduke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse;

-lidhjen e tregimit me informacionet që ka për planetin Mars dhe marsianët;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe tësakhtë të mendimeve tëtij/saj;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika "Shkruaj"

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Dëshira e fshehtë e Bubulinos (ora II)		Situata e të nxënit Diskutim rreth përshkrimit dhe vizatimit të nxënësve për një marsian. (bazuar në pamjen që u është dhënë atyre në filma të ndryshëm)	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon dhe interpreton në role tregimin; • diskuton rreth cilësive të personazhit kryesor mbi bazën e veprimeve të tij në tregim; • tregon përmbajtjen e tregimit sipas strukturës së tij; • flet për dëshirat e tij/saj të fshehta; • lidh tregimin me informacionet që ai ka për planetin Mars dhe marsianët; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • pranon me respekt mendimet dhe idetë e të tjerëve. 		Fjalët kyçe: -Bubulino; -marsianë; -dëshirë e fshehtë; -revistë shkencore; -libra fantastiko-shkencorë.	
Burimet dhe materialet didaktike: -teksti shkollor; -pamje nga gjithësia, pamje të planeteve të sistemit tonë diellor dhe të Marsit; -informacione nga interneti dhe kuriozitete për planetin Mars; -revista shkencore; -libri „Eh, more Bubulino!“, i autorit Viron Koka; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës, -teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -turi i galerisë; -diskutim; -harta e personazheve; -mendo, nxirr mesazhin; -bashkëbisedim; -karrigia e autorit; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e parë <i>Turi i galerisë:</i> Mësuesi/ja, fton nxënësit/et të vendosin punimet e tyre të bëra në shtëpi për përshkrimin dhe vizatimin e një marsiani. Secili nga nxënësit/et, prezanton dhe shpjegon punimin e tij/saj. Përzgjidhen punimet më të mira. • Veprimtaria e dytë 			
<p><i>Diskutim:</i> Nxënësit/et u drejtojnë pyetje njëri-tjetrit rreth përmbajtjes së tregimit. *Lexohet pjesa nga të gjithë nxënësit/et nëpërmjet leximit zinxhir dhe me role.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Punë në grup: Harta e personazheve:</i> Nxënësit/et shkruajnë për personazhin kryesor dy cilësi. Për secilën cilësi, shkëputet nga një pjesë ilustruese nga teksti. <div style="text-align: center;"> <p><i>Bubulino</i></p> <p>↙ ↘</p> <p><i>ëndërrimtar</i> <i>i guximshëm</i></p> <p>↙ ↘ ↙ ↘</p> <p><i>Ëndrra ime më e madhe, është që të jem i pari njeri që do të zbres në planetin Mars</i> <i>Këto që thashë nuk më pengojnë mua, që kur të rritem të shkoj në Mars.</i></p> </div> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Mendo, nxirr mesazhin:</i> Nxirrret mesazhi i tregimit në grupe nga nxënësit/et: <i>Ëndrrat e guximshme duhen përkrahur dhe mbështetur gjithnjë, sidomos kur ato frymëzohen nga aspiratat e zhvillimit dhe paqes.</i> *Tregohet përmbajtja nga disa nxënës/e. 			

- **Veprimtaria e pestë**

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxënësit/et tregojnë se si do të vepronin ata/ato, në rast se ndodheshin në klasën e Bubulinos.

*Nxiten nxënësit/et të tregojnë për dëshirat e tyre të fshehta.

- **Veprimtaria e gjashtë**

Karrigia e autorit: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të ulen në karrigen e autorit dhe të lexojnë pjesë nga libri i autorit Viron Koka “Eh, more Bubulino!” Nxënësit/et i drejtojnë pyetje personit që është ulur në karrige sikur të ishte ai autori i librit.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetritin.

- **Vlerësimi:** Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et për:

- leximin dhe interpretimin e tregimit në role;
- diskutimin rreth cilësive të personazhit kryesor mbi bazën e veprimeve të tij në tregim;
- diskutimin për dëshirat e tij/saj të fshehta;
- tregimin e përmbajtjes sipas strukturës së tregimit;
- lidhjen e tregimit me informacionet që ai ka për planetin Mars dhe marsianët;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- pranimin me respekt të mendimeve dhe ideve të të tjerëve;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie** Shkruaj një shkrim me 7-8 fjali, me temë “Unë kam një ëndërr”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Grupet kryesore të fjalëve në fjali (ora I)		Situata e të nxënës Përcaktimi i grupit emëror të kryefjalës dhe grupit foljor të kallëzuesit.	
Rezultatet e të nxënës Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • identifikon grupin emëror të kryefjalës dhe grupin foljor të kallëzuesit në fjali; • vë në dukje se fjalja e zgjeruar ndahet në dy grupe: GE, GF; • përcakton fjalët që plotësojnë kryefjalën dhe fjalët që plotësojnë kallëzuesin; • shkruan fjali, duke dalluar në to grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -fjali e zgjeruar; -fjalë plotësuese; -grupe kryesore; -grupi emëror i kryefjalës(GE); -grupi foljor i kallëzuesit(GF). 	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë,fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	


- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim;
 - mendo, puno në dyshe, shkëmbe;
 - rishikim në dyshe;
 - shkëmbe një problemë;
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim: Njihen nxënësit/et me temën e mësimit.

Orientohen ata/ato të vërejnë figurën në libër dhe të diskutojnë rreth saj.

Në një tabak letre mësuesi/ja ka shkruar dy fjali, në të cilat dallohen në fjalinë e parë, kryefjala dhe kallëzuesi, në fjalinë e dytë, grupi emëror i kryefjalës dhe grupi foljor i kallëzuesit.


(Nxënësit/et i kanë të paraqitura në libër).



*Nxënësit/et diskutojnë në dyshe, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es, se *grupi emëror përmban kryefjalën dhe fjalët që e plotësojnë atë dhe grupi foljor përmban kallëzuesin dhe fjalët që e plotësojnë atë.*

*Nxënësit/et lexojnë në dyshe dhe diskutojnë rreth grupeve kryesore të fjalëve në fjali (GE, GF) në rubrikën „Mbaj mend“.

Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve/eve, duke vënë në dukje, se fjalia e zgjeruar ndahet në dy grupe: grupi emëror i kryefjalës dhe grupi foljor i kallëzuesit.



- **Veprimtaria e dytë**

Mendo, puno në dyshe, shkëmbe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të lidhin me shigjetë fjalët që plotësojnë kryefjalën dhe ato që plotësojnë kallëzuesin.

Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Pastaj mendimet e tyre i shkëmbejnë me shokun/shoqen e bankës dhe në fund me gjithë klasën. Pasi binden për përgjigjen e saktë, punojnë në libër. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es për të treguar fjalët që plotësojnë kryefjalën dhe fjalët që plotësojnë kallëzuesin.

- **Veprimtaria e tretë**

Rishikim në dyshe: Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 2, ku në fjalitë e dhëna do të ngjyrosin me të kuqe grupin emëror të kryefjalës dhe me blu, grupin foljor të kallëzuesit.

Ata/ato shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, vlerësojnë njëri-tjetrin dhe diskutojnë ushtrimin me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e katërt**

Shkëmbe një problemë: Nxënësit/et në grupe, shkruajnë në tabakë letre 2 fjalitë zgjeruara dhe ua japin grupit fainië për të dalluar në to GE, GF.

Nxënësit/et diskutojnë në grup dhe nënvizojnë me ngjyra të ndryshme GE, GF.

Përfaqësuesit/et e secilit grup, prezantojnë punën e grupit.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.

• **Vlerësimi bëhet për:**

- identifikimin e grupit emëror të kryefjalës dhe grupit foljor të kallëzuesit në fjali;
- përcaktimin e fjalëve që plotësojnë kryefjalën dhe fjalëve që plotësojnë kallëzuesin;
- shkrimin e fjalive, duke dalluar në to grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit;
- paraqitjen dhe komunikimin lirshëm dhe saktë të mendimeve të tij /saj;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- vlerësimin që i bëjnë punës së shokëve e të shoqeve.

• **Detyrë shtëpie**

Në fjalitë e dhëna, dallo grupin emëror të kryefjalës dhe grupin foljor të kallëzuesit.

1. Vajzat e vogla ndërtojnë një kala prej rëre.
2. Fëmijët e gëzuar ngrejnë balona në ajër.
3. Lulet shumëngjyrëshe lulëzojnë në ballkon.
4. Zogjtë shtegtarë kthehen në pranverë.
5. Dallëndyshet bishtgëreshëra ndërtojnë foletë poshtëçative të shtëpive.

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Grupet kryesore të fjalëve në fjali (ora II)		Situata e të nxënit Përcaktimi i grupit emëror të kryefjalës dhe grupit foljor të kallëzuesit.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon grupin emëror të kryefjalës dhe grupin foljor të kallëzuesit në fjali; • zgjeron grupin e kryefjalës dhe të kallëzuesit duke shtuar fjalë në secilin prej tyre; • shkruan fjali, duke dalluar në to grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -fjali e zgjeruar; -fjalë plotësuese; -grupe kryesore; -grupi emëror i kryefjalës(GE); -grupi foljor i kallëzuesit(GF). 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. 	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p>Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit/et i lexojnë ato dhe diskutojnë rreth tyre nën drejtimin e mësuesit/es.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimin 3 synon që nxënësit/et të dallojnë në fjalitë e dhëna, grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit.</p> <p>Ushtrimin 4 synon që nxënësit/et të shkruajnë fjalëplotësuese për kryefjalën dhe kallëzuesin në fjali. Nxënësit/et punojnë individualisht. Ata/ato shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, vlerësojnë njëri-tjetrin dhe diskutojnë ushtrimin me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.</p>			

- **Veprimtaria e katërt**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimin 5, synon që nxënësit/et të shkruajnë 5 fjali dhe të ngjyrosin me të gjelbër grupin e kryefjalës dhe me blu grupin e kallëzuesit.

Nxiten nxënësit/et të lexojnë fjalitë e krijuara dhe të tregojnë grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit në to.

- **Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.**

- Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e grupit emëror të kryefjalës dhe grupin foljor të kallëzuesit në fjali;
- zgjerimin e grupit të kryefjalës dhe të kallëzuesit duke shtuar fjalë në secilin prej tyre;
- shkrimin e fjalive, duke dalluar në to grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- vlerësimin që i bëjnë punës së shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj 5 fjali, nënvizo në to, grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Një shok ka ndërruar shtëpi		Situata e të nxënit A ju ka ndodhur që një shok ose shoqe të largohet nga klasa, sepse ka ndërruar shtëpi?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit; • shpjegon fjalët dhe shprehjet e reja duke ndërtuar fjali me to; • dallon alternativat e sakta që kanë të bëjnë më përmbajtjen e letrës; • përcakton fjalët hyrëse dhe mbyllëse të letrës; • tregon emocionet që provon kur lexon letrën; • lidh tregimin me ngjarje nga jeta e tij/saj, kur i është dashur të ndërrojë shtëpi, apo një shok(shoqe) i/e tij/saj, ka ndërruar shtëpi; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -shok; -shoqe; -ndërroj shtëpi; -zbavitëse; -i bën sytë katër; -s'e bëra kastile; -zgërdhitem. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -teksti shkollor; -foto ku ka dalë me shokët dhe shoqet; -mjetë shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore. 	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**

-bisedë;
-diskutim;
-rishikim në dyshe;
-diagrami i Venit;
-bashkëbisedim;
-punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

Veprimtaritë e nxënësve/eve

- **Veprimtaria e parë**

Bisedë: Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et. Mësuesi/ja u drejton pyetjen:

-A ju ka ndodhur që një shok, ose shoqe të largohet nga klasa, sepse ka ndërruar shtëpi?

-Si e keni përjetuar largimin e shokut ose shoqes që është larguar nga klasa?

-A i keni mbajtur lidhjet me të?

Nxënësit/et, tregojnë për rastet që kanë patur, ku ndonjë shok, ose shoqe e tyre, është larguar nga klasa, sepse ka ndërruar shtëpi.

- **Veprimtaria e dytë**

Diskutim: Mësuesi/ja paraqet me titullin e pjesës “Një shok ka ndërruar shtëpi” dhe fton nxënësit/et të vërejnë foton. Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën, diskutojnë rreth saj.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë në heshtje, të nënvizojnë fjalët dhe shprehjet që nuk kuptojnë, si dhe fjalitë që u duken më interesante dhe më të rëndësishme.

*Punohen fjalët dhe shprehjet e fjalorit dhe ndërtohen fjali me to.

*Nxënësit/et tregojnë llojin e pjesës, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj (letër)

*Lexim zinxhir nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e tretë**

**Rishikim në dyshe:* Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et punojnë individualisht për të dalluar alternativat e sakta të qëkanë të bëjnë me përmbajtjen e letrës.

Ata/ato shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Më pas diskutojnë me gjithë klasën rreth alternativave.

- **Veprimtaria e katërt**

Diagrami i Venit: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et plotësojnë diagramin e Venit për të treguar të përbashkëtat dhe të veçantat që kanë me njërin nga personazhet.

- **Veprimtaria e pestë**

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”.

*Nxënësit/et tregojnë se si janë ndier pas leximit të kësaj letrë, duke zgjedhur një nga alternativat e dhëna dhe të shpjegojnë arsyen e përzgjedhjes.

*Nxënësit/et ndajnë me të tjerët histori të ngjashme që mund t’u kenë ndodhur atyre.

*Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi:** Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et për:

-leximin e rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;

-shpjegimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja duke ndërtuar fjali me to;

-dallimin e alternativave të sakta që kanë të bëjnë me përmbajtjen e letrës;

-përcaktimin e fjalëve hyrëse dhe mbyllëse të letrës;

-lidhjen e tregimit me ngjarje nga jeta e tij/saj, kur i është dashur të ndërrojë shtëpi, apo një shok(shoqe) e tij/saj, ka ndërruar shtëpi;

-respektimin e përpyekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Përshkruajmë një person		Situata e të nxënit Përshkruaj shokun/shoqen tim/e të bankës.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> shpreh mendimet personale rreth shoqes/shokut të saj/tij që e konsideron të veçantë; dallon në përshkrimin për shokun/shoqen, fjalitë që kanë të bëjnë me prezantimin, paraqitjen e jashtme, paraqitjen e brendshme, mendimin që ka për të, duke u ndihmuar nga pyetjet; shkruan për shoqen/shokun që e konsideron të veçantë, duke u bazuar në skemën e dhënë; respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -përshkrim; -shoqe/shok; -prezantimi; -paraqitja e jashtme; -paraqitja e brendshme; -mendimi për shoqen/shokun; -pëlqej; -i veçantë.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -mjete shkrimi, lapustilë, tabak letre, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -shkrim i shpejtë; -diskutim; -shkrim i lirë; -punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <p>Mësimi fillon me një shkrim të shpejtë, ku secili nga nxënësit/et do të përshkruajë me 3-4 fjali shoqen/shokun e saj/tij të bankës(pamjen e jashtme, cilësi të karakterit).</p> <p>Nxiten nxënësit/et të punojnë për disa minuta dhe më pas lexojnë përshkrimet e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaria e dytë <p><i>Diskutim:</i> <i>Punë në dyshe:</i> Mësuesi/ja prezanton temën e mësimin.</p> <p>Njihen nxënësit/et me kërkesën e ushtrimit 1. Orientohen nxënësit/et të lexojnë pjesët e skemës për përshkrimin e një personi dhe të lidhin me shigjetë pjesët e saj, me pyetjet korresponduese të tyre.</p> <p>Shpjegohen nga mësuesi/ja fjalët që nxënësit/et, i kanë të padëguara më parë.</p> <p>Ata/ato diskutojnë dhe punojnë në dyshe.</p> <p>Në përfundim të punës, përfaqësuesit e disa dysheve, prezantojnë punën e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaria e tretë <p><i>Shkrim i lirë:</i> Ushtrimin 2. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et, që nëpërmjet një shkrimi të lirë, të përshkruajnë një shok/shoqe, që e konsiderojnë të veçantë, duke u bazuar te skema dhe pyetjet përkatëse.</p> <div style="text-align: center;"> <p>Përshkrimi i një personi</p> <pre> graph TD A[Përshkrimi i një personi] --> B[Prezantimi] A --> C[paraqitja e jashtme] A --> D[paraqitja e brendshme] A --> E[mendimi yt] </pre> </div> <p>-</p> <p>Përshkrimi i nxënësit/et, shoqërohet me një skicë të thjeshtë të portretit të shokut/shoqes që e konsiderojnë të veçantë.</p> <p>Nxënësit/et punojnë individualisht, duke pasur parasysh rregullat gramatikore që duhet të zbatohen.</p> <p>Në përfundim, shkëmbejnë fletoret dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.</p> <p>Nxiten nxënësit/et të lexojnë përshkrimet e tyre dhe të japin mendime për përshkrimet e bëra nga të tjerët. Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.</p> <p>Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve/shoqeve.</p>			

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -shprehjen e mendimeve personale rreth shoqes/shokut të saj/tij, që e konsideron të veçantë; -dallimin në përshkrim të fjalive që kanë të bëjnë me prezantimin, paraqitjen e jashtme, cilësi të karakterit, mendimin që ka për të, duke u ndihmuar nga pyetjet; -përshkrimin për shoqen/shokun që e konsideron të veçantë, duke u bazuar në skemën e dhënë; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit; -qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es; -vlerësimin që i bëjnë punës së shokëve e të shoqeve. • Detyrë shtëpie Ushtrimi 3

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Ushtrime përmbledhëse: Fjalët dhe grupet kryesore të fjalëve në fjali (ora I)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të përcaktuar kryefjalën dhe kallëzuesin.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon kryefjalën dhe kallëzuesin në fjali; • përdor pyetjet <i>Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?</i> për gjetjen e kryefjalës dhe pyetjen:ç <i>'bën?</i> për të gjetur kallëzuesin; • gjen kryefjalën e nënkuptuar në fjali dhe e rishkruan fjalinë duke e shprehur kryefjalën; • përshtat kryefjalën me kallëzuesin në fjali; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -kryefjalë; -kallëzues; -pyetjet <i>Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?</i> -pyetjaç <i>'bën?</i> -kryefjalë e nënkuptuar. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me pyetjet për të gjetur kryefjalën dhe kallëzuesin; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. 	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -harta e konceptit; -rishikim në dyshe; -mendo-zbulo; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Punë në grupe; Harta e konceptit:</i> Mësuesi/ja njeh nxënësit/et me temën e mësimit. Nxiten ata/ato, të tregojnë se çfarë dinë për kryefjalën dhe kallëzuesin dhe të krijojnë hartën e konceptit, duke punuar në grupe. 			

Gjendet me pyetjet ← **Kryefjala** → Është fjalë kryesore në fjali.
Kush? Cili? Cila? Cilët?
 Tregon një njeri, send, kafshë që Shprehet me emër, përemër, numëror, grup fjalësh.
 kryen veprimin në fjali.

Gjendet me pyetjen ← **Kallëzuesi** → Është fjalë kryesore në fjali.
Çfarë bën?
 Fjalë që tregon se çfarë Shprehet me folje.
 bën kryefjala.

Përfaqësuesit/et e grupeve, prezantojnë punën e tyre para klasës.

- **Veprimtaria e dytë**

Rishikim në dyshe: Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 1, ku në fjalitë e dhëna, do të dallojnë kryefjalën dhe kallëzuesin. Ata/ato shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, vlerësojnë njëri-tjetrin dhe diskutojnë ushtrimin me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e tretë**

Mendo-zbulo: Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 2, ku do të gjejnë kryefjalën e nënkuptuar në fjalitë e dhëna dhe do të rishkruajnë fjalitë duke e shprehur kryefjalën.

Nxiten nxënësit/et, të lexojnë fjalitë dhe të diskutojnë rreth tyre.

- **Veprimtaria e katërt**

Rishikim në dyshe: Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 3, ku në fjalitë e dhëna do të dallojnë kallëzuesin dhe do të shkruajnë pyetjen e përdorur për gjetjen e tij.

Ata/ato shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, vlerësojnë njëri-tjetrin dhe diskutojnë ushtrimin me gjithë klasën.

- **Veprimtaria e pestë**

Shkëmbe një problemë: Nxënësit/et do të punojnë në grupe. Secili grup do të shkruajë në fleta, fjali dhe do t'ia japë grupit fqinjë, për të përcaktuar kryefjalën dhe kallëzuesin, duke treguar pyetjen me të cilat gjenden, me se shprehen ato dhe pozicionet e tyre në fjali.

Nxiten grupet të vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimibëhet për:**

-përcaktimin e kryefjalës dhe kallëzuesit në fjali, duke përdorur pyetjet përkatëse;

-gjetjen e kryefjalës së nënkuptuar në fjali dhe rishkrimin e fjalisë duke e shprehur kryefjalën;

-përshtatjen e kryefjalës me kallëzuesin në fjali;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij /saj;

-demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj 6 fjali të thjeshta. Nënvizon në to kryefjalën dhe kallëzuesin.

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Ushtrime përmbledhëse: Fjalët dhe grupet kryesore të fjalëve në fjali (ora II)		Situata e të nxëniet Manipulime me fjalë e fjali për të përcaktuar grupin emëror të kryefjalës dhe grupit foljor të kallëzuesit.	
Rezultatet e të nxëniet Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon grupin emëror të kryefjalës dhe grupin foljor të kallëzuesit në fjali; • zgjeron grupin emëror të kryefjalës në fjali; • përshtat kryefjalën me kallëzuesin në fjali; • përcakton fjalët që bëjnë pjesë në grupin emëror të kryefjalës dhe ato që bëjnë pjesë në grupin foljor të kallëzuesit në fjali; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -kryefjalë; -kallëzues; -fjali e zgjeruar; -fjalë plotësuese; -grupe kryesore; -grupi emëror i kryefjalës(GE); -grupi foljor i kallëzuesit(GF).	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me fjali; -mjete shkrimi,lapustilë, fletore, tabakë letre,fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim; -të nxënët me këmbime; -shkëmbe një problemë: -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë Mësimi fillon me leximin dhe diskutimin rreth detyrave të shtëpisë që nxënësve iu janë dhënë në orën e mëparshme. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Diskutim:</i> Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve/eve fisha ku ka shkruar nga një fjali. Nxiten nxënësit/et të punojnë në grupe për të dalluar grupin emëror të kryefjalës dhe grupin foljor të kallëzuesit në to. Pas përfundimit të punës, përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e tyre. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es,ku theksohet se <i>grupi emëror përmban kryefjalën dhe fjalët që e plotësojnë atë dhe grupi foljor, përmban kallëzuesin dhe fjalët që e plotësojnë atë.</i> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Të nxënët me këmbime:</i> Nxënësit grupohen në grupe me nga 4 individë dhe secilit u caktohet nga një numër nga 1-4. Nxënësve/eve u ndahen detyrat: Nxënësit/et me numrin 1 do të punojnë ushtrimin 4, i cili synon zgjerimin e grupit emëror të kryefjalës. Nxënësit/et me numrin 2 do të punojnë ushtrimin 5, i cili synon zëvendësimin e kryefjalës së shprehur me emër me njëpëremër vetor. Nxënësit/et me numrin 3, do të punojnë ushtrimin 7, i cili synon dallimin e grupit emëror të kryefjalës dhe grupit foljor të kallëzuesit në fjali. Nxënësit/et me numrin 4, do të punojnë ushtrimin 8, i cili synon dallimin e fjalëve që bëjnë pjesë në grupin emëror të kryefjalës dhe fjalëve që bëjnë pjesë në grupin foljor të kallëzuesit. Nxënësit/et sipas numrave që kanë, do të diskutojnë me njëri-tjetrin rreth ushtrimeve. Pas kryerjes së detyrave, ata do të shkojnë në grupet fillestare ku do t'ua shpjegojnë detyrën edhe anëtarëve të tjerë të grupit. Në fund diskutohet rreth çdo detyre me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. 			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Shkëmbe një problemë:</i> Nxënësit/et do të punojnë në grupe. Secili grup do të shkruajë në fleta fjali të zgjeruara dhe do t'ia japë grupit fqinjë për të përcaktuar grupin emëror të kryefjalës dhe grupin foljor të kallëzuesit në to. Nxiten grupet të vlerësojnë njëri-tjetrin. • Vlerësimi bëhet për: -dallimin e grupit emëror të kryefjalës dhe grupit foljor të kallëzuesit në fjali; -zgjerimin e grupit emëror të kryefjalës në fjali; -përshtatjen e kryefjalës me kallëzuesin në fjali; -përcaktimin e fjalëve që bëjnë pjesë në grupin emëror të kryefjalës dhe atyre që bëjnë pjesë në grupin foljor të kallëzuesit në fjali; -paraqitjen dhe komunikimin lirshëm dhe saktë të mendimeve të tij /saj; -bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre; -demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve; -vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve. • Detyrë shtëpie Ushtrimi 6
--

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Një shok i ri (ora I)		Situata e të nxënit Fëmijët tregojnë për kafshët që do të dëshironin të mbanin në shtëpi.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tregimin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; • tregon si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin; • pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tregimit ose rreth fjalëve të panjohura për të; • tregon llojin e tekstit që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit; • tregon përmbajtjen e tregimit mbi bazën e veprimeve të personazheve; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj, rreth rolit që luajnë kafshët shtëpiake në jetën tonë të përditshme; • demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup. 		Fjalë kyçe: -qen; -ekskursion; -lodra të ndryshme; -oshëtimë; -përdridhem; -buzëqeshje.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -foto të fëmijëve ku kanë dalë me kafshët e preferuara; -foto të fëmijëve që kanë bërë kur kanë qenë në ekskursion; -foto të kafshëve shtëpiake; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -shkencat e natyrës; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**

-pyetja sjell pyetjen:

- procedura:pyet sërish;
- marrëdhënie pyetje-përgjigje;
- ditari dypjesësh;
- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Pyetja sjell pyetjen: Mësuesi/ja fton nxënësit/et t'u përgjigjen pyetjeve:

- A ju pëlqejnë kafshët?
- A do t'ju pëlqente të mbanit në shtëpi një kafshë?
- Çfarë kafshe do të dëshiroje të mbaje në shtëpi?
- Si e imagjinon marrëdhënien që do të ndërtoje ti me të?
- A do të donit ta ndanit shoqërinë e kafshës suaj me shokët e shoqet?

- **Veprimtaria e dytë**

*Procedura:pyet sërish:*Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe fton nxënësit/et të vërejnë figurën. Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën diskutojnë rreth saj, duke treguar si i ndihmon ajo për të kuptuar më mirë tekstin.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në paragrafë. Nënvizojnë fjalët dhe shprehjet që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që u duken më interesante dhe më të rëndësishme.

*Pas leximit të çdo paragrafi, diskutojnë në dyshe: njëri prej tyre ndërton dy pyetje rreth fjalive më interesante në paragrafin e parë dhe tjetri i përgjigjet pyetjeve.

Për çdo paragraf të ri nxënësit/et ndërrojnë rolet.

*Punohet rubrika “Fjalë të reja” në libër.

Nxiten nxënësit/et të ndërtojnë fjali me to.

*Nxënësit/et tregojnë llojin e tekstit, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij(tregim).

- **Veprimtaria e tretë**

*Lexim me zë:*Lexim i pjesës zinxhir nga nxënësit/et dhe më pas në role.

- **Veprimtaria e katërt**

*Marrëdhënie pyetje-përgjigje.*Punohet rubrika „Lexoj dhe kuptoj“.

- Çfarë lajmi u dha mësuesja nxënësve të saj?
- Ç’duhet të bënin fëmijët?
- Cilat sende vendosi të merrte me vete Arioni?
- Cili është shoku i tij më i ngushtë në shtëpi?
- Çfarë ideje i lindi Arionit për të nesërmen?
- Çfarë ndodhi kur ai shkoi në mëngjes në shkollë?
- Si reagoi mësuesja?
- Si e kaluan fëmijët ditën e ekskursionit?

*Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e tregimit mbi bazën e veprimeve të personazheve.

- **Veprimtaria e pestë**

*Ditari dypjesësh:*Nxiten nxënësit/et të diskutojnë në grupe duke komentuar fragmentin:

Fragmenti	Komenti
Të gjithë fëmijët e mirëpritën ardhjen e Parkut në shëtitje dhe u miqësuan me të menjëherë. Fëmijët lozën dhe u argëtuan me të. Qeni Park ua zbukuroi ditën fëmijëve.	Pas pak u nisën për në kodrat e qytetit. Qëndruan disa orë duke luajtur me njëri-tjetrin. Ç’ditë e bukur! E papërsëritshme! Parku ua zbukuroi shumë këtë shëtitje.

Nxënësit/et dëgjojnë dhe vlerësojnë komentet e shokëve/shoqeve të tyre.

- **Vlerësimi bëhet për:**
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- përshkrimin e ilustrimit;
- diskutimin rreth rolit që luajnë kafshët shtëpiake në jetën tonë të përditshme;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;
- tregimin e përmbajtjes mbi bazën e veprimeve të personazheve;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.
- **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Një shok i ri (ora II)		Situata e të nxënit Krijim i një posteri me temë “T’i duam dhe të kujdesemi për kafshët”.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tregimin rrjedhshëm dhe në mënyrë shprehëse; • dallon cilësitë e personazheve mbi bazën e veprimeve të tyre; • shkruan nga një fjali përmbledhëse për çdo paragraf; • tregon përmbajtjen e tregimit mbi bazën e fjalive përmbledhëse të tij; • nxjerr mesazhin që përcjell tregimi; • vlerëson rolin e kafshëve shtëpiake në jetën tonë të përditshme; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj rreth atmosferës së veçantë që krijon prania e kafshëve shtëpiake në mjediset tona; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -qen; -ekskursion; -lodra të ndryshme; -oshëtimë; -përdridhem; -buzëqeshje.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -foto të fëmijëve ku kanë dalë me kafshët e preferuara; -foto të fëmijëve që kanë bërë kur kanë qenë në ekskursione; -foto të kafshëve shtëpiake; -mjete shkrimi,lapustilë, fletore, tabakë letre,fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore; -mjedisi.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -krijim i një posteri; -diskutim; -harta e personazheve; -mendo-nxirr mesazhin; -mendo-diskuto; -punë individuale; punë me gjithë klasën; punë në dyshe; punë në grup • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Veprimtari: Krijim i një posteri:</i>Mësuesi/ja ka porositur nxënësit/et disa ditë më parë të grumbullojnë materialet e duhura për të përgatitur një poster me temë „T’i duam dhe të kujdesemi për kafshët“. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të përgatisin posterin. Prezantohet posteri duke dhënë mesazhe sensibilizimi për kujdesin ndaj kafshëve. • Veprimtaria e dytë <i>Diskutim:</i>Nxënësit/et u drejtojnëpyetje njëri-tjetrit rreth përmbajtjes së tregimit. *Lexohet pjesa nga të gjithë nxënësit/et nëpërmjet leximit zinxhir. • Veprimtaria e tretë <i>Punë në grupe: Harta e personazheve:</i>Nxiten nxënësit të tregojnë personazhet që marrin pjesë në tregim dhe tëshkruajnë dy cilësi për personazhin e Arionit dhe të mësueses. Për secilën cilësi, shkëputet nga një pjesë ilustruese nga teksti. <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: flex-start; margin-top: 20px;"> <div style="text-align: center;"> <p>Arioni</p> <p>i sjellshëm miqësor me kafshët</p> <p>↓ ↓</p> <p>Pyeti prindërit e mësuesen Vendosi të merrte nëse duhet ta merrte qenin. qenin në ekskursion.</p> </div> <div style="text-align: center;"> <p>Mësuesja</p> <p>tolerante e mirëkuptueshme</p> <p>↓ ↓</p> <p>Pranoi zgjedhjen e Arionit Respektoi dëshirat e fëmijëve dhe të klasës për Parkun. për të marrë qenin me vete.</p> </div> </div>			

• **Veprimtaria e katërt**

**Punë në grupe:* Punohet rubrika “Analizoj”. Krijohen nga një fjali përmbledhëse për çdo paragraf të tregimit. Lexim i tyre nga nxënësit/et.

1. *Mësuesja i lajmëroi nxënësit se do të bënin një ekskursion dhe u dha porosi të bënin përgatitjet e duhura.*
2. *Në shtëpi Arioni përgatiti sendet e duhura.*
3. *Arioni mendonte se çfarë i duhej tjetër, ndërsa qëndronte në shoqërinë e qenit të tij.*
4. *Atij i lindi ideja të merrte me vete qenin Park.*
5. *Nëna e lejoi që të merrte qenin, nëse pranonte mësuesja.*
6. *Arioni e Parku u nisën të emocionuar për në shkollë.*
7. *Mësuesja pranoi që Parku të vinte në ekskursion.*
8. *Të gjithë u kënaqën nga prania e Parkut atë ditë.*

**Mesazhi:* Kujdesi ndaj kafshëve shtëpiake e bën më të mirë dhe më humane jetën tonë.

**Nxënësit/et tregojnë përmbajtjen e tregimit mbi bazën e fjalive përmbledhëse.*

• **Veprimtaria e pestë**

Punë në dyshe: Mendo-diskuto: Punohet rubrika “Reflektoj”.

Nxënësit/et bashkëbisedojnë ndërmjet tyre në dyshe rreth pyetjeve:

-Si të duket veprimi i Arionit? Pse?

-A je mik i kafshëve? Si ndihesh kur je pranë tyre?

-Mendon se mësuesja mund të mos e pranonte Parkun? Pse?

Më pas diskutojnë me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxiten nxënësit/et të vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

-leximin e rrjedhshëm dhe në mënyrë shprehëse të tregimit;

-dallimin e cilësive të personazheve mbi bazën e veprimeve të tyre;

-shkrimin e fjalive përmbledhëse për paragrafët;

-formulimin e mesazhit të tregimit;

-tregimin e përmbajtjes mbi bazën e fjalive përmbledhëse të tregimit;

-vlerësimin e atmosferës që krijon prania e një kafshe lozonjare dhe miqësore;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimi të tij/saj;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;

-vlerësimin që i bëjnë punës së shokëve/shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Flasim Një album i veçantë		Situata e të nxënit Flasim për kafshët shtëpiake që mbajmë në shtëpi. Shikim i një dokumentari për kafshët shtëpiake.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • diskuton në grupe të vogla për kafshët shtëpiake që mbajmë në shtëpi apo në mjedise të tjera, duke u bazuar te fotot dhe pyetjet; • përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës; • tregon për kujdesin që tregon për kafshën e tij/saj shtëpiake që ato të ndihen sa më mirë; • nxit të tjerët të bashkëbisedojnë rreth sjelljes me kafshët, që ato të ndihen mirë me njerëzit; • vlerëson atmosferën që krijon prania e një kafshe lozonjare dhe miqësore në shtëpi; • respekton rregullat e të folurit gjatë komunikimit me të tjerët. 		Fjalë kyçe: -kafshë shtëpiake; -qen; -mace; -peshq; -zogj; -kujdes; -album.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -foto që ata kanë bërë në veprimtari të ndryshme gjatë kohës së lirë me kafshë shtëpiake; -material filmik për kafshët shtëpiake, videoprojektor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës; -teknologjia dhe TIK-u; Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -vendimmarrja morale.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

- **Metodologjia:**

- diskutim paraprak;
- vëzhgo-diskuto;
- trego-komento;
- bashkëbisedim;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- **Veprimtaria e parë**

Diskutim paraprak: Zhvillohet një diskutim paraprak me nxënësit/et:

-A mbani kafshë në shtëpi?

-Kush kujdeset në familjen tuaj për të?

-Po ju, a kujdeseni për të? Nëç'mënyrë?

Mund të shfaqet me anë të videoprojektorit edhe njëdokumentar i shkurtër për kafshët shtëpiake.

- **Veprimtaria e dytë**

Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit. Njihen nxënësit/et me punën që ka bërë babai i Maelitpërrealizimin e disa fotografive që paraqesin kafshë të ndryshme shtëpiake, grupimin sipas llojeve dhe përgatitjen e një albumi me to.

Vëzhgo-diskuto. Mësuesi/ja ndan klasën në 4 grupe për të punuar ushtrimin 1.

Ndahen detyrat për çdo grup nxënësish.

Grupi I do të diskutojë rreth grupit të parë të fotografive.

Grupi II do të diskutojë rreth grupit të dytë të fotografive.

Grupi III do të diskutojë rreth grupit të tretë të fotografive.

Grupi IV do të diskutojë rreth grupit të katërt të fotografive.

Orientohen nxënësit/et të vërejnë fotografitë, të diskutojnë me njëri-tjetrin rreth tyre dhe t'u përgjigjen pyetjeve sipas mendimit të tyre.

*Nxënësit/et që mbajnë në shtëpi peshq, zogj, mace, qen ndajnë përvojat e tyre me shokët dhe shoqet, ku tregojnë për kujdesin që tregojnë ndaj tyre.

- **Veprimtaria e tretë**

Trego-komento: Punohet ushtrimi 2. Nxiten nxënësit/et të tregojnë se si duhet të sillemi me kafshët shtëpiake që ato të ndihen të lumtura me ne.

Ushtrimi 3. Nxënësit/et tregojnë për përkujdesjen e kafshëve për të vegjëlit e tyre, duke lexuar edhe kuriozitete për to.

- **Veprimtaria e katërt**

Bashkëbisedim: Punohet ushtrimi 4. Duke u nisur nga problemi i Erlit me peshqit e akuariumit, nxënësit/et japin idetë e tyre, se si mund të vepronin ata në një rast të tillë.

Nxënësit/et vlerësojnëpërgjigjet e njëri-tjetrit.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-diskutimin për kafshët shtëpiake që mbajnë në shtëpi, apo në mjedise të tjera, duke u bazuar te fotot dhe pyetjet;


-përdorimin e një fjalori të përshtatshëm rreth temës;

-bisedat për kujdesin ndaj kafshëve shtëpiake që ato të ndihen sa më mirë;

-nxitjen e të tjerëve në bashkëbisedim rreth sjelljes me kafshët, që ato të ndihen mirë me njerëzit;

-respektimin e rregullave të të folurit gjatë komunikimit me të tjerët;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Tomi dhe videoloja		Situata e të nxënit Aju pëlqejnë videolojërat?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tregimin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; • parashikon se çfarë do të ndodhë në tekst, duke u mbështetur në atë që lexon; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit; • shpreh ndjenjat dhe mendimet e tij/saj rreth tregimit me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es; • gjykon rreth personazhit të tregimit dhe veprimeve të tij; • tregon përmbajtjen e tregimit, mbi bazën e veprimeve të personazhit; • lidh ngjarjen e përshkruar në tregim me përvojën e tij/saj vetjake, në raportin e përdorimit të kompjuterit, internetit dhe leximit të librit; • kritikon rastet e tepërimit të përdorimit të kompjuterit duke anashkaluar detyrimet e tij/saj mësimore; • pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -videolajë; -ekran; -buton; -zbavitëse; -i kredhur; -kërpiste; -mornica; -dragonj; -maska.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -kompjuter; -libra artistikë; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -stuhi mendimesh; -veprimtari e leximit të drejtuar; -trego –argumento; -bashkëbisedim; -rrjeti i diskutimit; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Stuhi mendimesh:</i> Mësuesi/ja nxit nxënësit/et të flasin rreth lojërave që ata/ato luajnë me videolajë. -A ju pëlqen të luani me videolajë? -Çfarë lojërash luani? Mendimet e nxënësve/eve i paraqes në formën e një kllasteri në tabelë. <div style="text-align: center;">  </div> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Veprimtari e leximit të drejtuar:</i> Nxënësit/et njihen me titullin e pjesës “Tomi dhe videoloja” dhe autorin e saj R. Guarnier. *Vëzhgim dhe komentim i ilustrimit në libër nga nxënësit/et. *Lexim me ndalesa i pjesës nga nxënësit/et. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et, t’u përgjigjen pyetjeve të bëra prej saj për secilën ndalesë, duke u kujdesur të punohen të gjitha pyetjet e rubrikës “Lexoj dhe kuptoj”. -Nisur nga titulli dhe ilustrimi, për çfarë mendoni se bën fjalë kjo pjesë? 			

- **Veprimtaria e dytë**

Veprimtari e leximit të drejtuar: Nxënësit/et njihen me titullin e pjesës “Tomi dhe videoloja” dhe autorin e saj R. Guarnier.

*Vëzhgim dhe komentim i ilustrimit në libër nga nxënësit/et.

*Lexim me ndalesa i pjesës nga nxënësit/et. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et, t’u përgjigjen pyetjeve të bëra prej saj për secilën ndalesë, duke u kujdesur të punohen të gjitha pyetjet e rubrikës “Lexoj dhe kuptoj”.

-Nisur nga titulli dhe ilustrimi, për çfarë mendoni se bën fjalë kjo pjesë?

Ndalesa I *Tomi i pëlqen videolojërat... deri te... edhe pse ishte më pak zbavitëse.*

Pyetje:-Çfarë i pëlqenin Tomit?

-Ku e kalon një pjesë të kohës Tomi?

-Tomit i dukej më zbavitëse të luante vetëm, apo me ndonjë shok?

-Si mendoni se do të vazhdojë pjesa?

Ndalesa II *Videolja që i pëlqente... deri te...me harqe dhe shigjeta.*

Pyetje:-Cila ishte videoloja që i pëlqente më shumë Tomit?

-Pse i pëlqente Tomit shumë kjo lojë?

Ndalesa III *Atë ditë... deri te... Dragonjtë apo maskat?*

Pyetje:-Sa lojëra kishte luajtur Tomi atë ditë?

-Kush i kishte fituar këto lojëra?

Ndalesa IV *Tomi u zhyt në mendime... deri te...ishte më e fortë.*

Pyetje: -Përse u zhyt Tomi në mendime?

-Çfarë i ndodhi Tomit atë ditë kur ishte vetëm në shtëpi?

Ndalesa V *Pastaj Tomit...deri në fund.*

Pyetje:-Çfarë ndjesie pati Tomi?

-Çfarë mendoi ai?

-A ju pëlqeu kjo pjesë? Pse?

-Si u ndjetë pas leximit të kësaj pjese?

*Nxënësit/et lexojnë në heshtje, nënvizojnë fjalët e shprehjet që nuk kuptojnë.

*Punohet rubrika “Fjalët të reja” në libër. Më pas ata/ato ndërtojnë fjali me to.

*Lexim i pjesës zinxhir nga nxënësit/et.

*Tregohet përmbajtja nga disa nxënës/e mbi bazën e veprimeve të personazhit në tregim.

- **Veprimtaria e tretë**

Trego-argumento: Mësuesi/ja organizon klasën në grupe. Punohet rubrika “Analizoj”.

Nxiten nxënësit/et të tregojnë:

a) nëse ky tekst është realist, apo fantastik, duke argumentuar përgjigjet;

b) çfarë ka dashur autori të na tregojë me këtë ngjarje;

c) të krahasojnë veten e tyre me Tomin.

- **Veprimtaria e katërt**

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”.Nxiten nxënësit/et që nëpërmjet përgjigjeve të pyetjevetë tregojnë përvojën e tyre vetjake në lidhje me:

1.parapëlqimet e tyre për videolojërat;

2.kohën që kalojnë me videolojërat;

3.videolojën e preferuar;

4.pëlqimet e tij për të luajtur vetëm, apo me shokë.

- **Veprimtaria e pestë**

Punë në grupe: Rrjeti i diskutimit:

Po

Jo

A do të ishte më mirë të shpenzonit kohën duke luajtur videolojëra, apo duke lexuar libra? Pse?

Nxënësit/et ndajnë mendimet e tyre rreth pyetjes dhe grupohen sipas përgjigjeve që kanë dhënë, dukereplikuar me njëri-tjetrin. Në fund shkruhet në tabelë përfundimi,që lidhet me mesazhin e pjesës.

*Përfundimi:*Duhet të vendosim një raport të drejtë ndërmjet qëndrimit para ekranit për të luajtur me videolojëra dhe leximit.

*Nxënësit/et kritikojnë rastet e teprimit të videolojërave, duke anashkaluar detyrimet mësimore.

*Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimibëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante; -parashikimin se çfarë do të ndodhë në tekst, duke u mbështetur në atë që lexon; -përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit; -shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve të tij/saj, rreth tregimit me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es; -grykimin rreth personazhit të tregimit dhe veprimeve të tij; -tregimin e përmbajtjes së tregimit, mbi bazën e veprimeve të personazhit; -lidhjen e ngjarjes së përshkruar në tregim me përvojën e tij/saj vetjake, në raportin e përdorimit të kompjuterit, internetit dhe leximit të librit; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit. • Detyrë shtëpie Rubrika”Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Dita e Klestit (ora I)		Situata e të nxënit A keni krijuar ju një planifikim të ditës suaj?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan veprimtarinë e tij/saj ditore; • përdor fjalë ndihmëse për të plotësuar një rrëfim, duke u bazuar në ilustrime; • shkruan për rregullat që i kanë vendosur prindërit për qëndrimin në kompjuter; • përzgjedh formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë mendimet e tij/saj rreth zbatimit të regjimit ditor; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • vlerëson rëndësinë që ka organizimi i ditës sipas një planifikimi ditor të mirëmenduar; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -përshkrim; -rrëfim; -veprimtari; -orari; -rregull; -kompjuter; -lojë; -pushim. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; -teksti shkollor; -orari i veprimtarive të nxënësve/eve; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> -të drejtat e njeriut. 	

<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim paraprak; -rishikim në dyshe; -shkrim i lirë; -punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Diskutim paraprak:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et, të tregojnë rreth regjimit të tyre ditor, duke u drejtuar pyetjet:- A keni krijuar ju, një planifikim të ditës suaj? -A ju ndihmon zbatimi i këtij planifikimi në përmbushjen e detyrave tuaja, si dhe për të ndjekur programet për fëmijë, për të luajtur, ose për të shëtitur?</p>
--

- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim paraprak: Mësuesi/ja fton nxënësit/et, të tregojnë rreth regjimit të tyre ditor, duke u drejtuar pyetjet:-A keni krijuar ju, një planifikim të ditës suaj?

-A ju ndihmon zbatimi i këtij planifikimi në përmbushjen e detyrave tuaja, si dhe për të ndjekur programet për fëmijë, për të luajtur, ose për të shëtitur?

- **Veprimtaria e dytë**

Rishikim në dyshe: Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit.

*Komentohen ilustrimet në tekst nga nxënësit/et.

*Njihen nxënësit/et me kërkesën e ushtrimit 1.

Orientohen nxënësit/et të lexojnë fjalët ndihmëse.

Shpjegohen fjalët që ata i kanë të padëgjuaara më parë.

*Nxënësit/et punojnë individualisht për të plotësuar rrëfimin e Klestit, për veprimtaritë që kryen ai gjatë një dite, duke u bazuar te ilustrimet dhe fjalët ndihmëse.

Në përfundim, nxënësit/et shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

*Lexohet teksti i plotësuar nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e tretë**

Diskutim: Diskutohet me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es rreth veprimtarive që kryen Klesti gjatë një dite, duke theksuar rregullat, që mamaja i ka vendosur Klestit për qëndrimin në kompjuter.

-A mendoni se planifikimi i ditës së Klestit e bën atë të jetë më produktiv gjatë ditës?

-A ndihmon ky planifikim, që Klesti të gjejëkohë tëçlodhet dhe të argëtohet?

-Përse mendoni, se mamaja e Klestit insiston kaq shumë në zbatimin e rregullave, për kohën që shpenzon ai para kompjuterit, pauzat mes lojës, si dhe për lojërat që luan?

-A mendoni se kjo ndikon për mirë në shëndetin e Klestit, si dhe për të menaxhuar si duhet kohën?

- **Veprimtaria e katërt**

Shkrim i lirë: Duke u bazuar në rrëfimin e Klestit, orientohen nxënësit/et, që nëpërmjet një shkrimi të lirë, të tregojnë për rregullat të ngjashme që u kanë vendosur prindërit atyre për qëndrimin në kompjuter.

Nxënësit/et diskutojnë nën drejtimin e mësuesit/es për rregullat gramatikore që duhet të kenë parasysht gjatë të shkruarit.

Pas përfundimit të punës, nxiten nxënësit/et të lexojnë shkrimet e tyre me zë, para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-përshkrimin e veprimtarive të tij/saj ditore;

-plotësimin errëfimit duke përdorur fjalët ndihmëse dhe duke u bazuar në ilustrime;

-shkrimin e rregullave që i kanë vendosur prindërit për qëndrimin në kompjuter;

-përzgjedhjen e formës dhe gjuhës së përshtatshme për të përcjellë mendimet e tij/saj, rreth zbatimit të regjimit ditor;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-diskutimin për rëndësinë që ka organizimi i ditës, sipas një planifikimi ditor të mirëmenduar;

-qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie** Ushtrimin 2

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Dita e Klestit (ora II)		Situata e të nxënit Renditja e veprimtarive të një dite të zakonshme.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • tregon për planifikimin e tij/saj ditor (veprimtaritë që kryen gjatë ditëve të javës, duke bashkëngjitur edhe oraret përkatëse); • shkruan për veprimtaritë që kryen gjatë ditës, duke u bazuar në oraret e planit të tij/saj ditor dhe modelin e dhënë; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • vlerëson rëndësinë që ka organizimi i ditës, sipas një planifikimi ditor të mirëmunduar; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalët kyçe: -planifikim ditor; -veprimtari; -orar; -zbatim; -organizim.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -magnetofon, CD; -mjete shkrimi,lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -dëgjo-komento; -lexo-trego; -shkrim i lirë; -punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p>*Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë, ku nxënësit/et tregojnë orarin e veprimtarive të Klestit. <i>Dëgjo-komento:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të dëgjojnë në magnetofon një tekst, ku përshkruhet një ditë e zakonshme e Anit. -Ndiqni me vëmendje tekstin ku përshkruhet një ditë e zakonshme e Anit. <i>Ani e fillon ditën e tij në orën 7:00, por zakonisht atij i pëlqen të qëndrojë në shtrat edhe për disa minuta. Në orën 7:30, ai është në kuzhinë për të ngrënë mëngjesin. Në orën 7:4,5 ai del nga shtëpia për të shkuar në shkollë. Mësimi fillon në orën 8:00, por ai arrin gjithmonë pak minuta me vonesë. Pas mësimit, Ani e ka bërë zakon të luajë dhe kështu, arrin në shtëpi vonë dhe drekën e ha shumë i uritur në orën 2:00. Më pas, ai luan për një orë videolejër dhe kur vjen koha për të mësuar, ai është shumë i lodhur dhe nuk arrin t'i mësojë të gjitha mësimet. Shpesh, Ani e përgatit çantënshejt e shejt në mëngjes, duke harruar kështu, ndonjë fletore ose libër.</i> *Pasi dëgjojnë tekstin, nxiten nxënësit/et të diskutojnë rreth tij, duke iu përgjigjur pyetjeve: -A ka bërë Ani një planifikim të tijin ditor? -A ndjek ai një planifikim të rregullt ditor? -Ku duket kjo? -Si ndikon mosorganizimi i ditës sipas një planifikimi ditor të mirëmunduar?</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Lexo-trego:</i> Orientohen nxënësit/et të punojnë individualisht ushtrimin 3. Ata/ato do të shkruajnë veprimtaritë që kryejnë gjatë ditës duke i bashkëngjitur edhe oraret përkatëse, duke u ndihmuar edhe nga fotot në tekst. Pas përfundimit të punës, ftohen nxënësit/et, të tregojnë veprimtaritë që kryejnë gjatë ditës me oraret përkatëse.</p>			

- **Veprimtaria e dytë**

Lexo-trego: Orientohen nxënësit/et të punojnë individualisht ushtrimin 3. Ata/ato do të shkruajnë veprimtaritë që kryejnë gjatë ditës duke i bashkëngjitur edhe oraret përkatëse, duke u ndihmuar edhe nga fotot në tekst. Pas përfundimit të punës, ftohen nxënësit/et, të tregojnë veprimtaritë që kryejnë gjatë ditës me oraret përkatëse.

- **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i lirë: Punohet ushtrimi 4.

Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të përshkruajnë ditën e tyre.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore, duke u bazuar në oraret e planifikimit të tyre ditor dhe modelin e ushtrimit 1.

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et prezantojnë punën e tyre, duke lexuar me zë përshkrimet.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen korrigjimet e gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit/et japin mendime dhe vlerësojnë përshkrimet e shokëve e shoqeve të tyre.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-tregimin për planifikimin e tij/saj ditor (veprimtaritë që kryen gjatë ditëve të javës, duke i bashkëngjitur edhe oraret përkatëse);

-përshkrimin për veprimtaritë që kryen gjatë ditës, duke u bazuar në oraret e planit të tij/saj ditor dhe modelin e dhënë;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;

-vlerësimin e rëndësisë që ka organizimi i ditës, sipas një planifikimi ditor të mirëmenduar;

-shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë “H”-ja në arrati (ora I)		Situata e të nxënit A i shqiptojmë dhe i shkruajmë ne mirë të gjitha shkronjat e fjalëve në gjuhën shqipe?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante; • shpjegon fjalët dhe shprehjet e reja duke ndërtuar fjali me to; • tregon llojin e tekstit, duke vënë në dukje elementet fantastike të tij; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit; • dallon në tregim hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen; • tregon përmbajtjen me ndihmën e pyetjeve; • nxjerr mesazhin që përcjell tregimi; • lidh tregimin me ngjarje nga jeta e tij/saj, kur ai/ajo, apo shokët/shoqet, nuk kanë shqiptuar mirë një shkronjë të një fjale; • vlerëson rëndësinë që ka në komunikimin tonë, artikulimi dhe shkrimi i saktë i çdo shkronje të fjalëve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -shkronja “H”; -alfabeti i gjuhës shqipe; -qesënditë; -gërgisnin; -hut; -gërfaq; -holl; -hajjat; -autokritikë. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; -teksti shkollor; -alfabeti i shkronjave; -fjalor i drejtshkrimit të gjuhës shqipe; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore 	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - bisedë;
 - ndërveprim me tekstin;
 - marrëdhënie pyetje-përgjigje;
 - mendo-zbulo;
 - lojë;
 - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

Veprimtaritë e nxënësve/eve

- **Veprimtaria e parë**

*Bisedë:*Mësuesi/ja u drejton nxënësve/eve pyetjen:

-A i shqiptojmë dhe i shkruajmë ne mirë të gjitha shkronjat e fjalëve në gjuhën shqipe?

-Tregoni raste kur nuk i artikulonit mirëtingujt e njëfjale dhe se si kanë reaguar bashkëbiseduesit tuaj.

- **Veprimtaria e dytë**

*Ndërveprim me tekstin:*Nxënësit/et njihen me titullin e pjesës“**H**”-ja në arrati.

*Nxënësit/et vëzhgojnë dhe komentojnëilustrimin në libër.

*Nxënësit/et lexojnë tregimin në paragrafë në heshtje. Ata/ato nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më të rëndësishme.

*Punohet fjalori me fjalët e shprehjet e reja. Nxiten nxënësit/et tëkrijojnë fjali me to.

*Lexim zinxhir i tregimit nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e tretë**

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika „Lexoj dhe kuptoj”. Nxiten nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve rreth tregimit. Ata/ato diskutojnë në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën, rreth përgjigjeve për pyetjet e dhëna:

-Pse rrinte e heshtur dhe e veçuar “H”-ja?

-Pse shoqet mendonin se ajo ishte e parëndësishme?

-Ç’mendonte “H”-ja kur shoqet e ngacmonin?

-Çfarë vendosi “H”-ja një ditë?

-Çfarë ndodhi pas largimit të saj?

-Si vepruan shoqet e saj?

-Cilat ishin fjalët e “H”-së pasi u kthye?

*Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen duke u bazuar te pyetjet.

- **Veprimtaria e katërt**

Punë në grupe: Mendo-zbulo: Punohet rubrika “Analizoj”. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të dallojnë në tekst hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen duke i ngjyrosur me ngjyrat e rekomanduara, gjithashtu të tregojnë llojin e tekstit duke vënë në dukje elementet fantastike të tij.

(Ky është tregim fantastik, sepse shkronjat udhëtojnë, flasin, komunikojnë, sillen si njerëz: mërzhiten, pendohen, kërkajnë ndjesë, reflektojnë, etj...).

Nxënësit/et diskutojnë në grupe dhe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e pestë**

Lojë: Nisur nga tregimi, nxënësit/et në grupe gjejnëfjalë të tjera ku shkronja „H“ është e rëndësishme në formimin dhe kuptimin e fjalës dhe mungesa e saj, e deformon atë.

Nxënësit/et i lexojnë ato, krijohet një situatë gazmore në klasë, ku në fund nxënësit/et reflektojnë dhe mendojnë për rëndësinë që ka çdo shkronjë në komunikimin tonë të përditshëm.

Mesazhi: Të gjitha shkronjat e një gjuhe, kanë rëndësinë e tyre të pazëvendësueshme. Shqiptimi i tyre i saktë, na bën më të qartë dhe më të komunikueshëm.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi:** Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et për:

-leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante;

-shpjegimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja, duke ndërtuar fjali me to;

-tregimin e llojit të tekstit, duke vënë në dukje elementet fantastike të tij;

-përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;

-dallimin në tregim të hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes;

-tregimin e përmbajtjes me ndihmën e pyetjeve;

-formulimin e mesazhit që përcjell tregimi;

-lidhjen e tregimit me ngjarje nga jeta e tij/saj, kur ai/ajo, apo shokët/shoqet, nuk kanë shqiptuar mirë një shkronjë të një fjale;

-vlerësimin e rëndësisë që ka në komunikimin tonë artikulumin dhe shkrimin i saktë i çdo shkronje të fjalëve;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë “H”-ja në arrati (ora II)		Situata e të nxënës Diskutim: Roli i shkronjës „H“ si pjesë përbërëse e disa shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe (dh, sh, th, xh, zh).	
Rezultatet e të nxënës Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • gzykon rreth personazheve të tregimit, mbi bazën e veprimeve të tyre; • lidh tregimin me ngjarje nga jeta e tij/saj, kur ai/ajo, apo shokët/shoqet, nuk kanë shqiptuar mirë një shkronjë të një fjale; • tregon përmbajtjen e tregimit sipas rrjedhës së ngjarjes; • vlerëson rëndësinë që ka në komunikimin tonë artikulumin dhe shkrimin i saktë i çdo shkronje të fjalëve; • interpreton tregimin në role; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë, mendimet e tij/saj, rreth shqiptimit të saktë të shkronjave të alfabetit në çdo fjalë dhe shprehje; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalët kyçe: -shkronja “H”; -alfabeti i gjuhës shqipe.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënës/ës; -teksti shkollor; -alfabeti i shkronjave; -fjalor i drejtshkrimit të gjuhës shqipe; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

- **Metodologjia:**

- diskutim;
- harta e personazheve;
- dora e pyetjeve;
- mendo-diskuto;
- dramatizim;
- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- **Veprimtaria e parë**

Diskutim: Mësimi fillon me leximin dhe diskutimin rreth detyrave të shtëpisë, që nxënësve/eve, iu është dhënë në orën e mëparshme, ku nxënësit/et, shohin rolin e shkronjës „H“, si pjesë përbërëse e disa shkronjave në gjuhën shqipe (dh, sh, th, xh, zh).

- **Veprimtaria e dytë**

*Nxënësit/et u drejtojnë pyetje njëri-tjetrit rreth përmbajtjes së tregimit.


*Lexohet tregimi nga të gjithë nxënësit/et nëpërmjet leximit zinxhir.

Punë në grupe: Harta e personazheve: Nxiten nxënësit/et të tregojnë personazhet që marrin pjesë në tregim dhe të shkruajnë dy cilësi për to. Për secilën cilësi, shkëputet nga një pjesë ilustruese nga teksti.

Shkronja „H“

Modesteme sedër

Nuk mburrej për rëndësinë e saj.



Shoqet e „H“

shpërfillëse mburravece

Shpërfillnin rëndësinë e shkronjës “H”. Mburrnin veten e tyre.

- **Veprimtaria e tretë**

*Tregohet përmbajtja nga disa nxënës/e, sipas organizuesit grafik „Dora e pyetjeve“.

- **Veprimtaria e katërt**

Mendo-diskuto: Punohet rubrika “Reflektoj”.

*Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me mesazhet që ka dashur të përcjellë autori nëpërmjet kësaj historie.

*Nxiten nxënësit/et të japin mendimin e tyre, nëse kjo ndodhi është serioze apo gazmore, duke dhënë argumentet e tyre.

*Nxënësit/et ndajnë përvojat e tyre nga komunikimi i përditshëm lidhur me shqiptimin e drejtë të shkronjës „H“, por edhe të shkronjave të tjera.

Ata/ato diskutojnë në dyshe rreth përgjigjeve të pyetjeve, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e pestë**

Dramatizim: Nxënësit/et ndahen në grupe, përcaktojnë rolet dhe bëjnë dramatizimin e pjesës.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi:** Mësuesi/ja vlerëson nxënësit/et për:

- leximin e tekstit në mënyrë të rrjedhshme dhe me intonacionin e duhur;
- grykimin rreth personazheve të tregimit, mbi bazën e veprimeve të tyre;
- tregimin e përmbajtjes sipas rrjedhës së ngjarjes;
- lidhjen e tregimit me ngjarje nga jeta e tij/saj, kur ai/ajo, apo shokët/shoqet, nuk kanë shqiptuar mirë një shkronjë të një fjale;

-vlerësimin e rëndësisë që ka në komunikimin tonë artikulimi dhe shkrimi i saktë i çdo shkronje të fjalëve;

-interpretimin në role;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj, rreth shqiptimit të saktë të shkronjave të alfabetit, nëçdo fjalë dhe shprehje;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie**

Krijo 4 fjali me fjalë që kanë si shkronjë nistore “H” dhe 4 fjali me fjalë ku shkronja “H” është pjesë përbërëse e disa shkronjave të tjera të alfabetit të gjuhës sonë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm (ora I)		Situata e të nxëniet Manipulime me fjalë për të dalluar emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm.	
Rezultatet e të nxëniet Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përkufizon emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm; • dallon emrat e përgjithshëm dhe emrat e përveçëm, në fjali dhe tekste; • shkruan emra të përveçëm duke zbatuar rregullat drejtshkrimore të shkrimit të tyre; • krijon fjali me emra të përgjithshëm dhe emrave të përveçëm; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e të tjerëve. 		Fjalë kyçe: -emra të përgjithshëm; -emra të përveçëm; -shkronjë e madhe.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me emra të përgjithshëm dhe të përveçëm; -mjete shkrimi, lapustilë, tabakë letre, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve <ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim paraprak; -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e parë <i>Diskutim paraprak:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et, të vërejnë figurat në tekst. Tërhiqet vëmendja në fjalët e shkruara në secilën figurë. -Si mendoni, çfarë tregojnë fjalët: <i>vajzë, qen, qytet?</i> -Po fjalët: <i>Viola, Umi, Shkodra?</i> Lexohet rubrika “Kujtoj”. Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve/eve për kuptimin e emrave të përgjithshëm dhe të përveçëm. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Punë në dyshe:</i> Ushtrimi 1. Njihen nxënësit/et me kërkesën e ushtrimit. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të lexojnë emrat në libër dhe të dallojnë emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm. Më pas udhëzohen ata/ato të lidhin sipas modelit të dhënë secilin nga emrat e përgjithshëm me një emër të përveçëm. Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në dyshe, më pas zhvillohet një diskutim me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 2, synon që nxënësit/et të dallojnë emrat e përgjithshëm nga emrat e përveçëm dhe të drejtshkruajnë emrat e përveçëm. Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Ata/ato shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin dhe korrigjojnë gabimet. Zhvillohet një diskutim në klasë, nën drejtimin e mësuesit/es, duke vënë theksin se emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Shkëmbe një problemë:</i> Nxënësit/et punojnë në grupe. Ata/ato shkruajnë emra të përgjithshëm dhe të përveçëm dhe i shkëmbejnë me grupin fqinjë, për të krijuar fjali me to. Në përfundim, lexojnë fjalitë dhe japin gjykime rreth punës së të tjerëve dhe vlerësojnë njëri-tjetrin. <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -dallimin e emrave të përgjithshëm dhe emrave të përveçëm, në fjali dhe tekste; -shkrimin e emrave të përveçëm duke zbatuar rregullat drejtshkrimore të shkrimit të tyre; -krijimin e fjalive me emra të përgjithshëm dhe emra të përveçëm; -demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së të tjerëve. • Detyrë shtëpie Ushtrimi 3 			

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm(ora II)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë për të dalluar emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon emrat e përgjithshëm dhe emrat e përveçëm, në fjali dhe tekste; • shkruan emra të përveçëm duke zbatuar rregullat drejtshkrimore të shkrimit të tyre; • krijon fjali me emra të përgjithshëm dhe emra të përveçëm; • qorton gabimet drejtshkrimore në shkrimin e emrave të përveçëm; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve dhe të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -emra të përgjithshëm; -emra të përveçëm; -shkronjë e madhe.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me emra; -fisha me fjali; -mjete shkrimi,lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -dallo-trego; -shkrim i drejtuar; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. Nxiten nxënësit/et të lexojnë fjalitë dhe të identifikojnë emrat e përgjithshëm dhe emrat e përveçëm. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>*Dallo-trego:</i> Nxënësit/et punojnë në grupe ushtrimin 4. Njihen nxënësit/et me kërkesën e ushtrimit. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et që në tekstin e dhënë, të nënvizojnë emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm dhe t'i shkruajnë në tabelë të ndara sipas përkatësisë. Zhvillohet një diskutim në klasë rreth ushtrimit, nën drejtimin e mësuesit/es. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Shkrim i drejtuar:</i> Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 5. Nxiten ata/ato të lexojnë emrat e përgjithshëm dhe të shkruajnë nga tre emra të përveçëm për secilin prej tyre. Në përfundim të punës, nxënësit/et lexojnë emrat e përveçëm që kanë gjetur për çdo emër të përgjithshëm. Zhvillohet një diskutim në klasë rreth ushtrimit nën drejtimin e mësuesit/es. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Punë në grupe:Shkëmbe një problemë:</i>Nxënësit/et punojnë në grupe. Secili nga grupet shkruan në fleta nga 3 emra të përgjithshëm dhe 3 emra të përveçëm dhe ia jep grupit fqinjë të krijojë fjali me to. Përfaqësuesit e grupeve, lexojnë fjalitë e krijuara para klasës. Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin. <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -dallimin e emrave të përgjithshëm dhe të përveçëm në fjali dhe tekste; -shkrimin e emrave të përveçëm duke zbatuar rregullat drejtshkrimore për shkrimin e tyre; -krijimin e fjalive me emra të përgjithshëm dhe emra të përveçëm; -qortimin e gabimeve drejtshkrimore në shkrimin e emrave të përveçëm; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve; -vlerësimin e punës së shokëve dhe të shoqeve. • Detyrë shtëpie Shkruaj një tekst me temë“Filmi vizatimor që më ka pëlqyer më shumë”me 7-8 fjali, ku të përdorësh emra të përgjithshëm dhe emra të përveçëm. 			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Në strofkën e Lepurit (ora I)		Situata e të nxënit Shikim i sekuencave nga filmi „Liza në botën e çudirave”.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon pjesën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i bëjnë më shumë përshtypje; • tregon si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë pjesën; • pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tregimit ose rreth fjalëve të panjohura për të; • shpjegon fjalë të reja, duke ndërtuar fjali me to; • jep parashikimet e veta në lidhje me vazhdimin e tregimit; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit; • tregon përmbajtjen e tregimit mbi bazën e pyetjeve; • shprehndjenjat dhe emocionet e tij/saj, në lidhje me aventurën e Lizës; • pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tregimin; • demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup. 		Fjalë kyce: -Liza; -kopsht; -strofkë; -lepur; -tog; -kthinë; -erashkë; -shpëtova për qime; -shend e verë; -i beftë.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -libri „Liza në botën e çudirave“; -videoprojektor; material filmik; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -edukim fizik, sporte dhe shëndet; -teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -shikim i organizuar; -lexim dhe mendim i drejtuar; -hulumtim; -karrigia e autorit; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Shikim i organizuar:</i> Paraqiten me anë të videoprojektorit, disa sekuenca nga filmi për fëmijë “Liza në botën e çudirave”. Zhvillohet një diskutim i shkurtër me nxënësit/etrreth filmit. (Në mungesë të videoprojektorit, nxënësit/et flasin rreth filmit që ata e kanë parë). <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Lexim dhe mendim i drejtuar:</i> Nxënësit/et njihen me titullin e pjesës “Në strofkën e Lepurit” të autorit L. Karol, të marrë nga libri: “Liza në botën e çudirave”. <i>*Nxiten nxënësit/et të vërejnë ilustrimin dhe të tregojnë si i ndihmon ai, për të kuptuar më mirë pjesën. Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën rreth tij.</i> <i>*Udhëzohen nxënësit/et për leximin e pjesës në paragrafë.</i> <i>Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më interesante, më të rëndësishme. Më pas, nxënësit/et, iu përgjigjen pyetjeve të bëra nga mësuesi/ja.</i> Ndalesa I Liza ishte ulur... deri te... nuk i bënte asnjë brave. <i>Pyetje: -Cili i kaloi Lizës përpara?</i> <i>-Ku përfundoi Liza duke ndjekur lepurin?</i> <i>-Si mendoni se do të vazhdojë ngjarja?</i> Ndalesa II Sytë sa s’po i përloreshin... deri tek... aq e ngushtë. <i>-Çfarë pa Liza pasi hapi deriçkën e vogël?</i> <i>-Ç’ dëshirë e rrëmbeu Lizën?</i> <i>-Si mendoni, a do të kalojë Liza përmes deriçkës?</i> 			

Ndalesa III Liza mbylli derën.. deri te... Duhet të më hash.

- Çfarë gjeti Liza mbi tryezë?
- Çfarë i kujtonte Lizës shija dhe era e lëngut të shishkës?
- A mund të kalonte Liza përmes deriçkës pasi piu lëngun e shishkës? Pse?
- Pse Liza nuk mund ta merrte dot çelësin e artë?
- Çfarë pa Liza poshtë tryezës?
- Si mendoni, a do ta hajë Liza bonbonen?

Ndalesa IV Liza e hëngri dhe filloi të zgjatet... deri te...një erashkë në tjetrën.

- Ç'ndodhi me Lizën kur ajo hëngri bonbonen?
- A mundi Liza ta kalonte derën?Pse?
- Cili u shfaq para Lizës?
- Çfarë kishte Lepuri në duar?

Ndalesa V Kur Lepuri i kaloi pranë... deri në fund.

- Ç'bëri Lepuri me erashkën dhe dorezat që mbante në duar?
- Ç'ndodhi me Lizën pasi mori erashkën dhe dorezat që hodhi lepuri?
- Pse e flaku Liza erashkën?
- Çfarë tha Liza pasi flaku erashkën?
- A ju pëlqeu pjesa?Pse?
- Si u ndjetë pas leximit të kësaj pjese?
- Ç'gjë ju bëri më shumëpërshtypje?

*Nxënësit/et punojnë në dyshe fjalorin me fjalët dhe shprehjet e reja (*strofkë, tog, kthinë,erashkë, shpëtova për qime, i beftë*). Nxitenata/ato të krijojnëfjalë me to.

*U lihet kohë nxënësve/eve për ta rilexuar.

Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të krahasojnë parashikimet e tyre me tekstin.

*Nxënësit/et tregojnë llojin e pjesës, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj(tregim fantastik).

*Lexim me zë: Lexim i tregimit zinxhir nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e tretë**

*Hulumtim:*Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj” nxënësit/et punojnë në dyshe për të gjetur alternativat e sakta në fjalitë përmbledhëse rreth tregimit.

Ata/ato diskutojnë rreth ushtrimit me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

*Nxiten nxënësit/et tregojnë përmbajtjen mbi bazën e pyetjeve.

- **Veprimtaria e katërt**

Karrigia eautorit: Nxënësit/et ulen në karrigen e autorit dhe lexojnë fragmente nga libri “Liza në botën e çudirave”. Nxënësit/et i drejtojnë pyetje personit qëështë ulur në karrige, sikur të ishte ai autori i librit.

- **Vlerësimibëhet për:**

- leximin e pjesës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i bëjnë më shumë përshtypje;
- pyetjetqë bën për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tregimit, ose rreth fjalëve të panjohura për të;
- shpjegimin e fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to;
- parashikimet e dhëna në lidhje me vazhdimin e tregimit;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;
- tregimin e përmbajtjes mbi bazën e pyetjeve;
- shprehjen e ndjenjave dhe emocioneve të tij/saj, në lidhje me aventurën e Lizës;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Në strofkën e Lepurit (ora II)		Situata e të nxënit Tregim i aventurave të Lizës.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tregimin rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit; • dallon elementet fantastike në tregim; • shprehndjenjat dhe emocionet e tij/saj, në lidhje me aventurën e Lizës; • tregon përmbajtjen e tregimit mbi bazën e fjalive përmbledhëse të tij; • shkruan paragrafin hyrës të tregimit, duke menduar se këtë ngjarje po e tregon vetë Liza; • pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve rreth tregimit; • demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -Liza; -Lepuri i bardhë.	
Burimet dhe materialet didaktike: -teksti shkollor; -libri „Liza në botën e çudirave“ -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4		Lidhja me fushat e tjera -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -edukim fizik, sporte dhe shëndet.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -tregim aventurash; -lexo, përmblihdh në dyshe; -rishikim në dyshe; -shkrim i lirë; -punë individuale; punë me gjithë klasën; punë në dyshe; punë në grup. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Tregim aventurash:</i> Nxënësit/et tregojnë aventura të Lizës në botën e çudirave. • Veprimtaria e dytë *Nxënësit/et u drejtojnë pyetje njëri-tjetrit rreth përmbajtjes së tregimit. *Lexohet tregimi nga të gjithë nxënësit/et nëpërmjet leximit zinxhir. *Me anë të teknikës “<i>Lexo, përmblihdh në dyshe</i>” nxënësit/et në dyshe ndajnë tregimin në pjesëza i lexojnë dhe i përmbledhin me nga një fjali. *Tregohet përmbajtja nga disa nxënës/e, mbi bazën e fjalive përmbledhëse. • Veprimtaria e tretë *<i>Rishikim në dyshe:</i> Punohet rubrika „Analizoj“. Nxënësit/et të dallojnë elementet fantastike që gjenden në këtë pjesë, duke korrigjuar elementet fantastike që janë shkruar gabim. Nxënësit/et shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit dhe diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth detyrës. • Veprimtaria e katërt <i>Shkrim i lirë:</i> Rubrika “Shkruaj”. Nxënësit/et individualisht do të shkruajnë sërish paragrafët me ngjyrëblu duke menduar se këtë ngjarje po e tregon vetë Liza. Shkrimi do të fillojë me fjalët: <i>Isha ulur këtu, kur më kaloi përpara Lepuri i Bardhë me sy rozë.</i> Nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es, bëhen qortimet e gabimeve të thjeshta drejtshkrimore. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. • Vlerësimi bëhet për: -leximin e tregimit rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit; -dallimin e elementeve fantastike në tregim; -shprehjen endjeshme dhe emocioneve të tij/saj, në lidhje me aventurën e Lizës; -tregimin e përmbajtjes së tregimit mbi bazën e fjalive përmbledhëse të tij; -shkrimin e paragrafit hyrës të tregimit, duke menduar se këtë ngjarje po e tregon vetë Liza; -demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve. • Detyrë shtëpie Shkruaj në fletore përmbledhjen e tregimit. 		Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut.	

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Në muzeun e çokollatave (ora I)		Situata e të nxënit A do të dëshiroje të vizitoje muzeun e çokollatave?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon karakteristikate një tregimi fantastik; përdor elemente fantastike për të shkruar një tregim fantastik; shkruan një tregim fantastik, duke u mbështetur në pyetjet, ilustrimet dhe fjalë ndihmëse; shkruan duke respektuar strukturën hyrja- zhvillimi-mbyllja; respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; shfaqbesim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; bën qortimin e gabimeve drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyce: -tregim fantastik; -elemente fantastike; -personazh fantastik; -hyrja; -zhvillimi; -mbyllja; -muzeu i çokollatave; -dhoma e çuditshme.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -tregime fantastike; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut.	
<ul style="list-style-type: none"> Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -përvijim i të menduarit; -diskutim; -shkrim i lirë; -punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <p><i>Përvijim i të menduarit:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et, të flasin për çokolllatat që ata kanë marrë mes dhuratave të tjera për ditëlindje. Nxiten nxënësit/et të flasin rreth tyre.</p> <p style="text-align: center;">produkt ushqimor me bazë kakao me vlera ushqyese</p> <p style="text-align: center;">drejtkëndore</p> <pre> graph TD C[çokolllatat] --> F[format] C --> M[madhësia] C --> S[shija] C --> P[përdoret] F --> K[katrore] F --> RM[rrethore të mëdha] F --> SL[si lule, si makinë] S --> SK[si kukull me bajame me lajthitorta me vanilje] S --> ML[me mente me luleshtrydhe] M --> TV[të vogla] M --> SM[shumë të mëdha] P --> B[biskota] P --> AK[akulllore ëmbëlsira] </pre> <p>-A do të dëshironit që gjithë këto çokolllata t'i kishit në një muze? Si e përfytyroni ju atë?</p> <p>Nxiten nxënësit/et të flasin sipas fantazisë së tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaria e dytë <p><i>Diskutim:</i> Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit. Komentohen ilustrimet në tekst nga nxënësit/et. Nxiten nxënësit/et të tregojnë elementet e një tregimi fantastik: <i>personazhe, vend, kohë, ose ngjarje fantastike (të paktën një prej këtyre elementeve).</i> Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et duke u nisur nga teksti, të dallojnë karakteristikat e hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes së tregimit fantastik. Në dyshe nxënësit/et diskutojnë për të ndërtuar subjektin e tregimit fantastik, për personazhet që marrin pjesë (kryesore, dytësore, episodike), kohën, vendin ku zhvillohet ngjarja e tregimit fantastik. Nxënësit/et shkruajnë përgjigjet e pyetjeve, duke u bazuar në alternativat e dhëna.</p>			

- **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i lirë: Ushtrimi 1. Orientohen nxënësit/et që të shkruajnë të plotë tregimin në fletore. Mësuesi/ja i ndihmon ata, që t'i përmbahen rregullave të një tregimi fantastik, për të cilat u fol më lart. Pas përfundimit të punës, nxiten nxënësit/et të lexojnë tregimet e tyre me zë para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es, bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore. Nxënësit/et vlerësojnë shkrimet e njëri-tjetrit: subjektin më tërheqës, personazhet më interesante, përshkrimet e bëra, fjalorin e përdorur, ndërtimin e fjalisë, etj...

Në muzeun e çokollatave

Pasi mbaroi shkolla, gjatë pushimeve të verës, bashkë me familjen time/shokët e mi, vendosëm të vizitonim muzeun e çokollatave. Ai ndodhet në një qytet që është dy orë larg qytetit tim. U nisëm herët në mëngjes dhe arritëm atje në kohën e duhur.

U futëm në muze dhe të gjithë bashkë shikonim të mahnitur shumëllojshmërinë e formave dhe ngjyrave të çokollatave, lexonim historikun e tyre dhe përpiqeshim t'i shpëtonim tundimit për t'i prekur dhe shijuar ato. Ato kishin forma lulësh, zogjsh, frutash, delfinësh, makinash, shtëpish, këshqjellash, madje dhe njerëzish. Ishin të mëdha, të vogla, të larta e të ulta.

Në atë çast, pranë nesh u shfaq një burrë me mjekër që mbante në dorë një shportë me çokollata. Ai na mblodhi rreth vetes dhe na gostiti me to. Sapo i futëm në gojë për t'i shijuar, vumë re se të gjitha çokollatat u vunë në lëvizje: njerëzit bisedonin me njëri-tjetrin, makinat e trenat filluan lëvizjen, gjethet e lulet po lëkundeshin, zogjtë dhe fluturat filluan fluturimin. Kafshët po zgjoheshin nga gjumi i gjatë.

Në fillim u gëzuam nga kjo që ndodhi. Por më pas, çudia dhe frika na pushtoi. Nuk dinim ç'të bënim. Të trembur siç ishim, i gëlltitëm menjëherë. Si me magji, çdo gjë u kthye si më parë. Nuk po u besonim syve.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e karakteristikave të një tregimi fantastik;
- përdorimin e elementeve fantastike për të shkruar një tregim fantastik;
- shkrimin e një tregimi fantastik, duke u mbështetur në pyetjet, ilustrimet dhe fjalë ndihmëse;
- shkrimin duke respektuar strukturën hyrja-zhvillimi-mbyllja;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues, gjatë procesit të të shkruarit;
- qortimin e gabimeve drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- vlerësimin e shkrimeve tëshokëve e të shoqeve.

Tema mësimore Shkruajmë Në muzeun e çokollatave (ora II)	Situata e të nxënit Shkrim i një tregimi të shkurtër fantastik.
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon karakteristikat e një tregimi fantastik; • përdor elementet fantastike për të shkruar një tregim të shkurtër fantastik; • shkruan një tregim të shkurtër fantastik sipas fantazisë së tij, duke përdorur elementet fantastike. • shkruan duke respektuar strukturën hyrja-zhvillimi-mbyllja; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • bën qortimin e gabimeve drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 	Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -tregim fantastik; -elemente fantastike; -hyrja; -zhvillimi; -mbyllja; -fantazi.
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -tregime fantastike; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4. 	Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> -të drejtat e njeriut -mjedisi.

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim paraprak;
 - shkrim i lirë;
 - konkurs;
 - punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim paraprak: Nxiten nxënësit/et të tregojnëse ç' dinë për tregimin fantastik.

Mendimet e tyre, mësuesi/ja i paraqet në mënyrë grafike në tabelë.

hyrjapersonazhet

zhvillimi

mbylljakoha

ngjarja



- **Veprimtaria e dytë**

Shkrim i lirë: Orientohen nxënësit/et që nëpërmjet një shkrimi të lirë të shkruajnë një tregim fantastik me një nga temat e dhëna në tekst „Në det“, „Kështjella“, „Një udhëtim“.

Ndahet klasa në 3 grupe. Secili grup punon nga një temë.

Mësuesi/ja jep udhëzimet e duhura për shkrimin e një tregimi të shkurtër fantastik ku subjekti të jetë tërheqës, personazhet interesante, rrëfimi i ngjarjes të jetë mbresëlënëse dhe me të papritura, fjalori i përdorur t'i përshtatet temës, ndërtimi i fjalive të bëhet duke respektuar rregullat gramatikore.

- **Veprimtaria e tretë**

Konkurs: Pas përfundimit të punës, nxiten nxënësit/et të lexojnë me zë para klasës tregimet e tyre fantastike të krijuara. Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë tregimet e njëri-tjetrit për: subjektin më tërheqës, personazhet më interesante, rrëfimin e ngjarjes, përshkrimet e bëra, fjalorin e përdorur, ndërtimin e fjalisë, etj...

Një juri e përbërë nga 2 nxënës/e dhe mësuesi/ja jep çmimet për 3 vendet e para.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e karakteristikave të një tregimi fantastik;
- përdorimin e elementeve fantastike për të shkruar një tregim fantastik;
- shkrimin e një tregimi fantastik sipas fantazisë së tij/saj, duke përdorur elementet fantastike;
- shkrimin duke respektuar strukturën hyrja-zhvillimi-mbyllja;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- qortimin e gabimeve drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie**

Përzgjidh një temë tjetër në ushtrimin 2 dhe shkruaj një tregim të shkurtër fantastik.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Gjinia e emrit (ora I)		Situata e të nxënit Krijimi i një harte koncepti për emrin.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> përshkruan me anë të shembujve se pjesa më e madhe e emrave që tregojnë njerëz dhe kafshë, mund të kalojnë nga gjinia mashkullore në femërore duke ndryshuar mbaresën; vë në dukje rastet kur disa emra që tregojnë njerëz, ose kafshë, ndryshojnë tërësisht kur kalojnë nga gjinia mashkullore në femërore; tregon se emrat që tregojnë sende, janë vetëm të një gjinie, duke dhënë shembuj për çdo rast; kthen emrat që tregojnë njerëz dhe kafshë nga gjinia mashkullore në gjininë femërore dhe anasjelltas; krijon fjali me emra të gjinisë mashkullore dhe emra të gjinisë femërore; demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -gjinia e emrit; -gjinia mashkullore; -gjinia femërore; -përcaktimi i gjinisë së emrit; -emra që tregojnë njerëz; -emra që tregojnë kafshë; -mbaresë; -kthim. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me emra; -tabelë në të cilën janë shkruar emra që tregojnë frymorëtë gjinisë mashkullore dhe femërore, ku vihet në dukje mbaresa e tyre; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. 	
<ul style="list-style-type: none"> Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -harta e konceptit; -analizë; -rishikim në dyshe; -diskutim; -lojë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <p><i>Harta e konceptit:</i> Nxënësit/et në grupe krijojnë një hartë koncepti për emrin. Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë para klasës punën e bërë.</p> <p>Mësuesi/ja ndalet te gjinia e emrit, për të rikujtuar njohuritë e marra rreth gjinisës së emrit, duke u mbështetur edhe në rubrikën“Kujtoj“.</p>			

- **Veprimtaria e dytë**

Analizë: Ftohen nxënësit/et të lexojnë emrat e gjinisë mashkullore dhe femërore në tabelën e dhënë në libër, të cilën mësuesi/ja e ka paraqitur në dërrasën e zezë. Orientohen nxënësit/et të dallojnë mbaresat që shërbejnë për të formuar emrate gjinisë femërore për secilin rast.

*Lexohet rubrika „*Mbaj mend*“. Tërhiqet vëmendja se *pjesa më e madhe e emrave që tregojnë njerëz dhe kafshë, mund të kalojnë nga gjinia mashkullore në femërore, duke ndryshuar mbaresën.*

Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t'u lindin nxënësve/eve.

*Mësuesi/ja u fton nxënësit/et të thonë disa emra sendesh, të cilët i shkruan në dërrasën e zezë (libri, lapsi, fletorja, çanta, etj...). Më pas, u kërkon atyre që të provojnë t'u ndryshojnë gjininë këtyre emrave. Nxënësit/et diskutojnë me njëri-tjetrin dhe me ndihmën e mësuesit/es, dalin në përfundimin se *emrat që tregojnë sende, janë vetëm të një gjinie, të gjinisë mashkullore, ose të gjinisë femërore, se ato nuk mund të kalojnë nga njëra gjini në tjetrën.*

- **Veprimtaria e dytë**

Rishikim në dyshe: Nxiten nxënësit/et të emërtojnë figurat e dhëna duke shkruar me të kuqe emrat e gjinisë femërore dhe me blu, emrat e gjinisë mashkullore. Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Ata/ato shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim në klasë rreth ushtrimeve, me ndihmën e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e tretë**

Diskutim: Ushtrimi 1. Ftohen nxënësit/et të lexojnë emrat, të dallojnë gjininë e tyre dhe të lidhin me shigjetë emrat e gjinisë mashkullore me emrat e gjinisë femërore.

Zhvillohet një diskutim me nxënësit/et rreth ushtrimit, nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e katërt**

Lojë: Nxënësit/et luajnë në dyshe, njëri thotë një emër (emra që tregojnë njerëz, ose kafshë) të gjinisë mashkullore dhe tjetri e kthen atë në gjininë femërore, ose anasjelltas.

Nxiten nxënësit/et të krijojnë fjali me to.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-përshkrimin me anë të shembujve se pjesa më e madhe e emrave që tregojnë njerëz dhe kafshë mund të kalojnë nga gjinia mashkullore në femërore, duke ndryshuar mbaresën;

-vënien në dukje të rasteve, kur disa emra që tregojnë njerëz ose kafshë, ndryshojnë tërësisht kur kalojnë nga gjinia mashkullore në femërore;

-kthimin e emrave që tregojnë njerëz dhe kafshë nga gjinia mashkullore në gjininë femërore dhe anasjelltas;

-krijimin e fjalive me emra të gjinisë mashkullore dhe emra të gjinisë femërore;

-demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie** Ushtrimi 2

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Gjinia e emrit (ora II)		Situata e të nxënësve Shndërrimi i emrave që tregojnë njerëz dhe kafshë nga gjinia mashkullore në gjininë femërore dhe anasjelltas.	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon emrat që mund të shndërrohen nga njëra gjini në tjetrën; • kthen emrat që tregojnë njerëz dhe kafshë nga gjinia mashkullore në gjininë femërore dhe anasjelltas; • krijon fjali me emra që shndërrohen nga njëra gjini në tjetrën; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • vlerëson punën e shoqeve e shoqëve. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -gjinia e emrit; -gjinia mashkullore; -gjinia femërore; -përcaktimi i gjinisë së emrit; -emra që tregojnë njerëz; -emra që tregojnë kafshë; -mbaresë; -kthim. 	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me emra; -tabelë në të cilën janë shkruar emra që tregojnë frymorëtë gjinisë mashkullore dhe femërore ku vihet në dukje mbarësia e tyre; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fisha, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p>Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë nga nxënësit/et dhe diskutimin rreth tyre.</p> <p><i>Punë në grupe:</i> Mësuesi/ja u shpërndan çdo grupi nga një fletë ku ka shkruar një tekst.</p> <p>Ai/ajo udhëzon nxënësit/et që të përcaktojnë në tekst emrat dhe gjininë e tyre, të dallojnë emrat që mund të kthehen nga gjinia mashkullore në femërore dhe anasjelltas dhe t'i shkruajnë ato.</p> <p>Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të tregojnë llojin dhe gjininë e emrave të dhënë në tabelë.</p> <p>Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të lexojnë emrat në tabelë, të tregojnë llojin dhe gjininë e tyre, duke vënë theksin se për të përcaktuar gjininë e një emri, duhet ta kthesht atë në numrin njëjës, në trajtën e shquar.</p> <p>Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Ata/ato shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.</p> <p>Zhvillohet një diskutim në klasë rreth ushtrimeve, me ndihmën e mësuesit/es.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <p><i>Shkrim i drejtuar:</i> Ushtrimi 5 synon që nxënësit/et të dallojnë në tabelën e ushtrimit 3, emrat që mund të kthehen nga njëra gjini në tjetrën dhe të krijojnë fjali me to.</p> <p>Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.</p> <p>*Pas përfundimit të punës, zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es për të dalluar rastet kur emrat mund të kthehen nga njëra gjini në tjetrën dhe kur nuk mund të kthehen.</p> <p>*Disa nxënës/e lexojnë fjalitë e krijuara prej tyre.</p> <p>*Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.</p> <p>*Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.</p>			

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: -dallimin e emrave që mund të shndërrohen nga njëra gjini në tjetrën; -kthimin e emrave që tregojnë njerëz dhe kafshë nga gjinia mashkullore në gjininë femërore dhe anasjelltas; -krijimin e fjalive me emra që shndërrohen nga njëra gjini në tjetrën; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit; -qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bëjnë me ndihmën e mësuesit/es; -demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve; -bashkëpunimin në grup për kryerjen detyrave; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve. • Detyrë shtëpie Ushtrimi 4 			
Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Ashensori i madh prej kristali(ora I)		Situata e të nxënësve Shikim i disa sekuencave nga filmi për fëmijë “Çarli dhe fabrika e çokollatës”.	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tregimin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante; • shpjegon fjalët e reja, duke ndërtuar fjalë me to; • tregon llojin e tekstit, duke vënë në dukje disa karakteristika të tij; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit; • shpreh ndjenjat dhe emocionet e tij/saj, në lidhje me tregimin fantastik; • shkruan për vendet që do të dëshironin të shkonte, duke argumentuar edhe arsyen e përzgjedhjes; • pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin që lexon; • demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup. 		Fjalë kyçe: -ashensor; -kristal; -sy vezullues; -butona.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -videoprojektor, materiali filmik; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4		Lidhja me fushat e tjera -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -teknologjia dhe TIK-u.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -shikim i organizuar; -lexim dhe mendim i drejtuar; -hulumtim; -mendo-zbulim; -shkrim i shpejtë; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Shikim i organizuar:</i>Paraqitet me anë të videoprojektorit disa sekuenca nga filmi për fëmijë “Çarli dhe fabrika e çokollatës”. Zhvillohet një diskutim i shkurtër me nxënësit/et nën drejtimin e mësuesit/es: -Ku shkoi Çarli dhe shokët e tij? -Çfarë prodhohej në fabrikë dhe kush punonte atje? -Çfarë ju bëri përshtypje fëmijëve nga mjediset prej çokollate dhe karamelë të fabrikës? -A do t’ju pëlqente edhe ju ta vizitonit këtë fabrikë? (Në mungesë të videoprojektorit, nxënësit/et flasin rreth filmit të mirënjohur nga fëmijët.) 			

- **Veprimtaria e dytë**

Lexim dhe mendim i drejtuar: Nxënësit/et njihen me titullin e pjesës “Ashensori i madh prej kritali” të autorit Roald Dahi.

Udhëzohen nxënësit/et për leximin e tekstit në paragrafë.

Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më interesante, më të rëndësishme. Më pas, nxënësit/et iu përgjigjen pyetjeve të bëra nga mësuesi/ja.

Ndalesa I Si do të veprojmë atëherë... deri tek... Ejani! Hyjmë!

Pyetje: -Ç’ mendim kishin Çarli Buketi dhe Gjyshi Xho?

-Po Majk Tivu çfarë dëshirë kishte?

-Si mendoni se do të vazhdojë ngjarja?

Ndalesa II Kapërceu korridorin...deri te...të shtypje atë buton.

-Si u hap dera?

-Si iu duk Çarli Buketit ashensori? Pse?

-Në muret dhe tavanin e kabinës së ashensorit, çfarë mund të shikoje?

Ndalesa III Ky nuk është një ashensor normal... deri në fund.

-Si mund të lëvizte ashensori?

-Si u ndie gjyshi Xhon teksa vështronte butonat e panumërt?

-Çfarë shpjegimi dha zoti Vonka për ashensorin?

-A ju pëlqeu pjesa?

-Si u ndjetë pas leximit të kësaj pjese?

-Ç’ gjë ju bëri më shumëpërshtypje?

*Nxënësit/et punojnë në dyshe, fjalorin me fjalët e reja dhe ndërtojnë fjali me to.

*U lihet kohë nxënësve/eve për ta rilexuar.

Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të krahasojnë parashikimet e tyre me tekstin.

*Nxënësit/et tregojnë llojin e tekstit, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij (tregim fantastik).

**Lexim me zë:* Organizohet lexim zinxhir nga nxënësit/et dhe më pas me role.

- **Veprimtaria e tretë**

Hulumtim: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj” nxënësit/et punojnë në dyshe për të gjetur alternativat e sakta dhe të gabuara në fjalitë përmbledhëse rreth tregimit.

Nxiten nxënësit/et të shndërrojnë pohimet e gabuara në të vërteta.

Ata/ato diskutojnë rreth ushtrimit me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

*Nxënësit/et tregojnë përmbajtjesipas fjalive përmbledhëse të tregimit.

- **Veprimtaria e katërt**

Mendo-zbulo: Punohet rubrika “Analizoj”.Nxënësit/et do të dallojnë një nga elementet fantastike të këtij tregimi, duke nënvizuar në tekst pjesën ku përshkruhet ai.Nxiten nxënësit/et, tëpunojnë në grupe.

Përfaqësuesit/et e grupeve prezantojnë para klasës punën e secilit grup.

- **Veprimtaria e pestë**

Shkrim i shpejtë: Punohet rubrika “Shkruaj”. Nxënësit/et,individualisht, shkruajnë një listë me emrat e dhjetë vendeve, në të cilat do të donin të shkonin, duke treguar edhe arsyen e përzgjedhjes së këtyre vendeve për të vizituar.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimibëhet për:**

-leximin e tregimit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;

-shpjegimin e fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to;

-tregimin e llojit të tekstit, duke vënë në dukje disa karakteristika të tij;

-përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;

-shkrimin për vendet që do të dëshironte të shkonte, duke argumentuar edhe arsyen e përzgjedhjes;

-shprehjen e ndjenjave dhe emocioneve tëtij/saj, në lidhje me tregimin fantastik;

-demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj si mund të vazhdojë ngjarja.

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Ashensori i madh prej kristali (ora II)		Situata e të nxënit Rrëfim i vazhdimit të ngjarjes.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tregimin rrjedhshëm dhe në mënyrë shprehëse; • tregon përmbajtjen e tregimit sipas rrjedhës së ngjarjes; • shkruan sipas fantazisë së tij/saj, se ku do të donin që t'i çonte ashensori , në rast se do tëndodheshin brenda tij; • interpreton në role tregimin; • pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve rreth tregimit; • demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup; • vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalë kyçe: -ashensor; -kristal; -sy vezullues; -butona.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -tregime fantastike; -mjete shkrimi,lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim; -përmbledhje sipas disa fjalive kryesore; -intepretim në role; -bashkëbisedim; -shkrim i shpejtë; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë.Nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre rreth vazhdimit të ngjarjes në tregim, mbi bazën e fantazisë së tyre. • Veprimtaria e dytë <i>Përmbledhje sipas disa fjalive kryesore:</i>Nxënësit/et u drejtojnëpyetje njëri-tjetrit rreth përmbajtjes së tregimit. *Lexohet tregimi nga të gjithë nxënësit/et nëpërmjet leximit zinxhir. *Nxiten nxënësit/et të tregojnë përmbajtjen e tregimit duke umbështetur në pohimet e vërteta të ushtrimit 1. • Veprimtaria e tretë <i>Interpretim në role:</i> Ndahet klasa në grupe me ndihmën e mësuesit/es. Caktohen rolet brenda grupit. Interpretim i tregimit nga nxënësit/et në role. Nxënësit/et vlerësojnë intepretimet e shokëve e të shoqeve. • Veprimtaria e katërt <i>Bashkëbisedim:</i>Punohet rubrika “Reflektoj”.Nxiten nxënësit/et të japin përgjigje, sipas imagjinatës së tyre, se cilin buton zgjodhën personazhet e tregimit dhe ku i çoi ai? • Veprimtaria e pestë <i>Shkrim i shpejtë:</i> Nxënësit/et përdorin imagjinatën e tyre, për të treguar me 5-6 fjali, se ku do të donin t'i çonte një ashensor i tillë ata/ato. Pas përfundimit të punës, nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. • Vlerësimibëhet për: -leximin e tregimit rrjedhshëm dhe në mënyrë shprehëse; -tregimin e përmbajtjes së tregimit sipas rrjedhës së ngjarjes; -leximin në role tëtregimit; -shkrimin sipas fantazisë së tij/saj, se ku do të donin që t'i çonte ashensori, në rast se do të ndodheshin brenda tij; -demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup; -vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit. 			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Makina çudibërëse (ora II)		Situata e të nxënët Imagjino sikur njëlodër e jotja tëkishte fuqi magjike. Përshkruaje atë.	
Rezultatet e të nxënët Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan sipas fantazisë dhe imagjinatës një lodër me fuqi magjike; • përdor fantazinë dhe imagjinatën për të shkruar për ndodhitë me lodrën e tij/saj, me fuqi magjike; • shkruan një tregim të shkurtër sipas fantazisë dhe imagjinatës, duke përdorur elemente fantastike dhe • shkruan duke respektuar strukturën e tregimit hyrja-zhvillimi-mbyllja; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • qorton gabime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • vlerësonpunën e shokëve etë shoqeve. 		Fjalët kyçe: -përshkrim; -lodra me fuqi magjike; -ndodhi.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -libra, tregime fantastike; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -imagjinatë e drejtuar; -harta e konceptit; -shkrim i lirë; -konkurs; -punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Imagjinatë e drejtuar:</i> Nëpërmjet imagjinatës së drejtuar, ftohen nxënësit/et të imagjinojnë sikur kanë një lodër, e cila ka fuqi magjike dhe ta përshkruajnë atë. -Mbyllni sytë për disa çaste dhe përfytyroni sikur keni një lodër, e cila ka fuqi magjike! Si është ajo? -Çfarë është në gjendje të bëjë ajo? -Tani hapni sytë dhe përshkruajeni atë. • Veprimtaria e dytë <i>Harta e konceptit:</i> Nxiten nxënësit/et të punojnë në grupe, për të plotësuar hartën e konceptit për tregimin fantastik. <div style="text-align: center;"> <pre> graph LR TF(tregimi fantastik) --> S(struktura) TF --> EF(elementet fanatastike) S --> M(mbyllja) S --> K(koha) S --> N(ngjarja) EF --> H(hyrja) EF --> P(personazhet) EF --> Z(zhvillimi) EF --> V(vendi) </pre> </div>			
<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Shkrim i lirë:</i> Ushtrimi 2. Orientohen nxënësit/et, që nëpërmjet një shkrimi të lirë të shkruajnë një tregim të shkurtër, sipas imagjinatës dhe fantazisë së tyre për një ndodhi me lodrën e tyre me fuqi magjike. Mësuesi/ja jep udhëzimet e duhura për shkrimin e një tregimi të shkurtër sipas imagjinatës dhe fantazisë së nxënësve/eve. 			

Makina çudibërëse

Në fundjavë ftova në shtëpi shokun tim të bankës, Marselin. Po luanim në dhomën time, kur befas dëgjuam një zhurmë të çuditshme. Ajo ishte një zhurmë që na tërhoqi vëmendjen. E mprehtë, e vazhdueshme dhe alarmuese.

Unë e njihja mirë atë zhurmë, ndërsa Marseli, u shqetësua dhëmë pyeti: - Nga erdhi kjo zhurmë? Kush po bën kështu?

- Më duket se vjen nga kuzhina. Ndonjëherë ora e furrës e ndryshon tingullin.

Përgjigjja ime nuk e bindi. Tundi kokën me mosbesim dhe heshti. Më në fund vendosa t'ia tregoja Marselit sekretin tim. Nga sirtari nxora një makinë të kuqe.

- Kjo makinë e bëri atë zhurmën, - i thashë Marselit.

E shtyva makinën që lëshoi një zhurmë të ulët, por më të njëjtin tingull.

Kuptova që as ky veprim nuk e bindi, kështu që zgjata gishtin te njëri nga butonat e makinës. Sipër butonit ishte shkruar shkronja "N". Me këtë shkronjë, unë kuptoja "Nisu".

Sa e shtypa, makina lodër u transformua në makinën magjike që më çon kudo ku kam dëshirë. Ajo duket si anije kozmike, pasi ka formë stërgjatëshe dhe dy krahë të kuq të harkuar. Brenda saj, gjenden shumë butona me ngjyra të ndryshme, dy ndenjësë rrotulluese dhe plot drita që pulsojnë.

Unë hyra brenda makinës magjike dhe ftova edhe Marselin. Kur zuri vend pranë meje, e pyeta se ku donte të shkonte.

- Hm... mes palmave, arrave të kokosit, majmunëve dhe... nëxhungëëëëëëëëëëëë.

Pa mbaruar fjalinë, makina ishte nisur.

Ne përjetuam një udhëtim të paharrueshëm. Ajo ditë mbetet një nga ditët më të veçanta të miqësisë sime me Marselin.

• **Veprimtaria e katërt**

Konkurs: Pas përfundimit të punës, nxiten nxënësit/et të lexojnë me zë para klasës tregimet e tyre të krijuara sipas imagjinatës dhe fantazisë.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë tregimet e njëri-tjetrit për subjektin më tërheqës, përshkrimet e bëra, fjalorin e përdorur, ndërtimin e fjalisë, etj...

Një juri e përbërë nga dy nxënës/e dhe mësuesi/ja jep çmimet për trevendet e para.

Vlerësimi bëhet për:

-përshkrimin sipas fantazisë dhe imagjinatës të një lodre me fuqi magjike;

-fantazinë dhe imagjinatën e përdorur për të shkruar për ndodhitë me lodrën e tij/saj me fuqi magjike;

-shkrimin e një tregimi të shkurtër sipas fantazisë dhe imagjinatës, duke përdorur elemente fantastike;

-shkrimin e tregimit duke respektuar strukturën hyrja-zhvillimi-mbyllja;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues, gjatë procesit të të shkruarit;

-qortimin e gabimeve drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

• **Detyrë shtëpie**

Shkruaj një tregim të shkurtër fantastik, ku në qendër të jetë një objekt me fuqi magjike.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Numri i emrit (ora I)		Situata e të nxënit Manipulim me fjalë për të shndërruar emrat nga numri njëjës në numrin shumës dhe anasjelltas.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon emrat e numrit njëjës dhe emrat e numrit shumës, në fjali e tekste; • vë në dukje raste të emrave që nuk ndryshojnë, kur kthehen nga numri njëjës në numrin shumës; • kthen emrat e numrit njëjës në numrin shumës dhe anasjelltas; • shkruan fjali duke përdorur emra në numrin njëjës dhe emra në numrin shumës; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -numri i emrit; -numri njëjës; -numri shumës.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabelë në të cilën janë shkruar emra në numrin njëjës dhe në numrin shumës, ku vihen në dukje mbaresat e tyre; -fisha me fjalë e fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë Mësuesi/ja fton nxënësit/et të vërejnë figurat në tekst dhe të diskutojnë rreth tyre. Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë emrat e numrit njëjës (<i>nxënësi, nxënësj</i>) dhe emrat e numrit shumës (<i>nxënësit, nxënëset</i>). Rikujtohen njohuritë e marra rreth numrit të emrit, duke lexuar rubrikën “Kujtoj”. *Ftohen nxënësit/et të lexojnë emrat e gjinisë mashkullore dhe femërore të numrit njëjës dhe shumës në tabelën e dhënë në libër, të cilën edhe mësuesi/ja e ka paraqitur në dërrasën e zezë. Orientohen nxënësit/et të dallojnë mbaresat që shërbejnë për të formuar shumësin e emrave të gjinisë mashkullore dhe femërore. *Vihet në dukje, se <u>disa emra, nuk ndryshojnë kur kthehen nga numri njëjës në numrin shumës.</u> p.sh.: (<i>një këngë</i> - (<i>disa këngë</i>). *Lexohet rubrika „Mbaj mend“. Tërhiqet vëmendja, se <u>kur emrat kalojnë nga numri njëjës në shumës, mbaresa e tyre ndryshon.</u> Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve/eve. *Kërkohen shembuj nga nxënësit/et. • Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 1 synon, që nxënësit/et të dallojnë emrat e numrit njëjës dhe të numrit shumës. Ushtrimi 2 synon, që nxënësit/et të kthejnë në numrin shumës, emrat e numrit njëjës. Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të kthejnë në numrin shumës, emrat e numrit njëjës të gjinisë mashkullore. Nxënësit/et punojnë individualisht në libër me laps. Ata/ato shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es, rreth ushtrimeve. Theksohet fakti se <i>disa emra të gjinisë mashkullore kur kthehen në numrin shumës, mbarojnë me -e.</i> 			

• **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 4 synon që nxënësit/et të krijojnë fjali me emrat: *anije, pallto, lule*, në numrin njëjës dhe shumës.

Nxënësit/et punojnë individualisht.

Në përfundim të punës lexojnë fjalitë para klasës.

Theksohet fakti, se *këto fjalë, shkruhen njëlloj si në numrin njëjës dhe në numrin shumës.*

Me ndihmën e mësuesit/es, bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

• **Vlerësimi bëhet për:**

-dallimin e emrave të numrit njëjës dhe emrave të numrit shumës, në fjali e tekste;

-vënien në dukje të rasteve të emrave, që nuk ndryshojnë kur kthehen nga numri njëjës në numrin shumës;

-kthimin e emrave të numrit njëjës në numrin shumës dhe anasjelltas;

-shkrimin e fjalive duke përdorur emra në numrin njëjës dhe emra në numrin shumës;

-qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;

-demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

• **Detyrë shtëpie**

Shkruaj 5 emra në numrin njëjës. Ktheji ato në numrin shumës. Krijo fjali me to.

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Numri i emrit (ora II)		Situata e të nxënit Manipulim me fjalë për të shndërruar emrat nga numri njëjës në numrin shumës dhe anasjelltas.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon emrat e numrit njëjës dhe emrat e numrit shumës, në fjali e tekste; • kthen emrat e numrit njëjës në numrin shumës dhe anasjelltas; • shkruan fjali duke përdorur emra në numrin njëjës dhe emra në numrin shumës; • analizon emrat sipas llojit, gjinisë, numrit të tyre; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalë kyçe: -numri i emrit; -numri njëjës; -numri shumës.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me emra në numrin njëjës dhe shumës; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim;
 - rishikim në dyshe;
 - analizë;
 - shkëmbe një problemë;
 - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim: Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë dhe diskutim rreth tyre.

Punë në dyshe: Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve/eve fisha ku janë shkruar emra në numrin njëjës, apo në numrin shumës. Ai/ajo fton nxënësit/et të kthejnë emrat e numrit njëjës në numrin shumës dhe anasjelltas. Pas përfundimit të punës, zhvillohet një diskutim në klasë, nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e dytë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 5 synon që nxënësit/et të nënvizojnë emrat në dy paragrafët e parë të tekstit, me titull: „Ashensori i madh prej kristali“ dhe t’i klasifikojnë ato sipas numrit të tyre.

Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Ata/ato shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e tretë**

Analizë: Ushtrimi 6 synon që nxënësit/et të analizojnë emrat: *police, breshkë, lexueset, lajmëtarët*, duke treguar llojin, gjininë, numrin e tyre. Nxiten nxënësit/et të punojnë individualisht. Në përfundim, zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimit.

- **Veprimtaria e katërt**

Shkëmbe një problemë: Ftohen nxënësit/et të punojnë në grupe. Ndahet klasa në 6 grupe.

Ata/ato do të shkruajnë në tabakë letre 5 emra, (3 grupet e para do të shkruajnë emra në numrin njëjës, 3 grupet e dyta do të shkruajnë emra në numrin shumës). Udhëzohen nxënësit/et, t’i kthejnë emrat në numrin shumës (3 grupet e para) ose në numrin njëjës (3 grupet e dyta) dhe të krijojnë fjali me to.

Në përfundim të punës përfaqësuesit e çdo grupi paraqesin punën e bërëpara klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e emrave të numrit njëjës dhe emrave të numrit shumës, në fjali e tekste;
- kthimin e emrave të numrit njëjës në numrin shumës dhe anasjelltas;
- shkrimin e fjalive duke përdorur emra në numrin njëjës dhe emra në numrin shumës;
- analizën e emrave sipas llojit, gjinisë, numrit të tyre;
- qortimete thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave;
- vlerësimin e punës së shokëve e shoqeve.

- **Detyrë shtëpie:**

Shkruajnë një tekst të shkurtër me 7-8 fjali, me temë “Ditëlindja ime“, ku të përdorësh emra në numrin njëjës dhe në numrin shumës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Lexim jashtëklase (sipas zgjedhjes së mësuesit/es)		Fjalë kyçe	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëgjëza etj. (sipas pjesës që do ketë zgjedhur mësuesi/ja) • përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive. (sipas pjesës që do ketë zgjedhur mësuesi/ja) • përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon, se cilët janë personazhet e preferuara; • tregon interes dhe dëshirë për të lexuar; • shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit; • ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit; • pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë. 		Situata e të nxënit Leximi i librave jashtëklase	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es - libra jashtëklase 		Lidhja me fushat e tjera: Lidhja me temat ndërkurrikulare:	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia: diskutim, bisedë, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. <p>Veprimtaritë e nxënësve/eve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i titullit të librit dhe autori. • Leximi i pjesës. • Pyetje për llojin e pjesës dhe brendinë e saj. • Komenti i fragmentit që pëlqejnë më shumë. • Tregimi i brendisë së pjesës. • Personazhet dhe cilësitë e tyre. • Mesazhi që përcjell pjesa. • Lidhja e këtij mesazhi me jetën e tyre. • Ilustrim i pjesës me vizatim. <p>Vlerësimi bëhet për rezultatet që u arritën gjatë kësaj ore.</p> <p>Shënim: Disa rubrika të kësaj ore nuk janë plotësuar, pasi ato ndryshojnë në varësi të pjesës që do të zgjedhë mësuesja për të punuar.</p>			

Fusha; Gjuhët dhe komunikimi	Lënda; Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Diktim		Fjalë kyçe drejtshkrim, diktim, shkronjë e madhe, shenjë pikësimit, thonjëza.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: -shkruan një tekst me të diktuar; -përdor shenjat e pikësimit(pikë, pikëpyetje dhe pikëçuditëse në fund të fjalisë); - përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe në emrat e përveçëm; -zbaton rregullat drejtshkrimore në shkrimin e titujve të librave, filmave, këngëve, të emrave të shkollave, rrugëve, institucioneve, etj...; -shkruan saktë emrat e përgjithshëm dhe ato të përveçëm, emrat e numrit njëjës dhe ato të numrit shumës; -bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es.		Situata e të nxënit Shkrimi i një pjese me të diktuar	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -fletore, mjete shkrimi.		Lidhja me fushat e tjera	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: stuhi mendimesh, diskutim, punë individuale. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • <i>Stuhi mendimesh:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et për të treguar rregullat drejtshkrimore që dinë, (përdorimi i shkronjës së madhe, shenjate pikësimit në fund të fjalive, etj...). • Mësuesi/ja dikton pjesën. • Bëhet korrigjimi i diktimit me ndihmën e mësuesit/es. • Qortohen gabimet e bëra duke i shkruar përsëri saktë. <p>Vlerësimet bëhen për:</p> <p>-shkrimin e një teksti me të diktuar; -përdorimin e shenjave të pikësimit(pikë, pikëpyetje dhe pikëçuditëse në fund të fjalisë); -përdorimin e shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe në emrat e përveçëm; -zbatimin e rregullave drejtshkrimore në shkrimin e titujve të librave, filmave, këngëve, të emrave të shkollave, rrugëve, institucioneve, etj...;</p> <p>-shkrimin e saktë të emrave të përgjithshëm dhe të përveçëm, emrave të numrit njëjës dhe ato të numrit shumës; -qortimet e thjeshta drejtshkrimore,që bën me ndihmën e mësuesit/es.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Detyrë shtëpie <p>Mësoni 5 fjali përmendësh, nga pjesa “Në strofkën e lepurit” dhe bëjeni vetëdiktim.</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Vlerësim njohurish 1		Fjalë kyçe Vlerësim njohurish 1, test, plotëso, përcakto, kthe, analizo, shkruaj.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: - plotëson kërkesat e ushtrimeve në tekst; - shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; - respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.		Situata e të nxënit Vlerësim njohurish 1	
Burimet dhe materialet didaktike: - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; - fletët e testit, mjetet e shkrimit.		Lidhja me fushat e tjera: - shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: <ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia: bisedë, punë individuale e pavarur. Veprimtaritë e nxënësve/eve <ul style="list-style-type: none"> • Mësuesi/ja shpërndan fletët e vlerësimit të njohurive. Fton nxënësit/et të lexojnë kërkesat dhe të pyesin për paqartësitë. Udhëzon për punë të pavarur. • Në përfundim të testit, mblidhen fletët dhe bëhet zgjidhja e tij në tabelë, duke diskutuar me nxënësit/et. Vlerësimi bëhet për: -plotësimin e kërkesave të ushtrimeve në tekst; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.			

PLANIFIKIMI METODIK I PROJEKTIT					
Titulli i projektit	Festojmë së bashku Ditën e Flamurit		Kohëzgjatja	1 orë --Gjuhë shqipe (të shkruarit)	
				1 orë --Gjuhë shqipe (të shkruarit)	
Lënda: Gjuhë shqipe		Mësuesi:		1 orë --Gjuhë shqipe (të lexuarit)	
				1 orë --Gjuhë shqipe (të lexuarit)	
Lidhja me fushat e tjera:	Arte, Teknologjia dhe TIK-u,		Klasa:	E katërt	
	Shoqëria dhe mjedisi				
Ideja e projektit:	Jeta e çdo fëmije është e mbushur me ditë të veçanta. Ata kanë dëshirë të luajnë, të këndojnë, të vizatojnë, të diskutojnë në lidhje me historikun e këtyre ditëve. Pra, ata kanë dëshirë të festojnë. Në këtë projekt, nxënësit përdorin aftësitë hulumtuese, për të gjetur dhe lexuar dokumente që kanë të bëjnë me historikun e Ditës së Flamurit; aftësitë krijuese për të përgatitur postera, ftesa, vizatime; aftësitë interpretuese për vjersha, tregime, lojë me role, gjëza, etj...				
Ngjarjet hyrëse që frymëzojnë kërkimin dhe angazhimin e nxënësve	Filma të ndryshëm që kanë parë, histori që kanë dëgjuar apo lexuar, do të frymëzojnë nxënësit për të këkuar e zbuluar më shumë informacione në lidhje me këtë temë. Njohuritë paraprake të nxënësve, si dhe përvojat e mëparshme të tyre në lidhje me këtë ditë të shënuar, shfrytëzohen si nxitje për angazhimin e tyre në zotërimin e disa kompetencave.				
Kompetencat kyçe që zhvillohen	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.	x	Kompetenca personale	x	
	Kompetenca e te menduarit	x	Kompetenca qytetare	x	
	Kompetenca e të nxënësve	x	Kompetenca digjitale	x	
	Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.	X			
Temat e njohurive kryesore lëndore, të cilat do të rimerren në sajë të projektit	Shkruajmë ftesa për "Festën e Flamurit"		Lexojmë vjersha, tregime për "Festën e Flamurit"		
	Përgatitim postera për "Festën e Flamurit"		Interpretojmë në role vjersha, tregime për "Festën e Flamurit"		
Rezultatet e të nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> • mbledh informacione nga burime të ndryshme për "Ditën e Flamurit"; • diskuton në grupe për "Festën e Flamurit"; • përgatit postera për "Ditën e Flamurit"; • ndan me të tjerët përvojat e tij rreth kësaj feste; përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të shkruarit; • prezanton duke e shoqëruar me mjete pamore, filmime, foto, etj...; • rrëfen ngjarje, shpreh ndjenja, përcjell ide rreth "Ditës së Flamurit"; • demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • demonstroi besim në forcat e veta, respekt e tolerancë brenda grupit. 				

Metodologjia	(Individuale, në grup, ose e gjithë klasa)	Diskutim	x	Hulumtim	X
		Bisedë	x	Lojë me role	X
		Punë në grup	x	Tryeza rrethore	X
Burimet e nevojshme	Njerëzit e përfshirë	Mësuesi, nxënësit, prindërit, mësuesja e edukimit muzikor.			
	Mjetet:	Aparat fotografik, bllok shënimesh, foto, videoprojektor, karton, letër, lapustilë			
	Materiale dhe burime	Materiale të ndryshme nga interneti, foto dhe CD			
Pyetja kërkimore	A ju pëlqejnë festat? Pse?				
Përmbledhja e çështjeve, investigimi, kërkimi dhe zgjidhja e problemit.	<p>Mësuesja i ka udhëzuar nxënësit të marrin informacione në lidhje me “Ditën e Flamurit”, foto/video nga aktivitete, që u janë kushtuar këtyre ditëve.</p> <p>Gjuhë shqipe</p> <ul style="list-style-type: none"> Mësuesja ka ftuar në klasë prindër, si dhe mësuesen e edukimit muzikor. Ata do t’u bashkohen grupeve të fëmijëve. Për secilin grup, jepet nga një temë/detyrë.(Historiku i “Ditës së Flamurit”; postera për “Ditën e Flamurit”; poezi, tregime, filmime për “Ditën e Flamurit”; interpretime, lojë në role për “Ditën e Flamurit”). Grupet diskutojnë rreth tyre duke u mbështetur në temat e mësipërme. Pasi përfundojnë diskutimet dhe punimet në grup, njëri përfaqësues i grupit u prezanton përfundimet e shokëve të klasës. Shoqërohet me foto dhe video të marra nga interneti, që lidhen me tematikën (materiale që i kanë përgatitur më parë me udhëzimin e mësueses). Nxënësit e grupeve të tjera bëjnë komentet e tyre rreth videove, fotove dhe gjithashtu sjellin përvojat e tyre në lidhje me çështjen që po diskutohet. Mësuesja udhëzon nxënësit të luajnë me role, situata të improvizuara, të cilat kanë lidhje me “Ditën e Flamurit”. 				
Produktet kryesore	Në grup:	Festimi i “Ditës së Flamurit”			
	Individualisht:	Interpretime, lojë në role, postera etj.			
Vendi dhe pjesëmarrësit e prezantimit	Shkollë	X			
	Klasë	X			
Vlerësimet	Vlerësimet formuese	<p>Vlerësimi bëhet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> mbledhjen e informacioneve nga burime të ndryshme për “Ditën e Flamurit”; diskutimin në grup për “Festën e Flamurit”; përgatitjen e posterave për “Ditën e Flamurit”; ndarjen me të tjerët të përvojave të tij/saj rreth kësaj feste; prezantimin duke e shoqëruar me mjete pamore, filmime, foto etj; rrefimin e ngjarjeve, shprehjen e ndjenjave, përcjelljen e ideve rreth “Ditës së Flamurit”. Prezantimi i punëve 			
	(Gjatë projektit)				
	Vlerësime				
	(Në fund të projektit)				
Buxheti	Buxheti i detajuar	<ul style="list-style-type: none"> Në bashkëpunim me prindërit, mund të shpenzohet një fond prej 200 lekësh për blerjen e materialeve të ndryshme dhe letrave, tabakëve dhe lapustilëve me ngjyra. 			
	Përse?				
	Nga kush?				

Shënim: Ky projekt mund të përshatet nga mësuesit për çdo ditë feste.

Test 1**Si një herë e një kohë**

Po bënte shumë kohë e keqe, frynte erë e tërbuar, binte shi dhe mungonte edhe drita. Nuk shikoje dot televizor, as të luaje në kompjuter. Kur Dena e pyeti mamin se ç'mund të bënte, ajo s'gjeti asgjë interesante, vetëm se i tha të rregullonte shtratin, që ta kishte gati për të fjetur kur të vinte mbrëmja.

– Por e kam rregulluar, mami, – tha Dena.

– Atëherë qëro ca bizele, t'i kemi për nesër. Të mësoj unë se si qërohen.

Dena u zbavit pak me qërimin e bizeleve. Pastaj bënë dy-tri lojëra shah.

Shtrëngata po bëhej gjithnjë e më e fortë. Mbrëmja po afrohej dhe mami ndezi një qiri. Ashtu me qiri, hëngrën darkë. Të dyja, lanë enët dhe pastruan tryezën.

Më pas, mami e shoqëroi Denën për në shtrat. Ajo i lexoi disa përralla nga libri “Elefanti mori arratinë”. Dhe kështu, fletë pas flete, ato qeshën së bashku të gëzuara. Kur po fillonin përrallën e pestë, në shtëpi erdhi babi.

–Nuk e di si ia keni kaluar sot pa drita. Çfarë keni bërë tërë ditën?- pyeti babai.

– Shumë gjëra, – iu përgjigj Dena. – Me të vërtetë shumë gjëra, sikur kjo ditë të ketë qenë e gjatë sa një javë.

Mami, me të vërtetë sa shumë kohë të lirë që patëm!

– Po, – tha mami duke buzëqeshur. – Sot më është dukur sikur jam kthyer në kohët kur isha e vogël, kur kështu, pa drita, mbeteshim shpesh. Atëherë kishim më shumë kohë të lirë, pasi nuk rrinim tërë ditën para televizorit e kompjuterit.

1.Pjesa e mësipërme është tregim: (1 pikë)

- a) realist
- b) përshkrues
- c) fantastik

2.Në shtëpinë e Denës mungonte drita ngaqë: (1 pikë)

- a) binte shi dhe frynte erë e tërbuar
- b) mami kish ulur automatin
- c) kishte rënë zjarr në pallat

3. Dena e kaloi kohën pa drita në shtëpi duke: (1 pikë)

- a) vizatuar
- b) u ankuar
- c) ndihmuar mamin dhe duke luajtur.

4. Pjesa titullohet “Si një herë e një kohë”, sepse kohën e fëmijërisë së mamin të Denës, ndodhte shpesh të: (1 pikë)

- a) bënte kohë e keqe
- b) iknin dritat
- c) shihnin filma për fëmijë

5. Shkruaj një titull tjetër për këtë pjesë: (1 pikë)**6. Shkruaj mesazhin e pjesës: (1 pikë)****7. Shkruaj dy karakteristika të tregimit fantastik: (2 pikë)****8. Shkruaj një emër nga teksti. Analizoje atë. (5 pikë)**

Emri	Lloji	Gjinia	Numri	Rasa

9. Gjej kryefjalën në fjalitë e mëposhtme dhe shkruaj me se është shprehur ajo. (4 pikë)

Fjali nga teksti	Kryefjala	E shprehur me
Dena u zbavit pak me qërimin e bizeleve.		

Ajo i lexoi disa përralla nga libri “Elefanti mori arratinë”.		
---	--	--

10. Gjej kryefjalën e nënkuptuar. Rishkruaje fjalinë duke e shprehur kryefjalën. (1 pikë)
Atëherë kishim më shumë kohë të lirë.

11. Cili prej emrave në fjali mund të shndërrohet në gjininë tjetër. Rishkruaje fjalinë duke kryer shndërrimin. (2 pikë)
Shitësi i librarisë, idha vajzës një libër me përralla.

12. Nënvizoi kallëzuesin në fjalinë: (1 pikë)
Më pas, mami e shoqëroi Denën për në shtrat.

13. Në fjalitë e dhëna shkruaj si duhet kallëzuesin që është në kllapa: (2 pikë)
Djemtë (luan) _____ futboll në sheshin sportiv.
Nxënësi (interpretojnë) _____ një pjesë teatrale.

14. Ngjyros me të kuqe grupin emëror të kryefjalës dhe me blu, grupin foljor të kallëzuesit. (2 pikë)
Dena e vogël qëron me kujdes bizelet.

15. Shkruaj fjalë plotësuese në vendet bosh në fjalitë e mëposhtme: (2 pikë)
Lepuri (_____) doli (_____) nga strofulla e tij.

16. Gjej gabimin. Shkruaj drejt emërtimet e mëposhtme: (4 pikë)

Deti adriatik		rruga ali demi	
qeni reksi		ministra e mbrojtjes	

17. Ndërto fjali me fjalën:
deti - numri njëjës, rasa dhanore (2 pikë)

18. Përshkruaj shokun, ose shoqen e ngushtë me 6-7 fjali. (5 pikë)

Vlerësimi	AP	ANP	AK	ASHK	ASH
Pikët	0-10	11-20	21-26	27-34	35-38

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Një ëndërr së prapthi		Situata e të nxënësve Diskutim me nxënësit/et për ndjesitë që i shkaktajnë ëndrrat.	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tregimin rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • dallon elementet fantastike, duke i ilustruar ato me pjesë nga tregimi; • pyet për t'ua sqaruar rreth përmbajtjes së tregimit; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit; • tregon përmbajtjen e tregimit sipas strukturës së tij; • shkruan tregimin shkurtimisht duke e pasuruar atë me personazhe të rinj dhe situata të reja joreale; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -ngjarje fantastike; -korb; -përtac; -maçok; -miush; -botë së prapthi.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tregime fantastike; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A 4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -bisedë; -procedura: pyet sërish; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -mendo-zbullo; -shkrim i shpejtë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Bisedë:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të tregojnë për ndjesitë që i shkaktajnë ëndrrat që kanë parë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Procedura: pyet sërish:</i> Mësuesi/ja paraqet temën e mësimin dhe fton nxënësit/et, të vërejnë ilustrimet. Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën, diskutojnë rreth tyre.</p> <p>*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në paragrafë. Nënvizojnë fjalitë që tregojnë sjelljet e personazheve që mbartin kontekstet e rrjedhave fantastike, joreale.</p> <p>*Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et diskutojnë në dyshe: njëri prej tyre ndërton dy pyetje rreth veprimeve jo reale, fantastike të personazheve dhe tjetri i përgjigjet pyetjeve.</p> <p>Për çdo paragraf të ri, nxënësit/et ndërrojnë rolet.</p> <p>Paragrafi I Pyetje: -Kur e zuri gjumi korbën Albert? -Pse ai quhej përtac?</p> <p>Paragrafi II Pyetje: -Cila ishte ëndrra e maçokut Mjau me dy miushët? -Pse maçokut Mjau iu desh t'ia mbathte nga miushët?</p> <p>Paragrafi III Pyetje: -Si shprehet një botë së prapthi, në momentin që qeni Bulli ikën nga kërcënimi i maçokut?</p> <p>Paragrafi IV Pyetje: -Si mbaron ëndrra e korbës Albert? -A u kthye çdo gjë në vendin e vet? *Nxënësit/et tregojnë llojin e tekstit, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij (tregim fantastik). *Lexim i pjesës zinxhir nga nxënësit/et dhe më pas në role.</p>			

• **Veprimtaria e tretë**

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxiten nxënësit/et t’iu përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë i ndodhi Albertit?
- Cilat janë personazhet e ëndrrës së tij?
- Çfarë kishte të veçantë ëndrra e tij?
- Tregoni zinxhirin e situatave fantastike që pasojnë sjelljet e personazheve.
- *Disa nxënës/e tregojnë shkurtimisht përmbajtjen e tregimit fantastik.

• **Veprimtaria e katërt**

Mendo-zbulo: Punohet rubrika “Analizoj”“. Nxiten nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve rreth natyrës së ngjarjeve në tregim (fantastike) dhe pse duhet konsideruar të tilla, si dhe të tregojnë ndjesitë që përcjellin personazhet nëpërmjet veprimeve të tyre. Nxënësit/et diskutojnë në fillim në grupe të vogla më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

• **Veprimtaria e pestë**

Shkrim i shpejtë: Punohet rubrika “Reflektoj”“. Nxiten nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve me shkrim rreth mënyrës se si do ta rikrijonin ëndrrën e Albertit, nëse do ta pasuronin atë me personazhe të tjerë, apo do t’i jepnin këshilla personazhit kryesor.

Në përfundim nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

• **Vlerësimi bëhet për:**

- leximin e tregimit rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- dallimin e elementeve fantastike duke i ilustruar ato me pjesë nga tregimi;
- pyetjet e ndërtuara për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tregimit;
- përgjigjet për pyetjet rreth përmbajtjes së tregimit;
- tregimin e përmbajtjes së tregimit, sipas strukturës së tij;
- shkrimin e tregimit shkurtimisht duke e pasuruar atë me personazhe të rinj dhe situata të reja joreale;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që i bëjnë punës së shokëve e të shoqeve.

• **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”“

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Trajtat e emrit (ora I)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar trajtën e pashquar dhe të shquar të emrave.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon emrat e trajtës së pashquar dhe emrat e trajtës së shquar; • klasifikon emrat sipas numrit dhe trajtës së tyre; • kthen emrat e numrit njëjës dhe shumës nga trajta e pashquar në trajtën e shquar dhe anasjelltas; • shkruan emra të trajtës së pashquar dhe të trajtës së shquar në numrin njëjës dhe shumës; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e të tjerëve. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -emër; -numri njëjës; -numri shumës; -trajta e pashquar; -trajta e shquar; 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabelë në të cilën janë shkruar emra në numrin njëjës dhe shumës në trajtën e pashquar dhe të shquar; -fisha me emra në trajtën e pashquar dhe të shquar; -fisha me fjali që kanë emra në trajtën e pashquar dhe të shquar; -mjete shkrimi, lapustilë, tabakë letre, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. 	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - analizë;
 - diskutim;
 - rishikim në dyshe;
 - lojë;
 - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**


Njihen nxënësit/et me temën e mësimit.

Ftohen ata/ato të komentojnë figurat në tekst.

Lexohen fjalitë e dhëna.

Një djalë shkoi te një dentiste. Djali kontrolloi dhëmbët te **dentistja**.

Nxiten nxënësit/et të vërejnë me kujdes emrat në to. Zhvillohet një diskutim rreth tyre.



Mësuesi/ja sqaron:

Emrat: *një djalë*, *një dentiste*, që tregojnë në mënyrë të pacaktuar një njeri (një nga djemtë e tjerë, një nga dentistet e tjera) janë në trajtën e pashquar.

Emrat: *djali*, *dentistja*, që tregojnë konkretisht një njeri janë në trajtën e shquar.

*Lexohet rubrika “Mbaj mend” në të cilën jepen sqarime se çfarë tregon një emër në trajtën e pashquar dhe një emër në trajtën e shquar.

Tërhiqet vëmendja (rubrika “**Kujdes!**”) që për të dalluar trajtën e një emri në numrin njëjës, duhet të vendosësh përpara fjalën **një**. Nëse e pranon, emri është në trajtën e pashquar. Në rastin e kundërt, është në trajtën e shquar.

Për të dalluar trajtën e një emri në numrin shumës, përdorim fjalën **disa**.

*Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve/eve.

*Kërkohen shembuj nga nxënësit/et për emra në trajtën e shquar dhe të pashquar, në njëjës dhe shumës.

- **Veprimtaria e dytë**

Diskutim: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të grupojnë emrat e dhënë në trajtën e pashquar dhe të shquar, në numrin njëjës dhe shumës, duke i shkruar në tabelë.

Orientohen nxënësit/et të punojnë në grupe.

Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e grupit.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e tretë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të kthejnë emrat e numrit njëjës dhe shumës nga trajta e pashquar në trajtën e shquar.

Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të kthejnë në trajtën e shquar ose të pashquar, emrat e dhënë.

Nxënësit/et punojnë individualisht në libër me laps.

Në përfundim të punës, shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Ngrihen nxënës/e, të plotësojnë tabelën e paraqitur nga mësuesi/ja.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve.

- **Veprimtaria e katërt**

Lojë: Nxënësit/et luajnë në dyshe. Nxënësi/ja i/e parë thotë një emër në numrin njëjës, ose shumës në trajtën e pashquar dhe nxënësi/ja i/e dytë, e kthen atë në trajtën e shquar.

Më pas ata/ato ndërrojnë rolet. Nxënësi/ja i/e dytë thotë një emër në numrin njëjës ose shumës në trajtën e shquar dhe nxënësi/ja i/e parë, e kthen në trajtën e pashquar.

Nxiten nxënësit/et të krijojnë fjali me to.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <p>-dallimin e emrave të trajtës së pashquar dhe emrave të trajtës së shquar; -klasifikimin e emrave sipas numrit dhe trajtës së tyre; -kthimin e emrave të numrit njëjës dhe shumës nga trajta e pashquar në trajtën e shquar dhe anasjelltas; -shkrimin e emrave të trajtës së pashquar dhe trajtës së shquar në numrin njëjës dhe shumës; -demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së të tjerëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Detyrë shtëpie <p>Kthe emrat e dhënë nga trajta e pashquar në trajtën e shquar, ose nga trajta e shquar në trajtën e pashquar. <i>(një) djalë, (një) nxënës, (një) çantë, (një) mësuese, (disa) libra, (disa) lapsa, (disa) klasa, (disa) mjeke, liqeni, mali, fusha, lulja, qytetet, lepujt, dallëndyshet, pemët.</i></p>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Trajtat e emrit (ora II)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar trajtën e pashquar dhe të shquar të emrave.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon emrat e trajtës së pashquar dhe emrat e trajtës së shquar; • kthen emrat e numrit njëjës dhe shumës nga trajta e pashquar në trajtën e shquar dhe anasjelltas; • përzgjedh emrin në trajtën e duhur për të plotësuar fjalitë; • shkruan fjali në të cilat përdoren emrat në trajtën dhe numrin e kërkuar; • bën qortimin e gabimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e të tjerëve. 		Fjalë kyçe: -emër; -numri njëjës; -numri shumës; -trajta e pashquar; -trajta e shquar;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabelë në të cilën janë shkruar emra në numrin njëjës dhe shumës në trajtën e pashquar dhe të shquar; -fisha me emra në trajtën e pashquar dhe të shquar; -fisha me fjali që kanë emra në trajtën e pashquar dhe të shquar; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim;
 - rishikim në dyshe;
 - shkrim i drejtuar;
 - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim: Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë dhe diskutim rreth tyre.

Punë në dyshe: Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve/eve, fisha në të cilat janë shkruar nga një fjali.

Fton nxënësit/et të lexojnë fjalitë, të dallojnë emrat në to dhe të përcaktojnë trajtën e tyre.

Pas përfundimit të punës, zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e dytë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 4 ka karakter plotësues.

Orientohen nxënësit/et të lexojnë tekstin dhe të përzgjedhin emrin në trajtën e duhur, për të plotësuar fjalitë.

Nxënësit/et punojnë individualisht në libër me laps.

Në përfundim të punës, shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 5 synon që nxënësit/et të shkruajnë fjali, ku të përdorin emrat e dhënë në numrin dhe trajtën e kërkuar.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.

Pas përfundimit të punës, disa nxënës/e lexojnë fjalitë e krijuara.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-dallimin e emrave të trajtës së pashquar dhe emrave të trajtës së shquar;

-kthimin e emrave të numrit njëjës dhe shumës, nga trajta e pashquar në trajtën e shquar dhe anasjelltas;

-përzgjedhjen e emrit në trajtën e duhur për të plotësuar fjalitë;

-shkrimin e fjalive në të cilat përdoren emrat në trajtën dhe numrin e kërkuar;

-qortimin e gabimeve të thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;

-demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin e punës së të tjerëve.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj në fletore tekstin e plotësuar të ushtrimit 4. Analizo 3 emra të tekstit (lloji, gjinia, numri, trajta).

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda:Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Pinoku në shkollë		Situata e të nxënit Shikim i disa sekuencave nga filmi “Pinoku”.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth tregimit, me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es; • jep parashikimet e veta në lidhje me tregimin; • tregon llojin e tekstit që lexon, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit; • tregon përmbajtjen e tregimit sipas rrjedhës së ngjarjes; • lidh tregimin me ngjarje nga jeta e tij/saj, kur ai është ndodhur në situata të vështira, duke treguar se si e ka zgjidhur atë; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalët kyçe: -Pinoku; -kukull e drunjtë; -çapkënë; -trazovaçë.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor, -material filmik nga filmi i animuar “Pinoku” -libri “Pinoku” -videoprojektor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -shikim i organizuar; -veprimtari e leximit të drejtuar; -diskutim; -trego-argumento; -bashkëbisedim; -punë individuale; punë me gjithë klasën; punë në dyshe; punë në grup • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Shikim i organizuar:</i> Paraqiten me anë të videoprojektorit disa sekuenca nga filmi për fëmijë “Pinoku”. (Në mungesë të videoprojektorit, nxënësit/et flasin rreth filmimit të mirënjohur nga fëmijët “Pinoku” Zhvillohet një diskutim i shkurtër me nxënësit/et, nën drejtimin e mësuesit/es, rreth personazhit të Pinokut. • Veprimtaria e dytë <i>Veprimtari e leximit të drejtuar:</i> Njihen nxënësi/et me temën e mësimit “Pinoku në shkollë” dhe autorin e tij Karlo Kolodi. Komentohet figura në tekst. *Fillon leximi i pjesës me ndalesa nga nxënësit/et: Ndalesa e parë: Pinoku shkoi... deri te... që ta bënte të vallëzonte. Pyetje: - Ku shkoi Pinoku? -Si e pritën fëmijët atë? -Si silleshin fëmijët me të në shkollë? -Si mendoni se do të vazhdojë ngjarja? Ndalesa e dytë: Pinoku nuk bëri zë... deri te... mes gajasjeve. Pyetje: -Çfarë u kërkoi Pinoku fëmijëve? -Çfarë përgjigje i dhanë fëmijët? 			

Ndalesa e tretë: Njëri prej tyre... deri te... një bërryl stomakut.

Pyetje: - Ç'bëri njëri nga djemtë trazovaçë?

-A ia doli dot ai? Pse?

Ndalesa e katërt: Pinoku e fitoi menjëherë... deri në fund.

-A e fitoi Pinoku respektin e të tjerëve? Si?

-A ju pëlqeu pjesa?

-Si u ndjetë pas leximit të saj?

-Çfarë ju bëri përshtypje në këtë pjesë?

*Nxënësit/et tregojnë llojin e pjesës (tregim).

*Punohet rubrika "Fjalë të reja". Shpjegohen fjalët e reja, nxënësit/et krijojnë fjali me to.

*Lexim zinxhir nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e tretë**

Diskutim: Punohet rubrika "Lexoj dhe kuptoj". Nxënësit/et bashkëbisedojnë në dyshe dhe më pas diskutojnë me gjithë klasën për t'iu përgjigjur pyetjeve rreth pjesës.

*Disa nxënës/e tregojnë brendinë e pjesës mbi bazën e pyetjeve.

- **Veprimtaria e katërt**

Trego-argumento: Punohet rubrika "Analizoj". Nxiten nxënësit/et të diskutojnë në grupe për të përzgjedhur alternativën e saktë për llojin e ngjarjes që rrëfëhet duke e argumentuar atë dhe mesazhin e kësaj pjese.

- **Veprimtaria e pestë**

Bashkëbisedim: Punohet rubrika "Reflektoj". Nxiten nxënësit/et të tregojnë rastet kur ata janë ndodhur në një situatë të vështirë dhe se si kanë vepruar për ta zgjidhur atë.

*Nxënësit/et diskutojnë në grupe dhe më pas me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es, për të shpjeguar shprehjen "E ka hundën si të Pinokut".

Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e tekstit në mënyrë të rrjedhshme dhe me intonacionin e duhur;

-shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve rreth tregimit;

-parashikimet e dhëna në lidhje me tregimin;

-tregimin e llojit të tekstit që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij;

-përgjigjet për pyetjet rreth përmbajtjes së tregimit;

-tregimin e përmbajtjes sipas rrjedhës së ngjarjes;

-lidhjen e tregimit me ngjarje nga jeta e tij/saj, kur është ndodhur në situata të vështira, duke treguar se si e ka zgjidhur atë;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika "Shkrualj"

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Personazhi i Pinokut		Situata e të nxënit Diskutim rreth hapave që ndiqen në përshkrimin e një personazhi. Diskutim rreth personazhit të Pinokut.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan Pinokun mbi bazën e fotove dhe njohurive që ka për të; • përdor fjalët ndihmëse për të plotësuar një tekst; • u përgjigjet pyetjeve me shkrim rreth personazhit të Pinokut, paraqitjes, sjelljes dhe karakterit të tij; • plotëson skedën për personazhin e tij/saj më të parapëlqyer nga librat që ka lexuar; • shkruan rreth personazhit të tij/saj të preferuar. • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • vlerëson punën e të tjerëve. 		Fjalët kyçe: -Pinoku; -personazh; -kukull e drunjtë; -përshkrim. -personazh i preferuar; -pamja e jashtme; -komunikimi; -sjellja; -karakterit.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -libri “Pinoku”; foto të Pinokut; -libra për fëmijë; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -stuhi mendimesh; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -shkrim i lirë; -punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Stuhi mendimesh:</i> Rikujtohen me nxënësit/et, nëpërmjet diskutimit, hapat që ndiqen në përshkrimin e një personazhi (prezantimi, paraqitja e jashtme, paraqitja e brendshme, mendimi yt). *Mësuesi/ja fton nxënësit/et të tregojnë se çfarë dinë për Pinokun duke drejtuar edhe pyetjet: -Çfarë është? Si është? Ç’cilësi ka? Po të meta a ka? Nxënësit/et punojnë në grupe për të dhënë mendimet e tyre duke i argumentuar ato. <div style="text-align: center; margin: 10px 0;"> <pre> graph TD Pinoku((Pinoku)) --> A[është kukull prej druri] Pinoku --> B[i shkathët] Pinoku --> C[i dashur] Pinoku --> D[dembel] Pinoku --> E[ka hundë të gjatë] Pinoku --> F[ka këmbë dhe krahë të hollë] Pinoku --> G[nuk i pëlqen shkolla] Pinoku --> H[gënjeshhtar] </pre> </div> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit. <i>Rishikim në dyshe:</i> Njihen nxënësit/et me kërkesën e ushtrimit 1. Komentohet ilustrimi në tekst nga nxënësit/et. Nxiten nxënësit/et të plotësojnë tekstin me fjalët ndihmëse të dhëna. Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Lexohet teksti i përfunduar nga disa nxënës/e, zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es. 			

- **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et t'u përgjigjen pyetjeve të dhëna me shkrim.

Nxënësit/et punojnë individualisht me laps në libër.

Në përfundim, diskutojnë rreth përgjigjeve të pyetjeve nën drejtimin e mësuesit/es.

*Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et tregojnë për personazhin që u pëlqen më shumë nga librat që kanë lexuar, duke plotësuar skedën e dhënë:

- o *Emri:*
- o *Vendi që zë në libër:*
- o *Si është ai?*
- o *Çfarë mund të bëjë ai/ajo?*
- o *Për çfarë është i njohur?*
- o *Çfarë karakteri ka?*

Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim diskutojnë rreth skedës së plotësuar, nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e katërt**

Shkrim i lirë: Ushtrimi 4. Orientohen nxënësit/et që nëpërmjet një shkrimi të lirë, të përshkruajnë personazhin e tyre të preferuar, bazuar në skedën e plotësuar në ushtrimin 3 dhe në modelin e ushtrimit 1.

Pas përfundimit të punës, nxiten nxënësit/et, të lexojnë përshkrimet e tyre me zë para klasës.

(Në qoftë se nuk premtan koha për ta mbaruar detyrën, nxënësit/et e përfundojnë në shtëpi).

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- përshkrimin e Pinokut mbi bazën e fotove dhe njohurive që ka për të;
- plotësimin e një teksti duke përdorur fjalët ndihmëse;
- përgjigjet e pyetjeve me shkrim rreth personazhit të Pinokut, paraqitjes, sjelljes dhe karakterit të tij;
- plotësimin e skedës për personazhin e tij/saj më të parapëlqyer nga librat që ka lexuar;
- shkrimin rreth personazhit të tij/saj të preferuar;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

- **Detyrë shtëpie**

Përshkruaj një personazh të filmit tënd të preferuar.

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Stuhia kaloi		Situata e të nxënit *Shikim i një materiali të shkurtër filmik për një ditë me stuhi, bubullima dhe vetëtima. *Bisedë rreth dukurisë natyrore të stuhisë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; • tregon llojin e tekstit që lexon duke vënë në dukje disa karakteristika të tij; • përshkruan ndjenjat dhe mendimet e tij /saj rreth tekstit që lexon; • ndan me të tjerët ndjesitë që ka provuar, kur i ka ndodhur të përjetojë një stuhi; • tregon se çfarë duhet të bëjmë dhe si duhet të sillemi në rastet e stuhive të papritura për të shmangur pasojat negative; • pranon idetë dhe mendimet e të tjerëve rreth situatave të papritura të motit; • gjykon për rëndësinë e reshjeve për mjedisin, veçanërisht në stinën e verës; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • vlerëson punën e të tjerëve. 		Fjalë kyçe: -stuhi; -shkreptima; -gjëmim; -bubullima; -kundroi; -rrjedhë e zakonshme.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -videoprojektor, material filmik për stuhitë; -pamje të vendeve kur janë përfshirë nga stuhitë; -materiale nga interneti për stuhitë dhe dëmet që ato shkaktojnë; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës; -teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -shikim i organizuar; -lexim-diskutim në dyshe; -hulumtim; -dallos-trego; -ditari dypjesësh; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Shikim i organizuar:</i> Mësuesi/ja paraqit një material filmik me anë të videoprojektorit ku paraqitet një ditë me stuhi, bubullima dhe vetëtima. Zhvillohet një bisedë rreth dukurisë natyrore të stuhisë. -Në cilën stinë moti shoqërohet më shumë me shi, bubullima dhe vetëtima? (Në mungesë të materialit filmik, nxënësit/et tregojnë pamje të marra nga interneti si dhe lexojnë informacione për stuhitë). <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Lexim-diskutim në dyshe:</i> Njihen nxënësit/et me titullin e tekstit. Komentohet figura. *Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në heshtje. Nënvizojnë fjalët që nuk kuptojnë si dhe fjalët që u duken interesante. Pyesin njëri-tjetrin dhe mësuesin/en. Diskutojnë rreth tekstit. *Punohet rubrika “Fjalë të reja”. Shpjegohen fjalët e reja, nxiten nxënësit/et të krijojnë fjali me to. *Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit/et. 			

- **Veprimtaria e tretë**

Hulumtim: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj”, nxënësit/et punojnë për të gjetur alternativat e sakta. Ata/ato diskutojnë në fillim në dyshe, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e katërt**

Dallo-trego: Punë në grupe: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et të gjejnë alternativën e saktë për llojin e tekstit (përshkrues) dhe të tregojnë se ku duket kjo.

- **Veprimtaria e pestë**

Ditari dypjesësh: Nxënësit/et në grupe, do të plotësojnë ditarin dypjesësh, ku do të japin komentin e tyre rreth fjalisë.

Fjalja	Komenti
Epo, herë pas here, duhet ndonjë stuhi si kjo.	Reshjet janë të rëndësishme për mjedisin, për sa kohë ato nuk shkaktojnë shkatërrime të mbjellave të pemëve etj. Ato janë të domosdoshme për bujqësinë dhe fermerët. Reshjet janë të nevojshme për të pasur një ajër të pastër, klimë të freskët dhe të shëndetshme.

- **Veprimtaria e gjashtë**

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Zhvillohet një bashkëbisedim, ku nxënësit/et përshkruajnë ndjenjat dhe mendimet e tyre rreth tekstit dhe ndajnë me të tjerët ndjesitë që kanë provuar, kur u ka ndodhur të përjetojnë një stuhi.

*Mësuesi/ja u tregon nxënësve/eve se çfarë duhet të bëjnë dhe si duhet të sillen në rastet e stuhive të papritura për të shmangur pasojat negative.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalitë që i duken interesante;
- tregimin e llojit të tekstit që lexon duke vënë në dukje disa karakteristika të tij;
- përshkrimin e ndjenjave dhe mendimeve të tij/saj rreth tekstit që lexon;
- ndarjen me të tjerët të ndjesive që ka provuar, kur i ka ndodhur të përjetojë një stuhi;
- tregimin se çfarë duhet të bëjmë dhe si duhet të sillemi në rastet e stuhive të papritura për të shmangur pasojat negative;
- pranimin e ideve dhe mendimeve të të tjerëve rreth situatave të papritura të motit;
- grykimin për rëndësinë e reshjeve për mjedisin në stinën e verës;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- vlerësimin që i bëjnë të tjerëve.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Lakimi i emrave (ora I)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të përcaktuar rasën e emrave.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> dallon pyetjet që përdoren për të gjetur rasën e emrit; lakon emrat e numrit njëjës dhe shumës, në trajtën e pashquar dhe të shquar; përcakton rasën e emrave të numrit njëjës dhe shumës, të trajtës së pashquar dhe të shquar; analizon emrat, duke treguar llojin, numrin, gjininë, trajtën dhe rasën e tyre; respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; vlerëson punën e të tjerëve demonstron besim në forcat e veta, respekt dhe tolerancë brenda grupit. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -emër; -numri njëjës; -numri shumës; -trajta e pashquar; -trajta e shquar; -lakim; -rasa; -emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore; -pyetjet <i>Kush? Cili? Cila? I kujt? E kujt? Kujt? Cilit? Cilës? Kë? Cilin? Cilën? Prej kujt? Prej cilit? Prej cilës?</i> 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e pyetjeve sipas rasave; -tabela e lakimit të emrave të gjinisë mashkullore dhe femërore, në trajtën e pashquar dhe të shquar, në numrin njëjës dhe shumës; -mjete shkrimi, lapustilë, fisha, fletore, tabakë letre, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. 	
<ul style="list-style-type: none"> Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -tryezë rrethore; -diskutim; -rishikim në dyshe; -analizë; -konkurs; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <p>Njihen nxënësit/et me temën e mësimimit.</p> <p><i>Tryezë rrethore:</i> Nxënësit/et janë vendosur në grupe, në formë rrethore: Ftohen ata/ato të komentojnë figurën në tekst dhe të shkruajnë në fleta, fjali me emrat: <i>xhup, jelek, pallto</i>.</p> <p>Pas përfundimit të punës, nxënësit/et hapin fletat, i lexojnë fjalitë dhe diskutojnë për format e ndryshme që marrin këto emra në fjali.</p> <p>Nxiten nxënësit/et të tregojnë se çfarë dinë për rasat dhe lakimin e emrit, duke u bazuar në rubrikën “Kujtoj”.</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaria e dytë <p><i>Punë në dyshe: Diskutim:</i> Orientohen nxënësit/et që në dyshe, të plotësojnë tabelat e lakimit të emrave: <i>xhupi, jeleku, palltoja</i>, në numrin njëjës dhe shumës, në trajtën e pashquar dhe të shquar.</p> <p>Ngrihen nxënës/e të plotësojnë tabelat e paraqitura nga mësuesi/ja dhe t’i lexojnë ato me zë.</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaria e tretë <p><i>Diskutim:</i> Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të lakojnë emrat: <i>shoqja, drita, nxënësi</i>, në trajtën e pashquar dhe të shquar, në numrin njëjës dhe shumës.</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaria e katërt <p><i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të përcaktojnë rasën e emrit <i>Ermali</i>, në fjalitë e dhëna, duke shkruar pyetjet përkatëse.</p> <p>Nxënësit/et punojnë individualisht në libër me laps.</p> <p>Në përfundim të punës, shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.</p> <p>Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.</p>			

- **Veprimtaria e pestë**

Analizë, konkurs: Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të analizojnë emrat e dhënë në tabelë, duke përcaktuar gjininë, numrin, trajtën, rasën e tyre.

Nxënësit/et punojnë në grupe për plotësimin e tabelës.

Pas përfundimit të punës, secili grup prezanton tabelën e tij me përgjigjet përkatëse.

Zhvillohet një diskutim në klasë, nën drejtimin e mësuesit/es, duke vënë theksin se rasa gjinore ka gjithmonë përpara nyjat: *i, e, të, së*. Rasa rrjedhore ka përpara një fjalë si: *prej, rreth, para, pas*, etj...

Mësuesi/ja shpall grupin fitues.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-dallimin e pyetjeve që përdoren për të gjetur rasën e emrit;

-lakimin e emrave të numrit njëjës dhe shumës, në trajtën e pashquar dhe të shquar;

-përcaktimin e rasës së emrave të numrit njëjës dhe shumës, të trajtës së pashquar dhe të shquar;

-analizën e emrave, duke treguar llojin, numrin, gjininë, trajtën dhe rasën e tyre;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin e punës së të tjerëve;

-demonstrimin e besimit në forcat e veta, respektit dhe tolerancës brenda grupit.

- **Detyrë shtëpie**

Klasa ndahet në dy grupe.

Grupi 1: Lako një emër të gjinisë femërore, në numrin njëjës, në trajtën e pashquar dhe të shquar. Krijohet fjali me to.

Grupi 2: Lako një emër të gjinisë mashkullore, në numrin shumës, në trajtën e pashquar dhe të shquar. Krijohet fjali me to.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Lakimi i emrave (ora II)		Situata e të nxënësve Manipulime me fjalë e fjali për të përcaktuar rasën e emrave.	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lakon emrat sipas rasave; • përcakton rasën e emrave në fjali; • shkruan fjali me emrat e dhënë duke i përdorur ato në trajtën, numrin dhe rasën e kërkuar; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • vlerëson punën e shokëve/ shoqeve. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -emër; -numri njëjës; -numri shumës; -trajta e pashquar; -trajta e shquar; -lakim; -rasa; -emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore; -pyetjet: <i>Kush? Cili? Cila? I kujt? E kujt? Kujt? Cilit? Cilës? Kë? Cilin? Cilën? Prej kujt? Prej cilit? Prej cilës?</i> 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e lakimit të emrave të gjinisë mashkullore dhe femërore, në trajtën e pashquar dhe të shquar, numrin shumës; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. 	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - bisedë;
 - diskutim;
 - dallo-trego;
 - shkrim i drejtuar;
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Bisedë: Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit/et të lexojnë fjalitë ku kanë përdorur emra në gjininë, në trajtën dhe në numrin e kërkuar, duke rikujtuar njohuritë rreth lakimit të emrave.

- **Veprimtaria e dytë**

Diskutim: Mësuesi/ja shkruan disa emra në tabelë. Nxiten nxënësit/et t'i lakojnë ato sipas rasave.

- **Veprimtaria e tretë**

Dallo-trego: Ushtrimi 4 synon që nxënësit/et, në tekstin e dhënë, të nënvizojnë emrat dhe të përcaktojnë rasën e tyre.

Nxiten nxënësit/et të punojnë individualisht.

Në përfundim, ata/ato prezantojnë punën e tyre, duke vënë në dukje edhe pyetjet përkatëse që përdorën për gjetjen e rasës së emrave.

- **Veprimtaria e katërt**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 5 synon që nxënësit/et të shkruajnë në fletore fjali ku të përdorin emrat *det*, *rrugë*, *top*, në trajtën, numrin dhe rasën e kërkuar.

Pas përfundimit të punës, disa nxënës/e, lexojnë fjalitë e krijuara.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-lakimin e emrave sipas rasave;

-përcaktimin e rasës së emrave në fjali;

-shkrimin e fjalive me emrat e dhënë duke i përdorur ato në trajtën, numrin dhe rasën e kërkuar;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;

-demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;

-vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj 10 fjali në të cilat të përdorësh emrin *qyteti* në të gjitha rasat, në numrin njëjës dhe në numrin shumës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Një tip misterioz		Situata e të nxënit A duhet të vishemi dhe të sillemi në mënyrë të përshtatshme dhe a duhet të kemi mirëkuptim ndaj veshjeve të të tjerëve, kur ato nuk çënojnë të drejtat tona?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; • tregon se si ndikojnë ilustrimet për ta kuptuar më mirë përmbajtjen e tekstit; • tregon llojin e tekstit që lexon duke vënë në dukje disa karakteristika të tij; • shpjegon fjalët e reja, duke ndërtuar fjali me to; • përshkruan personazhin, duke e ilustruar me pjesë nga teksti; • gjykon për sjelljen dhe zakonet që mund të ketë personazhi në tekst, duke u nisur nga pamja e jashtme dhe veshja e tij; • pranon idetë dhe mendimet e të tjerëve rreth diversitetit të veshjes, sjelljes dhe mënyrës së jetesës së të tjerëve; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • vlerëson përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -misterioz; -i zhdërvjellët; -fyturë të mprehtë; -imcak; -të flashkët; -e feksur; -pupëz; -saten;	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tekste të ndryshme përshkruese; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim paraprak; -procedura: pyet sërish; -hulumtim; -dallos-trego; -mendo-zbullo; -debat i argumentuar; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim paraprak:</i> Mësuesi/ja u drejton nxënësve/eve pyetjet për diskutim: -A ju ka rastisur të shihni njerëz që kanë veshje dhe sjellje të çuditshme? -Çfarë kureshtje ju kanë ngjallur? -Si duhet të sillemi ndaj tyre? -A duhet t'i paragjykojmë ato? -Në jetën publike, a duhet të vishemi dhe sillemi në mënyrë të përshtatshme? <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Procedura: pyet sërish:</i> Mësuesi/ja njih nxënësit/et me temën e mësimit. Ftohen nxënësit/et të komentojnë ilustrimin në libër. Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën, diskutojnë rreth tij, duke treguar si i ndihmon ai për të kuptuar më mirë tekstin. *Udhëzohen nxënësit/et, të lexojnë tekstin në paragrafë, duke nënvizuar fjalët e reja dhe ato që i bëjnë përshtypje. *Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et diskutojnë në dyshe: njëri/a prej tyre ndërton dy pyetje rreth përshkrimit të personazhit dhe tjetri/a, u përgjigjet pyetjeve. Për çdo paragraf të ri, nxënësit/et ndërrojnë rolet. Paragrafi I Pyetje: -Ku shihej burri misterioz?			

Paragrafi II

-Ç'pamje kishte burri?

-Ç'trup kishte ai?

Paragrafi III

Pyetje: -Si ishte kapela e tij?

-Si mendoni, çfarë tregonte kapela për jetën e tij?

Paragrafi IV

Pyetje: -Si ishte këmisha e tij? Po xhaketa, pantallonat dhe këpucët?

**Shpjegim i fjalëve të reja: Punohet rubrika "Fjalë të reja". Shpjegohen fjalët e reja: i zhdërvjellët, të flashkët, sateni, e feksur, pupëz. Nxiten nxënësit/et të krijojnë fjali me to.*

**Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit/et.*

- **Veprimtaria e tretë**

Hulumtim: Në rubrikën "Lexoj dhe kuptoj" nxënësit/et punojnë në dyshe për të gjetur pohimet e vërteta dhe të gabuara, në fjalitë përmbledhëse rreth tekstit.

Nxiten nxënësit/et të kthejnë pohimet e gabuara në pohime të vërteta.

Ata/ato diskutojnë në fillim në dyshe, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e katërt**

Dallo-trego: Punohet rubrika "Analizoj". Nxiten nxënësit/et në grupe, të gjejnë alternativën e saktë për llojin e tekstit (përshkrues) dhe të tregojnë se ku duket kjo.

- **Veprimtaria e pestë**

Mendo-zbulo: Punohet rubrika "Reflektoj". Nxiten nxënësit/et t'u përgjigjen pyetjeve rreth sjelljes dhe zakoneve që mund të ketë personazhi duke u nisur nga pamja e jashtme dhe veshja.

Zhvillohet një diskutim me nxënësit/et nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e gjashtë**

Debat i argumentuar: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të debatojnë rreth pyetjes:

-Si mendoni çfarë mund ta ketë shtyrë njeriun misterioz të vishet në këtë mënyrë: varfëria, pamundësia, hobi, stili i jetesës?

Nxiten nxënësit/et të japin mendimin e tyre.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrit.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;

-tregimin se si ndikojnë ilustrimet për ta kuptuar më mirë përmbajtjen e tekstit;

-tregimin e llojit të tekstit që lexon duke vënë në dukje disa karakteristika të tij;

-shpjegimin e fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to;

-përshkrimin e personazhit, duke e ilustruar me pjesë nga teksti;

-gjykimin për sjelljen dhe zakonet që mund të ketë personazhi në tekst, duke u nisur nga pamja e jashtme dhe veshja e tij;

-pranimin e ideve dhe mendimeve të tjerëve rreth diversitetit të veshjes, sjelljes dhe mënyrës së jetesës së tjerëve;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;

-vlerësimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimet që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika "Shkruaj"

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Ushtrime përmbledhëse: Emri (ora I)		Situata e të nxënit Krijim i një harte konceptesh për emrin.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> shkruan emra të përveçëm përbri emrave të përgjithshëm; zëvendëson në fjali emrat e gjinisë femërore në emra të gjinisë mashkullore; kthen emrat e numrit njëjës në numrin shumës; krijon fjali duke përdorur emrat e dhënë në numrin, trajtën dhe rasën e kërkuar; respekton rregullat gramatikore gjatë të shkruarit; demonstron pavarësi në mendime dhe veprime; demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; vlerëson punën e të tjerëve. 		Fjalë kyçe: -lloji i emrit; -numri i emrit; -gjinia e emrit; -trajta e emrit; -rasat e emrit;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me emra; -harta e konceptit e emrit; -mjete shkrimi, lapustilë, tabakë letre, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -harta e konceptit; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <p><i>Harta e konceptit:</i> Nxënësit/et krijojnë në grupe hartën e konceptit për emrin. Mësuesi/ja e plotëson atë në tabelë, duke u mbështetur te puna e nxënësve/eve.</p> <p>njerëz, kafshë, sende, vende</p> <p>emërore gjinore dhanore kallëzore rrjedhore</p> <p>emërton fjalë e ndryshueshme i përgjithshëm</p> <p>emri</p> <p>gjinia</p> <p>numri trajta</p> <p>rasa</p> <p>njëjës shumës e shquar e pashquar</p> <p>mashkullore femërore</p> <p>Nxiten nxënësit/et të japin shembuj të emrave sipas llojit, numrit, trajtës, gjinisë dhe rasave.</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaria e dytë <p><i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të shkruajnë emra të përveçëm përbri emrave të përgjithshëm.</p> <p>Ushtrimi 2 synon, që nxënësit/et, të shkruajnë fjalitë e dhëna, duke zëvendësuar emrat e gjinisë femërore, të nënvizuara me emra të gjinisë mashkullore, sipas modelit të dhënë.</p> <p>Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Ata/ato shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin dhe korrigjojnë gabimet. Në fund zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.</p>			

• **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 4. Orientohen nxënësit/et të shkruajnë fjali me emrat: *lulishte, libër, pallat, lojë, telefoni, çanta*, në numrin, trajtën dhe rasën e kërkuar.

Nxënësit/et punojnë individualisht.

Pas përfundimit të punës nxiten nxënësit/et të lexojnë fjalitë me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es, bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

• **Vlerësimi bëhet për:**

- shkrimin e emrave të përveçëm përbri emrave të përgjithshëm;
- zëvendësimin në fjali, të emrave të gjinisë femërore, me emra të gjinisë mashkullore;
- kthimin e emrave të numrit njëjës në numrin shumës;
- krijimin e fjalive duke përdorur emrat e dhënë në numrin, trajtën dhe rasën e kërkuar;
- respektimin e rregullave gramatikore gjatë të shkruarit;
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

• **Detyrë shtëpie** Ushtrimi 3

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Ushtrime përmbledhëse Emri (ora II)		Situata e të nxënit Dallimi i emrave në tekste, analiza e tyre.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon emrat në tekste; • analizon emrat, duke treguar llojin, numrin, gjininë, trajtën dhe rasën e tyre; • krijon fjali duke përdorur emrat sipas llojit, numrit, trajtës dhe rasës së kërkuar; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore më ndihmën e mësuesit/es; • respekton rregullat gramatikore gjatë të shkruarit; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e të tjerëve. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -lloji i emrit; -numri i emrit; -gjinia e emrit; -trajta e emrit; -rasat e emrit; 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me emra; -tabela e lakimit të emrave; -tabela e analizës së emrave për ushtrimin 6; -mjete shkrimi, lapustilë, tabakë letre, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. 	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - lexo-dallo;
 - analizë;
 - konkurs;
 - shkrim i drejtuar;
 - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë.

Lexo-dallo: Ushtrimi 5 synon, që nxënësit/et të gjejnë emrat në tekstin e dhënë.

- **Veprimtaria e tretë**

Analizë, konkurs: Ushtrimi 6 synon, që nxënësit/et të analizojnë emrat në tekstin e ushtrimit 5, duke treguar llojin, numrin, gjininë, trajtën dhe rasën e tyre.

Nxënësit/et punojnë në grup për plotësimin e tabelës.

Pas përfundimit të punës, secili grup prezanton tabelën e tij me përgjigjet përkatëse.

Zhvillohet një diskutim në klasë, nën drejtimin e mësuesit/es. Mësuesi/ja shpall grupin fitues.

- **Veprimtaria e katërt**

Shkrim i drejtuar: U kërkohet nxënësve të shkruajnë 2 emra me këto karakteristika:

1: lloji i përgjithshëm, numri njëjës, gjinia mashkullore, trajta e shquar, rasa gjinore.

2: lloji i përgjithshëm, numri shumës, gjinia femërore, trajta e pashquar, rasa kallëzore.

Nxënësit/et krijojnë fjali me to.

Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim, ata/ato lexojnë fjalitë me zë.

Me ndihmën e mësuesit/es, nxënësit/et bëjnë qortime të thjeshta drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-dallimin e emrave në tekste;

-analizën e emrave, duke treguar llojin, numrin, gjininë, trajtën dhe rasën e tyre;

-krijimin e fjalive duke përdorur emrat sipas llojit, numrit, trajtës dhe rasës së kërkuar;

-qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën më ndihmën e mësuesit/es;

-respektimin e rregullave gramatikore gjatë të shkruarit;

-demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin e punës së të tjerëve.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj: a) 2 emra të përgjithshëm, në numrin njëjës, gjinia femërore, trajta e pashquar, rasa emërore, b) 2 emra të përgjithshëm, në numrin shumës, gjinia mashkullore, trajta e shquar, rasa dhanore.

Krijo fjali me to.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Ferma		Situata e të nxëniet Diskutim rreth njohurive paraprake që nxënësit/et kanë për fermën.	
Rezultatet e të nxëniet Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; • tregon llojin e tekstit që lexon duke vënë në dukje disa karakteristika të tij; • përshkruan ndjenjat dhe mendimet e tij/saj rreth tekstit që lexon; • ndan me të tjerët ndjesitë që ka provuar kur ka vizituar një fermë; • pranon idetë dhe mendimet e të tjerëve rreth pëlqimeve të tyre për jetën e larmishme në fermë; • vlerëson punën që bëjnë fermerët për të prodhuar produktet e nevojshme me të cilat ne ushqehemi përditë; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj. 		Fjalë kyçe: -fermë; -shtëpi; -pemishte; -përrua; -ngastra; -e harlisura; -gëlojnë; -kati përdhes; -stiva e druve.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -pamje nga ferma; -informacione për jetën në fermë; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -stuhi mendimesh; -lexim-diskutim në dyshe; -hulumtim; -dallo-trego; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Stuhi mendimesh:</i> Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën “Ferma”. Nxit nxënësit/et për të treguar se çfarë dinë për fermën me anë të pyetjeve: -A keni patur rast të vizitoni ndonjë fermë? -Çfarë keni parë atje? -Ç’gjë ju ka bërë përshtypje? -Çfarë punësh bëjnë fermerët? -Çfarë prodhohet në një fermë?</p> <p>Përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja i paraqet me anë të një kllasteri në tabelë.</p> <p style="text-align: center;">kasolle për kafshët shtëpiake, shtëpi</p> <pre> graph TD Ferma((Ferma)) --> A[toka të mbjella me perime] Ferma --> B[pemë frutore] Ferma --> C[kafshë shtëpiake gjedhë (lopë, viça)] Ferma --> D[kuaj] Ferma --> E[derra] Ferma --> F[shpendë (pula, rosa, pata)] Ferma --> G[zogj] Ferma --> H[bagëti (dhen, dhi)] </pre> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Lexim-diskutim në dyshe:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. Komentohet figura. *Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në heshtje. Nënvizojnë fjalët që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që u duken interesante. Pyesin njëri-tjetrin dhe mësuesin/en. Diskutojnë rreth tekstit. *Punohet rubrika “Fjalë të reja”. Shpjegohen fjalët e reja: <i>ngastra, pemishte, përroi, e harlisura, gëlojnë, kati përdhes, stiva e druve</i>. Nxënësit/et të krijojnë fjali me to. *Nxiten nxënësit/et të tregojnë për llojin e tekstit, duke vënë në dukje karakteristikat e tij. *Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit/et.</p>			

- **Veprimtaria e tretë**

Hulumtim: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj”, nxënësit/et punojnë në dyshe për të gjetur alternativat e sakta. Ata/ato diskutojnë në fillim në dyshe, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e katërt**

Dallo-trego: Punë në grupe: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et të gjejnë alternativën e saktë se çfarë përshkruhet në këtë tekst dhe si është bërë ky përshkrim në raport me shtëpinë dhe mjedisin rreth saj (nga jashtë-brenda).

Nxënësit/et në grupe, gjejnë në tekst fjalët që tregojnë vendin dhe pozicionin e sendeve në hapësirë. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e pestë**

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Zhvillohet një bashkëbisedim, ku nxënësit/e, ndajnë me të tjerët ndjesitë që kanë provuar kur kanë vizituar një fermë, shprehin pëlqimet e tyre për fermat që kanë parë, duke treguar edhe për gjërat që u kanë bërë më shumë përshtypje.

*Nxiten nxënësit/et të flasin për rëndësinë që ka puna që bëhet në fermë nga fermerët, për të prodhuar produktet me të cilat ne ushqehemi përditë.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;

-tregimin e llojit të tekstit që lexon duke vënë në dukje disa karakteristika të tij;

-përshkrimin e ndjenjave dhe mendimeve të tij/saj rreth tekstit që lexon;

-pranimin e ideve dhe mendimeve të të tjerëve rreth pëlqimeve të tyre për jetën e larmishme në fermë;

-vlerësimin për punën që bëjnë fermerët për të prodhuar produktet e nevojshme me të cilat ne ushqehemi përditë;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Dëgjojmë Ngrohtë dhe ftohtë		Situata e të nxënësve Ç’ndjesi ju jep një ditë e ftohtë me shi, ndërsa ju duhet të bëheni gati për të shkuar në shkollë?	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon, duke mbajtur shënime të shkurtra për fjalitë që i bëjnë më shumë përshtypje; • demonstroi të dëgjuar të qëllimshëm në kryerjen e detyrave; • përdori fjalorin e gjuhës shqipe për të gjetur kuptimin e fjalëve të reja të tekstit; • dallon llojin e tekstit, duke treguar elementet e një teksti realist; • diskuton rreth pjesës që dëgjon, duke u mbështetur në shënime të mbajtura prej tij/saj; • tregon rreth situatave kur është ndodhur në një ditë të ftohtë me shi; • pranon dhe tregon respekt ndaj ideve dhe mendimeve të shokëve/shoqeve rreth pjesës që dëgjojnë; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. 		Fjalë kyçe: -ditë me shi; -ngrohtë; -ftohtë; -trafiku i mbingjesit.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fjalor i gjuhës shqipe; -pamje nga një ditë me shi; -CD, magnetofon; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -shkencat e natyrës; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -mjedisi; -bashkëjetesa paqësore.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

- **Metodologjia:**

- dil rrotull, fol rrotull;
- dëgjo-lexo;
- marrëdhënie pyetje-përgjigje;
- dallos-trego;
- bashkëbisedim;
- trego- argumento;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- **Veprimtaria e parë**

Dil rrotull, fol rrotull: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të ngrihen në këmbë dhe të shkojnë në një vend të hapur në klasë. U shpjegon atyre se si do të veprojnë.

Mësuesi/ja u drejton nxënësve/eve pyetjen e parë.

Ata/ato do të ecin rrotull nëpër klasë, derisa mësuesi/ja të përplasë duart. Në momentin që përplas duart, nxënësit/et ndalojnë dhe flasin me shokun/shoqen ngjitur rreth pyetjes.

Më pas, mësuesi/ja përplas duart dy herë. Vazhdohet kështu për të tria pyetjet.

-Çfarë dini për shiun?

-Si visheni për të shkuar në shkollë në një ditë të ftohtë me shi?

-Ç'ndjesi ju jep një ditë e ftohtë me shi, ndërsa ju duhet të bëheni gati për të shkuar në shkollë?

Në përfundim të lojës, aktivizohen disa nxënës/e të diskutojnë rreth pyetjeve.

Mësuesi/ja paraqet temën e mësimi "Ngrohtë dhe ftohtë".

- **Veprimtaria e dytë**

Dëgjo-lexo: Komentohen fotoja në libër nga nxënësit/et.

Mësuesi/ja fton nxënësit/et (ushtrimi 1) të dëgjojnë tekstin në magnetofon.

Orientohen nxënësit/et, që gjatë dëgjimit të mbajnë shënime për fjalët e reja dhe për fjalitë që i bëjnë më shumë përshtypje.

- **Veprimtaria e tretë**

Marrëdhënie-pyetje-përgjigje: Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et t'përgjigjen pyetjeve rreth tekstit:

-Çfarë po mendonin Martini dhe Virgjinia ndërsa ishin akoma në shtrat?

-Ç'kanë të përbashkët dhe ku ndryshojnë mendimet e dy personazheve?

-Pse Virgjinia ndihej si një copë akulli që shkrinte në shkretëtirë?

-Si arriti në shkollë Martini atë ditë? Si ndihej ai?

- **Veprimtaria e katërt**

Dallos-trego: Punë në grupe: Ushtrimi 3 synon, që nxënësit/et të dallojnë llojin e tekstit, duke përzgjedhur alternativën e duhur, si dhe të dallojnë në tekst, elementet që e bëjnë realist këtë tekst.

- **Veprimtaria e pestë**

Punë individuale: Ushtrimi 4 synon, që nxënësit/et të ndërtojnë fjali përmbledhëse për çdo pjesë të ngjyrosur në tekst dhe të tregojnë ngjarjen që përshkruhet me fjalët e tyre.

- **Veprimtaria e gjashtë**

Bashkëbisedim: Ushtrimi 5. Nxënësit/et tregojnë përvojat e tyre kur janë ndodhur në situata të ngjashme me atë të tregimit, si vishen dhe me çfarë shkojnë në shkollë në një ditë me shi.

- **Veprimtaria e shtatë**

Trego- argumento: Ushtrimi 6. Nxënësit/et tregojnë se me cilin personazh të tregimit ngjajnë më shumë, duke e argumentuar atë.

Ushtrimi 7. Nxënësit/et punojnë në grupe për të dhënë shpjegimin, se çfarë ka dashur autori të tregojë me këtë ngjarje.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- ndjekjen me vëmendje të tekstit që dëgjon, duke mbajtur shënime të shkurtra për fjalitë që i bëjnë më shumë përshtypje;
- demonstrimin e të dëgjuarit të qëllimshëm në kryerjen e detyrave;
- përdorimin e fjalorit të gjuhës shqipe për të gjetur kuptimin e fjalëve të reja të tekstit;
- dallimin e llojit të tekstit, duke treguar elementet e një teksti realist;
- diskutimin rreth pjesës që dëgjon, duke u mbështetur në shënimet e mbajtura prej tij/saj;
- tregimin rreth situatave kur është ndodhur në ditë të ftohtë me shi;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Si u bë qimja tra		Situata e të nxënit Pse është e rëndësishme që të mos i fryjmë dhe të mos i zmadhojmë gjërat?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon përrallën duke mbajtur shënime për fjalitë që i pëlqejnë më shumë dhe i duken më interesante; • tregon si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë përrallën; • shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit; • shfaq ndjenjat dhe emocionet e tij/saj rreth përrallës; • tregon përmbajtjen e përrallës mbi bazën e fjalive përmbledhëse; • nxjerr mesazhin që përcjell përralla; • gjykon për pasojat që ka në marrëdhënie me të tjerët, kur i zmadhon ose i trillon ngjarjet; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -përrallë; -thërrime; -tra; -rosaku gushëbardhë; -veshëgjatë; -gjelat e detit; -kuajt.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -libra me përralla; -figura kafshësh; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -pyetja e ditës; -procedura: pyet sërish; -lexim me zë; -rishikim në dyshe; -debat; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Pyetja e ditës:</i> Mësuesi/ja shtron para nxënësve/eve pyetjen: -Pse është e rëndësishme që të mos i fryjmë dhe të mos i zmadhojmë gjërat? Secili/a nxënës/e, shpreh lirshëm mendimin e vet. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Procedura: pyet sërish:</i> Mësuesi/ja paraqet temën e mësimimit dhe fton nxënësit/et të vërejnë ilustrimin. Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën, diskutojnë rreth tij, duke treguar si i ndihmon ai për të kuptuar më mirë tekstin. *Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në paragrafë. Nënvizojnë fjalët dhe shprehjet që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që u duken më interesante dhe më të rëndësishme. *Pas leximit të çdo paragrafi, diskutojnë në dyshe: njëri prej tyre ndërton dy pyetje rreth fjalive më interesante në paragrafin e parë dhe tjetri i përgjigjet pyetjeve. Për çdo paragraf të ri nxënësit/et ndërrojnë rolet. Paragrafi I Pyetjet: –Çfarë i ndodhi rosakut në mëngjes teksa po hante ca thërrime? -Çfarë i thanë rosat patate? Paragrafi II Pyetjet:–Ku shkuan patat? -Çfarë i thanë ato gjelave të detit? Paragrafi III Pyetjet:- Ku shkuan gjelat e detit? -Çfarë u thanë ata kuajve?			

Paragrafi IV

Pyetjet: –Kë lajmëruan kuajt?

-Çfarë i thanë ata gomarit?

Paragrafi V

Pyetjet: –Për ku u nis veshgjati bashkë me kafshët e tjera?

-Çfarë i tha veshgjati rosakut?

-Si iu përgjigj rosaku?

-A ju pëlqeu pjesa?

-Si u ndjetë pas leximit të kësaj pjese?

- **Veprimtaria e tretë**

Shpjegim i fjalëve të reja: Punohet rubrika “Fjalë të reja” në libër.

Nxiten nxënësit/et të ndërtojnë fjali me to.

*Nxënësit/et tregojnë se kjo pjesë është përrallë, duke e argumentuar me 2-3 tipare të përrallave.

- **Veprimtaria e katërt**

Lexim me zë: Lexim i përrallës zinxhir nga nxënësit/et dhe më pas në role.

- **Veprimtaria e pestë**

Rishikim në dyshe: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj”, nxënësit/et lexojnë fjalitë përmbledhëse të përrallës. Ata/ato punojnë individualisht për të gjetur alternativat e sakta.

Udhëzohen nxënësit/et të korrigjojnë fjalitë jo të sakta, t’i shkruajnë ato ashtu siç duhet në fletore dhe t’i rendisin fjalitë përmbledhëse sipas rrjedhës së ngjarjes.

Shkëmbejnë fletoret, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Më pas dikutojnë me gjithë klasën.

*Nxënësit/et tregojnë përmbajtjen e përrallës duke u bazuar në fjalitë përmbledhëse.

- **Veprimtaria e gjashtë**

Debat: Në rubrikën “Analizoj”, nxënësit/et diskutojnë rreth shprehjes “u bë qimja tra”, në fillim në dyshe, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

*Nxiten nxënësit/et të tregojnë se cilët janë personazhet e përrallës, duke përzgjedhur alternativën e duhur dhe si përfundon përralla.

*Nxënësit/et në grupe punojnë për të nxjerrë mesazhin e përrallës.

Mesazhi: *Ndihma ndaj shokëve dhe shoqeve në nevojë, duhet të jetë e përhershme, por të bëhet gjithmonë pa i zmadhuar dhe ndryshuar gjërat.*

Prirja për të zmadhuar dhe fryrë gjërat, nuk sjell atë që ne dëshirojmë, por të kundërtën.

Përfaqësuesit e grupeve, prezantojnë punën e grupit. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Veprimtaria e shtatë**

Bashkëbisedim: Në rubrikën “Reflektoj”, nxënësit/et tregojnë raste kur janë ndodhur në situata kur fjalët e tyre janë ndryshuar. Ata/ato shprehen se si janë ndier dhe si kanë vepruar.

*Improvizohet në minutat e fundit loja “Telefoni i prishur”.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e përrallës duke mbajtur shënime për fjalitë që i pëlqejnë më shumë dhe i duken më interesante;

-shfaqjen e besimit dhe vullnetit në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit;

-shfaqjen e ndjenjave dhe emocioneve të tij/saj rreth përrallës;

-tregimin e përmbajtjes së përrallës mbi bazën e fjalive përmbledhëse;

-formulimin e mesazhit që përcjell përralla;

-grykimin për pasojat që ka në marrëdhënie me të tjerët kur i zmadhon ose i trillon ngjarjet;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”


Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda:Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Lexojmë Luani dhe flutura		Situata e të nxënit A duhet t'i nënvlerësojmë të tjerët për arsyen se janë të vegjël?	
Rezultatet e të nxënit <ul style="list-style-type: none"> • parashikon rreth përmbajtjes së fabulës duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe; • tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë fabulën; • përcakton dy-tre tipare të fabulave; • lexon fabulën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; • shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth fabulës; • analizon personazhet e fabulës duke u mbështetur në përshkrimet dhe veprimet e tyre; • tregon përmbajtjen e fabulës; • nxjerr mesazhin që përcjell fabula; • lidh idetë dhe informacionin e fabulës me njohuritë, përvojën dhe leximet e mëparshme ose dukuri të jetës së përditshme; • gjykon se si reflektohet morali i fabulës në marrëdhëniet e tyre të përditshme në shtëpi, shkollë, komunitet; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalë kyçe: -luani; -flutura; -ciku; -vakt; -krifë; -savanë.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -libra me fabula; -foto dhe informacione për fluturat dhe luanët; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -artet; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -parashikim me anë të titullit, ilustrimit dhe fjalëve kyçe; -diskutim; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -harta e personazheve; -mendo-nxirr mesazhin; -rishikim në dyshe; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë Mësuesi/ja shtron pyetjen: A duhet t'i nënvlerësojmë të tjerët pse mund të jenë më të vegjël, më të pafuqishëm? -Kësaj pyetje do t'i japin përgjigje në pjesë të ndryshme të orës. *Parashikim me anë të titullit, ilustrimit dhe fjalëve kyçe: Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët: <i>savanë, luan, flutur, ndihmoj</i>. Nxënësit/et shohin ilustrimin, lexojnë titullin dhe fjalët kyçe dhe bëjnë parashikimin për përmbajtjen e fabulës duke punuar në dyshe. I shkruajnë parashikimet e tyre në fletë (me katër fjali ku t'i përdorin këto fjalë). Nxiten nxënësit/et të lexojnë parashikimet e tyre. • Veprimtaria e dytë <i>Diskutim:</i> Lexohet fabula nga nxënësit/et në heshtje. Më pas, diskutohet në dyshe rreth përmbajtjes së saj. *Nxënësit/et tregojnë ndryshimet rreth përmbajtjes së saj dhe parashikimit që i kanë bërë. *Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, më të rëndësishme. *Punohet rubrika "Fjalë të reja". Nxënësit/et diskutojnë në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën rreth shpjegimit të fjalëve dhe krijojnë fjali me to. *Në përfundim të punimit të të gjithë pjesës, u lihet kohë nxënësve/eve ta rilexojnë atë. *Diskutohet me gjithë klasën për llojin e pjesës dhe dy-tre karakteristika (fabul, personazhe kafshë, mbyllet me një moral). *Zhvillohet leximi zinxhir. 			

• **Veprimtaria e tretë**

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj” nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së fabulës.

• **Veprimtaria e katërt**

Punë në grupe: Harta e personazheve: Për personazhet e fabulës gjenden dy cilësi. Për secilën cilësi shkëputet nga një pjesë ilustruese nga teksti.



• **Veprimtaria e pestë**

Mendo-nxirr mesazhin: Në rubrikën “Analizoj” nxënësit/et formulojnë në grupe mesazhin që përcjell fabula. Mesazhi: Mos nënvlerëso të tjerët edhe pse mund të jenë më të vegjël dhe më të pafuqishëm, pasi një ditë mund të kesh edhe ti nevojë për ta.

Miqësia nuk matet me forcën dhe madhësinë, por me besnikërinë, zemërgjërësinë dhe humanizmin.

*Nxiten nxënësit/et të gjykojnë se si reflektohet morali i fabulës në marrëdhëniet e tyre të përditshme në shtëpi, shkollë, komunitet.

• **Veprimtaria e gjashtë**

Rishikim në dyshe: Nxënësit/et punojnë individualisht për të plotësuar fjalitë e dhëna dhe të përmbledhin me nga një fjali: hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e fabulës.

Ata shkëmbejnë fletoret dhe kontrollojnë punën e shokëve, më pas zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

*Nxiten nxënësit/et të tregojnë përmbajtjen e fabulës.

• **Veprimtaria e shtatë**

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxënësit/et bashkëbisedojnë për një rrjedhë tjetër të ngjarjes, nëse flutura do të kishte ruajtur zemërimin me luanin.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

• **Vlerësimi bëhet për:**

- parashikimin rreth përmbajtjes së fabulës duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe;
- tregimin se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë fabulën;
- përcaktimin e dy-tre tipareve të fabulës;
- leximin e fabulës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth fabulës;
- analizën e personazheve të fabulës duke u mbështetur në përshkrimet dhe veprimet e tyre;
- tregimin e përmbajtjes së fabulës;
- formulimin e mesazhit që përcjell fabula;
- lidhjen e ideve dhe informacioneve të fabulës me njohuritë, përvojën dhe leximet e mëparshme ose dukuri të jetës së përditshme;
- gjykimin se si reflektohet morali i fabulës në marrëdhëniet e tyre të përditshme në shtëpi, shkollë, komunitet;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

• **Detyrës shtëpie** Rubrika “Shkruaj”

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda:Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Mbiemri. Gjinia dhe numri i tij (ora I)		Situata e të nxënit Krijimi i një harte konceptesh për mbiemrin.	
Rezultatet e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> dallon mbiemrat duke treguar gjininë dhe numrin e tyre; përzgjedh mbiemrin e duhur për të plotësuar fjalitë duke e përshtatur atë me emrin që cilëson; analizon mbiemrat duke përcaktuar llojin, gjininë dhe numrin e tyre; vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -mbiemri; -cilësi; -i nyjshëm; -i panyjshëm; -gjinia e mbiemrit; -numri i mbiemrit.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me mbiemra; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera -shoqëria dhe mjedisi; -artet.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodologjia: -harta e konceptit; -mendo, puno në dyshe, shkëmbe; -analizë, konkurs; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <p><i>Harta e konceptit:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimin. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të vërejnë figurat në tekst. Tërhiqet vëmendja në fjalët nën secilën figurë. -Si mendoni, çfarë tregojnë fjalët: <i>i vogël, e vogël, i kuq, të kuq, i lulëzuar, e lulëzuar, shumëngjyrëshe, shkëmbor?</i> *Lexohet rubrika “Kujtoj”. *Nxiten nxënësit/et të tregojnë se ç’dinë për mbiemrin dhe të japin shembuj të mbiemrave. Përgjigjet e tyre, mësuesi/ja i shkruan në dërrasë.</p> <pre> graph TD A([mbiemri]) --> B[tregon cilësi të njerëzve, kafshëve, sendeve, vendeve] A --> C[marrin gjininë, numrin e emrit që cilësojnë] A --> D[lloji] A --> E[numri] A --> F[gjinia] D --> G[i nyjshëm] D --> H[i panyjshëm] E --> I[njëjës] E --> J[shumës] F --> K[mashkullore] F --> L[femërore] </pre> <p>*Mësuesi/ja nënvizon faktin se <i>mbiemri jo gjithmonë ndodhet pas emrit, ndonjëherë për të theksuar cilësinë e emrit, ai vihet para tij.</i> Jepen shembuj për këtë rast. <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaria e dytë <p><i>Mendo, puno në dyshe, shkëmbe:</i> Ushtrimi 1 synon, që nxënësit/et të dallojnë mbiemrat në fjalitë e dhëna dhe të përcaktojnë gjininë dhe numrin e tyre. Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Pastaj mendimet e tyre i shkëmbejnë me shokun/shoqen e bankës dhe në fund me gjithë klasën. Pasi binden për përgjigjen e saktë, plotësojnë përgjigjet.</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaria e tretë <p><i>Analizë, konkurs:</i> Ushtrimi 2 synon, që nxënësit/et të analizojnë mbiemrat duke treguar llojin, gjininë, numrin e tyre. Nxënësit/et punojnë në grupe për plotësimin e tabelës. Pas përfundimit të punës, secili grup prezanton tabelën e tij me përgjigjet përkatëse. Zhvillohet një diskutim në klasë, nën drejtimin e mësuesit/es. Mësuesi/ja shpall grupin fitues.</p> </p>			

- **Veprimtaria e katërt**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të plotësojnë tekstin me mbiemrat e duhur, duke përcaktuar gjininë dhe numrin e tyre.

Nxënësit/et punojnë në fletore individualisht.

Pas përfundimit të punës, zhvillohet një diskutim me nxënësit/et nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-dallimin e mbiemrave duke treguar gjininë dhe numrin e tyre;

-përzgjedhjen e mbiemrit të duhur për të plotësuar fjalitë duke e përshtatur atë me emrin që cilëson;

-analizën e mbiemrave duke përcaktuar llojin, gjininë dhe numrin e tyre;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;

-demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

- **Detyrë shtëpie** Ushtrimi 4

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Mbiemri. Gjinia dhe numri i tij (ora II)		Situata e të nxënit Shqyrtimi i mbiemrave për të dalluar llojin, gjininë dhe numrin e tyre.	
Rezultatet e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> • dallon gjininë dhe numrin e mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm; • analizon mbiemrat duke treguar llojin, gjininë dhe numrin e tyre; • krijon fjali me mbiemra të nyjshëm dhe të panyjshëm në gjininë dhe në numrin e kërkuar; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. 		Fjalë kyçe: -mbiemri; -cilësi; -i nyjshëm; -i panyjshëm; -gjinia e mbiemrit; -numri i mbiemrit.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, tabakë letre, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -artet.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**Metodologjia:**

- shkëmbe një problemë;
- shkrim i drejtuar;
- analizë, konkurs;
- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- **Veprimtaria e parë**

Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë.

Zhvillohet një diskutim në klasë rreth tyre nën drejtimin e mësuesit/es.

Shkëmbe një problemë: Mësuesi/ja fton nxënësit/et që të punojnë në dyshe. Udhëzohen të shkruajnë në fisha dy fjali ku të kenë përdorur mbiemra. Fishën ia japin dyshes fqinjë për t'i dalluar mbiemrat e përdorur në fjali dhe për të përcaktuar llojin, gjininë dhe numrin e tyre.

Nxënësit/et diskutojnë ndërmjet tyre dhe më pas diskutojnë me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e dytë**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 5, synon që nxënësit/et të klasifikojnë mbiemrat e dhënë në të nyjshëm dhe të panyjshëm dhe t'i përdorin ata në fjali në gjininë dhe në numrin e kërkuar.

Tërhiqet vëmendja nga mësuesi/ja që të përshtaten mbiemrat me emrat që ata cilësojnë në gjini dhe numër.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.

Në përfundim, ata/ato lexojnë fjalitë me zë.

Me ndihmën e mësuesit/es, nxënësit/et bëjnë qortime të thjeshta drejtshkrimore.

- **Veprimtaria e tretë**

Analizë, konkurs: Ushtrimi 6 synon që nxënësit/et të dallojnë mbiemrat në tekstin e dhënë, t'i analizojnë ata duke treguar llojin, gjininë, numrin e tyre. Nxënësit/et punojnë në grup për plotësimin e tabelës.

Pas përfundimit të punës, secili grup prezanton tabelën e tij me përgjigjet përkatëse.

Zhvillohet një diskutim në klasë, nën drejtimin e mësuesit/es. Mësuesi/ja shpall grupin fitues.

Mbiemri	Lloji		Gjinia		Numri	
	i nyjshëm	i panyjshëm	femërore	mashkullore	njëjës	shumës
lozonjare		+	+		+	

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e gjinisë dhe numrit të mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm;
- analizën e mbiemrave duke treguar llojin, gjininë dhe numrin e tyre;
- krijimin e fjalive me mbiemra të nyjshëm dhe të panyjshëm në gjininë dhe në numrin e kërkuar;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

- **Detyrë shtëpie**

Bëj një shkrim me temë të lirë me 7-8 fjali, ku të përdorësh mbiemra.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Gabimi i diellit (ora I)		Situata e të nxënit Si e vlerësoni ju ndihmën e më të vegjëlve dhe a duhet besuar tek ajo kur ofrohet me zemërgjërësi?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> parashikon rreth përmbajtjes së përrallës duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe; lexon përrallën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; tregon se si ndikojnë ilustrimet për ta kuptuar më mirë përmbajtjen e përrallës; dallon llojin e pjesës mbi bazën e karakteristikave të saj; u përgjigjet pyetjeve rreth përrallës; tregon përmbajtjen e përrallës mbi bazën e pyetjeve; gjykon sjelljen e diellit ndaj resë së vogël dhe reflektimin e tij në fund; paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; demonstron aftësi të bashkëpunimit në grup; vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -dielli; -reja; -deti; -e vogël; -gjigant; -bardhoshe; -bulëza; -valëza; -gabim.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -pamje nga dielli, retë; -informacione për diellin, retë; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -shkencat e natyrës; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore; -mjedisi.	
<ul style="list-style-type: none"> Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim i ideve; -parashikim me anë të titullit, ilustrimeve dhe fjalëve kyçe; -ndërveprim me tekstin; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -ditari dypjesësh; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <p><i>Diskutim i ideve:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et, të shkëmbejnë idetë e tyre rreth pyetjes: -Si e vlerësoni ju ndihmën e më të vegjëlve dhe a duhet besuar tek ajo kur ofrohet me zemërgjërësi?</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaria e dytë <p><i>Parashikim me anë të titullit, ilustrimeve dhe fjalëve kyçe:</i> Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyçe: <i>dielli, reja, deti, gabon.</i> Nxënësit/et shohin ilustrimet, lexojnë titullin dhe fjalët kyçe dhe bëjnë parashikimin për përmbajtjen e pjesës, duke punuar në dyshe. I shkruajnë parashikimet e tyre në fletë (me katër fjali ku të përdoren këto fjalë). Nxiten nxënësit/et të lexojnë parashikimet e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> Veprimtaria e tretë <p><i>Ndërveprim me tekstin:</i> Mësuesi/ja prezanton temën “Gabimi i diellit”. *Nxënësit/et lexojnë tekstin në paragrafë, në heshtje. Ata/ato nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më të rëndësishme. *Punohet fjalori me fjalët e shprehjet e reja (<i>bardhoshe, bulëza, valëzat</i>) dhe nxënësit/et ndërtojnë fjali me to. *Nxënësit/et tregojnë llojin e pjesës (përrallë) duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj. *U lihet kohë nxënësve/eve ta rilexojnë përrallën. *Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të krahasojnë parashikimet e tyre me përrallën, duke e argumentuar atë. *Lexohet përralla zinxhir nga nxënësit/et.</p>			

- **Veprimtaria e katërt**

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”.

Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve rreth përrallës:

-Ku e takoi dielli renë bardhoshe?

-Përse po e kërkonte dielli erën? Çfarë e shqetësonte atë?

-Pse nuk e pranoi dielli ndihmën që i ofroi reja?

-Çfarë i uroi reja?

-Në ç’gjendje ishte dielli kur mbërriti te deti?

-Ç’mendim kishte deti për renë e vogël?

-Si u ndie dielli nga fjalët e detit?

-Çfarë porosie i la ai atij?

*Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e përrallës mbi bazën e pyetjeve.

- **Veprimtaria e pestë**

Ditari dypjesësh. Nxënësit/et punojnë në grupe për të bërë komentin e fragmentit:

Fragmenti	Komenti
O det i kaltër, - foli dielli që tashmë po freskohej, - të lutem mos harro. Po takove udhës renë e vogël, i thuaj që dielli të kërkon të falur.	-Dielli reflektoi pas refuzimit dhe mospërfilljes së ndihmës bujare që i ofroi atij reja e vogël. Ai i kërkoi detit që t’ia dërgonte ndjesën e tij resë.

Përfaqësuesit/et e grupeve prezantojnë punën e grupit. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-parashikimin rreth përmbajtjes së përrallës duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe;

-leximin e përrallës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;

-dallimin e llojit të pjesës mbi bazën e karakteristikave të saj;

-përgjigjet e pyetjeve rreth përrallës;

-tregimin e përmbajtjes së përrallës mbi bazën e pyetjeve;

-gjakimin për sjelljen e diellit ndaj resë së vogël dhe reflektimin e tij në fund;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;

-demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj përmbajtjen e përrallës në fletore.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Gabimi i diellit (ora II)		Situata e të nxënët Personazhi që më ka tërhequr me sjelljet dhe veprimet e tij.	
Rezultatet e të nxënët Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan personazhet në përrallë, duke veçuar personazhin e tij/saj të preferuar; • ndërton fjali përmbledhëse rreth përrallës; • nxjerr mesazhin e përrallës; • tregon përmbajtjen e përrallës, mbi bazën e fjalive përmbledhëse; • tregon se si do të vepronte ai/ajo po të ishte në vend të personazhit të përrallës (diellit); • jep mendimin e tij/saj për mbylljen e përrallës; • interpreton në role përrallën; • demonstroi siguri, kur flet në klasë; • vlerëson interpretimet e shokëve e shoqeve. 		Fjalë kyçe: -dielli; -reja; -deti; -ritregim; -mesazh;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -pamje të diellit e të reve; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -shkenca e natyrës; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore; -mjedisi.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskuto-argumento;
 - mendo-diskuto;
 - mendo-nxirr mesazhin;
 - bashkëbisedim;
 - dramatizim;
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- **Veprimtaria e parë**

Lexim i tregimit nga nxënësit/et.

Diskuto-argumento: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të japin mendimet e tyre rreth personazhit që i ka tërhequr më shumë me sjelljet dhe veprimet e tij.

-Trego personazhet që marrin pjesë në përrallë.

-Kush prej tyre ju ka tërhequr me sjelljet dhe veprimet e tij?

*Leximi zinxhir nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e dytë**

Mendo-diskuto: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et të tregojnë se si janë personazhet e përrallës, duke përzgjedhur alternativën e saktë.

- **Veprimtaria e tretë**

Mendo-nxirr mesazhin: Në grupe, ata/ato do të ndajnë përrallën në pjesëza të vogla, do të krijojnë nga një fjali për to dhe do të nxjerrin mesazhin e përrallës.

1. Dielli takoi renë bardhoshe dhe i shpreh shqetësimin e tij për të gjetur një re të madhe që ta freskonte.

2. Dielli refuzoi ndihmën bujare të resë së vogël.

3. Deti e kritikoi diellin për refuzimin e ndihmës së resë bardhoshe, duke i kujtuar se edhe të vegjëlit duhen përfillur.

4. Dielli reflektoi për sjelljen e tij ndaj resë së vogël dhe i kërkon detit që t’ia transmetonte asaj ndjesën e tij.

Mesazhi: Asnjëherë nuk duhet injoruar ndihma e më të vegjëlve.

Mendjemadhësia ka gjithmonë pasoja për ata që i mbartin.

Nxënësit/et tregojnë përmbajtjen e përrallës mbi bazën e fjalive përmbledhëse.

- **Veprimtaria e katërt**

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit/et të japin mendimin e tyre për renë bardhoshe. Ata/ato tregojnë se si do të vepronin po të ishin në vend të diellit dhe të japin mendimet e tyre për mbylljen e përrallës.

- **Veprimtaria e pestë**

Dramatizim: Nxënësit/et ndahen në grupe. Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës (autori, dielli, reja, deti). Më pas nxënësit/et ushtrohen në leximin me zë sipas roleve. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-përshkrimin e personazheve të përrallës, duke veçuar personazhin e tij/saj të preferuar;

-ndërtimin e fjalive përmbledhëse rreth përrallës;

-formulimin e mesazhit të përrallës;

-tregimin e përmbajtjes së përrallës, mbi bazën e fjalive përmbledhëse;

-tregimin se si do të vepronin ai/ajo po të ishte në vend të personazhit të përrallës (diellit);

-mendimet e dhëna për mbylljen e përrallës;

-interpretimin në role të përrallës;

-demonstrimin e sigurisë, kur flet në klasë;

-vlerësimin që bën për interpretimet e shokëve e shoqeve.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Lakimi i mbiemrave (ora I)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të përcaktuar rasën e emrit dhe mbiemrit që cilëson.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lakon grupin e fjalëve (emër+mbiemër); • plotëson fjalinë me mbiemrin që përshtaten me emrin që cilëson; • përcakton rasën e emrit dhe mbiemrit që cilëson; • paraqet dhe komunikon lirshëm e saktë mendimet e tij/saj; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • vlerëson punën e të tjerëve; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. 		Fjalë kyçe: -mbiemër; -trajtë; -lakim; -rasa; -emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e lakimit: emër i pashquar+mbiemër i nyjshëm, emër i shquar+mbiemër i nyjshëm; -mjete shkrimi, lapustilë, fisha, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim: Punë në dyshe:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. Komentohet figura në libër. Nxiten nxënësit/et të lexojnë tekstin në libër (të cilin edhe mësuesi/ja e ka paraqitur në tabelë) dhe të nënvizojnë mbiemrin <i>i ri</i>. Nxënësit/et diskutojnë nën drejtimin e mësuesit/es, rreth formave që merr mbiemri <i>i ri</i>, në fjali. *Lexohet rubrika “Mbaj mend” Në dyshe, studiohen tabelat e lakimit: emër i pashquar + mbiemër i nyjshëm; emër i shquar + mbiemër i nyjshëm; Disa nxënës/e i lexojnë ato me zë. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të lidhin me shigjetë emrin me mbiemrin e duhur. Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të plotësojnë fjalitë në tekst me mbiemra të përshtatshëm, duke përzgjedhur alternativën e duhur. Tërhiqet vëmendja që në fillim të përcaktohet rasia e emrit që cilëson mbiemri. Nxënësit/et punojnë individualisht në libër me laps. Në përfundim të punës, shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Diskutohen detyrat me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Shkëmbe një problemë:</i> Nxënësit/et punojnë në grupe. Ata/ato shkruajnë në fisha fjali. Ua japin grupit fqinjë për të dalluar grupet emër+mbiemër dhe për të treguar rasën e tyre. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. 			

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <p>-lakimin e grupit emër+mbiemër; -përcaktimin e rasës së emrit dhe mbiemrit që cilëson; -plotësimin e fjalive me mbiemrin e përshtatshëm; -krijimin e fjalive me grupet emër+mbiemër, duke i përdorur në rasat e kërkuara; -paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm e të saktë të mendimeve të tij/saj; -demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve; -vlerësimin e punës së të tjerëve; -bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Detyrë shtëpie <p>Formo fjali me mbiemrat duke i përdorur në rasat e kërkuara: (rrezet) e arta- rasa emërore (trëndafilat) e kuq - rasa gjinore (shoku /shoqja) i/e ngushtë - rasa dhanore (tregimi) fantastik - rasa kallëzore (miqtë) e rinj - rasa rrjedhore</p>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Lakimi i mbiemrave (ora II)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të përcaktuar rasën e emrit dhe mbiemrit që cilëson.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lakon grupin emër+mbiemër; • përcakton rasën e emrit dhe mbiemrit që cilëson; • plotëson fjalitë me mbiemrin e përshtatshëm; • krijon fjali me grupet emër+mbiemër, duke i përdorur në rasat e kërkuara; • paraqet dhe komunikon lirshëm e saktë mendimet e tij/saj; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • vlerëson punën e të tjerëve; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. 		Fjalë kyçe: -mbiemër; -trajtë; -lakim; -rasa; -emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e lakimit: emër i pashquar+mbiemër i nyjshëm, emër i shquar+mbiemër i nyjshëm; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fisha, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim;
 - dallo-trego:
 - rishikim në dyshe;
 - shkrim i drejtuar;
 - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim: Mësuesi/ja shkruan grupin e fjalëve: *(një) libër i bukur; (disa) lule shumëngjyrëshe libri i bukur; lulet shumëngjyrëshe.*

Nxiten nxënësit/et t'i lakojnë ato sipas rasave.

- **Veprimtaria e dytë**

Dallo-trego: *Punë në dyshe:* Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve/eve fisha ku janë shkruar fjali.

Nxiten nxënësit/et të dallojnë grupet emër+mbiemër dhe të tregojnë rasën e tyre.

- **Veprimtaria e tretë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të plotësojnë tekstin e dhënë me një mbiemër të përshtatshëm, duke përcaktuar rasën e emrit dhe të mbiemrit.

Tërhiqet vëmendja që: *për të gjetur mbiemrin e përshtatshëm, bëj pyetjen: Si? Drejtoja atë emrit!*

Nxënësit/et punojnë individualisht në libër me laps.

Në përfundim të punës, shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Diskutohen detyrat me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e katërt**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 4 synon që nxënësit/et të formojnë fjali me mbiemrat e dhënë, duke i përdorur në rasat e kërkuara.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.

Pas përfundimit të punës, disa nxënës/e lexojnë fjalitë e krijuara.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-lakimin e grupit emër+mbiemër;

-përcaktimin e rasës së emrit dhe mbiemrit që cilëson;

-plotësimin e fjalive me mbiemrin e përshtatshëm;

-krijimin e fjalive me grupet emër+mbiemër, duke i përdorur në rasat e kërkuara;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm e të saktë të mendimeve të tij/saj;

-demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;

-vlerësimin e punës së të tjerëve;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

- **Detyrë shtëpie**

Formo fjali me mbiemrat duke i përdorur në rasat e kërkuara:

(rrezet) e arta- rasa emërore

(trëndafilat) e kuq - rasa gjinore

(shoku /shoqja) i/e ngushtë - rasa dhanore

(tregimi) fantastik - rasa kallëzore

(miqtë) e rinj - rasa rrjedhore

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Të fshehtat e xhuxhave (ora I)		Situata e të nxënit A duhet të jemi mirënjohës ndaj ndihmës së të tjerëve dhe a na bën kjo të ndihemi më mirë?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon përrallën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; • tregon se si ndikojnë ilustrimet për ta kuptuar më mirë përmbajtjen e përrallës; • dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij; • u përgjigjet pyetjeve rreth përrallës; • shpreh ndjenjat dhe emocionet e tij/saj rreth përrallës; • tregon përmbajtjen e përrallës mbi bazën e pyetjeve; • gjykon rreth sjelljes së xhuxhave për të ndihmuar këpucarin e varfër; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij; • demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup; • vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalë kyçe: -këpucari; -gruaja e këpucarit; -xhuxhat; -të pikasim; -fener; -enkas; -rrecka.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -përralla për fëmijë të vëllezërve Grim; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim i ideve; -veprimtari e leximit të drejtuar; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -rishikim në dyshe; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim i ideve:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shkëmbejnë idetë e tyre rreth pyetjes: <i>A duhet të jemi mirënjohës ndaj ndihmës së të tjerëve dhe a na bën kjo të ndihemi më mirë?</i> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Veprimtari e leximit të drejtuar:</i> Mësuesi/ja prezanton titullin e pjesës “Të fshehtat e xhuxhave”. Ftohen nxënësit/et të vërejnë ilustrimin në libër dhe ta komentojnë atë, në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën. Fillon leximi i pjesës me ndalesa nga nxënësit/et: Ndalesa e parë: Një këpucar... deri te... gjumë i ëmbël. Pyetje: -Si ishte gjendja ekonomike e këpucarit? -Çfarë la të gatshme ai për mëngjesin e ditës tjetër të punës? -Si mendoni se do të vazhdojë ngjarja? Ndalesa e dytë: Në mëngjes...deri te... dy palë çizme. Pyetje: -Cila ishte e papritura e parë e këpucarit? -Si ishin punuar këpucët? -Si mendoni se do të vazhdojë ngjarja? Ndalesa e tretë: Ai mati dhe preu... deri te... katër palë çizme. Pyetje: -Çfarë i ndodhi këpucarit mëngjesin tjetër të punës? -Për sa palë çizme bleu ai lëkurë? -Si mendoni se do të vazhdojë ngjarja? 			

Ndalesa e katërt: Në mëngjesin e ditës tjetër... deri te... u bë i kamur.

Pyetje: -Kur i gjeti ai katër palë çizme të tjera të mbaruara?

-Çfarë po ndodhte që këpucari u bë i pasur?

Ndalesa e pestë: Një mbrëmje... deri te... ikën me vrap.

Pyetje: -Kur vendosën këpucari me të shoqen të zbulonin se kush po i ndihmonte në bërjen e këpucëve?

-Çfarë konstatuan ata në lidhje me xhuxhat?

Ndalesa e gjashtë: Mëngjesin tjetër... deri te... bënë xhuxhat.

Pyetje: -Cili ishte propozimi i gruas së këpucarit për të shpërblyer ndihmën e dhënë nga xhuxhat?

-Çfarë dhuratash i përgatitën dhe ku i lanë ato?

Ndalesa e gjashtë: Në mesnatë... deri në fund.

Pyetje: -Si i pritën xhuxhat dhuratat e familjes së këpucarit?

-Si mendoni, pse xhuxhat nuk u dukën më pas marrjes së dhuratave?

-A ju pëlqeu mbyllja?

-Çfarë ju bëri përshtypje në këtë pjesë?

*Nxënësit/et tregojnë llojin e pjesës (përrallë), duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj.

*Punohet fjalori me fjalët e shprehjet e reja dhe nxënësit/et ndërtojnë fjali me to.

*Lexohet përralla zinxhir nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e tretë**

**Marrëdhënie pyetje-përgjigje*: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et bashkëbisedojnë në dyshe dhe më pas diskutojnë me gjithë klasën për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth protagonistëve të përrallës dhe përmbajtjes së saj.

Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e përrallës mbi bazën e pyetjeve.

- **Veprimtaria e katërt**

Rishikim në dyshe: Nxënësit/et rendisin vargjet e këngës së xhuxhave, duke vendosur numrat 1-4 para çdo vargu. Shkëmbejnë librat dhe korrigjojnë njëri-tjetrin.

Nxiten nxënësit/et të lexojnë me zë vargjet e këngës së xhuxhave.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e përrallës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;

-tregimin se si ndikojnë ilustrimet për ta kuptuar më mirë përmbajtjen e përrallës;

-dallimin e llojit të tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;

-përgjigjet e pyetjeve rreth përrallës;

-shprehjen e ndjenjave dhe emocioneve të tij/saj rreth përrallës;

-tregimin e përmbajtjes së përrallës mbi bazën e pyetjeve;

-gjykimin rreth sjelljes së xhuxhave për të ndihmuar këpucarin e varfër;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;

-demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie**

Mësuesi/ja u ndan rolet nxënësve/eve dhe ua lë për detyrë t’i mësojnë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Të fshehtat e xhuxhave (ora II)		Situata e të nxënit Personazhi që më ka tërhequr me sjelljet dhe veprimet e tij.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur përrallën; • përshkruan personazhet, duke veçuar personazhin e tij/saj të preferuar; • ndërton fjali përmbledhëse për përrallën; • tregon përmbajtjen e përrallës mbi bazën e fjalive përmbledhëse; • gjykon rreth sjelljes së xhuxhave për të ndihmuar këpucarin e varfër; • interpreton në role pjesën; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • pranon dhe tregon respekt për mendimet dhe idetë e të tjerëve rreth përrallës; • vlerëson interpretimet e shokëve e shoqeve. 		Fjalë kyçe: -xhuxhat; -këpucari; -përmbajtje; -mesazh.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -përralla për fëmijë të vëllezërve Grim; -mjete shkrimi, fletore, lapustilë, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskuto-argumento; -lexo përmbledh në dyshe; -analizë; -vija e vlerës; -dramatizim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë Lexim i përrallës nga nxënësit/et. <i>Diskuto-argumento:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të japin mendimet e tyre rreth personazhit që e ka tërhequr më shumë me sjelljet dhe veprimet e tij. -Trego personazhet që marrin pjesë në përrallë. -Kush prej tyre ju ka tërhequr me sjelljet dhe veprimet e tij? <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë Me anë të teknikës “Lexo, përmbledh në dyshe”, nxënësit/et nën drejtimin e mësuesit/es, ndajnë përrallën në pjesëza dhe në dyshe shkruajnë nga një fjali përmbledhëse për secilën prej tyre: <ol style="list-style-type: none"> 1. Këpucari i varfër dhe gjendja e tij e pashpresë. 2. E papritura e parë e këndshme e këpucarit. 3. Mrekullia vijon, këpucari blen lëkurë për katër palë çizme. 4. Dikush vijon ta ndihmojë këpucarin pa u shfaqur, ai bëhet i kamur. 5. Këpucari dhe e shoqja vendosën të zbulojnë se kush qëndron pas qepjes enigmatike së këpucëve. 6. Këpucari dhe e shoqja bëjnë zbulimin e madh, dalin në skenë xhuxhat. 7. Dhuratat bujare të këpucarit dhe të së shoqes për xhuxhat. 8. Xhuxhat marrin dhuratat, festojnë të gëzuar dhe ikin përgjithmonë. *Nxiten nxënësit/et të lexojnë fjalitë përmbledhëse dhe të tregojnë përmbajtjen e përrallës mbi bazën e tyre. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Analizë:</i> Rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et në grupe të tregojnë se çfarë mësojnë nga kjo përrallë, duke përzgjedhur një nga alternativat e dhëna dhe të tregojnë arsyen e përzgjedhjes. 			

- **Veprimtaria e katërt**

Vija e vlerës: Rubrika “Reflektoj”. Nxënësit/et vendosen në skajet e një vije imagjinare sipas mendimeve që ata kanë për arsyen e largimit të xhuxhave:

-Xhuxhat u larguan sepse e kishin ndihmuar mjaftueshëm këpucarin të dilte nga varfëria, apo morën shpërblimin e punës së tyre?

Secili prej nxënësve pozicionohet në skajet, jep argumentat e tij/saj dhe të tjerët pozicionohen midis tyre.

- **Veprimtaria e pestë**

Dramatizim: Dramatizim i përrallës nga nxënësit/et në grupe.

Nxënësit/et vlerësojnë interpretimet e shokëve e të shoqeve.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur të përrallës;

-përshkrimin e personazheve, duke veçuar personazhin e tij/saj të preferuar;

-ndërtimin e fjalive përmbledhëse për përrallën;

-tregimin e përmbajtjes së përrallës mbi bazën e fjalive përmbledhëse;

-grykimin rreth sjelljes së xhuxhave për të ndihmuar këpucarin e varfër;

-interpretimin në role të pjesës;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Përshtatja e mbiemrit të nyjshëm me emrin që cilëson		Situata e të nxënit Manipulim fjalësh (emra dhe mbiemra) për t’i përshtatur ato në gjini, numër dhe rasë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përcakton gjininë, numrin dhe rasën e mbiemrave në fjali; • përshtat mbiemrin me emrin që cilëson në gjini, numër dhe rasë; • krijon fjali me mbiemrat e dhënë; • paraqet dhe komunikon lirshëm e saktë mendimet e tij/saj; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -mbiemri i nyjshëm; -përshtatja e mbiemrit me emrin.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me mbiemra; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim;
 - rishikim në dyshe;
 - shkrim i drejtuar;
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim: Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. Ftohen nxënësit/et të komentojnë figurat dhe të lexojnë fjalitë:

Kjo është fletorja e re e Elonës. Këto janë fletoret e reja të Elonës.

Nxiten nxënësit/et të gjejnë grupet emër+mbiemër dhe të përcaktojnë gjininë, numrin dhe rasën e emrave dhe mbiemrave.

Zhvillohet një diskutim në klasë: *A ka secili prej mbiemrave të njëjtën gjini, numër dhe rasë me emrin që cilëson?*

Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Dilet në përfundimin se *mbiemrat e nyjshëm përshtaten me emrin që cilësojnë në gjini, numër dhe rasë.*

Në rubrikën “Mbaj mend” nxënësit/et lexojnë dhe diskutojnë rreth shembujve që ilustrojnë përshtatjen e emrave me mbiemrat që cilësojnë.

- **Veprimtaria e dytë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të plotësojnë fjalitë me një nga mbiemrat e dhënë, duke e përshtatur atë me gjininë, numrin dhe rasën e emrit.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Ata/ato shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe korrigjojnë gabimet. Në fund zhvillohet një diskutim në klasë për mënyrën se si kanë punuar, nën drejtimin e mësuesit/es. Tërhiqet vëmendja nga mësuesi/ja që të përshtaten mbiemrat me emrat që ata cilësojnë në gjini, numër dhe rasë.

- **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të shkruajnë 6 fjali ku të përdorin mbiemrat:

i lartë, i zgjuar, e këndshme, të fortë, të bukura, e qetë, duke përcaktuar gjininë, numrin dhe rasën e tyre. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Lexojnë fjalitë e krijuara, vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- përcaktimin e gjinisë, numrit dhe rasës së mbiemrave në fjali;
- përshtatjen e mbiemrit me emrin që cilëson në gjini, numër dhe rasë;
- krijimin e fjalive me mbiemrat e dhënë;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm e të saktë të mendimeve të tij/saj;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.


- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj një shkrim me 7-8 fjali ku të përdoren mbiemra të nyjshëm me temë “Në parkun e qytetit”.

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda:Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Lexojmë Ezopi dhe udhëtari		Situata e të nxënësve Pse nuk duhet të nxitohemi për të nxjerrë konkluzione pa i njohur mirë situatat?	
Rezultatet e të nxënësve <ul style="list-style-type: none"> • lexon fabulën rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit; • tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë fabulën; • shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth fabulës; • analizon personazhet e fabulës duke u mbështetur në përshkrimet dhe veprimet e tyre; • tregon përmbajtjen e fabulës me fjalët e tij/saj; • lidh idetë dhe informacionin e fabulës me njohuritë, përvojën dhe leximet e mëparshme ose dukuri të jetës së përditshme; • interpreton në role fabulën; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson interpretimet e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -Ezopi; -fabul; -Greqia e lashtë; -udhëtar.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -libra me fabula, mjete shkrimi, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -artet; -shkenca e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -vendimmarrja morale.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -pyetja e ditës; -lexim, diskutim në dyshe; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -harta e personazheve; -mendo-nxirr mesazhin; -bisedë; -dramatizim; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Pyetja e ditës:</i> Mësuesi/ja shtron pyetjen: -Pse nuk duhet të nxitohemi për të nxjerrë konkluzione pa i njohur mirë situatat? -Kësaj pyetje do i japin përgjigje në pjesë të ndryshme të orës. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Lexim-diskutim në dyshe:</i> Njihen nxënësit/et me titullin e fabulës “Ezopi dhe udhëtari”. *Komentohet ilustrimi nga nxënësit/et në fillim në dyshe, më pas me gjithë klasën. Mësuesi/ja jep disa informacione rreth krijimtarisë së Ezopit: <i>I pari dhe më i famshmi prej fabulistëve të lashtë grekë, ishte Ezopi. (620 - 564 p.e.s.) Megjithëse ekzistenca e tij mbetet e paqartë dhe asnjë shkrim i tij nuk mbijeton, tregime të shumta që i janë besuar atij, janë mbledhur përgjatë shekujve dhe në shumë gjuhë, në një traditë tregimi që vazhdon edhe sot. Shumë nga tregimet karakterizohen nga kafshët dhe objektet e pajeta që flasin, zgjidhin problemet dhe në përgjithësi kanë karakteristika njerëzore.</i> *Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë fabulën në heshtje. Nënvizojnë fjalët që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që u duken interesante. Pyesin njëri-tjetrin dhe mësuesin/en. Diskutojnë rreth fabulës. *Zhvillohet leximi zinxhir. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Marrëdhënie pyetje-përgjigje:</i> Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”, ku nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve rreth protagonistëve të fabulës. 			

• **Veprimtaria e katërt**

Punë në grup: Harta e personazheve: Për personazhin e fabulës gjenden dy cilësi dhe ilustrohen me pjesë nga fabula këto cilësi.



Ai dinte t'i kthente përgjigje në mënyrën e duhur çdo pyetjeje.

Ai nuk lëndohet nga inatosja e udhëtarit, por i tregon atij për sa kohë do të mbërrinte në qytet.

• **Veprimtaria e pestë**

Mendo-nxirr mesazhin: Punohet rubrika “Analizoj”: Nxënësit/et në grupe formulojnë moralin e fabulës.

*Nxiten nxënësit/et thonë përmbajtjen e fabulës me fjalët e tyre.

• **Veprimtaria e gjashtë**

Bisedë: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxënësit/et diskutojnë nëse janë ndodhur në ndonjë situatë, në të cilën e kanë keqkuptuar bashkëbiseduesin.

• **Veprimtaria e shtatë**

Dramatizim: Mësuesi/ja fton nxënësit/et që të dramatizojnë pjesën sipas roleve (Ezopi, udhëtarit, autori).

Dallohet grupet dhe nxënësit/et që interpretuan më bukur.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

• **Vlerësimi bëhet për:**

- leximin e rrjedhshëm të fabulës dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;
- shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth fabulës;
- analizën e personazhit të fabulës duke u mbështetur në përshkrimet dhe veprimet e tij;
- tregimin e përmbajtjes së fabulës me fjalët e tij/saj;
- lidhjen e ideve dhe informacionit të fabulës me njohuritë, përvojën dhe leximet e mëparshme, ose dukuri të jetës së përditshme;
- interpretimin në role të fabulës;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- vlerësimin e interpretimeve të shokëve/shoqeve.

• **Detyrës shtëpie** Rubrika “Shkruaj”


Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda:Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Ushtrime përmbledhëse: Mbiemrat (ora I)		Situata e të nxënit Krijimi i një harte konceptesh për mbiemrin.	
Rezultatet e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> • dallon gjininë, numrin dhe rasën e mbiemrave në fjali; • përshtat mbiemrin me emrin që cilëson në gjini, numër dhe rasë; • zëvendëson në fjali grupe fjalësh me një mbiemër të nyjshëm; • shkruan mbiemra të panyjshëm për emrat e dhënë; • krijon fjali me mbiemrat e dhënë; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe -mbiemri; -cilësi; -i nyjshëm; -i panyjshëm; -gjinia e mbiemrit; -numri i mbiemrit; -rasa e mbiemrit.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me mbiemra; -harta e konceptit të mbiemrit; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera -shoqëria dhe mjedisi; -artet.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**Metodologjia:**

- harta e konceptit;
- rishikim në dyshe;
- të nxënët me këmbime;
- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Harta e konceptit: Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. Mësuesi/ja fton nxënësit/et që në grupe të plotësojnë hartën e konceptit të mbiemrit.



- **Veprimtaria e dytë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të lidhin çdo emër me grupin e përshtatshëm të mbiemrave. Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim të punës, shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Diskutohet në klasë rreth ushtrimit, nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Të nxënët me këmbime, grupet e ekspertëve: Nxënësit/et grupohen në grupe me nga 4 individë dhe secilit u caktohet nga një numër nga 1-4.

Nxënësve u ndahen detyrat:

Nxënësit/et me numrin 1, do të punojnë ushtrimin 2, ku do të zëvendësojnë grupet e fjalëve me një mbiemër të nyjshëm.

Nxënësit/et me numrin 2, do të punojnë ushtrimin 3, ku do të shkruajnë nga 4 mbiemra të panyjshëm për emrat *rrap* dhe *lis*.

Nxënësit/et me numrin 3, do të punojnë ushtrimin 4, ku do të nënvizojnë në tekst, emrat dhe mbiemrat, duke përcaktuar gjininë e tyre.

Nxënësit/et me numrin 4, do të punojnë ushtrimin 5, ku do të nënvizojnë mbiemrat së bashku me emrat që i cilësojnë, duke përcaktuar edhe numrin e tyre.

Nxënësit/et, sipas numrave që kanë, do të rigrupohen dhe do të diskutojnë me njëri-tjetrin rreth ushtrimeve.

Pas kryerjes së detyrave, ata/ato do të shkojnë në grupet fillestare ku do t'ua shpjegojnë detyrën edhe anëtarëve të tjerë të grupit. Në fund diskutohet rreth çdo detyre me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e gjinisë, numrit dhe rasës së mbiemrave në fjali;
- përshtatjen e mbiemrit me emrin që cilëson në gjini, numër dhe rasë;
- zëvendësimin e grupeve të fjalëve me një mbiemër të nyjshëm;
- shkrimin e mbiemrave të panyjshëm për emrat e dhënë;
- krijimin e fjalive me mbiemrat e dhënë;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe ato në grup.

- **Detyrë shtëpie**


Shkruaj 5 fjali ku të përdorësh mbiemra të ndryshëm. Trego numrin, gjininë dhe rasën e tyre.

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda:Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Ushtrime përmbledhëse: Mbiemrat (ora II)		Situata e të nxënit Shqyrtimi i mbiemrave për të dalluar llojin, gjininë, numrin dhe rasën e tyre.	
Rezultatet e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> • dallon gjininë, numrin dhe rasën e mbiemrave në fjali; • përshtat mbiemrin me emrin që cilëson në gjini, numër dhe rasë; • krijon fjali duke përdorur mbiemra në numrin dhe gjininë e kërkuar; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe -mbiemri; -cilësi; -i nyjshëm; -i panyjshëm; -gjinia e mbiemrit; -numri i mbiemrit; -rasa e mbiemrit.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me mbiemra; -harta e konceptit të mbiemrit; -tabela e ushtrimit 9; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera -shoqëria dhe mjedisi; -artet.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodologjia: -analizë; -konkurs; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë *Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. <i>Analizë, konkurs:</i> Ushtrimi 6. Nxiten nxënësit/et të lexojnë tekstin në ushtrimin 6 dhe të dallojnë mbiemrat në të. Nxënësit/et punojnë në grup për plotësimin e tabelës si ajo e ushtrimit 9, ku do të shënojnë llojin, gjininë dhe numrin e mbiemrave. Pas përfundimit të punës, secili grup prezanton tabelën e tij me përgjigjet përkatëse. Zhvillohet një diskutim në klasë, nën drejtimin e mësuesit/es. Mësuesi/ja shpall grupin fitues. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Shkrim i drejtuar:</i> Ushtrimi 7. Klasa ndahet në dy grupe. Grupi 1 do të shkruajë 4 fjali, në të cilat të përdoren mbiemra të nyjshëm në numrin njëjës, gjinia femërore. Grupi 2 do të shkruajë 4 fjali, në të cilat të përdoren mbiemra të panyjshëm në numrin shumës, gjinia mashkullore. Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim, ata/ato lexojnë fjalitë me zë. Me ndihmën e mësuesit/es, nxënësit/et, bëjnë qortime të thjeshta drejtshkrimore. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Analizë, konkurs. Punë në grupe:</i> Nxënësit/et do të nënvizojnë mbiemrat në tekstin e ushtrimit 8. Ata do të përcaktojnë karakteristikat e mbiemrave, duke plotësuar tabelën e ushtrimit 9. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: -dallimin e gjinisë, numrit dhe rasës së mbiemrave në fjali; -përshtatjen e mbiemrit me emrin që cilëson në gjini, numër dhe rasë; -krijimin e fjalive duke përdorur mbiemra në numrin dhe gjininë e kërkuar; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve; -demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup. <ul style="list-style-type: none"> • Detyrë shtëpie Shkruaj një tregim të shkurtër me temë “Vizitë në një vend turistik”, ku të përdorësh mbiemra.			

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda:Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Korbi i etur		Situata e të nxënit A mendoni se çdo vështirësi kapërcehet po të përdorim me mençuri mjetet e përshtatshme?	
Rezultatet e të nxënit <ul style="list-style-type: none"> • lexon fabulën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; • tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë fabulën; • përcakton dy-tre tipare të fabulave; • shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth veprimit të personazhit të fabulës, për të gjetur zgjidhje të situatës në të cilën ndodhej; • tregon fabulën mbi bazën e fjalive përmbledhëse; • nxjerr moralin e fabulës; • lidh fabulën me përvoja nga jeta e vet, kur ka gjetur një zgjidhje për një situatë të vështirë; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalë kyçe -korb; -etje; -gurë të vegjël.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit -teksti mësimor; -libra me fabula; -informacione nga interneti për korbin; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -vendimmarrja morale; -mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia: -pyetja e ditës; -lexim, diskutim në dyshe; -rishikim në dyshe; -harta e personazheve; -lexo, përmblihdh në dyshe; -mendo-nxirr mesazhin; -diskutim; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaritë e nxënësve • Veprimtaria e parë <i>Pyetja e ditës:</i> Mësuesi/ja shtron pyetjen: <i>-A mendoni se çdo vështirësi kapërcehet po të përdorim me mençuri mjetet e përshtatshme?</i> <i>-Kësaj pyetjeje, do t'i japin përgjigje në pjesë të ndryshme të orës.</i> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Lexim, diskutim në dyshe:</i> Mësuesi/ja prezanton titullin e pjesës “Korbi i etur”. Orientohen nxënësit/et të vështrojnë ilustrimin në libër dhe të diskutojnë rreth tij. *Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë pjesën në heshtje. Nënvizojnë fjalët që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që i duken interesante. Pyesin njëri-tjetrin dhe mësuesin/en. Diskutojnë rreth pjesës. *Diskutohet me gjithë klasën për llojin e pjesës duke vënë në dukje 2-3 karakteristika të saj. (fabul, personazhe kafshë, mbyllet me një moral). *Zhvillohet leximi zinxhir. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Rishikim në dyshe:</i> Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Individualisht, nxënësit/et bëjnë gjetjen e alternativës së duhur. Shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es. 			

• **Veprimtaria e katërt**

Punë në grupe -Harta e personazheve. Për personazhin e fabulës, gjenden dy cilësi dhe ilustrohen me vargje nga fabula këto cilësi.



Pasi mblodhi gurë të vegjël, i hodhi në fund të qypit në mënyrë që uji të ngrihej lart.

U lodh ca, por pas njëfarë kohe, ai e arriti ujin dhe e shoi etjen.

• **Veprimtaria e pestë**

Lexo, përmbledh në dyshe: Nxënësit/et duke punuar në dyshe lexojnë dhe e përmbledhin çdo paragraf me 1-2 fjali. Njëri/a lexon dhe tjetri/a përmbledh. Ndërrohen rolet pas çdo paragrafi.

*Nxënësit/et tregojnë përmbajtjen mbi bazën e fjalive përmbledhëse.

• **Veprimtaria e gjashtë**

Mendo-nxirr mesazhin: Punohet rubrika “Analizoj”, nëpërmjet saj del morali i fabulës:

Çdo situatë e vështirë ka një rrugëdalje, në rast se përpiqemi dhe gjejmë zgjidhjen e duhur.

• **Veprimtaria e shtatë**

Diskutim: Rubrika “Reflektoj”. Nga mesazhi lindin diskutime me nxënësit/et për ngjarje të ndryshme nga jeta e përditshme, kur janë ndodhur në situata që në fillim janë dukur pa rrugëdalje dhe se si kanë vepruar për të gjetur zgjidhje.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

• **Vlerësimi bëhet për:**

- leximin e fabulës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- tregimin se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë fabulën;
- shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth veprimit të personazhit të fabulës për të gjetur zgjidhje të situatës në të cilën ndodhej;
- tregimin e fabulës mbi bazën e fjalive përmbledhëse;
- formulimin e moralit të fabulës;
- lidhjen e fabulës me përvoja nga jeta e vet, kur ka gjetur një zgjidhje për një situatë të vështirë;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyrë shtëpie Rubrika “ Shkruaj”

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Dëgjojmë Peshku dhe dallëndyshja		Situata e të nxënit Plotësimi i një harte semantike për peshkun dhe dallëndyshen.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • ndjek me vëmendje përrallën që dëgjon, duke mbajtur shënime të shkurtra për çështje kryesore dhe detaje nga përralla; • demonstroi të dëgjuar të qëllimshëm në kryerjen e detyrave; • jep parashikimet e veta në lidhje me pjesën që dëgjon; • u përgjigjet pyetjeve rreth përrallës; • krijon një mbyllje tjetër për këtë histori; • gjykon rreth dëshirave të dallëndyshes dhe të peshkut për të dalë nga vetvetja; • lidh përmbajtjen e përrallës me fjalë të urta që kanë lidhje me të; • tregon për ëndrrën e tij/saj të madhe dhe se si ka menduar ta realizojë atë; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe -dallëndyshja; -peshku; -oktapodi; -bufi; -dëshira; -oqeani;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -magnetofon, CD; -enciklopedi; -mjete shkrimi, lapustilë, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore; -vendimmarrja morale.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -harta semantike; -dëgjim i drejtuar; -diskuto-argumento; -bisedë; -rishikim në dyshe; -shkrim i shpejtë; -punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Harta semantike: Punë në grupe.</i> Mësuesi/ja paraqet ilustrime të dallëndyshes dhe të peshkut. Nxënësit/et do të plotësojnë në grupe hartën semantike për dallëndyshen dhe për peshkun mbi bazën e ilustrimeve dhe njohurive që kanë për to.</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="text-align: center;"> </div> <div style="text-align: center;"> </div> </div> <p>Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e grupit. Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimit “Peshku dhe dallëndyshja”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>*Dëgjim i drejtuar:</i> Ushtrimi 1-4.Mësuesi/ja fton nxënësit/et të dëgjojnë me anë të magnetofonit, ose të leximit prej tij/saj, pjesën e parë të përrallës. Orientohen ata/ato që gjatë dëgjimit të mbajnë shënime të shkurtra për çështjet më kryesore. Nxënësit/et pas dëgjimit të pjesës së parë u përgjigjen pyetjeve rreth saj dhe bëjnë parashikime për vazhdimin e përrallës. Kështu vazhdohet edhe për pjesët e tjera të saj.</p> <p>Pjesa e parë: -Çfarë pa peshku i vogël kur po notonte? - Cila ishte ëndrra e tij më e madhe në atë çast? Çfarë e nxiti këtë ëndërr? - Mendon se në vazhdim të përrallës, peshku e realizon në ëndrrën e tij? Pse?</p>			

Pjesa e dytë -Çfarë bëri peshku për ta realizuar ëndrrën e tij?

-Kë shkoi të takonte ai? Pse?

-Si mendon, çfarë zgjidhje mund t'i japë oktapodi?

Pjesa e tretë -Çfarë i tregon oktapodi, peshkut të vogël?

-Çfarë mendoi peshku i vogël kur dëgjoi për dëshirën e dallëndyshes?

-A do të ketë gjetur zgjidhje bufi për dallëndyshen?

Pjesa e katërt -Çfarë i shpjegoi bufi, dallëndyshes?

-Si arriti të jetë e lumtur dhe e gëzuar dallëndyshja?

-Çfarë duhej të bënte peshku i vogël që të ishte i lumtur si dallëndyshja?

Në përfundim, nxiten nxënësit/et të krahasojnë mbylljen e përrallës me parashikimet e tyre.

*Disa nxënës/e, tregojnë përrallën në mënyrë të përmbledhur.

- **Veprimtaria e tretë**

Diskuto-argumento: Ushtrimi 5. Nxënësit/et diskutojnë në grupe se si u duket mendimi i bufit dhe i oktapodit.

- **Veprimtaria e katërt**

Bisedë: Ushtrimi 6. Nxiten nxënësit/et të tregojnë për ëndrrat e tyre dhe si kanë menduar për t'i realizuar ato.

- **Veprimtaria e pestë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 7. Nxënësit/et punojnë individualisht për të bërë lidhjen e përmbajtjes së përrallës që dëgjuan me disa nga fjalët e urta të dhëna. Në përfundim, shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, korrigjojnë gabimet dhe diskutojnë me gjithë klasën.

- **Veprimtaria e gjashtë**

Shkrim i shpejtë: Ushtrimi 8. Nxënësit/et do të krijojnë një mbyllje tjetër për këtë histori.

Nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-vëmendjen e treguar gjatë dëgjimit të përrallës, duke mbajtur shënime të shkurtra për çështje kryesore dhe detaje nga përralla;

-demonstrimin e të dëgjuarit të qëllimshëm në kryerjen e detyrave;

-parashikimeve të dhëna në lidhje me pjesën që dëgjon;

-përgjigjet e pyetjeve rreth përrallës;

-krijimin e një mbylljeje tjetër për këtë histori;

-grykimin rreth dëshirave të dallëndyshes dhe të peshkut, për të dalë nga vetvetja;

-lidhjen e përmbajtjes së përrallës me fjalë të urta që kanë lidhje me të;

-tregimin për ëndrrën e tij/saj të madhe dhe se si ka menduar ta realizojë atë;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin që i bëjnë punës së shokëve e të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Përmbledhim një përrallë (ora I)		Situata e të nxënësve Si duhet të përmbledhim një përrallë?	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • tregon çdo të thotë të përmbledhësh një përrallë dhe pse është e rëndësishme të bësh një përmbledhje edhe në komunikimin e përditshëm; • zbaton hapat që ndiqen për të përmbledhur një përrallë në mënyrë korrekte; • shkruan përmbledhjen e një përralle sipas modelit të dhënë; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalët kyçe: -përrallë; -përmbledhje.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor, -libra me përralla; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -tregojmë përralla; -lexim përmbledhje në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve • Veprimtaria e parë <i>Tregojmë përralla:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të tregojnë shkurtimisht përralla të ndryshme që dinë. Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Lexim përmbledhje në dyshe.</i> Ushtrimi 1. Orientohen nxënësit/et të lexojnë materialin teorik që bën fjalë për përmbledhjen e përrallës, hapat që ndiqen, duke lexuar modelin e ofruar në tekst për përmbledhjen e paragrafit të parë të përrallës “Peshku dhe dallëndyshja”, në mënyrë që të kuptojnë praktikisht procedurat që ndiqen për të përmbledhur një tekst, duke ruajtur përmbajtjen dhe duke paraqitur thelbin e saj për bashkëbiseduesin tjetër. Nxënësit/et komentojnë atë në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Shkrim i drejtuar:</i> Ushtrimi 2. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të përmbledhin në fletore individualisht, pjesëzat e tjera të përrallës “Peshku dhe dallëndyshja”, sipas orientimeve të tekstit duke u mbështetur në modelin e ushtrimit 1. Në përfundim të punës, shkëmbejnë fletoret ndërmjet tyre, kontrollojnë njëri-tjetrin dhe lexojnë detyrën para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es korrigjohen gabimet drejtshkrimore. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: -zbatimin e hapave që ndiqen për të përmbledhur një përrallë në mënyrë korrekte; -shkrimin e një përmbledhjeje të një përralle sipas modelit të dhënë; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit; -qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve. • Detyrë shtëpie Ushtrimi 3 			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Përmbledhim një përrallë (ora II)		Situata e të nxënit Shkruajmë përmbledhjen e një përralle.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • tregon ç'do të thotë të përmbledhësh një përrallë dhe pse është e rëndësishme të bësh një përmbledhje edhe në komunikimin e përditshëm; • zbaton hapat që ndiqen për të përmbledhur një përrallë në mënyrë korrekte; • shkruan përmbledhjen e një përralle sipas modelit të dhënë; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • vlerëson punën e shokëve dhe të shoqeve. 		Fjalët kyçe: -përrallë; -përmbledhje.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; -teksti shkollor; -libra me përralla; -mjete shkrimi, lapustilë, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë, ku nxënësit/et kanë shkruar të plotë përmbledhjen e përrallës “Peshku dhe dallëndyshja”, titullin dhe përmbajtjen e secilës pjesëz. Nxitet një diskutim për të vlerësuar përmbledhjen më të mirë, duke e argumentuar atë. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Diskutim:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të rikujtojnë praktikën e ndjekur për përmbledhjen e një përralle, bazuar edhe në mënyrën e përmbledhjes së përrallës “Peshku dhe dallëndyshja” . • Veprimtaria e tretë <i>Shkrim i drejtuar:</i> Ushtrimi 4. Bazuar në përvojën e krijuar në përmbledhjen e përrallës “Peshku dhe dallëndyshja”, mësuesi/ja fton nxënësit/et të përmbledhin përrallën “Si u bë qimja tra”. Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim të punës shkëmbejnë fletoret ndërmjet tyre, kontrollojnë njëri-tjetrin. Lexojnë detyrën para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es korrigjohen gabimet drejtshkrimore. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin dhe japin mendime për përmbledhjen më të mirë. <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: -tregimin; ç'do të thotë të përmbledhësh një përrallë dhe pse është e rëndësishme të bësh një përmbledhje në komunikimin e përditshëm; -zbatimin e hapave që ndiqen për të përmbledhur një përrallë në mënyrë korrekte; -shkrimin e përmbledhjes së një përralle sipas modelit të dhënë; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit; -qortimeve të thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es; -vlerësimin e punës së shokëve dhe të shoqeve. • Detyrë shtëpie Ushtrimi 5 			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Si lindi ylberi		Situata e të nxënit Çfarë dini për ylberin?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalitë që i pëlqejnë; • tregon llojin e tekstit, duke e argumentuar atë; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes; • ndan përvojat e tij/saj me të tjerët në lidhje me leximin; • tregon përmbajtjen me fjalët e tij/saj; • argumenton pse i pëlqen ylberi; • demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup; • vlerëson punën e të tjerëve. 		Fjalë kyçe: -ylber; -qiell; -perënditë dhe perëndeshat; -shaloi kalin; -mbërriti vetëtimthi; -u sul me revan; -skërkat.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -vizatim i ylberit; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -loja-gjëzë; -ndërveprim me tekstin; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -trego-argumento; -diskutim i argumentuar; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Loja-gjëzë:</i> Mësuesi/ja fiton nxënësit/et të gjejnë gjëgjëzën: Pas shiut në qiell, Kur ka edhe diell, Një shirit me shtatë ngjyra, I qesh e tërë fytyra. (<i>ylberi</i>) *Ftohen nxënësit/et të tregojnë se çfarë dinë për ylberin. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Ndërveprim me tekstin:</i> Mësuesi/ja prezanton temën “Si lindi ylberi”. *Nxënësit/et vërejnë ilustrimet dhe diskutojnë rreth tyre në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën. *Nxënësit/et lexojnë tekstin në paragrafë, në heshtje. Ata/ato nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më të rëndësishme. *Punohet fjalori me fjalët e shprehjet e reja dhe nxënësit/et ndërtojnë fjali me to. *Lexim zinxhir nga nxënësit/et. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Marrëdhënie pyetje-përgjigje:</i> Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes. 			

• **Veprimtaria e katërt**

Trego-argumento: Rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et tregojnë duke argumentuar ç’lloj teksti është (mit). *Ka personazh kryesor një qenie mitike, siç është Bathala, mbreti i zotave.*

Në përdorimin popullor, miti është një bindje, ose besim kolektiv që nuk bazohet në fakte, siç është edhe rasti i mitit të ylberit, që nga banorët e Filipineve besohet që u krijua nga miqtë qiellor të Bathalës, si një urë që të mbante kalin dhe kalorësin për të shkuar në qiell, prandaj quhet edhe “ura e mbretit”).

*Nxiten nxënësit/et të thonë përmbajtjen me fjalët e tyre.

• **Veprimtaria e pestë**

Diskutim i argumentuar: Rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit/et të tregojnë çfarë është ylberi dhe të japin argumentat e tyre pse u pëlqen ylberi.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

• **Vlerësimi bëhet për:**

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalitë që i pëlqejnë;
- tregimin e llojit të tekstit duke e argumentuar atë;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes;
- tregimin e përmbajtjes me fjalët e tij/saj;
- argumentimin pse i pëlqen ylberi;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

• **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Përemri vetor		Situata e të nxënit Manipulime fjalësh për të dalluar, zëvendësuar dhe përdorur në fjali përemrin vetor.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon përemrat vetorë, në fjali, duke përcaktuar numrin dhe vetën e tyre, për vetën e tretë njëjës dhe shumës edhe gjininë; • plotëson fjalitë me përemrin vetor që mungon; • zëvendëson përemrat vetorë në fjali me emra të përshtatshëm; • krijon fjali me përemrat vetorë; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalët kyçe: -përemri vetor; -unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato; -veta; -numri.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e përemrit vetor; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim paraprak;
 - mendo, puno në dyshe, shkëmbe;
 - rishikim në dyshe;
 - shkëmbe një problemë;
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim paraprak: Mësuesi/ja paraqet fjalitë, mbi të cilat zhvillohet një diskutim për të theksuar faktin, që përemrat vetorë, zëvendësojnë emrat e njerëzve, kafshëve, sendeve.

Jona mëson pianon. *Ajo* studion çdo ditë.

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve të gjejnë fjalën që zëvendëson emrin *Jona* në fjalinë e dytë (*ajo*).

*Punohen edhe raste të tjera ku përemrat zëvendësojnë emrat në fjali.

- **Veprimtaria e dytë**

Mendo, puno në dyshe, shkëmbe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të plotësojnë secilën nga fjalitë me përemrin vetor që mungon dhe të përcaktojnë vetën dhe numrin e secilit prej tyre.

Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Pastaj mendimet e tyre i shkëmbejnë me shokun/shoqen e bankës dhe në fund me gjithë klasën. Pasi binden për përgjigjen e saktë, plotësojnë përgjigjet në libër. Nxiten nxënësit/et që të lexojnë fjalitë dhe të diskutojnë për secilin rast, duke treguar përemrin vetor që mungon, numrin dhe vetën e tij.

- **Veprimtaria e tretë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të nënvizojnë përemrat vetorë në fjalitë e dhëna dhe t'i zëvendësojnë ata, me emra të përshtatshëm.

Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Më pas ata/ato punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrin.

Diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es për secilin rast.

- **Veprimtaria e katërt**

Shkëmbe një problemë: Nxënësit/et punojnë në grupe. Njëri grup shkruan përemrat vetorë dhe ia jep grupit fqinj të krijojë fjali me to.

Nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara, diskutojnë rreth punës së shokëve/shoqeve dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e përemrave vetorë, në fjali, duke përcaktuar numrin dhe vetën e tyre, për vetën e tretë njëjës dhe shumës edhe gjininë;
- plotësimin e fjalive me përemrin vetor që mungon;
- zëvendësimin e përemrave vetorë në fjali me emra të përshtatshëm;
- krijimin e fjalive me përemrat vetorë;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie** Ushtrimi 3

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Si lindën njerëzit		Situata e të nxënësve Si do të dukej toka pa praninë e njerëzve?	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalitë që i pëlqejnë; • tregon llojin e tekstit, duke treguar disa karakteristika të tij; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit; • diskuton rreth mitit të lindjes së njerëzve; • gjykon se pse bota nuk ishte më e trishtuar pas popullimit të saj nga njerëzit; • demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup; • vlerëson punën e të tjerëve. 		Fjalë kyçe: -njerëz; -perëndia P'an-Ku; -perëndia Nu-Kua; -kaos; -i erdhi në majë të hundës; -plis;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -mite të tjera për lindjen e njerëzimit; -enciklopedi; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -imagjinatë e drejtuar; -lexim, diskutim në dyshe; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -trego-argumento; -mendo-diskuto; -ditari dypjesësh; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Imagjinatë e drejtuar:</i> Mësuesi/ja u thotë nxënësve/eve: -Mbyllni sytë dhe mendoni për një çast si do të dukej toka pa ekzistencën e njerëzve? Nxënësit/et hapin sytë dhe tregojnë atë çfarë imagjinuan. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Lexim, diskutim në dyshe:</i> Mësuesi/ja prezanton temën “Si lindën njerëzit”. *Orientohen nxënësit/et të vështrojnë figurën dhe të diskutojnë rreth saj. Nxënësit/et diskutojnë në fillim në dyshe, më pas me gjithë klasën. *Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në heshtje. *Nënvizojnë fjalët që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që u duken interesante. Pyesin njëri-tjetrin dhe mësuesin/en. *Diskutojnë rreth tekstit. *Organizohet lexim zinxhir nga nxënësit/et. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>*Marrëdhënie pyetje-përgjigje:</i> Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et bashkëbisedojnë në dyshe dhe më pas, diskutojnë me gjithë klasën për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. -Çfarë bëri perëndia P’an-Ku? -Si reagon perënditë e tjera? -Përse u mërztën më pas ato? -Çfarë bëri në këtë rast perëndia Nu-Kua? -Çfarë përdori ajo? -Po njerëzit, çfarë bënë kur iu dhurua jeta? <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Trego-argumento:</i> Rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et në grupe, tregojnë duke e argumentuar ç’lloj teksti është dhe ç’personazhe ka. 			

- **Veprimtaria e pestë**

Mendo-diskuto: Rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit/et të japin mendimin e tyre se ç’do të thotë që deti, toka, qiejt, hëna, dielli, yjet, ishin një kaos i vërtetë.

Nxënësit/et diskutojnë në grupe të vogla, më pas me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e gjashtë**

Ditari dypjesësh. Nxënësit/et punojnë në grupe për të bërë komentin e fjalisë:

Fjalja	Komenti
Bota nuk ishte më e trishtuar.	Njerëzit e kishin populluar tokën. Ata jetonin, punonin, ndërtonin, eksperimentonin duke i sjellë ndryshime të mëdha asaj. Lindja e njeriut i dha kuptim të vërtetë jetës së gjallë në tokë.

Përfaqësuesit/et e grupeve prezantojnë punën e grupit.

*Me ndihmën e mësuesit/es, nxënësit/et diskutojnë për mite të tjera, që kanë të bëjnë me lindjen e njerëzimit, të cilat i kanë lexuar, apo parë në filma, dokumentarë, etj...

*Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalitë që i pëlqejnë;
- tregimin e llojit të tekstit, duke treguar disa karakteristika të tij;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;
- diskutimin rreth mitit të lindjes së njerëzve;
- gjykimin se pse bota nuk ishte më e trishtuar pas popullimit të saj nga njerëzit;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Përemri pronor (ora I)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar përemrin pronor.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon përemrin pronor në fjali, duke treguar funksionin e tij; • përshtat përemrin pronor me emrin në fjali; • përcakton vetën, numrin dhe gjininë e përemrit pronor; • krijon fjali me përemrat pronorë; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalët kyçe: -përemri pronor; -gjinia; -numri; -veta.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e përemrave pronorë; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim; -lexo-komento; -mendo, puno në dyshe, shkëmbe; -rishikim në dyshe; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Diskutim:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimin. Komentohen figurat në libër. Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë dhe të thonë ç’regojnë fjalët e ngjyrosura (<i>im, ime, e mia, jote</i>).</p>			

Emi: *Biçikleta ime është e kuqe. Po biçikleta jote?*

Tregon se kujt i përket biçikleta.

Ani: *Timoni im është i lehtë. Po biçikleta jote, si e ka timonin?*

Gjinia mashkullore

Gjinia femërore

Emi: *Rrotat e mia janë të trasha. Po biçikleta jote, si i ka rrotat?*

Numri shumë

Numri njëjës

Ani: *Të trasha besoj. Nuk kam shumë të dhëna, sepse kjo është biçikleta ime e parë.*

Veta e parë

*Lexohet rubrika “Mbaj mend”. Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet dhe paqartësitë që mund t’u lindin nxënësve/eve. Nxënësit/et diskutojnë lirshëm dhe dalin në konkluzionin, që fjalët: *ime, jote; janë përemra pronorë. Ata tregojnë se kujt i përket ajo për të cilën po flasim. Përemrat pronorë mund të jenë në gjininë femërore, ose mashkullore, në numrin njëjës, ose në shumë, në vetën e parë, të dytë, ose të tretë njëjës dhe shumë.*

*Lexo-komente: Lexohet dhe komentohet tabela e përemrave pronorë nga nxënësit/et nën drejtimin e mësuesit/es.

Veta	Gjinia mashkullore		Gjinia femërore	
	Numri njëjës	Numri shumë	Numri njëjës	Numri shumë
e parë njëjës	lapsi im	lapsat e mi	çanta ime	çantat e mia
e dytë njëjës	lapsi yt	lapsat e tu	çanta jote	çantat e tua
e tretë njëjës	lapsi i tij	lapsat e tij	çanta e tij	çantat e tij
e tretë njëjës	lapsi i saj	lapsat e saj	çanta e saj	çantat e saj
e parë shumë	lapsi ynë	lapsat tanë	çanta jonë	çantat tona
e dytë shumë	lapsi juaj	lapsat tuaj	çanta juaj	çantat tuaja
e tretë shumë	lapsi i atyre	lapsat e atyre	çanta e atyre	çantat e atyre

• **Veprimtaria e dytë**

Mendo, puno në dyshe, shkëmbe: Ushtrimi 1. Mësuesi/ja njih nxënësit/et me kërkesën e ushtrimit, i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Pastaj mendimet e tyre i shkëmbejnë me shokun/shoqen e bankës dhe në fund me gjithë klasën.

Pasi binden për përgjigjen e saktë, lidhin me shigjetë emrin me përemrin e duhur pronor.

• **Veprimtaria e tretë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 2, synon që nxënësit/et të plotësojnë fjalitë me përemrin pronor të përshtatshëm. Nxënësit/et punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrin.

Diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth plotësimit të fjalive me përemrin pronor të përshtatshëm duke evidentuar edhe një herë praktikisht se si përemri pronor mund të jetë në gjininë femërore, ose mashkullore, në numrin njëjës, ose në shumë, në vetën e parë, të dytë, ose të tretë, njëjës dhe shumë.

• **Veprimtaria e katërt**

Shkëmbe një problemë: Nxënësit/et punojnë në grupe. Njëri grup shkruan përemrat pronorë dhe ia jep grupit fqinjë të krijojë fjali me to. Nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara, diskutojnë rreth punës së shokëve/shoqeve dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

• **Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e përemrit pronor në fjali, duke treguar funksionin e tij;
- përshtatjen e përemrit pronor me emrin në fjali;
- përcaktimin e vetës, numrit dhe gjinisë së përemrit pronor;
- krijimin e fjalive me përemrat pronorë;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

• **Detyrë shtëpie Shkruaj 5 fjali ku të përdorësh përemra pronorë.**

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Përemri pronor (ora II)		Situata e të nxënit Krijimi i një harte konceptesh për përemrin pronor.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përcakton vetën, numrin dhe gjininë e përemrit pronor; • shkruan përemrat pronorë të përfutur, duke ndryshuar gjininë, ose numrin e tyre dhe shpjegon se si realizohet ky ndryshim; • krijon fjali me përemrat pronorë; • paraqet dhe komunikon lirshëm e saktë mendimet e tij/saj; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve. 		Fjalët kyçe: -përemri pronor; -gjinia; -numri; -veta.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e përemrave pronorë; -fisha; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -harta e konceptit; -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p>*Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. <i>Punë në grupe:</i> Nxiten nxënësit/et të krijojnë në grupe hartën e konceptit për përemrin pronor.</p> <div style="text-align: center;"> <p>tregon se kujt i përket ajo për të cilën flasim</p> <pre> graph TD A([Përemri pronor]) --> B[veta] A --> C[gjinia] B --> D[e parë] B --> E[e dytë] B --> F[e tretë] C --> G[femërore] C --> H[mashkullore] D --> I[numri] E --> I F --> I I --> J[njëjës] I --> K[shumës] </pre> </div> <p>*Mësuesi/ja shpërndan fisha, në të cilat janë shkruar fjali. Orientohen nxënësit/et të punojnë në dyshe për të dalluar përemrat pronorë, duke treguar edhe numrin, gjininë dhe vetën e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 3, synon që nxënësit/et të shkruajnë përemrat pronorë të përfutur, pasi u është ndryshuar gjinia, ose numri i tyre. Mësuesi/ja, i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Më pas ata/ato punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrin. Diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth ndryshimeve që pëson përemri pronor kur ndryshon gjininë dhe numrin, duke evidentuar për secilin rast, se si realizohet ky ndryshim.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <p><i>Shkrim i drejtuar:</i> Ushtrimi 4, synon që nxënësit/et të shkruajnë fjali, në të cilat të përdorin përemrat pronorë: <i>im, jonë, ime, e atyre, juaj, jonë, yt.</i> Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara. Me ndihmën e mësuesit/es korrigjohen gabimet drejtshkrimore. Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.</p>			

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: -përcaktimin e vetës, numrit dhe gjinisë së përemrit pronor; -shkrimin e përemrave pronorë të përfutur, duke ndryshuar gjininë, ose numrin e tyre, duke shpjeguar se si realizohet ky ndryshim; -krijimin e fjalive me përemrat pronorë; -demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve; -bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre. • Detyrë shtëpie Bëj një shkrim me temë “Dhoma ime”, me 7-8 fjali ku të përdorësh përemra pronorë. Trego vetën, numrin dhe gjininë e tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Një Vit i Ri madhështor		Situata e të nxënit Kalendari më i bukur i përgatitur për dhuratë, me rastin e festës së Vitit të Ri.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • ndan përvojat e tij/saj me të tjerët në lidhje me leximin; • shpreh ndjenjat dhe emocionet e tij/saj rreth pjesës që lexon; • tregon legjendën në mënyrë të përmbledhur; • përshkruan se si e feston Vitin e Ri; • flet rreth ndjesive që ka përjetuar gjatë kremtimit të festës së Vitit të Ri; • demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -legjendë kineze; -Viti i Ri; -kafshë; -ftesë.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -foto ku nxënësit/et kanë dalë duke festuar Vitin e Ri; -kalendarë; -informacione nga interneti për Vitin e Ri kinez; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkenca e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -bashkëjetesa paqësore; -identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -turi i galerisë; -veprimtari e dëgjimit dhe mendimit të drejtuar; -mendo-zbullo; -bisedë; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Turi i galerisë:</i> Mësuesja ka porositur nxënësit/et një javë më parë, të përgatisin në grupe kalendarë për t’ia dhuruar shokëve, ose të afërmeve të tyre me rastin e Vitit të Ri. Nxënësit/et i kanë sjellë ato në klasë dhe i vendosin në këndin e klasës. Përfaqësuesit e grupeve, prezantojnë kalendarët e përgatitur. Një juri e përbërë nga dy nxënës/e dhe mësuesi/ja, përzgjedhin kalendarët më të bukur. • Veprimtaria e dytë <i>Veprimtari e dëgjimit dhe mendimit të drejtuar:</i> Nxënësit/et njihen me titullin e pjesës “Një Vit i Ri madhështor“. Mësuesi/ja lexon pjesën me ndalesa. Orientohen nxënësit/et të dëgjojnë me vëmendje dhe t’u përgjigjen pyetjeve të bëra nga mësuesi/ja rreth pjesës që dëgjojnë. Ndalesa I Shumë kohë më parë... deri te... por edhe kafshët. Pyetje: -Në ç’ mënyrë e festoi Vitin e Ri mbreti kinez? -Cilët vendosi të ftonte ai në festë? 			

Ndalesa II Dërgoi lajmëtarë... deri te... donte e bardha zemër.

-Ç' detyrë u dha ai lajmëtarëve?

-Ç' përgatitje kishte bërë mbreti?

Ndalesa III Mbreti... deri te... mbërriti derri.

-Cilat kafshë mbërritën të parat?

-Po më pas, cilat kafshë erdhën?

Ndalesa IV Për të falënderuar... deri në fund.

-Çfarë vendosi të bëjë mbreti në shenjë falënderimi për të gjitha ato kafshë që pranuan ftesën?

-A ju pëlqeu pjesa?

-Si u ndjetë pasi dëgjuat këtë pjesë?

-Çfarë ju bëri më shumë përshtypje?

Mësuesi/ja shpjegon se kjo është një legjendë kineze, duke shpjeguar karakteristikat e saj.

*Udhëzohen nxënësit/et të hapin librat, të vëzhgojnë dhe komentojnë figurën.

*Organizohet lexim zinxhir nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e tretë**

Mendo-zbulo: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et në grupe gjejnë alternativat e sakta. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

*Nxënësit/et tregojnë përmbajtjen në mënyrë të përmbledhur.

- **Veprimtaria e katërt**

Bisedë: Rubrika “Reflektoj”. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të tregojnë se si e festojnë ata Vitin e Ri, duke iu përgjigjur edhe pyetjeve:

-Po ti çfarë bën për Vitin e Ri?

-Si përgatitesh për të festuar fundin e vitit?

-Me kë feston? Na trego!

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e rrjedhshëm dhe me intonaionin e duhur;

-ndarjen e përvojave të tij/saj me të tjerët në lidhje me leximin;

-shprehjen e ndjenjave dhe emocioneve të tij/saj, rreth pjesës që lexon;

-tregimin e legjendës në mënyrë të përmbledhur;

-përshkrimin se si e feston Vitin e Ri;

-diskutimin rreth ndjesive që ka përjetuar gjatë krenimit të festës së Vitit të Ri;

-demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Flasim Festa e Vitit të Ri		Situata e të nxënit Tregoni se si e festoni festën e ndërrimit të viteve.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • diskuton në grupe për temën e festimit të Vitit të Ri; • tregon për dhuratën që do të dëshironte të merrte këtë fundvit, duke argumentuar përzgjedhjen e tij/saj; • bën një prezantim të thjeshtë për të treguar një eksperiencë të vetën rreth kremtimeve të festës së ndërrimit të viteve, duke e shoqëruar prezantimin me foto; • demonstroi siguri kur flet në klasë; • shpreh opinionet, mendimet dhe ndjesitë e tij/saj, rreth festës së Vitit të Ri, me një gjuhë të saktë e të kuptueshme; • nxit të tjerët të bashkëbisedojnë për mënyrën se si e festojnë ata Vitin e Ri; • përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës; • respekton rregullat e të folurit gjatë komunikimit me të tjerët; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. 		Fjalët kyçe: -Viti i Ri; -festoj; -bredhi i Vitit të Ri; -elemente dekorative; -drita të ndezura; -dhurata.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -pamje nga qytetet e zbukuruara me rastin e Vitit të Ri; -foto që nxënësit/et kanë bërë në festën e Vitit të Ri; -informacione nga interneti për origjinën e festimeve të Vitit të Ri, përdorimit të pemës, dritave si simbole të kësaj feste; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës; -teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -brainstorming; -vëzhgo-diskuto; -lexo-diskuto; -bashkëbisedim; -diagrami i Venit; -punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Brainstorming:</i> Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët <i>Festa e Vitit të Ri</i>. Ftohen nxënësit/et të tregojnë se çfarë u vjen në mendje, kur lexojnë këto fjalë. Përgjigjet e nxënësve/eve mësuesi/ja i shkruan në tabelë.</p> <div style="text-align: center;"> <pre> graph TD A((Festa e Vitit të Ri)) --> B[festohet në 31 dhjetor] A --> C[është festë tradicionale që festohet në gjithë botën] A --> D[zbukurojmë bredhin ndezim dritat] A --> E[qyteti ndriçohet nga drita në qendër të qytetit vendoset pema e zbukuruar] A --> F[shkruajmë kartolina, mesazhe] A --> G[marrim dhurata] A --> H[pjekim gjelin e detit] A --> I[përgatiten ëmbëlsirat tradicionale] A --> J[njerëzit dalin në sheshe për të festuar] </pre> </div> <p>Mësuesi/ja prezanton temën e mësimimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Vëzhgo-diskuto:</i> Ushtrimin 1. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të vëzhgojnë fotot në libër dhe të diskutojnë në grupe rreth tyre, duke iu përgjigjur pyetjeve: -Si duken qytetet? Pse ka kaq shumë drita të ndezura? -Çfarë po festohet? Nga e kupton këtë? -Cilat janë elementet dekorative që mbizotërojnë? Cili prej tyre të pëlqen më shumë? Pse?</p>			

- **Veprimtaria e tretë**

Lexo-diskuto: Ushtrimi 2. Orientohen nxënësit/et të lexojnë tekstin dhe të tregojnë se si kujdeset Lura bashkë me vëllanë e saj, për zbulimin e bredhit të Vitit të Ri.

*Nxiten ata/ato të tregojnë për dëshirat që kanë për zbulimin e bredhit të Vitit të Ri.

- Veprimtaria e katërt

Punë në dyshe: Ushtrimi 3. Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë kalendarin e veprimeve që sjellin lumturi, për muajin dhjetor dhe të diskutojnë rreth tij.

Më pas edhe ata/ato në dyshe do të plotësojnë vendet bosh me veprime të tjera që sjellin lumturi.

Nxiten nxënësit/et t'i lexojnë ato para klasës, duke veçuar kalendarin më të kompletuar në dëshira dhe mirësi.

- **Veprimtaria e pestë**

Bashkëbisedim: Ushtrimi 4. Nxënësit/et shprehin dëshirat e tyre për dhuratat që do të dëshironin të merrnin këtë fundvit, duke argumentuar dhe përzgjedhjen e tyre.

Ushtrimi 5. Nxënësit/et ndajnë përvojat e tyre me shokët dhe shoqet, ku tregojnë për traditat që kanë në familjet e tyre për kremtimin e festës së ndërrimit të viteve, duke i shoqëruar përshkrimet me foto.

- **Veprimtaria e gjashtë**

Diagrami i Venit: Ushtrimi 6. Nxiten nxënësit/et të punojnë në grupe për të plotësuar diagramin e Venit, për të gjetur të përbashkëtat dhe ndryshimet në mënyrën se si festojnë ata dhe familjet e tyre.

*Nxënësit/et lexojnë informacione të nxjerra nga interneti për origjinën e festimeve të Vitit të Ri, përdorimit të pemës, dritave si simbole të kësaj feste.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-diskutimin në grupe për temën e festimit të Vitit të Ri;

-tregimin për dhuratën që do të dëshironte të merrte këtë fundvit, duke e argumentuar përzgjedhjen e tij/saj;

-prezantimin që bën për të treguar një eksperiencë të vetën rreth kremtimeve të festës së ndërrimit të viteve, duke e shoqëruar prezantimin me foto;

-demonstrimin e sigurisë kur flet në klasë;

-shprehjen e opinioneve, mendimeve dhe ndjesive të tij/saj rreth festës së Vitit të Ri me një gjuhë të saktë e të kuptueshme;

-nxitjen e të tjerëve të bashkëbisedojnë për mënyrën se si e festojnë ata/ato festën e Vitit të Ri;

-përdorimin e një fjalori të përshtatshëm rreth temës;

-respektimin e rregullave të folurit gjatë komunikimit me të tjerët;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Arusha e madhe		Situata e të nxënit Çfarë shihni në qiell në një natë të kthjellët vere?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalitë që i pëlqejnë; • tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin; • shpjegon fjalët e reja duke krijuar fjali me to; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit; • ndan përvojat e tij/saj me të tjerët në lidhje me leximin; • tregon se çfarë shpjegon ky mit, duke përzgjedhur alternativën e saktë; • demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup; • vlerëson punën e të tjerëve. 		Fjalë kyçe: -Arusha e Madhe; -pikas; -shquaj; -ethet e gjuetisë; -Ylli Polar.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -pamje nga gjithësia; -enciklopedi; -informacione nga interneti për yjet; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkenca e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim paraprak;
 - lexim, diskutim në dyshe;
 - marrëdhënie pyetje-përgjigje;
 - mendo-zbulo;
 - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim paraprak: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të diskutojnë rreth pyetjeve:

-A ju ka ndodhur të shihni në një natë të kthjellët qiellin?

-Çfarë keni parë?

Paraqiten me anë të videoprojektorit pamje të Arushës së Madhe dhe diskutohet rreth tyre.

- **Veprimtaria e dytë**

Lexim, diskutim në dyshe: Njihen nxënësit/et me titullin e tekstit “Arusha e Madhe”.

*Orientohen nxënësit/et të vështronjë figurën dhe të diskutojnë rreth saj. Nxënësit/et diskutojnë në fillim në dyshe, më pas me gjithë klasën.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në heshtje. Nënvizojnë fjalët që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që u duken interesante. Pyesin njëri-tjetrin dhe mësuesin/en. Diskutojnë rreth tekstit.

*Nxiten nxënësit/et të lexojnë shënimin në libër për Arushën e Madhe dhe të dallojnë në figurë Arushën e Madhe, Arushën e Vogël dhe Yllin Polar.

*Mësuesi/ja shpjegon se ky tekst është një mit indian.

*Organizohet lexim zinxhir nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e tretë**

**Marrëdhënie pyetje-përgjigje:* Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et bashkëbisedojnë në dyshe dhe më pas diskutojnë me gjithë klasën për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.

-Sa burra dolën për të gjuajtur ariun e zi?

-Arritën ta pikasin ata ariun?

-Pas sa kohësh i dalluan gjuetarët gjurmët e ariut?

-Ku ndodheshin burrat kur e arritën ariun?

-Çfarë ndodhi me ta?

*Nxënësit/et tregojnë përmbajtjen në mënyrë të përmbledhur.

- **Veprimtaria e katërt**

Mendo-zbulo: Rubrika “Reflektoj”. Nxënësit/et diskutojnë në grupe, të zbulojnë se çfarë shpjegon ky mit, duke përzgjedhur alternativën e saktë.

*Nxënësit/et lexojnë informacione nga interneti për yjet.

*Nxiten nxënësit/et të vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalitë që i pëlqejnë;

-shpjegimin e fjalëve të reja duke krijuar fjali me to;

-përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;

-ndarjen e përvojave të tij/saj me të tjerët në lidhje me leximin;

-tregimin se çfarë shpjegon ky mit, duke përzgjedhur alternativën e saktë;

-demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie** Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Përemrat: ushtrime përmbledhëse (ora I)		Situata e të nxënit Ç'dimë për përemrat?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përcakton llojin, vetën, numrin e përemrave; • bën dallimin ndërmjet përemrit vetor dhe përemrit pronor; • përshtat përemrin pronor me emrin në fjali; • krijon fjali me përemrat vetorë dhe përemrat pronorë; • paraqet dhe komunikon lirshëm e saktë mendimet e tij/saj; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalët kyçe: -përemri vetor; -përemri pronor; -gjinia; -numri; -veta.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e përemrave vetorë dhe e përemrave pronorë; -fisha me fjalë e fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A ₄ .		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -përvijim i të menduarit; -mendo, puno në dyshe, shkëmbe; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Përvijim i të menduarit:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të punojnë në grupe dhe të tregojnë se çfarë dinë për përemrin.</p> <p>Tregon se kujt i përket ajo për të cilën flasim.</p> <pre> graph TD P([Përemri]) --> P[pronor] P --> V[vetor] P --> Z[Zëvendësojnë emrat e njerëzve kafshëve, sendeve.] P --> N[numri] P --> Veta[veta] P --> G[gjinia] P --> N1[numri] P --> N2[numri] P --> N3[numri] P --> Veta1[veta] P --> Veta2[veta] P --> Veta3[veta] P --> G1[gjinia] P --> G2[gjinia] N1 --> N1_1[njëjës] N1 --> N1_2[shumës] N2 --> N2_1[e parë] N2 --> N2_2[e dytë] N2 --> N2_3[e tretë] N3 --> N3_1[femërore] N3 --> N3_2[mashkullore] Veta1 --> Veta1_1[njëjës] Veta1 --> Veta1_2[shumës] Veta2 --> Veta2_1[e parë] Veta2 --> Veta2_2[e dytë] Veta2 --> Veta2_3[e tretë] Veta3 --> Veta3_1[femërore] Veta3 --> Veta3_2[mashkullore] G1 --> G1_1[femërore] G1 --> G1_2[mashkullore] G2 --> G2_1[femërore] G2 --> G2_2[mashkullore] G1_1 --> G1_1_1[III] G1_1 --> G1_1_2[III] G2_1 --> G2_1_1[III] G2_1 --> G2_1_2[III] G1_2 --> G1_2_1[III] G1_2 --> G1_2_2[III] G2_2 --> G2_2_1[III] G2_2 --> G2_2_2[III] style G1_1_1 fill:none,stroke:none style G1_1_2 fill:none,stroke:none style G1_2_1 fill:none,stroke:none style G1_2_2 fill:none,stroke:none style G2_1_1 fill:none,stroke:none style G2_1_2 fill:none,stroke:none style G2_2_1 fill:none,stroke:none style G2_2_2 fill:none,stroke:none </pre> <p>(për përemrin vetor në vetën III)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Mendo, puno në dyshe, shkëmbe:</i> Ushtrimi 1. Njihen nxënësit/et me kërkesën e ushtrimit. Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Pastaj, mendimet e tyre i shkëmbejnë me shokun/shoqen e bankës dhe në fund me gjithë klasën.</p> <p>Pasi binden për përgjigjen e saktë, lidhin me shigjetë përemrin vetor me foljen e duhur dhe emrin me përemrin e duhur pronor.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <p><i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 2, 3, synon që nxënësit/et të plotësojnë fjalitë e dhëna me përemrat vetorë apo përemrat pronorë të përshtatshëm.</p> <p>Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Më pas ata/ato punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrin.</p> <p>Diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <p><i>Shkrim i drejtuar:</i> Ushtrimi 4, synon që nxënësit/et të përzgjedhin përemrin e përshtatshëm dhe të shkruajnë tekstin në fletore.</p> <p>Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.</p> <p>Në përfundim lexojnë tekstin e plotë duke argumentuar përzgjedhjen e tyre.</p> <p>Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.</p>			

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -përcaktimin e llojit, vetës, numrit të përemrave; -dallimin ndërmjet përemrit vetor dhe përemrit pronor; -përshtatjen e përemrit pronor me emrin në fjali; -paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm e të saktë të mendimeve të tij/saj; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve. • Detyrë shtëpie Ushtrimi 5 			
Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Përemrat: ushtrime përmbledhëse (ora II)		Situata e të nxënit Manipulime me përemrat për të dalluar llojin, vetën, numrin e tyre.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon llojin, vetën, numrin e përemrave; • përshtat përemrin pronor me emrin në fjali; • shndërron grupet emër+përemër pronor, nga njëjësi në shumës, ose anasjelltas, duke shpjeguar ndryshimet që pëson përemri pronor; • krijon fjali me përemrat vetorë dhe përemrat pronorë; • paraqet dhe komunikon lirshëm e saktë mendimet e tij/saj; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -përemri vetor; -përemri pronor; -gjinia; -numri; -veta. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e përemrave vetorë dhe e përemrave pronorë; -fisha me fjalë e fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. 	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit/et dallojnë përemrat vetorë e pronorë në fjalitë e dhëna dhe diskutojnë rreth tyre. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 6, 7, synon që nxënësit/et të shkruajnë grupet emër + përemër pronor, duke i shndërruar ato, nga numri njëjës në numrin shumës, ose anasjelltas. Mësuesi/ja, i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Më pas ata/ato punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrin. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es, për të shpjeguar ndryshimet që pëson përemri pronor gjatë kalimit nga numri njëjës në shumës, ose anasjelltas. • Veprimtaria e tretë <i>Shkrim i drejtuar:</i> Ushtrimi 8 synon që nxënësit/et të shkruajnë fjali ku të përdorin përemrat e dhënë. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Nxiten të lexojnë fjalitë e krijuara. Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve të thjeshta drejtshkrimore. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -dallimin e llojit, vetës, numrit të përemrave; -përshtatjen e përemrit pronor me emrin në fjali; -shndërrimin e grupeve emër+përemër pronor, nga njëjësi në shumës, nga gjinia mashkullore në femërore, duke shpjeguar ndryshimet që pëson përemri pronor; -krijimin e fjalive me përemrat vetorë dhe përemrat pronorë; -paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm e të saktë të mendimeve të tij/saj; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve. • Detyrë shtëpie Shkruaj një tekst të shkurtër me temë “Biblioteka ime”, ku të përdorësh përemra vetorë dhe pronorë. 			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Historia e zebrës (ora I)		Situata e të nxënit Plotësim i një harte semantike për legjendën dhe për zebrat.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan pamjen karakteristike të zebrës dhe kushtet e mjedisit ku jeton; • shkruan historinë e zebrës sipas strukturës hyrja- zhvillimi- mbyllja, duke u mbështetur në figurat, pyetjet, fjalët ndihmëse; • tregon se ç’lloj teksti është historia që shkruan, duke përzgjedhur njërin nga alternativat e dhëna; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalët kyçe: -zebër; -savana; -vija bardhezi; -personazh fantastik; -zebra piktores; -hyrja-zhvillimi-mbyllja.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -foto të zebrave; -informacione nga interneti për zebrat dhe savanat; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkenca e natyrës.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -harta semantike; -diskutim; -shkrim i lirë; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve • Veprimtaria e parë <p><i>Punë në grupe, Harta semantike:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të kujtojnë se çfarë dinë për legjendat, duke treguar edhe tituj legjendash që ata/ato dinë.</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="text-align: center;"> <p>Është një lloj tregimi fantastik, që ka si pikënisje një fakt të vërtetë.</p> </div> <div style="text-align: center;"> </div> <div style="text-align: center;"> <p>Protagonist i saj, mund të jetë: një vend, bimë, lule, ose kafshë.</p> </div> </div> <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center; margin-top: 10px;"> <div style="text-align: center;"> <p>Zakonisht përfundon me shprehjet: <i>Ja përse... Që atëherë... etj...</i></p> </div> <div style="text-align: center;"> </div> <div style="text-align: center;"> <p>Në një legjendë, dallojmë: hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen.</p> </div> </div> <p>*Nxiten nxënësit/et të plotësojnë në grupe hartën semantike për zebrat, duke u mbështetur në njohuritë që kanë për to.</p> <div style="display: flex; justify-content: center; align-items: center; margin: 10px 0;"> <div style="text-align: center;"> <p>ushqimi</p> </div> <div style="text-align: center;"> </div> <div style="text-align: center;"> <p>jetesa</p> </div> </div> <p>Diskutimi ilustron me foto dhe informacione për zebrat.</p> <p>Zebra është një kafshë e egër barngrënëse, e cila jeton në savanë (Savanat shtrihen në Afrikë, në Amerikën Jugore, në Azi dhe në Australi).</p> <p><i>Zebra i ngjan kalit, vetëm se është më e vogël dhe në trup ka vija të zeza. Është kafshë njëthundrake. Ato lëvizin gjithmonë në tufë për të mbrojtur shoqet. Ajo është një pre e luanit, tigrin dhe hienës.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p>Mësuesi/ja njeh nxënësit/et me temën e mësimin.</p> <p>Orientohen nxënësit/et që të vërejnë fotot në libër dhe të lexojnë monologun e zebrave.</p> <p><i>Diskutim. Punë në dyshe.</i> Ushtrimi 1, synon që nxënësit/et të shkruajnë historinë e zebrës, nisur nga fakti i vërtetë, që trupi i saj është me vija bardhe e zi. Mësuesi/ja, u kujton nxënësve/eve, që historia të ketë hyrje, zhvillim dhe mbyllje.</p> <p>Nxënësit/et, e tregojnë hap pas hapi historinë e zebrës, duke u bazuar në skemën e dhënë në libër, përfshirë edhe shtimin e një personazhi fantastik që do t'i ndihmojë zebrat në qëllimin e tyre, në dizenjimin e ngjyrave të reja.</p> <p>Ushtrimi 2. Nxiten nxënësit/et të tregojnë se ç’lloj teksti është historia që shkruan, duke përzgjedhur njërin nga alternativat e dhëna.</p>			

• **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i lirë: Ushtrimi 3. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shkruajnë të plotë historinë e zebrës, në fletore. Nxënësit/et lexojnë shkrimin me zë para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es, korrigjohen gabimet drejtshkrimore. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. (Nëse nuk u del koha, nxënësit/et e përfundojnë detyrën në shtëpi).

Historia e zebrës

Një herë e një kohë, kur çdo gjë ishte e gjelbër, edhe zebrat ishin të gjelbra. Herë-herë, ato e pëlqenin veten siç ishin dhe herë-herë, mërzitëshin.

Duke u bërë njësh me çdo gjë që i rrethonte, ato ngatërroheshin me njëra-tjetrën dhe humbisnin. Madje as “Syllambyllazi” nuk luanin dot. Një ditë, u mbledhën dhe diskutuan për ta zgjidhur këtë problem.

Zebrat vendosën që të pikturonin trupin e tyre.

Këtë detyrë ia caktuan zebrës piktores.

Ajo me shumë dëshirë dhe përkushtim, i pikturoi me dy ngjyrat e saj të preferuara: bardhë e zi.

I bëri me vija. Ato u dukën shumë të bukura.

Që atëherë, nuk i ndërruan më ngjyrat e tyre. Ato vrapojnë krenare nëpër savanë, për ngjyrat e tyre bardhë e zi.

• **Vlerësimi bëhet për:**

- përshkrimin e pamjes karakteristike të zebrës dhe kushtet e mjedisit ku jeton;
- shkrimin e historisë së zebrës sipas strukturës hyrja- zhvillimi-mbyllja, duke u mbështetur në figurat, pyetjet, fjalët ndihmëse;
- tregimin se ç’lloj teksti është historia që shkruan, duke përzgjedhur njërin nga alternativat e dhëna;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Historia e zebrës (ora II)		Situata e të nxënit Shkruajmë një histori të ngjashme me atë të zebrës, në qendër të së cilës, të jetë një bimë, një lule, ose një kafshë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen, si dhe elementin real dhe atë të trilluar në historinë e zebrës; • përdor një element real nga bota e bimëve luleve apo kafshëve, për të ndërtuar një ngjarje fantastike, duke respektuar strukturën hyrje-zhvillim-mbyllje; • shkruan një histori të ngjashme me atë të zebrës, në qendër të së cilës mund të jetë një bimë, një lule, ose një kafshë; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -përrallë; -fakt i vërtetë; -ja përse... -që atëherë... -struktura hyrja-zhvillimi-mbyllja. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -kuriozitetet nga bota e bimëve dhe e kafshëve; -libër me përralla; -foto të bimëve, luleve, kafshëve; -videoprojektor; -mjete shkrimi, fletore, lapustilë, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -teknologjia dhe TIK-u. 	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - lexo-diskuto;
 - shkrim i lirë;
 - konkurs;
 - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve**
- **Veprimtaria e parë**

Lexo-diskuto: Lexim i historisë së plotë të zebrës, i shkruar në fletore nga nxënësit/et, duke evidentuar hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e përrallës, elementin real dhe atë të trilluar në këtë histori.

- **Veprimtaria e dytë**

Shkrim i lirë: Punohet ushtrimi 4. Ndahen nxënësit/et në tre grupe. Nxiten nxënësit/et të shkruajnë një histori të ngjashme me atë të zebrës, në qendër të së cilës të jetë:

Grupi 1 → një bimë

Grupi 2 → një lule

Grupi 3 → një kafshë

Tërhiqet vëmendja, se për të shkruar një histori të ngjashme me atë të zebrës, nxënësit/et duhet të:

- a) nisen nga një fakt i vërtetë për të përfunduar një ngjarje fantastike;
- b) të respektojnë strukturën hyrje-zhvillim-mbyllje;
- c) të përdoren në mbyllje shprehjet: *Ja përse... Që atëherë... etj...*

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.

Në përfundim të punës shkëmbejnë fletoret ndërmjet tyre, kontrollojnë njëri-tjetrin.

- **Veprimtaria e tretë**

Konkurs: Nxënësit/et lexojnë me zë shkrimet e tyre.

Me ndihmën e mësuesit/es korrigjohen gabimet drejtshkrimore.

Një juri e përbërë nga mësuesi/ja dhe dy nxënës/e shpall tre çmimet e para për shkrimet më të realizuara nga pikëpamja e rrëfimit, respektimit të strukturës, gërshetimit të elementeve realë me ato fantastikë, fjalorit të përdorur, ndërtimit të fjalive, respektimin e rregullave drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-dallimin e hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes, si dhe elementin real dhe atë të trilluar në historinë e zebrës;

-përdorimin e një elementi real nga bota e bimëve, luleve apo kafshëve, për të ndërtuar një ngjarje fantastike, duke respektuar strukturën hyrje-zhvillim-mbyllje;

-shkrimin e një historie të ngjashme me atë të zebrës, në qendër të së cilës, mund të jetë një bimë, një lule, ose një kafshë;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;

-shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Maçoku dhe miu (ora I)		Situata e të nxënit Ndërtimi i një historie duke u mbështetur në terma paraprake.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • parashikon rreth përmbajtjes së pjesës; • lexon pjesën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante; • shpjegon fjalë të reja, duke ndërtuar fjali me to; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së pjesës; • shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit; • shpreh ndjenjat dhe emocionet e tij/saj, në lidhje me legjendën; • gjykon rreth sjelljes së personazheve; • vlerëson hilen dhe grykësinë si shkaktare të shkatërrimit të miqësisë dhe besueshmërisë; • demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup; • vlerëson punën e të tjerëve. 		Fjalë kyçe: -maçoku; -miu; -mel; -i vyer; -vëre vath në vesh; -grykësi; -mani.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -ilustrime të macës, miut; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4		Lidhja me fushat e tjera -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: - parashikim me terma paraprakë; - lexim dhe mendim i drejtuar; - hulumtim; - ruaje fjalën e fundit për mua; - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Parashikim me terma paraprakë:</i> Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyçe: <i>maçoku, miu, hëngri, grykësi</i>. Ftohen nxënësit/et të bëjnë parashikimin për përmbajtjen e pjesës, duke punuar në dyshe. Ata/ato i shkruajnë parashikimet e tyre në fletë (me katër fjali ku t'i përdorin këto fjalë). Nxiten nxënësit/et të lexojnë parashikimet e tyre. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Lexim dhe mendim i drejtuar:</i> Nxënësit/et njihen me titullin e pjesës "Maçoku dhe miu". Udhëzohen nxënësit/et për leximin me ndalesa. Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më interesante e më të rëndësishme. Më pas, nxënësit/et iu përgjigjen pyetjeve të bëra nga mësuesi/ja. Ndalesa I Shumë kohë më parë... deri te... në mënyrë të barabartë. Pyetje: -Ku jetonin Maçoku dhe Miu shumë kohë më parë? -Si silleshin ata me njëri-tjetrin? Ndalesa II Kur erdhi koha e të korrave... deri te... u nis për udhë. -Ç' bëri i zoti i shtëpisë para se të nisej për udhëtim? -Si ia ndau ai ushqimin Maçokut dhe Miut? -Si mendoni, a do ta preknin të dy miqtë ushqimin e njëri-tjetrit? Ndalesa III Maçoku... deri te... një rast më të mirë. -Pse u habit Maçoku kur pa pjatën e tij? -Ç' kishte bërë Miu? -Si mendoni se do të vazhdojë ngjarja? 			

Ndalea IV Maçoku u nxeh keq... deri te... deri atë ditë.

-Pse u nxeh keq Maçoku?

-Si mendoni se do të jetë reagimi i Maçokut ndaj Miut?

Ndalea V Ti o Mi... deri te... vëre vath në vesh.

-Ku e takoi Maçoku Miun?

-Çfarë i tha ai mikut të tij?

-Si mendoni, a do të vazhdojë më miqësia e tyre?

Ndalea VI Kështu ndodhi... deri në fund.

-A mund ta kishte më Miu besimin e mikut të tij dhe të të tjerëve?

-Për ç'shkak e humbi ai besimin e mikut të tij?

-A ju pëlqeu pjesa?

-Si u ndjetë pas leximit të kësaj pjese?

-Çfarë ju bëri më shumë përshtypje te kjo pjesë?

*Nxënësit/et punojnë në dyshe, fjalorin me fjalët dhe shprehjet e reja (*mel, i vyer, vëre vath në vesh, grykësi, mani*) dhe ndërtojnë fjali me to.

U lihet kohë nxënësve/eve për ta rilexuar.

Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të krahasojnë parashikimet e tyre me pjesën.

*Lexim zinxhir nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e tretë**

Hulumtim: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj” nxënësit/et punojnë individualisht për të gjetur alternativat e sakta në fjalitë përmbledhëse rreth tekstit dhe për çdo fjali të gabuar, të ndërtojnë fjalinë e saktë. Shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

*Nxënësit/et tregojnë përmbajtjen e pjesës mbi bazën e pyetjeve.

- **Veprimtaria e katërt**

Ruaje fjalën e fundit për mua: Në këtë veprimtari nxënësit/et punojnë me grupe. Mësuesi/ja udhëzon:

-Zgjidhni në tekst 5 fjali që ju bëjnë për të qeshur, ose ju tërheqin më shumë. Shkruajini në fleta. Në anën e prapme të fletës shkruani komentin tuaj. Fletën kalojeni te shokët pranë, për të shkruar edhe ata komentet e tyre.

Nxënësi/ja lexon njërin nga fjalitë:

P.sh. “Ti, o Mi, vërtet je i vogël, por je ligësia vetë! Si arrite të ma vjedhësh ushqimin duke më lënë të vuaj urie?”

Komentet e shokëve/shoqeve.

Nxënësi/ja 1: Kjo fjali më bën për të qeshur, sepse maçoku i thotë miut se është edhe i vogël, por edhe i lig.

Nxënësi/ja 2: Më trishton fakti se asgjë nuk mund ta kompensojë humbjen e besimit të mikut të ngushtë.

Nxënësi/ja 3: Kjo fjali më bën të mendoj se sa e dhimbshme është të shpërdorohet besimi i mikut.

Komenti i nxënësit/es që përzgjedhi dhe lexoi fjalinë:

Miqësia e vërtetë bazohet te ndershmëria dhe sinqeriteti.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-parashikimin rreth përmbajtjes së pjesës;

-leximin e pjesës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante;

-shpjegimin e fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to;

-përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së pjesës;

-shfaqjen e besimit dhe vullnetit në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit;

-shprehjen e ndjenjave dhe emocioneve të tij/saj, në lidhje me legjendën;

-grykimin rreth sjelljes së personazheve;

-demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj fjalë të urta për miqësinë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Maçoku dhe miu (ora II)		Situata e të nxënës Nxënësit/et lexojnë fjalë të urta për miqësinë.	
Rezultatet e të nxënës Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit; • dallon cilësitë e personazheve mbi bazën e veprimeve të tyre; • tregon përmbajtjen e pjesës në mënyrë të përmbledhur; • shpjegon me fjalët e tij/saj domethënien e legjendës; • nxjerr mesazhin që përcjell legjenda; • pranon dhe tregon respekt ndaj ideve dhe mendimeve të të tjerëve; • shfaq aftësi të bashkëpunimit në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -legendë; -maçoku; -miu; -mesazh.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; -teksti shkollor; -fjalë të urta për miqësinë; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës; Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -dora e pyetjeve; -shkrim argumentues; -bashkëbisedim; -harta e personazheve; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë Mësimi fillon me detyrat e shtëpisë, ku nxënësit/et lexojnë fjalë të urta për miqësinë. • Veprimtaria e dytë Lexim nga nxënësit/et zinxhir. Nxënësit/et tregojnë legjendën me anë të organizuesit grafik “Dora e pyetjeve”. • Veprimtaria e tretë <i>Shkrim argumentues:</i> Rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore për të argumentuar sipas mendimit të tyre, domethënien e kësaj legjende. Nxiten nxënësit/et të lexojnë shpjegimet e bëra sipas mendimit të tyre. <i>*Nxirret mesazhi i legjendës nga nxënësit/et: <u>Grykësia dhe ligësia dëmtojnë çdo miqësi. Miqësia ruhet me përpjekje të dyanshme, bazuar te ndershmëria dhe sinqeriteti.</u></i> • Veprimtaria e katërt <i>Bashkëbisedim:</i> Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxënësit/et nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve, japin opinionet e tyre rreth personazheve të legjendës dhe veprimeve të tyre. Nxiten ata/ato të mendojnë dhe të tregojnë se si mund të kishte vepruar ndryshe maçoku. • Veprimtaria e pestë <i>Harta e personazheve:</i> Punohet rubrika “Shkruaj”. Nxiten nxënësit/et, që në grupe, të shkruajnë dy cilësi për secilin prej personazheve të legjendës. Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e bërë. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. • Vlerësimi bëhet për: -leximin e pjesës në mënyrë të rrjedhshme dhe duke respektuar shenjat e pikësimit; -dallimin e cilësive të personazheve mbi bazën e veprimeve të tyre; -tregimin e përmbajtjen së pjesës në mënyrë të përmbledhur; -shpjegimin me fjalët e tij/saj për domethënien e legjendës; -formulimin e mesazhit që përcjell legjenda; -shfaqjen e aftësive të bashkëpunimit në grup; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve. • Detyrë shtëpie Shkruaj legjendën në mënyrë të përmbledhur. 			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Diktim		Fjalë kyçe -drejtshkrim; -diktim; -shkronjë e madhe; -shenjë pikësimi; -thonjëza.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: -shkruan një tekst me të diktuar; -përdor shenjat e pikësimit (pikë, pikëpyetje dhe pikëçuditëse në fund të fjalisë); -përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë, si dhe për emrat e përveçëm; -shkruan saktë emrat e përgjithshëm dhe ato të përveçëm, emrat e numrit njëjës dhe ato të numrit shumës; -shkruan saktë mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm; -shkruan saktë përemrat vetorë dhe pronorë; -bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es.		Situata e të nxënit Shkrimi i një pjese me të diktuar	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -fletore, mjete shkrimi.		Lidhja me fushat e tjera	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -stuhi mendimesh; -diskutim; -punë individuale. • Veprimtaritë e nxënësve/eve <ul style="list-style-type: none"> *<i>Stuhi mendimesh</i>: Mësuesi/ja fton nxënësit/et për të treguar rregullat drejtshkrimore që dinë. (fillimi i fjalisë me shkronjë të madhe, shenjat e pikësimit në fund të fjalive, shkronja e madhe për emrat e përveçëm, etj...). *Mësuesi/ja dikton pjesën. *Bëhet korrigjimi i diktimit me ndihmën e mësuesit/es. *Qortohen gabimet e bëra duke i shkruar përsëri saktë. • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -shkrimin e një teksti me të diktuar; -përdorimin e shenjave të pikësimit (pikë, pikëpyetje dhe pikëçuditëse në fund të fjalisë); -përdorimin e shkronjës së madhe në fillim të fjalisë si dhe për emrat e përveçëm; -shkrimin e saktë të emrave të përgjithshëm dhe ato të përveçëm, emrave të numrit njëjës dhe ato të numrit shumës; -shkrimin e saktë të mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm; -shkrimin e saktë të përemrave vetorë dhe pronorë; -qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es. • Detyrë shtëpie Mësoni 5 fjali përmendësh nga pjesa “Maçoku dhe miu” dhe bëjeni vetë diktim. 			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Era dhe flamuri		Situata e të nxënit Shikim i disa sekuencave të filmit: “Nëntori i dytë”.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan flamurin tonë kombëtar; • dallon strofat, vargjet në poezi; • lexon poezinë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • tregon për flamurin si simbol të kombit tonë; • shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth poezisë; • nxjerr mesazhin që përcjell poezia; • shpjegon me fjalë të thjeshta, domethënien poetike të vargjeve të poezisë; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • vlerëson interpretimin e shokut/shoqes për poezinë; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • demonstroi besim në forcat e veta, respekt dhe tolerancë brenda grupit. 		Fjalë kyçe: -poezi; -strofa; -varg; -flamuri; -era; -të ndrit nuri; -palat rreh; -skaj.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -flamuri ynë kombëtar; -magnetofon, CD; -videoprojektor; -materiali filmik; -fisha me vargjet e poezisë; -vjersha për flamurin; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -shikim i organizuar; -dora e fshehtë; -lexim dhe diskutim; -lexo-përmbledh në dyshe; -trego-komento; -pesëvargësh; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Shikim i organizuar:</i> Nxënësit/et shikojnë me anë të videoprojektorit disa sekuenca nga filmi “Nëntori i dytë”. Më pas diskutojnë rreth tij.</p> <p>Në mungesë të videoprojektorit, paraqiten foto të Ismail Qemalit dhe atdhetarëve të tjerë duke ngritur flamurin në Vlorë si dhe foto të Monumentit të Shpalljes së Pavarësisë në Vlorë.</p> <p>Diskutohet me nxënësit/et rreth Ditës së Flamurit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Dora e fshehtë:</i> Nxënësit/et njihen me titullin e poezisë “Era dhe flamuri” dhe autorin e saj Betim Muço. Udhëzohen nxënësit/et në secilin grup të tërheqin nga dora e fshehtë, nga një fishë, në të cilat janë shkruar vargjet e poezisë. Secili nga grupet ka për detyrë të renditë vargjet e poezisë, siç duhet. Çdo grup paraqet para klasës në fletë formati renditjen e poezisë.</p> <p>Mësuesi/ja lexon poezinë dhe del se cili nga grupet i ka renditur saktë vargjet.</p>			

- **Veprimtaria e tretë**

Lexim dhe diskutim: Nxënësit/et vërejnë dhe komentojnë ilustrimet në libër.

Mësuesi/ja u tregon nxënësve se flamuri kombëtar shqiptar ka një fushë të kuqe dhe shqiponjën dykrenare të zezë në mes.

Flamuri shqiptar e ka prejardhjen nga simboli i heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastriot, Skënderbeu, i cili i udhëhoqi shqiptarët në një kryengritje të përbashkët në shekullin XV kundër Perandorisë Osmane, duke i sjellë trojeve shqiptare pavarësinë për një kohë të shkurtër. Shqiponja ishte pjesë e emblemës së familjes Kastrioti.

Festa e Flamurit është festa më e madhe e kombit shqiptar dhe kremtohet më datën 28 Nëntor të çdo viti, ditën kur Ismail Qemali dhe patriotët e tjerë shqiptarë shpallën Pavarësinë e Shqipërisë nga Perandoria Osmane (28 Nëntor 1912).

*Lexim i poezisë nga nxënësit/et në strofa.

Për çdo strofë u drejtohen nxënësve pyetje që nxisin diskutimin, duke u kujdesur që të punohen edhe pyetjet e rubrikës “Lexoj dhe kuptoj”:

-Çfarë vuri re era te flamuri?

-Cila ishte arsyeja që flamuri shkëlqente nga bukuria?

-Çfarë i kërkoi flamuri erës? Pse?

*Diskutohet në klasë për karakteristikat e poezisë (është e shkruar në vargje, përbëhet nga strofa dyshe me rimë).

*Punohet rubrika “Fjalë të reja”. Nxiten nxënësit/et të lexojnë dhe të diskutojnë rreth kuptimit të fjalëve:

të ndrit nuri, palat rreh, skaj.

*Nxënësit/et krijojnë fjali me to.

*Lexim i poezisë me intonacion nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e katërt**

Lexo-përmbledh në dyshe: Duke punuar në dyshe, nxënësit/et lexojnë dhe përmbledhin çdo strofë me 1-2 fjali. Në strofën pasardhëse, nxënësit/et ndërrojnë rolet.

*Në grupe nxënësit/et nxjerrin mesazhin që përcjell kjo poezi: Ne duhet të ndihemi krenarë për flamurin kuq e zi si, simbol i kombit shqiptar dhe të kontribuojmë, që ta mbajmë atë gjithmonë lart, të lirë dhe të pavarur.

*Nxënësit/et në grupe interpretojnë në role poezinë. Dallohet grupi që interpretoi më bukur poezinë.

- **Veprimtaria e pestë**

Trego-komente: Punohet rubrika “Reflektoj”, nxiten nxënësit/et të japin mendimet e tyre rreth poezisë duke iu përgjigjur pyetjeve:

-A të pëlqen kjo poezi? Pse?

-Çfarë di për Ditën e Flamurit?

-Si e festove Ditën e Flamurit? Veço veprimtarinë që të bëri më shumë përshtypje.

Nxënësit/et tregojnë për Ditën e Flamurit, duke u mbështetur në filmat që kanë parë, librat që kanë lexuar, historitë që kanë dëgjuar. Ata/ato ndajnë me të tjerët përvojat e tyre rreth festimeve të Ditës së Flamurit më 28 Nëntor të çdo viti, duke veçuar veprimtarinë që u ka bërë më shumë përshtypje.

- **Veprimtaria e gjashtë**

Pesëvargësh: Nxënësit/et në grupe krijojnë pesëvargësja për fjalën dhe i lexojnë ato.

Flamuri

i shtrenjtë kuq e zi,

valëvitet, ngrihet, nderohet.

Ne krenohemi me flamurin tonë kombëtar.

Simbol i kombit tonë.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e poezisë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;

-shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth poezisë;

-formulimin e mesazhit që përcjell poezia;

-shpjegimin me fjalë të thjeshta, të domethënies poetike të vargjeve të poezisë;

-paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;

-vlerësimin e interpretimit të shokut/shoqes për poezinë;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-demonstrimin e besimit në forcat e veta, respektit dhe tolerancës brenda grupit.

- **Detjere shtëpie**

Mësoni përmendësh poezinë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Dita e flamurit (ora I)		Situata e të nxënit Shkrimi i një ftese me rastin e një veprimtarie në klasë, shoqëruar me program.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan festën që ka organizuar klasa me rastin e Ditës së Flamurit; • dallon elementet e një ftese që dërgohet me rastin e një feste (Festës së Flamurit) dhe strukturën e programit që do të ndiqet në këtë ditë; • shkruan një ftesë sipas modelit të dhënë me program për shfaqjen që organizohet me rastin e Ditës së Flamurit; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalët kyçe: -Dita e Flamurit; -ftesë; -program; -skenar; -tematika e festës; -fjala përshëndetëse; -shfaqje; -bisedë; -interpretime;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor, -foto të nxënësve ku kanë dalë në Festën e Flamurit; -modele ftesash të përgatitura me rastin e Ditës së Flamurit, apo festave të tjera; -teksti i programit të veprimtarive me rastin e Ditës së Flamurit; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -bisedë; -lexo-komento; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve • Veprimtaria e parë Bisedë: -Çfarë aktivitete organizohen me rastin e Ditës së Flamurit në klasën tuaj? Nxiten nxënësit/et të japin mendimet e tyre. Përgjigjet e tyre mësuesi/ja i paraqet në tabelë <div style="text-align: center;"> <pre> graph TD A([Dita e Flamurit]) --> B[fjala përshëndetëse e drejtorit, e mësuesit] A --> C[koncert festiv] A --> D[ktivitete sportive] A --> E[interpretim i pjesëve teatrale] A --> F[shfaqja e dokumentarëve] A --> G[bisedë me historianë] </pre> </div> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë Lexo-komento: Mësuesi/ja njih nxënësit/et me temën e mësimit. Komentohet fotoja në libër. Nxënësit/et njihen me përmbajtjen e tekstit që bën fjalë për organizimin e një shfaqje festive të nxënësve të klasës IV^B, me rastin e Ditës së Flamurit. *Orientohen nxënësit/et të lexojnë ftesën e përgatitur me rastin e Ditës së Flamurit. Ata/ato diskutojnë fillimisht në grupe rreth saj më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es, duke u ndalur te elementet e konceptimit të tekstit të ftesës, të dizenjës, përzgjedhjes së llojit të shkronjave, etj. Më pas njihen nxënësit/et me programin e veprimtarive që do të ndiqen me rastin e Ditës së Flamurit. • Veprimtaria e tretë Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 2. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shkruajnë një ftesë për një shfaqje të ngjashme, sipas skemës së dhënë dhe programin e veprimtarive për këtë festë. Nxënësit/et prezantojnë punën e bërë para klasës. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es. Me ndihmën e mësuesit/es korrigjohen gabimet drejtshkrimore. Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve. 			

- **Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e elementeve të një ftese që dërgohet me rastin e një feste (Festës së Flamurit) dhe strukturën e programit që do të ndiqet në këtë ditë;
- shkrimin e një ftese sipas modelit të dhënë me program, për shfaqjen që organizohet me rastin e Ditës së Flamurit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Dita e flamurit (ora II)		Situata e të nxënit Shkruajmë një ftesë me program për një festë, shfaqje, apo eveniment.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • vë në dukje rëndësinë që ka çdo element i ftesës me program; • shkruan një ftesë sipas modelit të dhënë me program për një festë, shfaqje apo eveniment që mund të ketë së afërmi; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -festë; -shfaqje; -eveniment; -ftesë; -program; -skenar. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor, -foto të nxënësve ku kanë dalë në shfaqje, festa, apo evenimente të ndryshme; -ftesa të përgatitura me program me rastin e shfaqjeve, festave, apo evenimenteve të ndryshme; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. 	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -bisedë; -diskutim; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve • Veprimtaria e parë <p><i>Bisedë:</i> Mësuesi/ja paraqet një ftesë ku mungojnë 1-2 elemente. Orienton nxënësit/et të lexojnë atë dhe të tregojnë për elementet e ftesës që mungojnë. Nxitet diskutimi ku del se sa i rëndësishëm është çdo element i ftesës.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Diskutim:</i> Rikujtojmë elementet e një ftese me program, duke e ilustruar me ftesën dhe programin e Ditës së Flamurit. Mësuesi/ja në bashkëbisedim me nxënësit/et përmbledh konceptimin e ftesës me program dhe elementet kryesore të saj.</p> <p>Ftesa: <i>Konceptohet teksti i ftesës, i cili duhet të jetë i shkurtër, i qartë, të tregojë se për çfarë bëhet fjalë, të ketë të shënuar se kujt i drejtohet ftesa, të saktësojë kohën dhe vendin ku do të zhvillohet veprimtaria dhe në fund, se kush e dërgon atë (grupi organizator i shfaqjes, mësuesi/ja kujdestar/e, senatori i klasës).</i></p> <p>Programi: <i>Hartimi i programit paraprihet nga një diskutim i organizatorëve lidhur me elementet që do të përzgjidhen për shfaqjen festive (përsëritje, këngë, recitime, pjesë teatrale, kërcime, pjesë instrumentale, etj...). Pasi të jenë përzgjedhur në mënyrë përfundimtare nga grupi organizator bashkë me mësuesin/en, bëhet renditja e tyre në program. Kjo ka për qëllim që shfaqja të ketë një rend, rregull, por edhe një alternim të pjesëve të ndryshme të shfaqjes. Programi parashikon renditjen e secilës pjesë me numrin përkatës duke llogaritur edhe kohën e ekzekutimit të saj, në mënyrë që të kemi planifikuar edhe kohëzgjatjen e plotë të shfaqjes.</i></p>			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Shkrim i drejtuar:</i> Ushtrimi 2. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shkruajnë një ftesë për një shfaqje të ngjashme, sipas skemës së dhënë dhe programin e veprimtarive për këtë festë. Nxënësit/et prezantojnë punën e bërë para klasës. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es. Me ndihmën e mësuesit/es korrigjohen gabimet drejtshkrimore. Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve. • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -dallimin e elementeve të një ftese që dërgohet me rastin e një feste (Festës së Flamurit) dhe strukturën e programit që do të ndiqet në këtë ditë; -shkrimin e një ftese sipas modelit të dhënë me program, për shfaqjen që organizohet me rastin e Ditës së Flamurit; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Një pyetje që duhet bërë patjetër		Situata e të nxënit Bisedë me nxënësit/et për kuptimin e kohës dhe shfrytëzimin e saj në mënyrë produktive e pozitive.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon strofat, vargjet në poezi; • lexon poezinë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth poezisë; • diskuton në grup për bilancin e tij/saj ditor; • tregon për rëndësinë që ka axhenda ditore në jetën tonë të përditshme; • nxjerr mesazhin që përcjell poezia; • vlerëson shfrytëzimin e kohës në mënyrë intensive dhe me produkt pozitiv; • gjykon për rolin aktiv të njeriut në jetë; • pranon dhe tregon respekt, për mendimet dhe idetë e të tjerëve rreth poezisë; • demonstroi besim në forcat e veta, respekt dhe tolerancë brenda grupit. 		Fjalë kyçe: -poezi; -strofa; -varg; -kalendar; -ditë.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me vargjet e poezisë; -informacione për jetën dhe veprimtarinë e autorit; -kalendar; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -vendimmarrja morale.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim;
 - dora e fshehtë;
 - lexo-diskuto;
 - lexo-përmbledh në dyshe;
 - rishikim në dyshe;
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim: Mësuesi/ja u drejton nxënësve pyetjet për diskutim, ku ata/ato shprehin mendimet e tyre për kuptimin që kanë për shfrytëzimin e kohës dhe synimeve në jetë.

-A ju ka ndodhur që në fund të ditës t’i bëni një pyetje vetes, se cili ka qenë bilanci i angazhimeve tuaja ditore?

-Çfarë keni bërë dhe çfarë ju ka mbetur pa bërë?

-A e keni shfrytëzuar si duhet ditën tuaj?

-Ç’mund të ndodhë sikur njerëzit t’u shmangen detyrimeve të tyre për punë dhe angazhime të tjera që mbajnë gjallë jetën tonë?

- **Veprimtaria e dytë**

Dora e fshehtë: Nxënësit/et njihen me titullin e poezisë: “Një pyetje që duhet bërë patjetër” dhe autorin e saj Xhevahir Spahiu.

Xhevahir Spahiu lindi më 1 mars të vitit 1945, në Malind të Skraparit, është shkrimtar i njohur shqiptar. Studioi në Fakultetin Histori-Filologji, dega gjuhë-letërsi shqipe.

Që nga viti 1968, ka punuar si gazetar në gazetën “Zëri i Popullit”, redaktor në revistën “Nëntori”, mësues dhe libretist në Teatrin e Operas e Baletit në Tiranë.

Është i nderuar me çmimin “Migjeni” dhe është fitues i çmimit të parë në konkursin e 45-vjetorit të çlirimit të Atdheut.

Titujt e veprave

- Mëngjes sirenash
- Ti qytet i dashur
- Vdekje e perëndive
- Dyer dhe zemra të hapura
- Agime shqiptare
- Zambakët e Mamicës
- Kitaristët e vegjël
- Nesër jam aty
- Heshtje s’ka
- Dielli i lodrave
- Poezia shqipe
- Kohë e krisur

*Udhëzohen nxënësit/et në secilin grup të tërheqin nga dora e fshehtë nga një fishë, në të cilat janë shkruar vargjet e poezisë. Secili nga grupet ka për detyrë të renditë vargjet e poezisë, siç duhet.

Çdo grup paraqet para klasës në fletë formati renditjen e saj.

Mësuesi/ja lexon poezinë dhe del se cili nga grupet i ka renditur saktë vargjet.

- **Veprimtaria e tretë**

Lexo-diskuto: Lexim i poezisë nga nxënësit/et në strofa.

Për çdo strofë u drejtohen nxënësve pyetje që nxisin diskutimin.

Strofa I - Cila është pyetja që poeti i bën vetes, ndërsa ikën edhe një ditë?

Strofa II - Si e kuptoni vargun “nga guri, ja u ngrit ndërtesa”

-Çfarë konstaton poeti, ndërsa vlerëson punën e njeriut?

Strofa III- Pse poeti thotë “Koha vrapon si lumë”?

-Ç’kuptim ka vargu: “nga kalendari fleta ra”?

-Pse autori e përsërit si refren vargun “Ditës ç’i dhe e çfarë të dha?”

-A ju pëlqeu poezia? Pse?

-Si u ndjetë pas leximit të kësaj poezie?

*Diskutohet në klasë për karakteristikat e poezisë (është e shkruar në vargje, përbëhet nga strofa katërshe me rimë).

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt Lexo-përmbledh në dyshe, diskutim: Duke punuar në dyshe, nxënësit/et lexojnë dhe përmbledhin çdo strofë me 1-2 fjali. Në strofën pasardhëse nxënësit/et ndërrojnë rolet. Nxjerrin mesazhin: <i>Të shfrytëzojmë kohën në mënyrë intensive dhe me produkt pozitiv, pasi koha ikën dhe të lë pas.</i> *Lexim i poezisë nga nxënësit/et. • Veprimtaria e pestë <i>Rishikim në dyshe:</i> Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/es ngjyrosin me të njëjtën ngjyrë shprehjen e përdorur në poezi me kuptimin e saj. Në përfundim shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. • Veprimtaria e gjashtë <i>Diskutim në grup:</i> Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit/es ngjyrosin me ngjyra të ndryshme dy vargje dhe një strofë të kësaj poezie. Nxënësit/es gjejnë alternativën e duhur se ç’kuptojnë nga fjalia “<i>Ditës ç’i dhe e qfarë të dha?</i>” *Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxënësit/es i përgjigjen pyetjes se si ndihen në fund të ditës së tyre, duke zgjedhur njëren prej dy alternativave të dhëna. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. • Vlerësimi bëhet për: -dallimin e strofave, vargjeve në poezi; -leximin e poezisë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; -shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth poezisë; -diskutimin në grup për bilancin e tij/saj ditor; -tregimin për rëndësinë që ka axhenda ditore në jetën tonë të përditshme; -formulimin e mesazhit që përcjell poezia; -vlerësimin për shfrytëzimin e kohës në mënyrë intensive dhe me produkt pozitiv; -grykimin për rolin aktiv të njeriut në jetë; -vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit. • Detyrë shtëpie Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Zgjedhjmë foljen në kohën e tashme		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar foljet në kohën e tashme.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • zgjedhon foljet e rregullta në kohën e tashme të mënyrës dëftore, duke dalluar mbaresat që marrin ato gjatë zgjedhimit; • dallon në fjali e tekste foljet në kohën e tashme duke përcaktuar vetën dhe numrin e tyre; • përshtat foljen në kohën e tashme me përemrin vetor, në fjali; • shkruan fjali me folje në kohën e tashme, në vetën dhe numrin e kërkuar; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalët kyçe: -folje; -zgjedhim; -koha e tashme.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e zgjedhimit të foljeve në kohën e tashme; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskuto-nxirr përfundimin;
 - dallo-trego;
 - rishikim në dyshe;
 - shkrim i drejtuar;
 - punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskuto-nxirr përfundimin: Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fisha me fjali dhe i orienton të punojnë në dyshe për të dalluar foljet në fjali. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

Njihen nxënësit/et me temën e mësimit.

*Lexohet rubrika: "Kujtoj", ku jepet kuptimi për foljen në kohën e tashme.

Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t'u lindin nxënësve/eve.

Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të lexojnë tabelën e zgjedhimit të disa foljeve të rregullta në kohën e tashme.

Orientohen nxënësit/et të vënë re mbaresat që marrin foljet, gjatë zgjedhimit.

- **Veprimtaria e dytë**

Dallo-trego: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të dallojnë foljet në tekstin e dhënë dhe të tregojnë kohën kur është kryer veprimi. Nxënësit/et lexojnë tekstin, diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es rreth foljeve në kohën e tashme që gjenden në tekst.

- **Veprimtaria e tretë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të plotësojnë fjalitë me foljet *lexoj, hap* në kohën e tashme.

Mësuesi/ja i lë nxënësit të lirë të mendohen për disa çaste. Më pas ata/ato punojnë individualisht.

Shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrin.

Diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimit.

- **Veprimtaria e katërt**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të krijojnë fjali, në të cilat të përdorin foljet *shkruaj, mbyll, zë*, në kohën e tashme, në vetën dhe numrin e kërkuar.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Shkëmbejnë fletoret, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Nxënësit/et lexojnë fjalitë me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime të thjeshta drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-zgjedhimin e foljeve të rregullta në kohën e tashme të mënyrës dëftore, duke dalluar mbaresat që marrin foljet gjatë zgjedhimit në kohën e tashme;

-dallimin në fjali e tekste, të foljeve në kohën e tashme duke përcaktuar vetën dhe numrin e tyre;

-përshtatjen e foljes në kohën e tashme me përemrin vector, në fjali;

-shkrimin e fjalive me folje në kohën e tashme, në vetën dhe numrin e kërkuar;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;

-demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj fjali ku të përdorësh foljet:

luaj, koha e tashme, veta e tretë, numri njëjës.

kap, koha e tashme, veta e parë, numri njëjës.

vë, koha e tashme, veta e dytë, numri shumës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Gjyshi në laptop		Situata e të nxënit Përshkrimi i historive personale të fëmijëve në lidhje me përpjekjet e gjyshërve të tyre për t'u përshtatur me teknologjinë e re si laptopi, interneti, rrjetet sociale etj.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon elementet e vjershës si: strofa, vargu, rima; • lexon vjershën rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • shpjegon fjalët e reja, duke ndërtuar fjali me to; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së vjershës; • shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth vjershës; • tregon për karakterin e personazhit kryesor të vjershës, duke e ilustruar me vargje nga vjersha; • argumenton me fjalë të thjeshta këmbënguljen e gjyshit për të shfrytëzuar internetin (rrjetet sociale) për t'u lidhur me bashkëmoshatarët e tij si dhe me nipërit, mbesat; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -vjershë; -strofa; -laptop; -gjyshi; -facebook; -skype.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim paraprak; -diskutim; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -lexo-përmbledh në dyshe, bashkëbisedim; -mendo-zbuloj; -bisedë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim paraprak:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et për të treguar historitë e tyre personale me përpjekjet e gjyshërve për t'u përshtatur me teknologjinë e re, si: laptopi, interneti, rrjetet sociale për t'u lidhur me familjarët, nipërit, mbesat, bashkëmoshatarët e tyre, pavarësisht vështirësive që hasin me anglishten, mungesën e njohjes së kompjuterit, etj... Mësuesi/ja prezanton titullin e vjershës "Gjyshi në laptop". <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Diskutim:</i> Nxënësit/et vërejnë dhe komentojnë figurën në dyshe dhe më pas me gjithë klasën. *Lexim i vjershës nga nxënësit/et në strofa. *Diskutohet në klasë për karakteristikat e vjershës (është e shkruar në vargje, përbëhet nga strofa katërshe, me rimë). *Punohet rubrika "Fjalë të reja", ku shpjegohen fjalët që nxënësit/et nuk i kuptojnë, më pas krijohen fjali me to. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Marrëdhënie pyetje-përgjigje:</i> Punohet rubrika "Lexoj dhe kuptoj", ku nxënësit/et iu përgjigjen pyetjeve rreth vjershës. Nxënësit/et diskutojnë në dyshe për përgjigjet e pyetjeve dhe më pas me gjithë klasën. -Për kë flitet në këto vargje? -Me çfarë problemi po ndeshet gjyshi? Pse? -Pse do gjyshi të përdorë facebook-un? Po skype-n? 			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt Lexo-përmbledh në dyshe, bashkëbisedim: Duke punuar në dyshe, nxënësit/et lexojnë dhe përmbledhin çdo strofë me 1-2 fjali. Në strofën pasardhëse nxënësit/et ndërrojnë rolet. *Lexim i vjershës nga nxënësit/et me intonacionin e duhur. • Veprimtaria e pestë Mendo-zbulo: Punë në grupe: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et të zbulojnë karakterin e personazhit të vjershës duke e ilustruar me vargje. • Veprimtaria e gjashtë Bisedë: Punohet rubrika “Reflektoj”. Ftohen nxënësit/et të vënë veten në vend të fëmijës së këtyre vargjeve dhe të imagjinojnë si do të ishte marrëdhënia e tyre me gjyshin e vjershës. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrit. • Vlerësimi bëhet për: -dallimin e elementeve të vjershës si: strofa, vargu, rima; -leximin e vjershës rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; -shpjegimin e fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to; -përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së vjershës; -shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth vjershës; -tregimin për karakterin e personazhit kryesor të vjershës, duke e ilustruar me vargje nga vjersha; -argumentimin me fjalë të thjeshta për këmbënguljen e gjyshit për të shfrytëzuar internetin (rrjetet sociale) për t’u lidhur me bashkëmoshatarët e tij si dhe me nipërit, mbesat; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit. Detyrë shtëpie Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Zgjedhojmë foljen në kohën e pakryer		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar foljet në kohën e pakryer.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • zgjedhon foljet e rregullta në kohën e pakryer të mënyrës dëftore, duke dalluar mbaresat që marrin ato gjatë zgjedhimit; • dallon në fjali e tekste foljet në kohën e pakryer, duke përcaktuar vetën dhe numrin e tyre; • përshtat foljen në kohën e pakryer me përemrin vetor, në fjali; • shkruan fjali në të cilat përdor folje në kohën e pakryer, në vetën dhe numrin e kërkuar; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; • bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave. 		Fjalët kyçe: -folje; -zgjedhim; -koha e pakryer; -vetë; -numër.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e zgjedhimit të foljeve të rregullta në kohën e pakryer; -fisha me tekste të shkurtra, ku janë përdorur folje të rregullta në kohën e pakryer; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskuto-nxirr përfundimin;
 - rishikim në dyshe;
 - shkrim i drejtuar;
 - dialog;
 - punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskuto-nxirr përfundimin: Njihen nxënësit/et me temën e mësimit.

*Lexohet rubrika “Kujtoj”, ku jepet kuptimi për foljen në kohën e pakryer.

Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve/eve.

Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të lexojnë tabelën e zgjedhimit të disa foljeve të rregullta në kohën e pakryer.

Orientohen nxënësit/et të vënë re mbaresat që marrin foljet në kohën e pakryer gjatë zgjedhimit.

**Punë në dyshe:* Mësuesi/ja shpërndan fisha ku është shkruar një tekst i shkurtër dhe fton nxënësit/et të gjejnë në të foljet në kohën e pakryer. Nxënësit/et punojnë në dyshe.

Në përfundim, çdo dyshe prezanton punën e bërë.

- **Veprimtaria e dytë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të plotësojnë fjalitë duke përzgjedhur foljen e duhur.

Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të plotësojnë fjalitë me foljet *shikoj, pi* në kohën e pakryer.

Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Më pas ata/ato punojnë individualisht.

Shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrin.

Diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimit.

- **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të krijojnë fjali në të cilat të përdorin foljet *fitoj, mbyll, pi* në kohën e pakryer, në vetën dhe numrin e kërkuar.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Shkëmbejnë fletoret, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Nxënësit/et lexojnë fjalitë me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime të thjeshta drejtshkrimore.

- **Veprimtaria e katërt**

Dialog: Nxiten nxënësit/et që në dyshe të dialogojnë me njëri-tjetrin duke përdorur folje në kohën e pakryer. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi** bëhet për:

-zgjedhimin e foljeve të rregullta në kohën e pakryer të mënyrës dëftore, duke dalluar mbaresat që marrin ato gjatë zgjedhimit;

-dallimin në fjali e tekste të foljeve në kohën e pakryer, duke përcaktuar vetën dhe numrin e tyre;

-shkrimin e fjalive ku të përdorin folje në kohën e pakryer në vetën dhe numrin e kërkuar;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj fjali ku të përdorësh foljet:

tregoj, koha e pakryer, veta e tretë, numri njëjës.

kap, koha e pakryer, veta e dytë, numri shumës.

vë, koha e pakryer, veta e parë, numri njëjës.

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda:Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Lexim jashtë klase 2 (sipas zgjedhjes së mësuesit/es)		Fjalë kyçe	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëgjëza etj. (sipas pjesës që do ketë zgjedhur mësuesi/ja) • përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive. (sipas pjesës që do ketë zgjedhur mësuesi/ja) • përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara; • tregon interes dhe dëshirë për të lexuar; • shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit; • ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit; • pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë. 		Situata e të nxënit Leximi i librave jashtë klase	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none"> - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; - libra jashtë klase. 		Lidhja me fushat e tjera Lidhja me temat ndërkurrikulare	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve <ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia: diskutim, bisedë, punë në çift, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve <ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i titullit të librit dhe autori. • Leximi i pjesës. • Pyetje për llojin e pjesës dhe brendinë e saj. • Komenti i fragmentit që pëlqejnë më shumë. • Tregimi i brendisë së pjesës. • Personazhet dhe cilësitë e tyre. • Mesazhi që përcjell pjesa. • Lidhja e këtij mesazhi me jetën e tyre. • Ilustrim i pjesës me vizatim. • Vlerësimi bëhet për: <p>-leximin e poezive, përrallave nga folklori, përrallave nga autorë të ndryshëm, tregimeve, fabulave, gjëgjëzave, etj...;</p> <p>-përcaktimin e dy-tre tipareve të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive;</p> <p>-përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazheve dhe tregimin se cilët janë personazhet e preferuara;</p> <p>-shfaqjen e besimit dhe vullnetit në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit;</p> <p>-ndarjen me të tjerët të përvojave të tij rreth leximit.</p> <p>Shënim: Disa rubrika të kësaj ore nuk janë plotësuar, pasi ato ndryshojnë në varësi të pjesës që do të zgjedhë mësuesja për të punuar.</p>			

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda:Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Vlerësim njohurish 2		Fjalë kyçe: -vlerësim njohurish; -test; -përcakto; -kthe; -shkruaj.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - plotëson kërkesat e ushtrimeve në tekst; - shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; - respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit. 		Situata e të nxënit Vlerësim njohurish 2	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none"> - njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; - fletët e testit, mjetet e shkrimit. 		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia: bisedë, punë individuale e pavarur. Veprimtaritë e nxënësve/eve <ul style="list-style-type: none"> • Mësuesi/ja shpërndan fletët e vlerësimit të njohurive. Fton nxënësit/et të lexojnë kërkesat dhe të pyesin për paqartësitë. Udhëzon për punë të pavarur. • Në përfundim të testit, mblidhen fletët dhe bëhet zgjidhja e tij në tabelë duke diskutuar me nxënësit/et. Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -plotësimin e kërkesave të ushtrimeve në tekst; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit. 			

PLANIFIKIMI METODIK I PROJEKTIT					
Titulli i projektit	Traditat tona		Kohëzgjatja		1 orë -- Gjuhë shqipe (të shkruarit)
					1orë -- Gjuhë shqipe (të shkruarit)
Lënda: Gjuhë shqipe		Mësuesi/ja:			1 orë -- Gjuhë shqipe (të lexuarit)
					1 orë -- Gjuhë shqipe (të lexuarit)
Lidhja fushat e tjera:	Arte Teknologjia dhe TIK-u Shoqëria dhe mjedisi		Klasa:		E katërt
Ideja e projektit:	<p>Traditat e një populli janë pasuri shpirtërore, pikëpamje, zakone, virtyte etj, që janë formuar historikisht në jetën e tij dhe që ruhen, trashëgohen e zhvillohen më tej si një thesar i çmuar nga njëri brez në tjetrin.</p> <p>Duke trashëguar arrijtjet më të mira në të gjitha fushat e jetës, gjithçkaje të mirë e përparimtare që na kanë lënë brezat e kaluar, krijojmë një përvojë të pasur dhe të mirë në jetën tonë.</p> <p>Në këtë projekt nxënësit përdorin aftësitë hulumtuese, për të gjetur dhe lexuar dokumente, foto që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe zhvillimin e traditave tona.</p> <p>Ata zbatojnë aftësitë krijuese për të përgatitur postera, vizatime, albume; aftësitë interpretuese për vjersha, tregime, lojë me role, gjëza, lojëra në natyrë, etj...</p>				
Ngjarjet hyrëse që frymëzojnë kërkimin dhe angazhimin e nxënësve:	<p>Filma të ndryshëm që kanë parë, foto, ose albume me veshje e lojëra, objekte, apo gatime, histori që kanë dëgjuar, apo lexuar, do të frymëzojnë nxënësit për të kërkuar e zbuluar më shumë informacione në lidhje me këtë temë.</p> <p>Njohuritë paraprake të nxënësve si dhe përvojat e mëparshme të tyre në lidhje me këtë temë, shfrytëzohen si nxitje për angazhimin e tyre në zotërimin e disa kompetencave.</p>				
Kompetencat kyçe që zhvillohen:	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.	x	Kompetenca personale	X	
	Kompetenca e të menduarit	x	Kompetenca qytetare	X	
	Kompetenca e të nxënësve	x	Kompetenca digjitale	x	
	Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.	x			
Temat e njohurive kryesore lëndore, të cilat do të rimerren në sajë të projektit:	Lexojmë informacione për ruajtjen dhe zhvillimin e traditave të popullit tonë		Shkruajmë pyetje dhe informacione për "Traditat tona"		
	Interpretojmë në role për të demonstruar ruajtjen dhe zhvillimin e traditave tona		Përgatitim albume, postera me temë "Traditat tona"		
Rezultatet e të nxënësve:	<ul style="list-style-type: none"> • mbledh informacione nga burime të ndryshme për "Traditat tona"; • diskuton në grupe për ruajtjen dhe zhvillimin e traditave të popullit tonë; • komunikon me të moshuarit (ftuarit) për të zbuluar sa më shumë rreth trashëgimisë së vlerave; • organizon mbledhjen e folklorit shqiptar; • dallon këngët, vallet e vjetra shqiptare, duke i klasifikuar ato sipas krahinave; • grupon veshjet karakteristike shqiptare sipas zonës që i përkasin; • demonstroi lojra popullore që janë trashëguar brez pas brezi; • përgatiti albume, postera me foto që tregojnë ndërtesa karakteristike shqiptare, objekte, veshje, etj...; • ekspozon objekte të trashëguara ndër vite; • interpreton dialogje të shkurta duke demonstruar dialekte dhe veshje popullore të krahinave të ndryshme; • ekspozon gatime tradicionale që i përkasin zonave të ndryshme; • ndan me të tjerët përvojat e tij rreth kësaj teme; <p>përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të shkruarit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • prezanton duke e shoqëruar me mjete pamore filmime, foto, etj...; • rrëfen ngjarje, shpreh ndjenja, përcjell ide rreth temës "Traditat tona"; • demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; • demonstroi besim dhe vullnet në arrijtjet e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • demonstroi besim në forcat e veta, respekt e tolerancë brenda grupit. 				
Metodologjia:	(Individuale, në grup, ose e gjithë klasa)	Diskutim	X	Hulumtim	X
		Bisedë	X	Lojë me role	X
		Punë në grup	X	Tryeza rrethore	X
Burimet e nevojshme:	Njerëzit e përfshirë	Mësuesi, nxënësit, prindërit, gjyshërit, një historian.			
	Mjetet:	Aparat fotografik, bllok shënimesh, foto, videoprojektor, karton, letër, lapustilë			
	Materiale dhe burime	Materiale të ndryshme nga interneti, foto dhe CD			

Pyetja kërkimore:	Duhet t'i ruajmë dhe zhvillojmë traditat e popullit tonë? Pse?	
Përmbledhja e çështjeve, investigimi, kërkimi dhe zgjidhja e problemit:	<p>Mësuesja i ka udhëzuar nxënësit të marrin informacione në lidhje me “Traditat tona”, foto/video nga aktivitetet që u janë kushtuar këtyre ditëve.</p> <p>Gjuhë shqipe</p> <ul style="list-style-type: none"> Mësuesja ka ftuar në klasë prindër, gjyshër si dhe një historian, (ose mësuesen e historisë). Ata do t'u bashkohen grupeve të fëmijëve. Nxënësit janë njohur më parë me temën e projektit. Ata kanë sjellë informacione në lidhje me “Traditat tona”. Përfaqësues të grupeve, lexojnë informacionet e gjetura dhe diskutojnë rreth tyre. <p>Po ashtu, nxënësit kanë përgatitur pyetje me shkrim për të ftuarit. Diskutohet me ta për të zbuluar sa më shumë rreth trashëgimisë së vlerave të popullit tonë.</p> <ul style="list-style-type: none"> Për secilin grup jepet nga një temë/detyrë, (demonstrojnë këngët dhe vallet e vjetra shqiptare duke i klasifikuar sipas krahinave; sfilojnë veshjet karakteristike shqiptare, duke i grupuar sipas zonës që i përkasin; demonstrojnë lojëra popullore që janë trashëguar brez pas brezi; përgatitin albume dhe postera me foto që tregojnë ndërtesa karakteristike shqiptare, objekte, veshje, etj...; përgatitin një ekspozitë të vogël me objekte të trashëguara nga brezat e mëparshëm; interpretojnë të veshur me veshje popullore të krahinave të ndryshme dialogje të shkurta të improvizuara; degustimi i gatimeve tradicionale që i përkasin zonave të ndryshme të Shqipërisë - leximi dhe diskutimi i recetave përkatesë). Grupet diskutojnë rreth temave të mësipërme. Pasi përfundojnë diskutimet dhe punimet në grup, ata prezantojnë para shokëve të klasës. Prezantimet shoqërohen me foto dhe video të marra nga interneti që lidhen me tematikën (materiale që i kanë përgatitur më parë me udhëzimin e mësueses). Nxënësit e grupeve të tjera, bëjnë komentet e tyre rreth videove, fotove dhe gjithashtu sjellin përvojat e tyre në lidhje me çështjen që po diskutohet. Mësuesja udhëzon nxënësit të luajnë me role situata të improvizuara, të cilat kanë lidhje me “Traditat tona”, (mundësisht të veshin veshje popullore të krahinave të ndryshme e të përdorin dialekt në dialogjet që do të interpretojnë) 	
Produktet kryesore:	Në grup:	Demonstrim i këngëve, valleve, lojrave, veshjeve, albumeve, posterave, etj...
	Individualisht:	Interpretime, lojë në role, postera, albume, sfilim, etj.
Vendi dhe pjesëmarrësit e prezantimit:	Shkollë	X
	Klasë	X
Vlerësimet:	Vlerësimet formuese (Gjatë projektit)	<ul style="list-style-type: none"> mbledhjen e informacioneve nga burime të ndryshme për “Traditat tona”; diskutimin në grupe për ruajtjen dhe zhvillimin e traditave të popullit tonë; komunikimin me të moshuarit (ftuarit) për të zbuluar sa më shumë rreth trashëgimisë së vlerave; organizimin e mbledhjes së folklorit shqiptar; dallimin e këngëve, valleve të vjetra shqiptare, duke i klasifikuar ato sipas krahinave; grupimin e veshjeve karakteristike shqiptare sipas zonës që i përkasin; demonstrimin e lojrave popullore që janë trashëguar brez pas brezi; përgatitjen e albumeve, posterave me foto që tregojnë ndërtesa karakteristike shqiptare, objekte, veshje, etj...; ekspozimin e objekteve të trashëguara ndër vite; interpretimin e dialogjeve të shkurta duke demonstruar dialekte dhe veshje popullore të krahinave të ndryshme; ekspozimin e gatimeve tradicionale, që u përkasin zonave të ndryshme; <p>përzgjedhjen e fjalorit të duhur gjatë të shkruarit;</p> <ul style="list-style-type: none"> prezantimin e tyre duke e shoqëruar me mjete pamore filmime, foto, etj...; rrëfimin e ngjarjeve, shprehjen e ndjenjave, përcjelljen e ideve rreth temës “Traditat tona”; demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime; demonstrimin besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve; respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; demonstrimin e besimit në forcat e veta, respektit dhe tolerancës brenda grupit.
	Vlerësime përmbledhëse (Në fund të projektit)	<ul style="list-style-type: none"> Prezantimi i punëve.
Buxheti:	Buxheti i detajuar Përse? Nga kush?	<ul style="list-style-type: none"> Në bashkëpunim me prindërit mund të shpenzohet një fond prej 200 lekësh për blerjen e materialeve të ndryshme dhe letrave, tabakëve dhe lapustilëve me ngjyra.

Test 2**Flutura**

Një mëngjes maji, lindi një flutur e vogël, me krahë të bardhë e të brishtë. Menjëherë ajo ndjeu dëshirën të rendte e të lozte. Rrahu krahët dhe u ndal te një trëndafil i kuq:

- A luajmë “E ka kush e ka?” – e pyeti.
- Unë nuk luaj dot, – iu përgjigj trëndafili. – Lulet nuk kanë krahë dhe s’munden të fluturojnë.
- Po çfarë di të bësh? – pyeti kureshtarja e vogël.
- Unë di të ngjyros me të kuqe krahëzat e tu...

Dhe ndërkaq lulja e spërkati fluturën me pikëza të kuqe. Flutura, e gëzuar, e falënderoi dhe fluturoi te një lule tjetër për të luajtur “E ka kush e ka”. Por të gjitha lulet i dhanë të njëjtën përgjigje dhe e spërkatën me ngjyrat e tyre.

Sa e lumtur ishte flutura e vogël! Ajo çdo ditë fluturonte nga një lule te tjetra dhe i falënderonte. Ndërsa lulet i këndonin atë këngën që e dimë të gjithë: “Flutur, flutur, zonjë e bukur...”

E ku ka si mirënjohja dhe mirësia! Ato janë ndër virtytet më të çmuara për njeriun.

Qarko përgjigjen e saktë.**1. Pjesa e mësipërme është:**

(1 pikë)

- a) tregim
- b) përrallë
- c) fabul

2. Trëndafili nuk fluturonte dot sepse:

(1 pikë)

- a) nuk dëshironte
- b) nuk kishte krahë
- c) ishte zemëruar me fluturën

3. Fluturës i dha ngjyrë

:(1 pikë)

- a) vetëm trëndafili
- b) të gjitha lulet
- c) asnjë lule

4. Trëndafili i dha fluturës ngjyrë:

(1 pikë)

- a) të verdhë
- b) të kuqe
- c) të gjitha ngjyrat

5. Shkruaj mesazhin e pjesës:

(1 pikë)

6. Shkruaj një titull tjetër.

(1 pikë)

7. Shkruaj një karakteristikë të tregimit.

(1 pikë)

8. Në fjalinë “Flutura, e gëzuar, e falënderoi dhe fluturoi te një lule tjetër” gjej një emër dhe analizoje atë.

(6 pikë)

Emri	Lloji	Gjinia	Numri	Rasa	Trajta

9. Ndërto fjali me emrin libër në numri shumës, trajtën e shquar, rasën kallëzore.

(2 pikë)

10. Në fjalinë “Një mëngjes maji, lindi një flutur e vogël, me krahë të bardhë e të brishtë” gjej dy mbiemra dhe analizoji ato.

(10 pikë)

Mbiemri	Lloji	Numri	Gjinia	Rasa

11. Në fjalinë “Unë di të ngjyros me të kuqe krahëzat e tu...” gjej përemrat dhe përcakto llojin e tyre (2 pikë)

12. Në fjalinë “Ajo çdo ditë fluturonte nga një lule te tjetra”, gjej foljen dhe analizoje atë. (4 pikë)

Folja	Koha	Veta	Numri

13. Shkruaj një fjali ku të përdorësh foljen lexoj në kohën e pakryer, vetën e dytë, numrin shumës (2 pikë)

14. Përshkruaj personazhin tënd të preferuar me 6-7 fjali. (5 pikë)

Vlerësimi	AP	ANP	AK	ASHK	ASH
Pikët	0-10	11-22	23-28	29-35	36-38

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Ditë pranvere		Situata e të nxënit Shikim me anë të videoprojektorit të pamjeve të lindjes së një dite pranvere në fshat.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon elementet e poezisë si: strofa, vargu, rima; • lexon poezinë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • shpjegon fjalët e reja, duke ndërtuar fjali me to; • shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth poezisë; • bën lidhjen ndërmjet shprehjeve të përdorura në poezi me shpjegimin e tyre; • përshkruan ndjesitë e tij/saj për lindjen e një dite të re; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -poezi; -strofa; -ditë pranvere; -agim; -qetim; -pëqi.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -videoprojektor; -material filmik; -pamje të lindjes së diellit; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -mjedisi; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -shikim i organizuar; -dora e fshehtë; -lexim dhe diskutim; -rishikim në dyshe; -mendo-zbulo; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Shikim i organizuar:</i> Paraqitet me anë të videoprojektorit pamje të lindjes së një dite pranvere në fshat. Ftohen nxënësit/et të flasin rreth tyre. (Në mungesë të videoprojektorit komentohen pamje). Mësuesi/ja prezanton titullin e poezisë “Ditë pranvere” dhe autorin e saj Asdreni.</p> <p><i>Aleksandër Stavre Drenova apo Asdreni</i> lindi më 11 prill 1872 në Drenovë (Korçë), vdiq më 1947 në Bukuresht, Rumani. Ka qenë një poet, publicist, patriot shqiptar. Është autori i tekstit të “Himni i Flamurit”. Është bërë i njohur me vëllimet poetike “Rreze dielli”, “Ëndrra e lot”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Dora e fshehtë:</i> Udhëzohen nxënësit/et në secilin grup të tërheqin nga dora e fshehtë nga një fishë, në të cilat janë shkruar vargjet e poezisë. Secili nga grupet ka për detyrë të renditë vargjet e poezisë, siç duhet. Çdo grup paraqet para klasës në fletë formati, renditjen e poezisë. Mësuesi/ja lexon poezinë dhe del se cili nga grupet i ka renditur saktë vargjet.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <p><i>Lexim dhe diskutim:</i> Nxënësit/et vërejnë dhe komentojnë pamjen në libër, në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.</p> <p>*Lexim i poezisë nga nxënësit/et në strofa. Nxiten nxënësit/et të shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre për poezinë. -Si u ndjetë pas leximit të kësaj poezie? -A ju pëlqeu poezia? Pse? *Diskutohet në klasë për karakteristikat e poezisë (është e shkruar në vargje, përbëhet nga strofa pesëshe, me rimë). *Punohet rubrika “Fjalë të reja”, ku shpjegohen fjalët: <i>agimi, qetimi, pëqi</i>. Nxiten nxënësit/et të krijojnë fjali me to. *Lexim i poezisë me intonacion nga nxënësit/et.</p>			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Rishikim në dyshe:</i> Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”, ku nxënësit/et do të ngjyrosin me të njëjtën ngjyrë shprehjen e përdorur në poezi me kuptimin e saj. Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth detyrës. • Veprimtaria e pestë <i>Mendo-zbulo:</i> Punë në grupe: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et të zbulojnë se për cilin moment të ditës flet poezia dhe të renditin fjalitë përmbledhëse për secilën strofë sipas rrjedhës së poezisë. Përfaqësuesit e secilit grup, prezantojnë punën e tyre para klasës. • Veprimtaria e gjashtë <i>Bashkëdisedim:</i> Punohet rubrika “Reflektoj”. Zhvillohet një bashkëbisedim me nxënësit/et rreth ndjesive që kanë provuar kur kanë parë lindjen e diellit në vende të ndryshme ku është ndodhur. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrit. • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -dallimin e elementeve të poezisë si: strofa, vargu, rima; -leximin e poezisë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; -shpjegimin e fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to; -lidhjen që bën ndërmjet shprehjeve të përdorura në poezi me shpjegimin e tyre; -përshkrimin e ndjesive të tij/saj për lindjen e një dite të re; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit. • Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj” Mëso përmendësh poezinë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Zgjedhjmë foljet në kohën e kryer të thjeshtë (ora I)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar foljet në kohën e kryer të thjeshtë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • zgjedhon foljet e rregullta në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore, duke dalluar mbaresat që marrin ato gjatë zgjedhimit; • dallon në fjali e tekste foljet në kohën e kryer të thjeshtë, duke përcaktuar vetën dhe numrin e tyre; • përshtat foljen në kohën e kryer të thjeshtë me përemrin vetor, në fjali; • shkruan fjali në të cilat përdor folje në kohën e kryer të thjeshtë; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; • bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -folje; -zgjedhim; -koha e kryer e thjeshtë; -vetë; -numër. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e zgjedhimit të foljeve të rregullta në kohën e kryer të thjeshtë; -fisha me tekste të shkurtra, ku janë përdorur folje të rregullta në kohën e kryer të thjeshtë; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. 	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskuto-nxirr përfundimin;
 - rishikim në dyshe;
 - dallo-trego;
 - shkëmbe një problemë;
 - punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskuto-nxirr përfundimin: Njihen nxënësit/et me temën e mësimi.

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë fjalitë e shkruara në dërrasë të zezë të cilat ata/ato i kanë të shkruara edhe në libër.

Dora vrapoi, ndërsa unë qëndrova në vend.

Piva ujë. Arrita Dorën. Rrugës, në mbloodhëm lule.

Nxiten nxënësit/et të tregojnë se çfarë vënë re te foljet me ngjyrë të gjelbër.

Nxënësit/et shkëmbejnë mendimet ndërmjet tyre, në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.

*Lexohet rubrika “Mbaj mend”, ku jepet kuptimi për foljen në kohën e kryer të thjeshtë.

Mësuesi/ja vë në dukje se foljet me ngjyrë të gjelbër në fjalitë e mësipërme janë në kohën e kryer të thjeshtë.

Ato tregojnë një veprim që është i përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës.

Orientohen nxënësit/et të lexojnë tabelën e zgjedhimit të foljeve: *punoj, kap, pi*, në kohën e kryer të thjeshtë dhe të vënë re mbaresat që marrin ato gjatë zgjedhimit.

Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve/eve.

- **Veprimtaria e dytë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1, synon që nxënësit/et të lidhin me shigjetë pjesët e fjalive duke përshtatur kështu përemrin vetor me foljen në kohën e kryer të thjeshtë në fjali.

Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Më pas ata/ato punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrin.

Diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimit, duke vënë në dukje përshtatjen e përemrit vetor me foljen në kohën e kryer të thjeshtë në fjali.

- **Veprimtaria e tretë**

Dallo-trego: Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve me shkrim, të nënvizojnë foljet në fjalitë pyetëse dhe në përgjigjet e tyre të përcaktojnë kohën, vetën dhe numrin e foljeve.

shoqëroi → *folje, koha e kryer e thjeshtë, veta e tretë, numri njëjës.*

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Shkëmbejnë fletoret, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën rreth ushtrimit, nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e katërt**

Shkëmbe një problemë: Punë në grupe: Orientohen nxënësit/et të punojnë në grupe. Ata/ato do të shkruajnë në fleta folje në kohën e kryer të thjeshtë dhe do t’i shkëmbejnë me grupet fqinjë për të krijuar fjali me to, duke përcaktuar vetën dhe numrin e tyre.

Përfaqësuesit/et e secilit grup, prezantojnë punën e tyre para klasës.

Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-zgjedhimin e foljeve të rregullta në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore, duke dalluar mbaresat që marrin ato gjatë zgjedhimit;

-dallimin në fjali e tekste të foljeve në kohën e kryer të thjeshtë, duke përcaktuar vetën dhe numrin e tyre;

-përshtatjen e foljes në kohën e kryer të thjeshtë me përemrin vetor, në fjali;

-shkrimin e fjalive duke përdorur folje në kohën e kryer të thjeshtë;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;

-demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj fjali ku të përdorësh foljet: recitoj, këndoj, notoj, udhëtoj, hap, pi, në kohën e kryer të thjeshtë. Trego në cilën vetë dhe numër i ke përdorur foljet në fjali.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Zgjedhjmë foljet në kohën e kryer të thjeshtë (ora II)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar foljet në kohën e kryer të thjeshtë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • zgjedhon foljet e rregullta në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore, duke dalluar mbaresat që marrin ato gjatë zgjedhimit; • dallon, në fjali e tekste, foljet në kohën e kryer të thjeshtë, duke përcaktuar vetën dhe numrin e tyre; • bën dallimin ndërmjet foljeve në kohën e pakryer dhe atyre në kohën e kryer të thjeshtë; • përshtat foljen në kohën e kryer të thjeshtë me përemrin vector, në fjali; • kthen foljet nga koha e tashme në kohën e kryer të thjeshtë; • shkruan fjali në të cilat përdor folje në kohën e kryer të thjeshtë, në vetën dhe numrin e kërkuar; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalët kyçe: -folje; -zgjedhim; -koha e kryer e thjeshtë; -vetë; -numër.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e zgjedhimit të foljeve të rregullta në kohën e kryer të thjeshtë; -fisha me tekste të shkurtra, ku janë përdorur folje të rregullta në kohën e kryer të thjeshtë; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim; -shkrim i drejtuar; -shkëmbe një problemë; -dialog; -punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë, ku nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara prej tyre me foljet e dhëna në kohën e kryer të thjeshtë. <i>Punë në dyshe:</i> Mësuesi/ja shpërndan fleta në të cilat është shkruar një tekst i shkurtër dhe fton nxënësit/et të gjejnë në to foljet në kohën e kryer të thjeshtë. Nxënësit/et punojnë në dyshe. Në përfundim, disa prej dysheve prezantojnë punën e bërë. <i>Diskutim:</i> Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth kuptimit të foljeve në kohën e kryer të thjeshtë, mbaresave që ato marrin gjatë zgjedhimit në të tria vetat e njëjësit dhe shumësit, duke i dalluar ato nga foljet e kohës së pakryer. *Nxiten nxënësit/et të zgjedhjnë folje në kohën e pakryer dhe në kohën e kryer të thjeshtë dhe të tregojnë dallimin që ekziston ndërmjet foljeve në këto kohë. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Shkrim i drejtuar:</i> Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të krijojnë fjali në të cilat të përdorin foljet: <i>mësoj, hap, pi</i>, në kohën e kryer të thjeshtë, në vetën dhe numrin e kërkuar. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Shkëmbejnë fletoret, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Nxënësit/et lexojnë fjalitë me zë para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet të thjeshta drejtshkrimore. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Shkëmbe një problemë:</i> <i>Punë në grupe:</i> Orientohen nxënësit/et të punojnë në grupe. Ata/ato do të shkruajnë në fleta 3 folje në kohën e mësuar dhe do t'i shkëmbejnë me grupet fqinjë për t'i kthyer në kohën e kryer të thjeshtë dhe për të krijuar fjali me to. Përfaqësuesit/et e secilit grup prezantojnë punën e tyre para klasës. Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin. 			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Një zog... një bebe... një botë!		Situata e të nxënit Diskutim: Dashuria e nënës për ty.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon elementet e poezisë si: strofa, vargu, rima; • lexon poezinë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • shpjegon fjalët e reja, duke ndërtuar fjali me to; • shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth poezisë; • bën lidhjen ndërmjet zogut të sapoçelur dhe bebes; • nxjerr mesazhin e poezisë; • vlerëson dashurinë dhe përkushtimin e nënës së tij/saj për të; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -poezi; -strofa; -zog; -bebe; -botë; -i strukur; -belbëzoj.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -foto të nxënësve/eve kur kanë qenë bebe; -videoprojektor; -material i shkurtër filmik për zogjtë se si kujdesen ata për të vegjlit e tyre; -kuriozitete, informacione nga interneti; -enciklopedi; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -vëzhgo-diskuto; -dora e fshehtë; -lexim dhe diskutim; -rishikim në dyshe; -mendo-zbullo; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Vëzhgo-diskuto:</i> Nxënësit/et paraqesin foto ku kanë dalë në krahë të nënave të tyre, kur kanë qenë bebe. Diskutohet rreth tyre. Nxiten nxënësit/et t'u përgjigjen pyetjeve: -Si e vlerësoni kujdesin e nënës për ju? -A e keni parë përkujdesjen e nënës suaj për motrën, apo vëllanë tuaj më të vogël? -Si e vlerësoni sot që jeni më të rritur dashurinë dhe përkushtimin që ju ka dhuruar nëna bashkë me qumështin e gjirit? *Me anë të videoprojektorit, mësuesi/ja paraqet pamje të zogjve me të vegjëlit e tyre. (Në mungesë të videoprojektorit, paraqiten foto). Zhvillohet një diskutim në klasë. -A ju ka rastisur që të shikoni foletë e dallëndysheve me të vegjëlit e tyre, që zakonisht i ngrenë poshtë çatave dhe në ballkone? -A e keni vënë re kujdesin që tregojnë ato për të vegjëlit e tyre? *Mësuesi/ja prezanton titullin e poezisë “Një zog... një bebe... një botë!” dhe autoren e saj Adelina Mamaqi. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Dora e fshehtë:</i> Udhëzohen nxënësit/et në secilin grup të tërheqin nga dora e fshehtë nga një fishë, në të cilat janë shkruar vargjet e poezisë. Secili nga grupet ka për detyrë të renditë vargjet e poezisë, siç duhet. Çdo grup paraqet para klasës në fletë formati renditjen e poezisë. Mësuesi/ja lexon poezinë dhe del se cili nga grupet i ka renditur saktë vargjet. 			

- **Veprimtaria e tretë**

Lexim dhe diskutim: Nxënësit/et vërejnë dhe komentojnë foton në libër, në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.

*Lexim i poezisë nga nxënësit/et në strofa.

Nxiten nxënësit/et të shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre për poezinë, duke iu përgjigjur pyetjeve të bëra nga mësuesi/ja:

-Si u ndjetë pas leximit të kësaj poezie?

-A ju pëlqeu poezia? Pse?

*Diskutohet në klasë për karakteristikat e poezisë (është e shkruar në vargje, përbëhet nga strofa gjashtëshe, me rimë).

*Punohet rubrika “Fjalë të reja”, ku shpjegohen fjalët e fjalorit.

Nxiten nxënësit/et të krijojnë fjali me to.

*Lexim i poezisë me intonacion nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e tretë**

Rishikim në dyshe: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”, ku nxënësit/et do të përzgjedhin alternativat e duhura për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth poezisë.

Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim, shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth detyrës.

- **Veprimtaria e katërt**

Mendo-zbulo: Punë në grupe: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et të zbulojnë se çfarë kanë të përbashkët zogu, bebja dhe gjithë njerëzit e botës, nga ku nxirret mesazhi i poezisë:

Gjithë bota mban në zemër dashurinë e nënës.

- **Veprimtaria e pestë**

Bashkëdisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Zhvillohet një bashkëdisedim me nxënësit/et për dashurinë që kanë ata/ato për nënën e tyre.

*Rubrika “Shkruaj”. Nxiten nxënësit/et të nënvizojnë rrokjet e fjalës së fundit të çdo rreshti. Diskutohet për rimën e përdorur.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-dallimin e elementeve të poezisë, si: strofa, vargu, rima;

-leximin e vjershës rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;

-shpjegimin e fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to;

-shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth poezisë;

-formulimin e mesazhit të poezisë;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie**

Mëso përmendësh poezinë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa VI	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Zgjedhjmë foljen në kohën e ardhme		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar foljet në kohën e ardhme.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • zgjedhon foljet e rregullta në kohën e ardhme të mënyrës dëftore, duke dalluar mbaresat që marrin foljet gjatë zgjedhimit; • gjen në fjali e tekste folje në kohën e ardhme duke përcaktuar vetën dhe numrin e tyre; • përshtat foljen në kohën e ardhme me përemrin vetor, në fjali; • kthen foljet e kohës së tashme në kohën e ardhme; • shkruan fjali me folje në kohën e ardhme, në vetën dhe numrin e kërkuar; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; • bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave. 		Fjalët kyçe: -folje; -veta; -numri; -zgjedhim; -koha e ardhme.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e zgjedhimit të foljeve të rregullta në kohën e ardhme, të mënyrës dëftore; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskuto -nxirr përfundimin; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -dialog; -punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskuto-nxirr përfundimin:</i> Mësuesi/ja paraqet me anë të videoprojektorit një tekst të shkurtër (ose të shkruar në një tabak letre). Fton nxënësit/et ta lexojnë atë, të dallojnë foljet dhe kohën e tyre. Zhvillohet një diskutim në klasë, nën drejtimin e mësuesit/es. Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. *Zhvillohet një diskutim në klasë rreth njohurive që nxënësit/et kanë për foljen në kohën e ardhme, duke u mbështetur edhe në rubrikën “Kujtoj”. <p>Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve/eve, duke vënë në dukje se folja në kohën e ardhme tregon një veprim që pritet të ndodhë në të ardhmen, pra <i>më vonë</i> dhe ka gjithmonë përpara fjalëzat: <i>do të</i>.</p> <p>*Nxiten nxënësit/et të lexojnë zgjedhimin e foljeve: <i>punoj, kap, di</i>, në kohën e ardhme dhe të dallojnë mbaresat që marrin këto folje, kur përdoren në veta të ndryshme në kohën e ardhme.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve me shkrim dhe të nënvizojnë foljet në fjalitë pyetëse dhe në përgjigjet e tyre. Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të plotësojnë fjalitë me foljen e duhur në kohën e ardhme, duke përshtatur kështu foljen me përemrin vetor. Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të kthejnë foljet në fjali, në kohën e ardhme. Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Nxënësit/et punojnë individualisht në libër me laps. Pasi përfundojnë punën, shkëmbejnë librat për të kontrolluar punën e njëri-tjetrit. Mësuesi/ja nxit diskutimin në klasë rreth ushtrimeve. 			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Shkrim i drejtuar:</i> Ushtrimi 4. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të shkruajnë fjali, në të cilat të përdorin foljet: shkruaj, mbyll, zë në kohën e ardhme, në vetën dhe numrin e kërkuar. Ata/ato punojnë individualisht në fletore. Shkëmbejnë fletoret për të kontrolluar njëri-tjetrin. Lexojnë fjalitë para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime të thjeshta drejtshkrimore. • Veprimtaria e katërt <i>Dialog:</i> Nxiten nxënësit/et që në dyshe të dialogojnë me njëri-tjetrin duke përdorur folje në kohën e ardhme. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. • Vlerësimi bëhet për: -zgjedhimin e foljeve të rregullta në kohën e ardhme të mënyrës dëftore, duke dalluar mbaresat që marrin foljet gjatë zgjedhimit; -dallimin në fjali e tekste të foljeve në kohën e ardhme, duke përcaktuar vetën dhe numrin e tyre; -përshtatjen e foljes në kohën e ardhme me përemrin vetor, në fjali; -kthimin e foljeve nga koha e tashme në kohën e ardhme, në fjali; -shkrimin e fjalive me folje në kohën e ardhme, në vetën dhe numrin e kërkuar; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve; -demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime; -bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave. • Detyrë shtëpie Shkruaj një tekst me temë “Planet e mia dhe të familjes për pushimet verore” me 7-8 fjali, ku të përdorësh folje në kohën e ardhme.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Gjumi i ëmbël		Situata e të nxënit Bisedë për gjumin dhe si e përjetojmë atë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon elementet e poezisë si: strofa, vargu; • lexon poezinë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • shpjegon fjalët e reja, duke ndërtuar fjali me to; • shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth poezisë; • përshkruan ndjesitë e tij/saj për meditimin e fëmijës së vogël për gjumin dhe dëshirën që ta shohë atë se si vjen; • tregon të përbashkëtat që mund të ketë ai me personazhin e vargjeve; • gjykon për rëndësinë e gjumit për fëmijët; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -poezi; -strofa; -gjumi; -terr.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - bisedë;
 - lexim dhe diskutim;
 - rishikim në dyshe;
 - mendo-zbulo;
 - bashkëbisedim;
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Bisedë: Zhvillohet një bisedë me nxënësit/et për gjumin, duke iu drejtuar pyetjet:

- Pse ju thonë prindërit kur shkoni për të fjetur “Gjumë të ëmbël”?
 - A keni menduar se si ju vjen gjumi?
 - A do të dëshironit ju ta shihnit gjumin?
 - Sot do të njohim një personazh, bashkëmoshatar i juaj, që ëndërron të shohë një herë se si vjen gjumi.
- Mësuesi/ja prezanton titullin e poezisë “Gjumi i ëmbël”.

- **Veprimtaria e dytë**

Lexim dhe diskutim: Nxënësit/et vërejnë dhe komentojnë foton në libër, në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.

- *Lexim i poezisë nga nxënësit/et në strofa.
- Nxiten nxënësit/et të shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre për poezinë.
- Si u ndjetë pas leximit të kësaj poezie?
- A ju pëlqeu poezia? Pse?
- *Diskutohet në klasë për karakteristikat e poezisë.
- *Punohet rubrika “Fjalë të reja”.
- *Lexim i poezisë me intonacion nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e tretë**

Rishikim në dyshe: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”, ku nxënësit/et do të gjejnë alternativat e sakta. Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth detyrës.

- **Veprimtaria e katërt**

Mendo-zbulo: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et të zbulojnë kuptimin e vargjeve:

Kur të vjen gjumi

Gjumi

Gjuuumii

Gjuuuuummmi.

- Pse mendoni që janë shkruar në këtë formë?

Nxënësit/et diskutojnë në dyshe rreth kuptimit të vargjeve dhe më pas ndajnë mendimet e tyre me gjithë klasën.

- **Veprimtaria e pestë**

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Duke marrë shkas nga përpjekjet e djalit të poezisë për të kapur gjumin, zhvillohet një bashkëbisedim rreth përvojave të ngjashme individuale me gjumin. Nxiten nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve:

- Sa orë gjumë bëni çdo natë?
- Ç’dini për rëndësinë e gjumit në rritjen e fëmijëve?

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-dallimin e elementeve të poezisë si: strofa, vargu;

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Zgjedhjmë foljen jam (ora I)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar format e ndryshme që merr folja <i>jam</i> gjatë zgjedhimit.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • zgjedhon foljen <i>jam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; • dallon në fjali e tekste foljen <i>jam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme, duke përcaktuar vetën dhe numrin e saj; • përshtat foljen <i>jam</i> me përemrin vetor, në fjali; • shkruan fjali në të cilat përdor foljen <i>jam</i>, në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • vlerëson punën e shokëve e të shoqëve; • demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; • bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave. 		Fjalët kyçe: -folja: <i>jam</i> ; -zgjedhim; -koha e tashme; -koha e pakryer; -koha e kryer e thjeshtë; -koha e ardhme; -vetë; -numër.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e zgjedhimit të foljes <i>jam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; -fisha me fjali e tekste të shkurtra, ku është përdorur folja <i>jam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim; -dallo-trego; -rishikim në dyshe; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimin. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë fjalitë e shkruara në dërrasë të zezë të cilat janë të dhëna edhe në libër. <i>Unë jam Eliza, kurse ai është Ivesti. Ne jemi në klasë të katërt.</i> Nxiten nxënësit/et të tregojnë foljet e përdorura në këto fjali. Nxënësit/et shkëmbejnë mendimet e tyre në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën. Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t'u lindin nxënësve/eve. *Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të lexojnë tabelën e zgjedhimit të foljes <i>jam</i> në kohën e tashme, në kohën e pakryer, në kohën e kryer të thjeshtë, në kohën e ardhme. Zhvillohet një diskutim nën drejtimin e mësuesit/es për zgjedhimin e foljes <i>jam</i> në kohë të ndryshme. *Vihet në dukje se folja <i>jam</i> zgjedhohet në një mënyrë të veçantë. • Veprimtaria e dytë <i>Dallo-trego:</i> Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të dallojnë foljen <i>jam</i> në tekstin e dhënë dhe të përcaktojnë kohën në të cilën është përdorur. Nxënësit/et lexojnë tekstin, nënvizojnë foljen <i>jam</i>, diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es rreth kohëve në të cilat është përdorur folja <i>jam</i> në fjali. • Veprimtaria e tretë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të tregojnë se në cilën vetë, numër dhe kohë është përdorur folja <i>jam</i> në fjalitë e dhëna. Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Shkëmbejnë librat, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën rreth ushtrimit, nën drejtimin e mësuesit/es. 			

- **Veprimtaria e katërt**

Shkëmbe një problemë: Punë në grupe: Orientohen nxënësit/et të punojnë në grupe. Ata/ato do të shkruajnë në fleta foljen jam në kohët e mësuara, në veta dhe në numra të ndryshëm dhe do t'i shkëmbejnë me grupet fqinjë për të krijuar fjali dhe për të dalluar kohën, vetën, numrin në të cilat është përdorur folja jam.

Përfaqësuesit/et e secilit grup prezantojnë punën e tyre para klasës.

Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- zgjedhimin e foljes jam në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme.
- dallimin në fjali e tekste të foljes jam në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme, duke përcaktuar vetën dhe numrin e saj;
- përshtatjen e foljes jam me përemrin vector, në fjali;
- shkrimin e fjalive në të cilat përdor foljen jam, në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj fjali ku të përdorësh foljen jam në:

- kohën e tashme, veta e parë, numri shumë;
- kohën e pakryer, veta e dytë, numri njëjës;
- kohën e kryer të thjeshtë, veta e parë, numri njëjës;
- kohën e ardhme, veta e tretë, numri shumë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Zgjedhjmë foljen jam (ora II)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar format e ndryshme që merr folja <i>jam</i> gjatë zgjedhimit.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • zgjedhon foljen <i>jam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; • dallon në fjali e tekste foljen <i>jam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme, duke përcaktuar vetën dhe numrin; • plotëson fjalitë me foljen <i>jam</i> në kohën e kërkuar, duke e përshtatur atë me kryefjalën; • shkruan fjali duke përdorur foljen <i>jam</i>, në kohët e mësuara, në vetën dhe numrin e kërkuar; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • demonstroi besim dhe vullnet në kryerjen e detyrave; • bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave. 		Fjalët kyçe: -folje; -jam; -zgjedhim; -koha e tashme; -koha e pakryer; -koha e kryer e thjeshtë; -koha e ardhme; -vetë; -numër.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e zgjedhimit të foljes <i>jam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; -fisha me fjali e tekste të shkurtra, ku është përdorur folja <i>jam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim;
 - rishikim në dyshe;
 - shkrim i drejtuar;
 - punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë, ku nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara prej tyre.

**Punë në dyshe:* Mësuesi/ja shpërndan fleta në të cilat është shkruar një tekst i shkurtër (ose 2-3 fjali të ndryshme) dhe fton nxënësit/et të gjejnë në to foljen *jam*, duke përcaktuar kohën, vetën, numrin e tyre. Nxënësit/et punojnë në dyshe.

Në përfundim, disa prej dysheve prezantojnë punën e bërë.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth zgjedhimit të foljes *jam* në kohët e mësuara.

- **Veprimtaria e dytë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 3 ka karakter plotësues. Nxiten nxënësit/et të plotësojnë fjalitë me foljen *jam* në kohën e kërkuar, duke e përshtatur atë me kryefjalën në fjali.

Nxënësit/et punojnë ndividualisht në libër. Shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimit me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 4 synon që nxënësit/et të krijojnë fjali në të cilat të përdorin foljen *jam* në kohën, vetën dhe numrin e kërkuar.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.

Shkëmbejnë fletoret, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Nxënësit/et lexojnë fjalitë me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime të thjeshta drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-zgjedhimin e foljes *jam* në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme.

-dallimin në fjali e tekste të foljes *jam* në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme, duke përcaktuar vetën dhe numrin e saj;

-plotësimin e fjalive me foljen *jam* në kohën e kërkuar, duke e përshtatur atë me kryefjalën;

-shkrimin e fjalive duke përdorur foljen *jam*, në kohët e mësuara, në vetën dhe numrin e kërkuar;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;

-demonstrimin e besimit dhe vullnetit në kryerjen e detyrave;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj për një udhëtim që ke bërë në një vend turistik me 7-8 fjali, ku të përdorësh foljen *jam* në kohët e mësuara.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Më prit se do të vij!		Situata e të nxënit Nxënësit/et tregojnë rreth fotove ku kanë dalë gjatë pushimeve verore, duke treguar shkurtimisht se pse kanë preferuar të përzgjedhin t'i kalojnë ato në det, mal, fshat etj.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon elementet e poezisë si: strofa, vargu, rima; • lexon poezinë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • demonstroi të kuptuarit e fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to; • u përgjigjet pyetjeve rreth poezisë; • shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth poezisë; • flet për bukurinë dhe magjinë e pushimeve në natyrë; • shpjegon domethënien e vargjeve të poezisë; • përshkruan ndjesitë e tij/saj për detin; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -poezi; -strofa; -puhi; -stërkalë; -qelibar.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -foto të fëmijëve ku kanë dalë në plazh; -pamje të bregdetit në stinën e verës; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -mjedisi.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -bisedë; -dora e fshehtë; -lexim dhe diskutim; -rishikim në dyshe; -mendo-zbulo; -bashkëbisedim; -pesëvargësh; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Mësuesi/ja i ka porositur nxënësit/et të sjellin foto ku kanë dalë gjatë pushimeve verore. Nxiten nxënësit/et t'i paraqesin ato para klasës, duke treguar shkurtimisht, se pse kanë preferuar të përzgjedhin t'i kalojnë pushimet verore në det, mal, fshat, etj... Mësuesi/ja prezanton titullin e poezisë “Më prit se do të vij” dhe autorin e saj Odhise Grillo. Mësuesi/ja jep disa të dhëna për poetin: Odhise Grillo lindi më 21 mars 1932, në Vuno të Himarës dhe vdiq më 24 shtator të vitit 2003, në Tiranë. <i>Grillo ishte ndër shkrimtarët më të njohur për fëmijë, i cili dha një kontribut të madh për letërsinë shqiptare.</i> <i>Disa nga krijimet e tij për fëmijë janë:</i> <i>Vjersha “Shtatë ngjyrat”</i> <i>Vjersha dhe poema “Një zog dhe një lule”</i> <i>Përralla “Gabimet e Veshkaushit”</i> <i>Përralla “Shokët e Veshkaushit”</i> <i>Përralla “Miqte e Veshkaush Llapushit”</i> <i>Vjersha dhe poema “Zërat e fëmijërisë”</i> <i>Rikrijim për të vegjël “Historia e Skënderbeut”, etj...</i> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Dora e fshehtë:</i> Udhëzohen nxënësit/et në secilin grup të tërheqin nga dora e fshehtë nga një fishë, në të cilat janë shkruar vargjet e poezisë. Secili nga grupet, ka për detyrë të renditë vargjet e poezisë, siç duhet. Çdo grup paraqet para klasës në fletë formati, renditjen e poezisë. Mësuesi/ja lexon poezinë dhe del se cili nga grupet i ka renditur saktë vargjet. 			

- **Veprimtaria e tretë**

Lexim dhe diskutim: Nxënësit/et vërejnë dhe komentojnë foton në libër, në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.

*Lexim i poezisë nga nxënësit/et në strofa.

Nxiten nxënësit/et të shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre për poezinë.

-Si u ndjetë pas leximit të kësaj poezie?

-A ju pëlqeu poezia? Pse?

*Punohet rubrika “Fjalë të reja”, ku shpjegohen fjalët: puhi, stërkala, qelibar.

Nxiten nxënësit/et të krijojnë fjali me to.

*Lexim i poezisë me intonacion nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e katërt**

Rishikim në dyshe: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”, ku nxënësit/et do t’u përgjigjen pyetjeve:

-Nga sa vargje përbëhet kjo poezi?

-Në sa strofa janë të organizuara ato?

-Për cilën periudhë të vitit flet kjo poezi? Nga cilët merr ftesa poeti në katër strofat e para?

-Ku vendos të shkojë në strofën e fundit poeti? Pse?

- **Veprimtaria e pestë**

Mendo-zbulo: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et në dyshe, të gjejnë në poezi dhe të tregojnë vargjet që rimojnë dhe të shpjegojnë domethënien e vargjeve “Vendlindja ime më thërret!”.

- **Veprimtaria e gjashtë**

Bashkëdisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Zhvillohet një bashkëbisedim me nxënësit/et rreth përzgjedhjeve që ata bëjnë për vendet që e ftojnë poetin për të pushuar.

- **Veprimtaria e shtatë**

Pesëvargësh: Nxiten nxënësit/et të krijojnë në grupe pesëvargësha për detin.

deti

i madh i kaltër

oshëtin dallgëzon freskon

Deti na fton çdo verë.

kaltërsi

Përfaqësuesit/et e grupeve lexojnë pesëvargëshat.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-dallimin e elementeve të poezisë si: strofa, vargu, rima;

-leximin e poezisë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;

-demonstrimin e të kuptuarit të fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to;

-përgjigjet e pyetjeve rreth poezisë;

-shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth poezisë;

-shpjegimin e domethënies së vargjeve të poezisë;

-përshkrimin e ndjesive të tij/saj për detin;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

- **Detyrë shtëpie:** Mëso përmendësh poezinë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Zgjedhjmë foljen kam (ora I)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar format e ndryshme që merr folja <i>kam</i> gjatë zgjedhimit.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • zgjedhon foljen <i>kam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; • dallon në fjali e tekste foljen <i>kam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme, duke përcaktuar vetën dhe numrin e saj; • përshtat foljen <i>kam</i> me përemrin vetor, në fjali; • shkruan fjali në të cilat përdor foljen <i>kam</i>, në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • demonstron pavarësi në mendime dhe veprime; • bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave. 		Fjalët kyçe: -folje; -kam; -zgjedhim; -koha e tashme; -koha e pakryer; -koha e kryer e thjeshtë; -koha e ardhme; -vetë; -numër.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e zgjedhimit të foljes <i>kam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; -fisha me fjali, apo tekste të shkurtra, ku është përdorur folja <i>kam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim; -dallo-trego; -rishikim në dyshe; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë fjalitë e shkruara në dërrasë të zezë, të cilat janë të dhëna edhe në libër. <i>Unë kam një libër me tregime, kurse ti ke një libër me përralla.</i> Nxiten nxënësit/et të tregojnë foljet e përdorura në këto fjali (<i>kam, ke</i>). Nxënësit/et shkëmbejnë mendimet e tyre në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën. Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t'u lindin nxënësve/eve. *Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të lexojnë tabelën e zgjedhimit të foljes <i>kam</i> në kohën e tashme, në kohën e pakryer, në kohën e kryer të thjeshtë, në kohën e ardhme. Zhvillohet një diskutim nën drejtimin e mësuesit/es për zgjedhimin e foljes <i>kam</i> në kohë të ndryshme. Vihet në dukje se folja <i>kam</i> zgjedhohet në një mënyrë të veçantë. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Dallo-trego:</i> Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të dallojnë foljen <i>kam</i> në tekstin e dhënë dhe të përcaktojnë kohën në të cilën është përdorur. Nxënësit/et lexojnë tekstin nënvizojnë foljen <i>kam</i>, diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es rreth kohëve, në të cilat është përdorur folja <i>kam</i> në fjali. • Veprimtaria e tretë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të përcaktojnë vetën, numrin dhe kohën e foljes <i>kam</i> në fjalitë e dhëna. Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Shkëmbejnë librat, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën rreth ushtrimit, nën drejtimin e mësuesit/es. 			

- **Veprimtaria e katërt**

Shkëmbe një problemë: Punë në grupe: Orientohen nxënësit/et të punojnë në grupe. Ata/ato do të shkruajnë në fleta foljen kam në kohët e mësuara dhe do t'i shkëmbejnë me grupet fqinje për të dalluar kohën, vetën dhe numrin e tyre dhe për të krijuar fjali me to.

Përfaqësuesit/et e secilit grup prezantojnë punën e tyre para klasës.

Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-zgjedhimin e foljes kam në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;
-dallimin në fjali e tekste të foljes kam në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme, duke përcaktuar vetën dhe numrin e saj;

-përshtatjen e foljes kam me përemrin vetor në fjali;

-shkrimin e fjalive në të cilat përdor foljen kam, në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë e të ardhme;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;

-demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj fjali ku të përdorësh foljen kam në:

- a) kohën e tashme, veta e dytë, numri shumë;
- b) kohën e pakryer, veta e parë, numri njëjës;
- c) kohën e kryer të thjeshtë, veta e tretë, numri shumë;
- d) kohën e ardhme, veta e tretë, numri njëjës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Zgjedhjmë foljen <i>kam</i> (ora II)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar format e ndryshme që merr folja <i>kam</i> gjatë zgjedhimit.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • zgjedhon foljen <i>kam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; • dallon në fjali e tekste foljen <i>kam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme, duke përcaktuar vetën dhe numrin e saj; • plotëson fjalitë me foljen <i>kam</i> në kohën e kërkuar duke e përshtatur atë me kryefjalën; • shkruan fjali duke përdorur foljen <i>kam</i>, në kohët e mësuara, në vetën dhe numrin e kërkuar; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave. 		Fjalët kyçe: -folje; -kam; -zgjedhim; -koha e tashme; -koha e pakryer; -koha e kryer e thjeshtë; -koha e ardhme; -vetë; -numër.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e zgjedhimit të foljes <i>kam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; -fisha me fjali e tekste të shkurtra, ku është përdorur folja <i>kam</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim;
 - rishikim në dyshe;
 - shkrim i drejtuar;
 - punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë, ku nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara prej tyre.

**Punë në dyshe:* Mësuesi/ja shpërndan fleta, në të cilat është shkruar një tekst i shkurtër, apo 2-3 fjali të ndryshme dhe fton nxënësit/et të gjejnë në to, foljen *kam* duke përcaktuar kohën, vetën, numrin e saj.

Nxënësit/et punojnë në dyshe.

Në përfundim, disa prej dysheve, prezantojnë punën e bërë.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth zgjedhimit të foljes *kam* në kohët e mësuara.

- **Veprimtaria e dytë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 2 ka karakter plotësues. Nxiten nxënësit/et të plotësojnë fjalitë me foljen *kam* në kohën e kërkuar, duke e përshtatur atë me kryefjalën.

Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimit me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të krijojnë fjali në të cilat të përdorin foljen *kam* në kohën, vetën dhe numrin e kërkuar.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Shkëmbejnë fletoret, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Nxënësit/et lexojnë fjalitë me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime të thjeshta drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-zgjedhimin e foljes *kam* në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;

-dallimin në fjali e tekste të foljes *kam* në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme, duke përcaktuar vetën dhe numrin e saj;

-plotësimin e fjalive me foljen *kam* në kohën e kërkuar duke e përshtatur atë me kryefjalën;

-shkrimin e fjalive duke përdorur foljen *kam*, në kohët e mësuara, në vetën dhe numrin e kërkuar;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;

-demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj një tekst të shkurtër me 7-8 fjali me temë “Pasioni im për lulet”, ku të përdorësh foljen *kam* në kohët e mësuara.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Nisu! (ora I)		Situata e të nxënët Heroi yt i preferuar, si model në jetë.	
Rezultatet e të nxënët Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon elementet e poezisë si: strofa, vargu, rima; • lexon poezinë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • demonstroi të kuptuarit e fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to; • shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth poezisë; • arsyeton se pse individët e suksesshëm, shërbejnë si modele për shoqëritë, kombet, popujt; • shpjegon domethënien e vargjeve të poezisë; • nxjerr mesazhin që përcjell poezia; • gjykon se rrugët e lehta dhe pritshmëritë, nuk na çojnë kurrë drejt suksesit të menduar; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -poezi; -strofa; -çirret; -shtati; -çaj; -Më priftë e mbara!	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -vendimmarrje morale.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim paraprak; -dora e fshehtë; -lexim dhe diskutim; -rishikim në dyshe; -analizë; -mendo - nxirr mesazhin; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim paraprak:</i> Zhvillohet një diskutim me nxënësit/et. Mësuesi/ja u drejton pyetjet: -Kush është hero i juaj i preferuar nga librat që keni lexuar, përrallat që keni dëgjuar, apo filmat që keni parë? -Çfarë sakrificash ka bërë ai për t'ia dalë mbanë vështirësive, për të patur sukses duke përballuar rreziqet? -Si i ka realizuar ai këto suksese, duke ndenjur, apo duke u përpjekur për të bërë të pamundurën të mundur? -A do të ishte ky frymëzuesi juaj në jetë? Pse? Nxiten nxënësit/et të japin mendimet e tyre. Mësuesi/ja prezanton titullin e poezisë “Nisu!” dhe autoren e saj, Sesil Shabo. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Dora e fshehtë:</i> Udhëzohen nxënësit/et në secilin grup, të tërheqin nga dora e fshehtë nga një fishë, në të cilat janë shkruar vargjet e poezisë. Secili nga grupet ka për detyrë të renditë vargjet e poezisë, siç duhet. Çdo grup paraqet para klasës në fletë formati, renditjen e poezisë. Mësuesi/ja lexon poezinë dhe del se cili nga grupet i ka renditur saktë vargjet. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Lexim dhe diskutim:</i> Nxënësit/et vërejnë dhe komentojnë pamjen në libër, në dyshe dhe më pas me gjithë klasën. *Lexim i poezisë nga nxënësit/et në strofa. Nxiten nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre për poezinë. -Cili është mendimi i parë që ju vjen në mendje pasi lexuat këtë poezi? *Diskutohet në klasë për karakteristikat e poezisë (është e shkruar në vargje, përbëhet nga strofa katërshe, me rimë). *Punohet rubrika “Fjalë të reja”, ku shpjegohen fjalët dhe shprehjet: çirret, shtati, çaj, Më priftë e mbara! Nxiten nxënësit/et të krijojnë fjali me to. *Lexim i poezisë me intonacion nga nxënësit/et. 			

- **Veprimtaria e katërt**

Rishikim në dyshe: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et gjykojnë rreth porosive që poetja i jep fëmijës në poezi, duke gjetur alternativën e saktë.

Nxënësit/et punojnë individualisht.

Në përfundim, shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es, rreth detyrës.

- **Veprimtaria e pestë**

Analizë: Punë në grupe: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et të zbulojnë kuptimin e vargjeve të poezisë duke përzgjedhur alternativën e duhur.

Përfaqësuesit/et e secilit grup prezantojnë punën e tyre para klasës.

- **Veprimtaria e gjashtë**

Mendo - nxirr mesazhin: Nxënësit/et në grupe nxjerrin mesazhin që përcjell poezia:

Mesazhi: Suksesi arrihet përmes punës së pandërprerë dhe përballimit me guxim të vështirësive të njëpasnjëshme.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-dallimin e elementeve të poezisë si: strofa, vargu, rima;

-leximin e poezisë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;

-shpjegimin e fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to;

-shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth poezisë;

-arsyetimin se pse individët e suksesshëm shërbejnë si modele për shoqëritë, kombet, popujt;

-shpjegimin e domethënies së vargjeve të poezisë;

-formulimin e mesazhit që përcjell poezia;

-gjykimin se rrugët e lehta dhe pritshmëritë, nuk na çojnë kurrë drejt suksesit të menduar;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

- **Detyrë shtëpie:** Rubrika “Shkruaj”

Mëso përmendësh poezinë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Nisu! (ora II)		Situata e të nxënit Vargjet që më pëlqejnë më shumë. Recitim dhe koment i tyre.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • reciton poezinë me ndjenjë; • tregon si e kupton titullin e poezisë; • përshkruan si ka vepruar për të kapërcyer situatat e vështira në të cilat është ndodhur; • gjykon se rrugët e lehta dhe pritshmëritë nuk na çojnë kurrë drejt suksesit të menduar; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; • pranon dhe tregon respekt për mendimet dhe idetë e të tjerëve rreth poezisë; • vlerëson recitimet e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -poezi; -strofa; -çirret; -shtati; -çaj; -Më priftë e mbara!	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -vendimmarrje morale.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - lexo-trego;
 - tryezë e rrumbullakët;
 - bashkëbisedim;
 - debat i argumentuar;
 - konkurs;
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Lexo-trego: Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit/et lexojnë vargjet e poezisë që u pëlqejnë më shumë dhe tregojnë arsyen e përzgjedhjes së tyre.

Lexim i poezisë nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e dytë**

Tryezë e rrumbullakët: Punohet rubrika “Reflektoj”. Secili nxënës/e, në grup, shkruan mendimin e tij/saj me një fjali se si e kupton titullin e kësaj poezie. Fletën e palos dhe ia jep shokut/shoqes që ka pranë. Në përfundim, lexohen fjalitë e shkruara nga nxënësit/et për secilin grup.

- **Veprimtaria e tretë**

Bashkëbisedim: Zhvillohet një bashkëbisedim me nxënësit/et rreth situatave që u janë dukur të vështira dhe se si kanë vepruar për t’i kapërcyer ato.

- **Veprimtaria e katërt**

Debat i argumentuar: Zhvillohet një debat me nxënësit/et:

-Në rast se do të gjendeshe para një vështirësie, apo pengese, si do ta gjeje zgjidhjen:

1. duke kërkuar ndihmë;
2. duke u përballur me vështirësitë;
3. duke u tërhequr.

-Argumento se cila rrugë në jetë do të na çojë drejt suksesit të qëndrueshëm:

1. duke gjetur justifikime.
2. duke ua lënë fajin të tjerëve.
3. duke qenë optimist.
4. duke marrë me guxim përgjegjësi personale.

- **Veprimtaria e pestë**

Konkurs: Nxënësit/et recitojnë poezinë përmendësh. Një juri e përbërë nga 2 nxënës/e dhe mësuesi/ja, japin çmimet për 3 vendet e para.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-recitimin e poezisë me ndjenjë;
-tregimin si e kupton titullin e poezisë;
-përshkrimin si ka vepruar për të kapërcyer situatat e vështira në të cilat është ndodhur;
-bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
-vlerësimet për recitimet e shokëve e të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Drejtshkrimi i foljeve		Situata e të nxënit Shkrimi i foljeve në kohët e mësuara sipas rregullave drejtshkrimore.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • diskuton rreth drejtshkrimit të foljeve të rregullta të mënyrës dëftore, në kohët e mësuara; • dallon ndryshimet që pësojnë foljet: <i>marr, jap, dal, shoh</i>, kur përdoren në kohën e kryer të thjeshtë; • përdor foljet e rregullta në kohët e mësuara në fjali, duke zbatuar rregullat drejtshkrimore; • shkruan fjali me folje në kohën, vetën dhe numrin e kërkuar; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • vlerëson përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalët kyçe: -folje; -drejtshkrim; -koha e tashme; -koha e pakryer; -koha e kryer e thjeshtë; -koha e ardhme; -folje që mbarojnë me -j; -folje që mbarojnë me bashkëtingëllore; -folje që mbarojnë me zanore.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e zgjedhimit të foljeve që mbarojnë me -j, me bashkëtingëllore, me zanore në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim; -lexim, përmbledhje në dyshe; -të nxënësit me këmbime; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Diskutim:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të thonë folje që mbarojnë me -j, me bashkëtingëllore dhe zanore. Më pas, ata/ato do të zgjedhjnë nga një folje për çdo rast në kohët e mësuara, duke i shkruar në tabakë letre. Nxënësit/et ndahen në 3 grupe. Ndahen detyrat për çdo grup.</p> <p>Grupi I do të zgjedhë një folje që mbaron me -j.</p> <p>Grupi II do të zgjedhë një folje që mbaron me bashkëtingëllore.</p> <p>Grupi III do të zgjedhë një folje që mbaron me zanore.</p> <p>Përfaqësuesit/et e secilit grup, paraqesin zgjedhimin e këtyre foljeve para klasës. Nxiten nxënësit/et të dallojnë mbaresat që marrin foljet kur përdoren në veta të ndryshme në kohën e tashme, të pakryer, të kryer e thjeshtë, të ardhme.</p> <p>Hapet një diskutim rreth drejtshkrimit të këtyre foljeve, nën drejtimin e mësuesit/es.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Lexim, përmbledhje në dyshe:</i> Nxënësit/et në dyshe, lexojnë dhe përmbledhin njohuritë për drejtshkrimin e foljeve në kohët e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme, në rubrikën “Mbaj mend”.</p> <p>Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth drejtshkrimit të foljeve në kohët e mësuara, duke vënë theksin se:</p>			

1. Koha e tashme

Foljet si: *mësoj, lexoj, bëj, punoj, blej* shkruhen me -j në fund në vetën e parë, numri njëjës.
mësoj dhe jo ~~mësoj~~ *bëj* dhe jo ~~bëj~~ *blej* dhe jo ~~ble~~ *laj* dhe jo ~~lanj~~

Foljet si: *pi, di, fle* shkruhen pa -j në fund në vetën e parë, numri njëjës.

pi dhe jo *pij* *fle* dhe jo *flej*

2. Koha e pakryer

Foljet si: *pi, di, fle* shkruhen me -j.

pija dhe jo ~~pinja~~ *flija* dhe jo ~~flija~~

3. Koha e kryer e thjeshtë

Foljet si: *mësoj, lexoj, punoj*, shkruhen me -i në fund në vetën e tretë, numri njëjës.

ai mësoi dhe jo ~~mësovia~~ *i lexoi* dhe jo ~~lexovi~~

Foljet si: *marr, dal, jap*, shoh kur zgjedhohen në kohën e kryer të thjeshtë, ndryshojnë shumë.

marr-mora dhe jo ~~marr~~ *dal-dola* dhe jo ~~dolla~~ *jap-dhashë* *shoh-pashë*

4. Koha e ardhme

Foljet që mbarojnë me zanore në kohën e ardhme, shkruhen pa -j.

do të hamë dhe jo ~~do të hajmë~~ *do të flenë* dhe jo ~~do të flejnë~~

• **Veprimtaria e tretë**

Të nxënësit me këmbime, grupet e ekspertëve: Nxënësit/et grupohen në grupe me nga 4 individë dhe secilit u caktohet nga një numër nga 1-4.

Nxënësve/eve u ndahen detyrat:

Nxënësit/et me numrin 1 do të punojnë ushtrimin 1, ku do të përzgjedhin foljen e duhur për të plotësuar fjalitë.

Nxënësit/et me numrin 2 do të punojnë ushtrimin 2, ku do të dallojnë në grupet e foljeve, foljen që është futur gabimisht.

Nxënësit/et me numrin 3 do të punojnë ushtrimin 3, ku do të shkruajnë përgjigje për pyetjet e dhëna, duke nënvizuar foljet në to.

Nxënësit/et me numrin 4 do të punojnë ushtrimin 4, ku do të plotësojnë foljet me shkronjat që mungojnë, duke përcaktuar kohën e secilës prej tyre.

Nxënësit/et sipas numrave që kanë do të rigrupohen dhe do të diskutojnë me njëri-tjetrin rreth ushtrimeve. Pas kryerjes së detyrave, ata/ato do të shkojnë në grupet fillestare ku do t'ua shpjegojnë detyrën edhe anëtarëve të tjerë të grupit.

Në fund, diskutohet rreth çdo detyre me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve

• **Veprimtaria e katërt**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 5 nxënësit/et do të krijojnë fjali me foljet: shkruaj, pi, mbyll, zë, hap, në kohën, vetën dhe numrin e kërkuar.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.

Nxiten ata/ato të lexojnë fjalitë e krijuara, duke vënë theksin te drejtshkrimi i foljeve.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

• **Vlerësimi bëhet për:**

-diskutimin rreth drejtshkrimit të foljeve të rregullta të mënyrës dëftore, në kohët e mësuara;

-dallimin e ndryshimeve që pësojnë foljet: marr, jap, dal, shoh, kur përdoren në kohën e kryer të thjeshtë;

-përdorimin e foljeve të rregullta në kohët e mësuara në fjali, duke zbatuar rregullat drejtshkrimore;

-shkrimin e fjalive me folje në kohën, vetën dhe numrin e kërkuar;

-qortimet drejtshkrimore që bëhen me ndihmën e mësuesit/es;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;

-vlerësimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

• **Detyrë shtëpie**

Shkruaj fjali në të cilat të përdorësh foljet:

mësoj, koha e tashme, veta e tretë, numri njëjës;

blej, koha e tashme, veta e dytë, numri njëjës;

dal, koha e kryer e thjeshtë, veta e parë, numri shumës;

fle, koha e pakryer, veta e dytë, numri njëjës;

ha, koha e ardhme, veta e parë, numri shumës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Dëgjojmë Poetja e fëmijëve		Situata e të nxënit Dëgjim dhe diskutim i disa poezive të poetes për fëmijë Adelina Mamaqi.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • ndjek me vëmendje informacionin që dëgjon, duke mbajtur shënime të shkurtra për çështje kryesore; • demonstroi të dëgjuar të qëllimshëm në kryerjen e detyrave; • lidh vargjet e poezive të poetes Adelina Mamaqi, me titullin e tyre; • diskuton rreth tematikave për të cilat ka shkruar Adelina Mamaqi; • tregon për poezinë e parapëlqyer prej tij/saj të poetes Adelina Mamaqi, duke treguar arsyen e përzgjedhjes; • reciton me ndjenjë poezinë e preferuar të poetes Adelina Mamaqi; • pranon dhe tregon respekt ndaj ideve dhe mendimeve të shokëve/shoqeve rreth poezive të Adelina Mamaqi; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. 		Fjalë kyçe: -poezi; -poezia “Qukapik o qukapik” -poezia “Pyetje për mamin” -poezia “Orkestra gazmore” -poezia “Shoku im i shtrenjtë” -poezia “Lulja dhe zogu” -poezia “Libri”	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -libra me poezi të poetes Adelina Mamaqi; -CD, magnetofon; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -dëgjo-diskuto; -recitim i poezive; -bashkëbisedim; -diskutim; -dramatizim; -punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Dëgjo-diskuto:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et (ushtrimi 1), të dëgjojnë nga magnetofoni, strofat e para të poezive. Orientohen nxënësit/et të diskutojnë me njëri-tjetrin, për të kujtuar titullin e poezive nga janë shkëputur vargjet. Nxënësit/et punojnë individualisht për të lidhur vargjet me titullin e poezisë nga janë shkëputur. Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën për të kujtuar autoren e këtyre poezive. *Nxiten nxënësit/et të dëgjojnë disa informacione për poeten Adelina Mamaqi duke mbajtur shënime për çështje kryesore (ushtrimi 2). *Nxënësit diskutojnë në grup rreth tematikave për të cilat ka shkruar ajo dhe mesazheve që ka përcjellë nëpërmjet shkrimeve të saj, duke i ilustruar me shembuj konkretë (ushtrimi 3, 4). <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Recitim i poezive:</i> Ushtrimi 5. Nxiten nxënësit/et, të tregojnë poezinë që i pëlqen më shumë të poetes Adelina Mamaqi, duke treguar arsyen e përzgjedhjes dhe ta recitojnë atë. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Bashkëbisedim:</i> Ushtrimi 6. Nxënësit/et bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin se për çfarë do të donin të shkruante poetja në ditët e sotme, duke treguar edhe arsyen pse mendojnë kështu. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Diskutim në grup:</i> Ushtrimi 7. Nxiten nxënësit/et që në grupe të zgjedhin një prej poezive të kësaj autoreje, të diskutojnë rreth përmbajtjes së vargjeve, mesazhit që përcjellin, lidhjen që kanë me fëmijët. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e pestë <i>Dramatizim:</i> Ushtrimi 8. Nxënësit/et interpretojnë në role poezitë “Pyetje për mamin” dhe “Qukapik o qukapik”. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. 			

• **Vlerësimi bëhet për:**

- ndjekjen me vëmendje të informacionit që dëgjon, duke mbajtur shënime të shkurtra për çështje kryesore;
- demonstrimin e të dëgjuarit të qëllimshëm në kryerjen e detyrave;
- lidhjen e vargjeve tëpoezive të poetes Adelina Mamaqi, me titullin e tyre;
- diskutimin rreth tematikave për të cilat ka shkruar Adelina Mamaqi;
- tregimin për poezinë e parapëlqyer të tij/saj, duke treguar arsyen e përzgjedhjes;
- recitimin me ndjenjë të poezive;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Lexim jashtë klase 3 (sipas zgjedhjes së mësuesit/es)		Fjalë kyçe	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëgjëza, etj... (sipas pjesës që do ketë zgjedhur mësuesi/ja) • përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive. (sipas pjesës që do ketë zgjedhë mësuesi/ja) • përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara; • tregon interes dhe dëshirë për të lexuar; • shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit; • ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit; • pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë. 		Situata e të nxënit Leximi i librave jashtë klase	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none"> - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; - libra jashtë klase. 		Lidhja me fushat e tjera Lidhja me temat ndërkurrikulare	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: diskutim, bisedë, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve <ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i titullit të librit dhe autori. • Leximi i pjesës. • Pyetje për llojin e pjesës dhe brendinë e saj. • Komenti i fragmentit që pëlqejnë më shumë. • Tregimi i brendisë së pjesës. • Personazhet dhe cilësitë e tyre. • Mesazhi që përcjell pjesa. • Lidhja e këtij mesazhi me jetën e tyre. • Ilustrim i pjesës me vizatim. • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -leximin e poezive, përrallave nga folklori, përrallave nga autorë të ndryshëm, tregimeve, fabulave, gjëgjëzave, etj...; -përcaktimin e dy-tre tipareve të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive; -përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazheve dhe tregimin se cilët janë personazhet e preferuara; -shfaqjen e besimit dhe vullnetit në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit; -ndarjen me të tjerët të përvojave të tij rreth leximit. <p>Shënim: Disa rubrika të kësaj ore, nuk janë plotësuar, pasi ato ndryshojnë në varësi të pjesës që do të zgjedhë mësuesja për të punuar.</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Ushtrime përmbledhëse: Folja (ora I)		Situata e të nxënit Ç’дини për kohët e foljes?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • zgjedhon foljet e rregullta në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme të mënyrës dëftore, duke dalluar mbaresat që marrin ato gjatë zgjedhimit; • shkruan folje që mbarojnë me –j, me bashkëtingëllore, me zanore; • dallon në fjali e tekste, folje, duke përcaktuar kohën, vetën dhe numrin e tyre; • zbaton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit të foljeve në kohët e mësuara; • demonstroi vëmendje dhe përqendrim gjatë kryerjes së detyrave; • bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave. 		Fjalë kyçe: -folja; -veta; -numri; -koha e tashme; -koha e pakryer; -koha e kryer e thjeshtë; -koha e ardhme; -zgjedhoj.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e zgjedhimit të foljeve që mbarojnë me –j, me bashkëtingëllore, me zanore, në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -stuhi mendimesh; -diskutim; -rishikim në dyshe; -analizë; konkurs; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Stuhi mendimesh:</i> Zhvillohet një bisedë me nxënësit/et rreth foljes dhe kohëve të foljeve të mësuara.</p> <p>-Ç’дини për foljet? -Ç’kohë të foljeve kemi mësuar? -Ç’regon secila prej këtyre kohëve të foljeve? Përgjigjet e dhëna nga nxënësit/et, mësuesi/ja i paraqet në mënyrë grafike në tabelë.</p> <div style="text-align: center;"> <p>Tregon një veprim ← <i>Koha e ardhme</i> ← Kohët e foljeve → <i>Koha e tashme</i> → Tregon një veprim që pritët të ndodhë në të ardhmen</p> <p style="margin-left: 100px;">↙ ↘</p> <p><i>Koha e kryer e thjeshtë</i> <i>Koha e pakryer</i></p> <p>Tregon një veprim që është i përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës. Tregon një veprim që është në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës, pra i papërfunduar.</p> </div> <p>Nxiten nxënësit/et të zgjedhojnë folje të ndryshme në kohët e mësuara.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Diskutim: Punë në dyshe:</i> Nxënësit/et punojnë në dyshe për të plotësuar tabelën në ushtrimin 1. Pas përfundimit të punës nxiten ata/ato të lexojnë foljet sipas klasifikimit të tyre. Vihet theksi te mbaresat e këtyre foljeve pa e përmendur që i takojnë grupit të parë, të dytë dhe të tretë të zgjedhimit të foljeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <p><i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 2. Nxënësit/et punojnë individualisht për të dalluar kohët e foljeve në fjalitë e dhëna.</p> <p>Nxënësit/et shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim në klasë rreth ushtrimit nën drejtimin e mësuesit/es.</p>			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Analizë, konkurs:</i> Ushtrimi 3. Nxënësit/et punojnë në grupe në tabakë letre për të analizuar foljet e ushtrimit <p>2. Pas përfundimit të punës, secili grup prezanton punën e tij. Zhvillohet një diskutim në klasë, nën drejtimin e mësuesit/es. Mësuesi/ja shpall grupin fitues. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -zgjedhimin e foljeve të rregullta në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme të mënyrës dëftore, duke dalluar mbaresat që marrin ato gjatë zgjedhimit; -shkrimin e foljeve që mbarojnë me –j, me bashkëtingëllore, me zanore; -dallimin në fjali e tekste, të foljeve, duke përcaktuar kohën, vetën dhe numrin e tyre; -zbatimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit të foljeve në kohët e mësuara; -demonstrimin e vëmendjes dhe përqendrimit gjatë kryerjes së detyrave; -vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit; -bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave. • Detyrë shtëpie: Krijohet 10 fjali duke përdorur foljet: lexoj, përhap, di, në kohët e mësuara.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Folja: Ushtrime përmbledhëse (ora II)		Situata e të nxënës Shqyrtimi i foljeve për të dalluar kohën, vetën, numrin e tyre.	
Rezultatet e të nxënës Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • zgjedhon foljet e rregullta të mënyrës dëftore, në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; • zgjedhon foljet <i>jam</i> dhe <i>kam</i>, në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; • përshtat foljen në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme me përemrin vector në fjali; • analizon foljet duke përcaktuar kohën, vetën, numrin e tyre; • shkruan fjali duke përdorur folje në kohën, vetën dhe numrin e kërkuar; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • qorton gabimet drejtshkrimore më ndihmën e mësuesit/es; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • demonstroi vëmendje dhe përqendrim gjatë kryerjes së detyrave; • bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -folja; -veta; -numri; -koha e tashme; -koha e pakryer; -koha e kryer e thjeshtë; -koha e ardhme; -zgjedhoj. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e zgjedhimit të foljeve që mbarojnë me –j, me bashkëtingëllore, me zanore dhe e foljeve <i>jam</i> dhe <i>kam</i>, në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. 	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim;
 - rishikim në dyshe;
 - analizë;
 - lojë;
 - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Mësimi nis me leximin dhe diskutimin e detyrave të shtëpisë.

Diskutim: Punë në dyshe: Mësuesi/ja shpërndan fisha me fjali të ndryshme dhe fton nxënësit/et të gjejnë foljet e përdorura në to, duke dalluar kohën, vetën dhe numrin e tyre.

Nxënësit/et punojnë në dyshe dhe çdo dyshe prezanton punën e bërë.

- **Veprimtaria e dytë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 4. Orientohen nxënësit/et që në fjalitë e dhëna të ngjyrosin me të gjelbër foljen e përshtatshme.

Më pas nxënësit/et do të shkruajnë tekstin e plotësuar në fletore dhe do të analizojnë foljet duke treguar kohën, vetën dhe numrin e tyre.

Shkëmbejnë fletoret ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrit.

Nxiten nxënësit/et të lexojnë tekstin me zë, duke treguar kohën, vetën dhe numrin e foljeve.

- **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 5. Nxënësit/et punojnë individualisht për të krijuar fjali me 2 folje për secilin grup në tabelën e ushtrimit 1, duke i përdorur në kohën, vetën dhe numrin e kërkuar.

Në përfundim të punës, nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-zgjedhimin e foljeve të rregullta të mënyrës dëftore, në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;

-përshtatjen e foljeve në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme me përemrin vetor në fjali;

-analizën e foljeve duke përcaktuar kohën, vetën, numrin e tyre;

-shkrimin e fjalive duke përdorur foljen në kohën, vetën dhe numrin e kërkuar;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-qortimin e gabimeve drejtshkrimore më ndihmën e mësuesit/es;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;

-demonstrimin e vëmendjes dhe përqëndrimit gjatë kryerjes së detyrave;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave.

- **Detyrë shtëpie**

Shkruaj një tekst me 7-8 fjali të thjeshta me temë "Një ditë pranvere". Nënvizoj foljet, trego kohën, vetën dhe numrin e tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shpatat dhe mbishkrimet		Situata e të nxënit Diskutim rreth llojeve të shpatave të përdorura historikisht nga trimat legjendarë shqiptarë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; • tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin; • dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij; • lidh fjalët e reja me kuptimin e tyre; • tregon se cilës fushë i përket tema e këtij teksti; • u përgjigjet pyetjeve rreth tekstit; • shkruan nga një titull për çdo paragraf të tekstit; • shpjegon rëndësinë që ka frekuentimi i muzeve tona për t'u njohur me vlerat dhe aftësitë e artizanëve shqiptarë në shekuj; • vë në dukje rëndësinë dhe vlerat e shpatave ceremoniale në muzetë tona për shpjegimin e historisë sonë; • gjykon për domosdoshmërinë që ka ruajtja dhe mirëmbajtja e këtyre relikeve të së shkuarës sonë; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -shpata; -mbishkrime; -teh; -dorezë; -këllëf; -ceremonial; -është konstatuar; -daltë; -motiv zbukurues; -i skuqur; -limohej; -deshifrohen; -studiuesve.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -kllasteri i përgatitur rreth tekstit informues; -album me vizatime shpatash; -foto të shpatave të ndryshme; -foto të Skënderbeut me shpatë; -informacione të shkurtra nga interneti në lidhje me gjendjen e shpatave ceremoniale në muzetë shqiptare, artizanët që i kanë prodhuar, luftëtarët, apo autoritetet që i kanë përdorur; -mjete shkrimi, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -teknologjia dhe TIK-u; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -vëzhgo-komento; -diskutim; -lexo-përmblihdh në dyshe; -lexo-dallo; -analizë; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Vëzhgo-komento:</i> Nxënësit/et paraqesin foto të ndryshme shpatash të përdorura ndër vite të ruajtura nëpër muze. Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të diskutojnë rreth tyre. Mësuesi/ja prezanton temën e mësimiit “Shpatat me mbishkrime”.</p>			

- **Veprimtaria e dytë**

Diskutim: Orientohen nxënësit/et të vërejnë ilustrimet në libër.

Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën, diskutojnë rreth tyre.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në paragrafë.

*Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et në dyshe, diskutojnë për shpjegimin e kuptimit të fjalëve të reja duke plotësuar edhe rubrikën “Fjalë të reja”.


*Nxiten nxënësit/et tregojnë llojin e tekstit (*teksti informues*), duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij. (*Paraqet informacione të hollësishme për shpatat me mbishkrime, kohën dhe teknikën e prodhimit të tyre nga artizanët shqiptarë, përdorimin e tyre, vlerat e tyre historike*).

*Mësuesi/ja jep informacione shtesë rreth tekstit informues:

Teksti informues paraqet informacione të hollësishme për tema të ndryshme: historike, gjeografike, shkencore, të aktualitetit, etj...

Përdorimi Gjuha

Përdoret në revista, enciklopedi, libra mësimorë si dhe në internet



Organizimi

*Zakonisht një tekst informues fillon me titullin.
Vazhdon me paraqitjen e çështjeve që lidhen me temën,
të cilat janë të organizuara në paragrafë.
Shoqërohet me fotografi, vizatime, tabela dhe skema që na
ndihmojnë për ta kuptuar më mirë atë.*

Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e tretë**

Lexo-përmbledh në dyshe: Nxiten nxënësit/et të përmbledhin me 4-5 fjali informacionin e dhënë në tekst dhe më pas e ndajnë me gjithë klasën.

- **Veprimtaria e katërt**

Lexo-dallo: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj”, nxënësit/et tregojnë, se në sa paragrafë është organizuar teksti.

*Nxiten nxënësit/et të punojnë në grupe për të dalluar ato pjesë të tekstit, ku shpjegohet se:

- ku ndodhen mbishkrimet e shpatave për të cilat flet ky tekst;
- ku janë prodhuar këto shpata;
- cila është teknika e prodhimit të tyre;
- këto shpata kanë edhe vlera historike.

- **Veprimtaria e pestë**

Analizë: Punohet rubrika “Analizoj”.

*Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën, se cilës fushë i përket tema e këtij teksti.

*Nxënësit/et shkruajnë mbi vizat e çdo paragrafi në tekst, nga një titull dhe i lexojnë ato para klasës.

- **Veprimtaria e gjashtë**

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Zhvillohet një bashkëbisedim me nxënësit/et rreth dëshirave që kanë ata/ato për të vizituar një muze, për të parë nga afër shpatat e dikurshme.

Nxiten të gjykojnë për rëndësinë që ka ruajtja dhe mirëmbajtja e këtyre relikeve të së shkuarës sonë.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- tregimin se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;
- dallimin e llojit të tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;
- lidhjen e fjalëve të reja me kuptimin e tyre;
- tregimin se cilës fushë i përket tema e këtij teksti;
- përgjigjet e pyetjeve rreth tekstit;
- shkrimin nga një titull për çdo paragraf të tekstit;
- shpjegimin për rëndësinë që ka frekuentimi i muzeve tona për t’u njohur me vlerat dhe aftësitë e artizanëve shqiptarë në shekuj;
- arsyetimin për rëndësinë dhe vlerat e shpatave ceremoniale në muzetë tona në shpjegimin e historisë sonë;
- gjykimin për rëndësinë që ka ruajtja dhe mirëmbajtja e këtyre relikeve të së shkuarës sonë;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie**

Grupi i parë: Gjeni informacione për shpatën e Skënderbeut.

Grupi i dytë: Rubrika “Veprimtari”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Ndajfolja (ora I)		Situata e të nxëniet Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar ndajfoljen.	
Rezultatet e të nxëniet Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon ndajfoljen në fjali; • vë në dukje se ndajfolja qëndron pranë foljes dhe plotëson kuptimin e saj; • përdor pyetjet: <i>Si? Kur? Ku? Sa?</i> për të gjetur ndajfoljen në fjali, duke ia drejtuar foljes; • përzgjedh ndajfoljen e duhur për të plotësuar kuptimin e fjalisë; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • demonstroi vëmendje dhe përqendrim gjatë kryerjes së detyrave; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -ndajfolje; -Si? -Kur? -Ku? -Sa?	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me ndajfolje; -mjete shkrimi, lapustilë, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim; -dallo-trego; -rishikim në dyshe; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Njihet nxënësit/et me temën e mësimin. Orientohen ata/ato të vërejnë figurën në libër dhe të diskutojnë rreth saj. Në një tabak letre mësuesi/ja ka shkruar tekstet të cilat nxënësit/et i kanë edhe në libër. Nxiten nxënësit/et të lexojnë tekstin e parë dhe të dallojnë foljet në to, duke punuar në dyshe. <i>Toku, maçoku i Aidës hyn në kuzhinë. Ai ulet nëkarrige. Mblidhet dhe gërhet.</i> <i>(hyn, ulet, mblidhet, gërhet.)</i> Në tekstin e dytë dhe të tretë do të dallojnë foljet dhe fjalët që plotësojnë kuptimin e tyre. <i>Toku, maçoku i Aidës hyn nxitimthi në kuzhinë.</i> <i>Ai i afrohet karriges dhe ulet sipër. Mblidhet shpejt dhe gërhet shumë.</i> <i>Toku, maçoku i Aidës, hyn ngathtas në kuzhinë. Ai i afrohet karriges dhe ulet poshtë. Mblidhet ngadalë dhe gërhet pak.</i> <i>(hyn nxitimthi, ulet sipër, mblidhet shpejt, gërhet shumë)</i> <i>(hyn ngathtas, ulet poshtë, mblidhet ngadalë, gërhet pak)</i> Mësuesi/ja tregon se fjalët me shkronja të zeza, quhen ndajfolje. *Nxënësit/et lexojnë në dyshe dhe diskutojnë rreth kuptimit për ndajfoljen në rubrikën “Mbaj mend”. Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve/eve, duke vënë në dukje se <i>ndajfolja qëndron pranë foljes dhe plotëson kuptimin e saj</i>. Për të gjetur ndajfoljet, i drejtojmë foljes pyetjet: <i>Si? Kur? Ku? Sa?</i> etj... <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Dallo-trego:</i> Ushtrimi 1. Synon që nxënësit/et të nënvizojnë ndajfoljet në tekstin e dhënë duke treguar pyetjet që përdorën. • Veprimtaria e tretë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 2. Synon që nxënësit/et të përzgjedhin njërin nga ndajfoljet në kllapa, për të plotësuar fjalinë. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Ata/ato shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe korrigjojnë gabimet. Në fund zhvillohet një diskutim në klasë për mënyrën se si kanë punuar, nën drejtimin e mësuesit/es. 			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt Shkëmbe një problemë: Nxiten nxënësit/et të punojnë në grupe. Secili grup shkruan në fleta 5 ndajfolje dhe ia jep grupit fqinjë të krijojë fjali me to. Lexohen fjalitë para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime të gabimeve drejtshkrimore. Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit. • Vlerësimi bëhet për: -dallimin e ndajfoljes në fjali; -përdorimin e pyetjeve: Si? Kur? Ku? Sa? për të gjetur ndajfoljen në fjali; -përzgjedhjen e ndajfoljes së duhur për të plotësuar kuptimin e fjalisë; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve; -demonstrimin e vëmendjes dhe përqendrimit gjatë kryerjes së detyrave; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup. • Detyrë shtëpie Ushtrimit 3 Shënim: Mësuesi duhet të jetë shumë i kujdesshëm në trajtimin e kësaj teme, pasi nxënësit shpesh ngatërrojnë ndajfoljen me parafjalën. Eci përreth shtëpisë. (parafjalë) Eci përreth. (ndajfolje)

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Ndajfolja (ora II)		Situata e të nxënit Krijimi i një harte konceptesh për ndajfoljen.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon ndajfoljen në fjali; • kthen ndajfoljet në mbiemra, sipas modeleve; • shkruan ndajfolje me kuptim të kundërt me ndajfoljet e dhëna; • krijon fjali me ndajfolje; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • demonstroi vëmendje dhe përqendrim gjatë kryerjes së detyrave; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -ndajfolje; -Si? -Kur? -Ku? -Sa?	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me ndajfolje; -mjete shkrimi, lapustilë, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -harta e konceptit; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Harta e konceptit:</i> Nxiten nxënësit/et të tregojnë se ç’ dinë për ndajfoljen dhe të japin shembuj të ndajfoljeve. Përgjigjet e tyre, mësuesi/ja i shkruan në dërrasë. Gjendet me pyetjet: <i>Si? Kur? Ku? Sa?</i> Qëndron pranë foljes(zakonisht pas saj). <i>shpejt, bukur, lehtë,shpesh, ngadalë</i> Plotëson kuptimi e foljes. • Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 4 synon që nxënësit/et të kthejnë ndajfoljet e dhëna në mbiemra, sipas modeleve. Ushtrimi 5 synon që nxënësit/et të shkruajnë ndajfolje me kuptim të kundërt me ndajfoljet e ushtrimit 4. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Ata/ato shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Zhvillohet një diskutim në klasë rreth ushtrimeve, nën drejtimin e mësuesit/es. 			

• **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 6 synon që nxënësit/et të ndërtojnë fjali ku të përdorin ndajfoljet e dhëna.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Ata/ato lexojnë fjalitë e krijuara.

Bëjnë qortimin e gabimeve drejtshkrimore nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

• **Vlerësimi bëhet për:**

-dallimin e ndajfoljeve në fjali;

-kthimin e ndajfoljeve në mbiemra, sipas modeleve;

-shkrimin e ndajfoljeve me kuptim të kundërt me ndajfoljet e dhëna;

-krijimin e fjalive duke përdorur ndajfolje;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;

-demonstrimin e vëmendjes dhe përqëndrimit gjatë kryerjes së detyrave;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

• **Detyrë shtëpie**

Krijo fjali ku të përdorësh ndajfoljet: *pak, ngadalë, përherë, larg, mirë, qartë.*

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore		Situata e të nxënit Shikim i organizuar i një materiali të shkurtër filmik rreth elefantëve afrikanë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; • tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin; • dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij; • demonstroi të kuptuarit e fjalëve të reja, duke krijuar fjali me to; • demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij; • tregon karakteristikat e elefantëve afrikanë (pamja e jashtme, të ushqyerit, sjellja, mënyra e jetesës); • shpreh preferencat e tij/saj për elefantin, duke i argumentuar ato; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -elefantë; -gjitarë; -për të bulurirë; -për të zhvoshkur.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -informacione të shkurtra nga interneti në lidhje me elefantët; -enciklopedi; -material i shkurtër filmik për elefantët afrikanë; -videoprojektor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shkenca e natyrës; -teknologjia dhe TIK-u; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - shikim i organizuar;
 - procedura: pyet sërish;
 - lexo-përmbledh në dyshe;
 - analizë;
 - rrjeti i diskutimit;
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Shikim i organizuar: Ftohen nxënësit/et të shohin një material të shkurtër filmik rreth elefantëve afrikanë. (Në mungesë të videoprojektorit, nxënësit/et tregojnë foto të elefantëve dhe lexojnë kuriozitete për elefantët). Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit.

- **Veprimtaria e dytë**

Procedura: pyet sërish: Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe fton nxënësit/et të vërejnë ilustrimet. Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën, diskutojnë rreth tyre.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në paragrafë. Gjatë leximit, ata/ato nënvizojnë fjalët e reja dhe fjalitë që u duken interesante.

*Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et diskutojnë në dyshe: njëri prej tyre ndërton dy pyetje rreth paragrafit dhe tjetri përgjigjet. Për çdo paragraf të ri, nxënësit/et ndërrojnë rolet.

Mësuesi/ja kujdeset që në këtë veprimtari të punohen edhe pyetjet e rubrikës “Lexoj dhe kuptoj”.

Paragrafi I

Pyetje: -Sa të lartë janë elefantët afrikanë? Sa peshojnë ata?

-Si i kanë veshët ata? Përse i ndihmojnë veshët e mëdhenj?

Paragrafi II

Pyetje: -Pse e pëlqejnë ujin elefantët afrikanë?

- Çfarë bëjnë ata pasi e njomin trupin?

Paragrafi III

Pyetje: -Çfarë është noçka e elefantit? Përse shërben ajo?

-Nga se formohet noçka e elefantit?

Paragrafi IV

Pyetje: -Si janë dhëmbët e elefantëve?

-Përse i përdorin ato?

Paragrafi V

Pyetje: -Sa ushqim në ditë mund të konsumojë një elefant i rritur?

*Punohet rubrika “Fjalë të reja”. Nxënësit/et lexojnë dhe diskutojnë rreth kuptimit të fjalëve të reja në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën dhe krijojnë fjali me to.

- **Veprimtaria e tretë**

Lexo-përmbledh në dyshe: Nxiten nxënësit/et të lexojnë dhe të përmbledhin në dyshe çdo paragraf të tekstit.

- **Veprimtaria e katërt**

Analizë: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën për llojin e tekstit, duke përzgjedhur alternativën e saktë dhe duke dhënë shpjegimet përkatëse. (*Tekst informues. Paraqet informacione të hollësishme për elefantët afrikanë: pamjen e jashtme, të ushqyerit, sjelljen, mënyrën e jetesës së tyre.*)

- **Veprimtaria e pestë**

Rrjet diskutimi: Punohet rubrika “Reflektoj”. Diskutojnë dhe japin argumenta pro dhe kundër rreth pëlqimeve që kanë për elefantin.

Po

Jo

A ju pëlqejnë elefantët? Pse?

Dalin në një përfundim: Të gjitha kafshët janë pjesë e natyrës dhe kanë rëndësinë e tyre.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;

-tregimin se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;

-dallimin e llojit të tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;

-demonstrimin e të kuptuarit e fjalëve të reja, duke krijuar fjali me to;

-demonstrimin e të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve;

-tregimin e karakteristikave të elefantëve afrikanë (pamja e jashtme, të ushqyerit, sjellja, mënyra e jetesës);

-shprehjen e preferencave të tij/saj për elefantin, duke i argumentuar ato;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie:** Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Sinonimet dhe antonimet (ora I)		Situata e të nxënësve Manipulim me fjalë për të dalluar fjalët sinonimike dhe antonimike.	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon fjalët me kuptim të njëjtë, ose afërsisht të njëjtë; • dallon fjalët me kuptim të kundërt; • gjen sinonime të fjalëve të dhëna (emra, folje, mbiemra, ndajfolje); • tregon larmishmëri të shprehuri dhe pasuri të leksikut, duke përdorur sinonimet; • përzgjedh fjalën e duhur për të shprehur ngjyrimet më të plota të fjalëve në kontekstin e dhënë; • gjen antonime të fjalëve të dhëna (emra, folje, mbiemra, ndajfolje); • demonstroi vëmendje dhe përqendrim gjatë kryerjes së detyrave; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave. 		Fjalët kyçe: -fjalë me kuptim të njëjtë; -fjalë me kuptim afërsisht të njëjtë; -fjalë me kuptim të kundërt; -sinonime; -antonime.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me fjalë me kuptim të njëjtë dhe të afërt; -fisha me fjalë me kuptim të kundërt; -figura; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskuto-nxirr përfundimin; -rishikim në dyshe; -të nxënësit me këmbime; -konkurs; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskuto-nxirr përfundimin:</i> Mësuesi/ja njih nxënësit/et me temën e mësimit. Orientohen nxënësit/et që në rubrikën "Kujtoj", të vëzhgojnë figurat, të lexojnë dialogët, duke u përqendruar te fjalët me shkronja të zeza. U drejtohen nxënësve/eve pyetjet: Për figurën e parë: -Si mendoni për fjalët apartament dhe shtëpi, a kanë kuptim të njëjtë? Për figurën e dytë: -Fjalët majtas dhe djathtas, ç'kuptim kanë? Nxënësit/et lexojnë dhe diskutojnë rreth sqarimeve që jepen për sinonimet dhe antonimet. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të lidhin me vijë, çiftet e fjalëve sinonimike. Nxënësit/et punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Diskutohet me gjithë klasën rreth ushtrimit, nën drejtimin e mësuesit/es. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Të nxënësit me këmbime, grupet e ekspertëve:</i> Nxënësit/et grupohen në grupe me nga 4 individë dhe secilit, i caktohet nga një numër nga 1-4. Nxënësve/eve u ndahen detyrat: Nxënësit/et me numrin 1 do të punojnë ushtrimin 2, ku do të dallojnë fjalën që nuk është sinonime me fjalën e dhënë. Nxënësit/et me numrin 2 do të punojnë ushtrimin 3, ku do të shkruajnë sinonime të fjalëve të dhëna (emra, folje, mbiemra, ndajfolje). Nxënësit/et me numrin 3 do të punojnë ushtrimin 4, ku do të dallojnë fjalën që është antonime me fjalën e dhënë. Nxënësit/et me numrin 4 do të punojnë ushtrimin 5, ku do të shkruajnë antonime të fjalëve të dhëna (emra, folje, mbiemra, ndajfolje). Nxënësit/et sipas numrave që kanë, do të rigrupohen dhe do të diskutojnë me njëri-tjetrin rreth ushtrimeve. Pas kryerjes së detyrave, ata/ato do të shkojnë në grupet fillestare ku do t'ua shpjegojnë detyrën edhe anëtarëve të tjerë të grupit. Në fund diskutohet rreth çdo detyre me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es. Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve 			

- **Veprimtaria e katërt**

Konkurs: Ndahen nxënësit/et në grupe.

1. Mësuesi/ja jep 5 fjalë (që kanë sinonime) dhe u kërkon nxënësve/eve të gjejnë sinonime të tyre.
 2. Mësuesi/ja jep 5 fjalë (që kanë antonime) dhe u kërkon nxënësve/eve të gjejnë antonimet e tyre.
- Shpallet fitues, grupi që i ka gjetur sinonimet dhe antonimet e fjalëve të dhëna.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e fjalëve me kuptim të njëjtë, ose afërsisht të njëjtë;
- dallimin e fjalëve me kuptim të kundërt;
- gjetjen e sinonimeve të fjalëve të dhëna (emra, folje, mbiemra, ndajfolje);
- gjetjen e antonimeve të fjalëve të dhëna (emra, folje, mbiemra, ndajfolje);
- demonstrimin e vëmendjes dhe përqendrimit gjatë kryerjes së detyrave;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave.

- **Detyrë shtëpie:**

Gjej me ndihmën e prindërve, nga fjalori i gjuhës shqipe, fjalë sinonime dhe çifte antonimike.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Sinonimet dhe antonimet (ora II)		Situata e të nxënit: Manipulim me fjalë për të dalluar fjalët sinonimike dhe antonimike.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • gjen sinonime të fjalëve të dhëna (emra, folje, mbiemra, ndajfolje); • gjen antonime të fjalëve të dhëna (emra, folje, mbiemra, ndajfolje); • tregon larmishmëri të shprehuri dhe pasuri të leksikut, duke përdorur sinonimet; • përzgjedh fjalën e duhur për të shprehur ngjyrimet më të plota të fjalëve në kontekstin e dhënë; • përdor në fjali sinonime dhe antonime; • demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -fjalë me kuptim të njëjtë; -fjalë me kuptim afërsisht të njëjtë; -fjalë me kuptim të kundërt; -sinonime; -antonime. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -figura; -fisha me fjalë me kuptim të njëjtë dhe të afërt; -fisha me fjalë me kuptim të kundërt; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> -identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave. 	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim;
 - shkrim i drejtuar;
 - shkëmbe një problemë;
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim: Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë, ku nxënësit/et lexojnë çiftet e fjalëve sinonimike dhe antonimike, duke rikujtuar edhe njohuritë e marra për sinonimet dhe antonimet.

sinonime

antonime

fjalë me kuptim të njëjtë, ose afërsisht të njëjtë
(rrugë-udhë)

fjalë me kuptim të kundërt
(i bardhë- i zi)

- **Veprimtaria e dytë**

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 6, 7, synon që nxënësit/et të krijojnë fjali me sinonimet dhe antonimet e dhëna. Nxënësit/et ndahen në dy grupe.

Grupi A: Ushtrimi 6

Grupi B: Ushtrimi 7

Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim, lexojnë fjalitë para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e thjeshta drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

- **Veprimtaria e tretë**

Shkëmbe një problemë: Nxënësit/et punojnë në grupe. Ata/ato shkruajnë fjalë që kanë sinonime (antonime) dhe ia japin grupit fqinjë që të gjejnë sinonimet (antonimet) e tyre.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e grupeve fqinjë.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- gjetjen e sinonimeve të fjalëve të dhëna;
- gjetjen e antonimeve të fjalëve të dhëna;
- përzgjedhjen e fjalëve të duhura për të shprehur ngjyrimet më të plota të fjalëve në kontekstin e dhënë;
- përdorimin në fjali të sinonimeve dhe antonimeve;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shpikja e mprehëses së lapsit		Situata e të nxënit Nxënësit/et tregojnë rreth shpikjeve më të mëdha të njerëzimit, duke u bazuar te njohuritë që kanë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; • tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin; • dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij; • demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij; • përshkruan ecurinë e shpikjes së mprehëses së lapsit që nga fillimet deri në modernizimin e saj; • shkruan për objektin që do të dëshironte të shpikte dhe qëllimin e shpikjes së tij; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -shpikje; -mprehëse e lapsit;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -enciklopedi; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -teknologjia dhe TIK-u; -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim për njohuritë paraprake;
 - lexo-përmblihdh në dyshe;
 - marrëdhënie pyetje-përgjigje;
 - dallo-trego;
 - shkrim i lirë;
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim për njohuritë paraprake: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të tregojnë rreth shpikjeve më të mëdha të njerëzimit, duke u bazuar te njohuritë që ata/ato kanë.

Përgjigjet e tyre i paraqet në tabelë në formë kllasteri.

*Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit “Shpikja e mprehëses së lapsit”.

- **Veprimtaria e dytë**

Lexo-përmblihdh në dyshe: Orientohen nxënësit/et të vërejnë ilustrimin në libër dhe të diskutojnë rreth tij.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në paragrafë.

*Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et në dyshe, përmbledhin me 2-3 fjali informacionin e dhënë në tekst dhe më pas e ndajnë me gjithë klasën.

*Nxiten nxënësit/et tregojnë llojin e tekstit (*tekst informues*), duke vënë në dukje disa karakteristika të tij. (*Paraqet informacione të hollësishme për ecurinë e shpikjes së mprehëses së lapsit që nga fillimet deri në modernizimin e saj*).

*Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e tretë**

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj”, nxënësit/et do t’u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit:

-Çfarë përdorej për të bërë majën e lapsit para se të shpikkej mprehësja?

a) gërshëra, b) brisku, c) tehu i thikës.

-Cili objekt e frymëzoi shpikësin e mprehëses së lapsit?

-Në ç’vit u shpik mprehësja e parë moderne e lapsave?

- **Veprimtaria e katërt**

Dallo-trego: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et të tregojnë se për çfarë shërben mjete që është vendosur në figurën në krah të tekstit.

- **Veprimtaria e pestë**

Shkrim i lirë: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit/et të shkruajnë rreth një objekti që do të dëshironin të shpiknin dhe për çfarë do të shërbente ai.

Nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre para klasës.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;

-tregimin se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;

-dallimin e llojit të tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;

-përshkrimin e ecurisë së shpikjes së mprehëses së lapsit, që nga fillimet deri në modernizimin e saj;

-shkrimin për objektin që do të dëshironte të shpikte dhe qëllimin e shpikjes së tij;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie**

Përshkruaj një nga shpikjet, që mendon se ka patur ndikimin më të madh në zhvillimin e shoqërisë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Gjuha jonë Fjalët me shumë kuptime		Situata e të nxënët Manipulime me fjalë e fjali, për të dalluar fjalët me shumë kuptime.	
Rezultatet e të nxënët Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon fjalët me shumë kuptime; • përdor fjalët me shumë kuptime në fjali; • përzgjedh fjalën e duhur për të shprehur kuptimin e përcaktuar në fjali; • demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; • bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave. 		Fjalët kyçe: -fjalë me shumë kuptime.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me fjalë me shumë kuptime; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim; -rishikim në dyshe; -mendo-zbulo; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. Orientohen ata/ato të vërejnë figurat në libër dhe të diskutojnë rreth tyre. Në një tabak letre, mësuesi/ja ka shkruar fjalitë, të cilat nxënësit/et i kanë edhe në libër. Nxiten nxënësit/et të lexojnë fjalitë në heshtje dhe të dallojnë kuptimin që ka fjala “fletë”, në secilën prej fjalive. <ol style="list-style-type: none"> 1. Fleta e bardhë duhej mbushur, por nuk kisha frymëzim. 2. Ejona mblodhi fletët e rëna të pemëve. 3. Fletët e trëndafilin ishin ngjyrë rozë e ëmbël. 4. Fletët e dritares ishin të hapura. Zhvillohet një diskutim me nxënësit/et nën drejtimin e mësuesit/es, për të përcaktuar kuptimin e fjalës “fletë” gjatë përdorimit në secilën prej fjalive, si dhe kuptimin e parë të kësaj fjale. *Lexohet rubrika “Mbaj mend”, ku sqarohet se fjala <i>fletë</i>, ka shumë kuptime. Kuptimi i fjalës del më qartë në fjali. Nxiten nxënësit/et të japin shembuj të tjerë të fjalëve me shumë kuptime. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të lidhin me vijë, kuptimin e fjalës me figurën që e pasqyrojnë atë. Nxënësit/et punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Diskutohet me gjithë klasën rreth ushtrimeve, nën drejtimin e mësuesit/es. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Mendo-zbulo:</i> Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të përcaktojnë kuptimin e fjalëve të njëjta në çiftet e fjalëve të dhëna. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Shkrim i drejtuar:</i> Ushtrimi 3. Nxiten nxënësit/et, të krijojnë fjali me fjalët: <i>grykë, vesh, flokë</i>, duke i përdorur në kuptime të ndryshme. Nxënësit/et të ndihmuar nga mësuesi/ja, përdorin fjalorin e gjuhës shqipe, për të gjetur kuptimet e ndryshme të këtyre fjalëve. Pas përfundimit të punës, nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara. Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore. Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve. 			

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e fjalëve me shumë kuptime;
- përdorimin e fjalëve me shumë kuptime në fjali;
- përzgjedhjen e fjalës së duhur për të shprehur kuptimin e përcaktuar në fjali;
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave.

- **Detyrë shtëpie:** Gjej 3 fjalë me shumë kuptime. Krijo fjali me to.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Udhëtimi i farës		Situata e të nxënit Diskutim rreth ciklit të zhvillimit nga fara në bimë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; • dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij; • demonstroi të kuptuarit e fjalëve të reja, duke krijuar fjali me to; • tregon funksionin e farave për ripërtëritjen e bimës dhe ciklin e zhvillimit të saj nga mbjellja në tokë, deri tek fruti i saj; • demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -fara; -nektar; -thekët e lules.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -enciklopedi; -videoprojektor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shkencat e natyrës; -teknologjia dhe TIK-u; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim paraprak; -lexo-përmbledh në dyshe; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -dallos-trego; -shkrim i shpejtë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Diskutim paraprak:</i> Mësuesi/ja u tregon nxënësve fara të bimëve të ndryshme (fara fasulesh, specash, kungulli, bizeleje ,etj...) dhe u kërkon atyre t'i emërtojnë. Nxënësve/eve u drejtohen pyetjet:</p> <p>-Çfarë mund të ndodhë nëse këto fara bien në një tokë të punuar, me lagështirë dhe në një mjedis me temperaturë të ngrohtë?</p> <p>-A ju ka rastisur të shihni prindërit, apo gjyshërit, tek mbjellin farat e luleve në vazo?</p> <p>-Çfarë transformimi keni vënë re nga fara e hedhur te bima e vogël?</p> <p>Mësuesi/ja mirëpret përgjigjet e nxënësve/eve, duke i ndihmuar ata/ato, për ta përmbledhur sa më saktë ciklin e zhvillimit nga fara në bimë.</p> <p>Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit.</p>			

- **Veprimtaria e dytë**

Lexo-përmbledh në dyshe: Orientohen nxënësit/et të vërejnë foton në libër dhe të diskutojnë rreth saj.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në paragrafë.

*Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et në dyshe përmbledhin me 3-4 fjali informacionin e dhënë në tekst dhe më pas e ndajnë me gjithë klasën.

*Punohet rubrika “Fjalë të reja”. Nxënësit/et lexojnë dhe diskutojnë rreth kuptimit të fjalëve të reja (*nektar; thekët e lules*) në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën dhe krijojnë fjali me to.

*Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit/et.

- **Veprimtaria e tretë**

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Në rubrikën ”Lexoj dhe kuptoj”, nxënësit/et do t’u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.

-Cili është funksioni i farave?

-Cilët i shpërndajnë farat?

-Ç’ndodh me farat kur bien në tokë?

-Për çfarë ka nevojë fara që të lëshojë rrënjë?

-Po pas rrënjës, çfarë çel e mbin pak nga pak?

-Cili është roli i bletëve në udhëtimin e farës?

- **Veprimtaria e katërt**

Dallo-trego: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën për llojin e tekstit, duke përzgjedhur alternativën e saktë dhe duke dhënë shpjegimet përkatëse. (*Tekst informues. Paraqet informacione të hollësishme për ciklin e zhvillimit të farës.*)

- **Veprimtaria e pestë**

Shkrim i shpejtë: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxënësit/et me anë të një shkrimi të shpejtë, tregojnë preferencat e tyre për llojet e bimëve, ose luleve që duan të kultivojnë, duke vënë në dukje edhe arsyen e përzgjedhjes.

Nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre.

Ata/ato vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;

-dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;

-demonstron të kuptuarit e fjalëve të reja, duke krijuar fjali me to;

-tregon funksionin e farave për ripërtëritjen e bimës dhe ciklin e zhvillimit të saj, nga mbjellja në tokë, deri tek fruti i saj;

-demonstron të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;

-respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup;

-vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie:** Rubrika “Shkruaj

Fusha:Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Lulja që më pëlqen (ora I)		Situata e të nxënit Përshkruaj lulen tënde të preferuar.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan tulipanin, duke treguar karakteristikat kryesore të tij; • plotëson tekstin informues me fjalët e dhëna; • përgatit një skedë për lulen e trëndafilin, duke u bazuar te fotoja dhe njohuritë që ka për të; • shkruan duke u mbështetur në modelin dhe skedën, një tekst informues për lulen e trëndafilin; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalët kyçe: -tekst informues; -lule; -tulipan; -"Tulipa Albanica"	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor, -informacione të shkurtra nga interneti për lulen e tulipanit; -foto, vizatime të lules së tulipanit, lule të freskëta tulipani e trëndafilin; -enciklopedi, revista, kurozitetet për lulet; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -dikutim; -rishikim në dyshe; -mendo-puno në dyshe, shkëmbe; -shkrim i lirë; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të përshkruajnë lulen e tyre të preferuar, duke kërkuar që të ndalen te veçoritë e tyre siç janë: forma, ngjyra, madhësia e petaleve, kërcelli, periudha e lulëzimit, vendi ku jeton, etj... Paraqiten foto dhe vizatime të lules së tulipanit. Nxiten nxënësit/et të flasin rreth saj. Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe, diskutim:</i> Ushtrimi 1 ka karakter plotësues. Njihen nxënësit/et me kërkesën e ushtrimit. Nxënësit/et punojnë individualisht për të plotësuar tekstin me fjalët e dhëna. Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Më pas, ata/ato punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrin. Nxiten nxënësit/et të lexojnë tekstin e plotësuar. *Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es, për lulen e tulipanit dhe veçoritë e saj (lartësia, kërcelli, gjethet, aroma, ngjyrat) duke evidentuar edhe tulipanin shqiptar, të njohur me emrin "Tulipa Albanica". <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Mendo, puno në dyshe, shkëmbe:</i> Ushtrimi 2. Nxënësit/et do të plotësojnë skedën e dhënë në libër për lulen e trëndafilin. Orientohen nxënësit/et të vërejnë figurën në libër dhe të diskutojnë rreth saj në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën. Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të lexojnë skedën e paplotësuar, të mendohen për disa çaste për plotësimin e saj. Pastaj mendimet e tyre i shkëmbejnë me shokun/shoqen e bankës dhe në fund me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es. Pasi binden për përgjigjen e saktë, plotësojnë skedën. Nxënësit/et lexojnë skedën e plotësuar për lulen e trëndafilin. 			

• **Veprimtaria e katërt**

Shkrim i lirë: Ushtrimi 3. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shkruajnë një tekst informues për trëndafilin, duke u mbështetur në modelin e ushtrimit 1 dhe në skedën që kanë plotësuar për të. Nxiten nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre. Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime të gabimeve drejtshkrimore. Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Më poshtë po japim një variant të një teksti informues për lulen e trëndafilin.

Lulja që më pëlqen

Trëndafili është bimë zbukuruese që bën pjesë në familjen e shkurreve. Kjo bimë shkon deri në dy metra lartësi. Kërçelli është i mbushur me gjemba të gjatë dhe gjethe të vogla. Lulet e trëndafilin janë të bukura, me erë të këndshme. Petalet janë të mëdha dhe shumëngjyrëshe. Zakonisht çel në pranverë dhe verë. Trëndafili është lulja që u dhurohet më shpesh njerëzve.

• **Vlerësimi bëhet për:**

- përshkrimin e tulipanit, duke treguar karakteristikat kryesore të tij;
- plotësimin e tekstit informues me fjalët e dhëna;
- përgatitjen e një skede për lulen e trëndafilin, duke u bazuar te fotoja dhe njohuritë që ka për të;
- shkrimin duke u mbështetur në modelin dhe skedën, e një teksti informues për lulen e trëndafilin;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- qortimet e thjeshta drejtshkrimore të bëra me ndihmën e mësuesit/es;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

• **Detyrë shtëpie**

Kërko informacione në revista, enciklopedi, internet për lulen tënde të preferuar.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Lulja që më pëlqen (ora II)		Situata e të nxënit Lexim nga nxënësit/et i informacioneve për lulen e preferuar të marra nga revistat, enciklopeditë, interneti.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • tregon karakteristikat e lules që pëlqen më shumë; • përgatit një skedë për lulen e preferuar, duke u bazuar te fotoja dhe njohuritë që ka për të; • shkruan një tekst informues për lulen që pëlqen më shumë, sipas modeleve; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • vlerëson punën e shokëve dhe të shoqeve. 		Fjalët kyçe: -tekst informues; -lulja e preferuar; -karakteristika; -veçori;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/et; -teksti shkollor; -foto, vizatime të luleve; -enciklopedi, revista, kurozitetet për lulet; -mjete shkrimi, tabakë letre, lapustilë, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkenca e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim;
 - shkrim i lirë;
 - konkurs;
 - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve**
- **Veprimtaria e parë**

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë informacionet e sjella për lulen e preferuar, të marra nga revistat, enciklopeditë, interneti, duke i shoqëruar me foto, ose vizatime të tyre.

- **Veprimtaria e dytë**

Diskutim: Ftohen nxënësit/et të plotësojnë skedën për lulen e preferuar dhe të diskutojnë rreth saj.

- **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i lirë: Ushtrimi 4. Nxiten nxënësit/et të shkruajnë një tekst informues për lulen që pëlqen më shumë sipas modeleve.

Nxënësit/et punojnë individualisht për shkrimin e tekstit informues, duke e shoqëruar shkrimin me foto dhe vizatime.

Në përfundim të punës, shkëmbejnë fletoret ndërmjet tyre, kontrollojnë njëri-tjetrin.

Lexojnë detyrën para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es korrigjohen gabimet drejtshkrimore.

- **Veprimtaria e katërt**

Konkurs: Një juri e përbërë nga mësuesi/ja dhe 2 nxënës/e, ndajnë çmimet për tre shkrimet më të mira.

Nxënësit/et vlerësojnë punët e njëri-tjetrit.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- tregimin e karakteristikave të lules që pëlqen më shumë;
- përgatitjen e një skede për lulen e preferuar, duke u bazuar te fotoja dhe njohuritë që ka për të;
- shkrimin e një teksti informues për lulen që pëlqen më shumë, sipas modeleve;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- vlerësimin e punës së shokëve dhe të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie**

Përshkruaj sipas modeleve një lule që rritet në zonën tuaj.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Një vullkan “i bërë vetë”		Situata e të nxënësve *Nxënësit/et tregojnë se ç’dinë për vullkanet. *Një tekst udhëzues në jetën e përditshme.	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin udhëzues duke dalluar elementet kryesore të tij; • tregon shembuj nga jeta e përditshme të teksteve udhëzuese; • demonstroi në praktikë përdorimin e një teksti udhëzues; • bëri dallimin ndërmjet udhëzimeve dhe këshillave; • demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit udhëzues, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij; • gjykon pse nuk mund të ndryshohet radha e udhëzimeve që jepet në një tekst udhëzues; • analizon gjuhën e përdorur në tekstet udhëzuese; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -tekst udhëzues; -udhëzime; -këshilla; -përmbajtja e tekstit udhëzues; -organizimi; -gjuha në tekstin udhëzues; -vullkan.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -tekste të ndryshme udhëzuese; -informacione nga interneti për vullkanet; -gotë letre, rrotull letre alumini, plastelinë, paketë sodë buke, shishe uthulle; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shkencat e natyrës; -teknologjia dhe TIK-u; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -stuhi mendimesh; -lexo-komento; -lexo-vepro; -diskutim: -analizë: -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Stuhi mendimesh:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të tregojnë se ç’dinë për vullkanet, mbi bazën e njohurive që kanë për të dhe informacioneve të marra nga interneti, enciklopeditë, dokumentarët, etj... *Mësuesi/ja ndihmon dhe saktëson mendimet e nxënësve për vullkanin, duke iu referuar tekstit të shkurtër informues për vullkanin, i cili lexohet dhe komentohet nga nxënësit/et. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Lexo-komento:</i> Më pas nxiten nxënësit/et, të lexojnë tekstet udhëzuese që ata/ato kanë sjellë në klasë, p.sh.: tekste udhëzuese, që shoqërojnë përdorimin e një medikamenti mjekësor që ne marrim kur jemi të sëmurë, instalimin dhe përdorimin e një pajisje elektroshtëpiake, të një celulari, të përdorimit të produkteve të ndryshme, etj... Me ndihmën e mësuesit/es zhvillohet një diskutim rreth tekstit udhëzues, duke prezantuar me anë të një klasteri elementet kryesore të një teksti udhëzues (përmbajtja, gjuha, organizimi). Mësuesi/ja prezanton temën e mësimi Një vullkan “i bërë vetë”. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Lexo-vepro:</i> Ftohen nxënësit/et të përgatisin një vullkan duke ndjekur hap pas hapi udhëzimet në tekstin udhëzues në libër. Nxënësit/et punojnë në grupe. Secili grup vendos mjetet e duhura mbi tavolinë. Ata/ato ndajnë detyrat në grup. Më pas merren me përgatitjen e një vullkani të improvizuar me mjete rrethanore, duke ndjekur udhëzimet në tekst dhe duke patur parasysh këshillat e dhëna në rubrikën “Këshilla”. 			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <p><i>Diskutim:</i> Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxiten nxënësit/et:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ të gjejnë alternativën e saktë, nëse vullkani për të cilin bën fjalë teksti, është i vërtetë, apo një eksperiment për ta paraqitur atë; ○ të gjejnë numrin e udhëzimeve që duhet të ndjekin për ta “bërë vetë vullkanin”, duke i treguar ato; ○ të gjejnë numrin e këshillave që jepen në tekst, duke i treguar ato. <p>Mësuesi/ja të kujdeset për të bërë dallimin ndërmjet udhëzimeve dhe këshillave.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e pestë <p><i>Analizë:</i> Punohet rubrika “Analizoj”, ku nxënësit/et gjejnë alternativën e saktë rreth përmbajtjes së tekstit dhe të analizojnë gjuhën e përdorur në tekstin udhëzues.</p> <p>Nxiten nxënësit/et të gjykojnë dhe të japin mendimin e tyre, nëse mund të ndryshohet radha e udhëzimeve, apo radha e këshillave në përdorimin e një teksti udhëzues, duke i konkretizuar me radhën e udhëzimeve në tekstin udhëzues për përgatitjen e një vullkani.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e gjashtë <p><i>Bashkëbisedim:</i> Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxënësit/et japin mendimin e tyre, pse ky vullkan quhet “i bërë vetë”. Nxiten ata/ato të tregojnë për vullkanet nga dokumentarët që kanë parë.</p> <p>Ata/ato vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -leximin e tekstit udhëzues duke dalluar elementet kryesore të tij; -demonstrimin në praktikë të përdorimit të një teksti udhëzues; -dallimin që bën ndërmjet udhëzimeve dhe këshillave; -demonstrimin e të kuptuarit të përmbajtjes së tekstit udhëzues, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij; -gjykimin se pse nuk mund të ndryshohet radha e udhëzimeve që jepet në një tekst udhëzues; -analizën e gjuhës së përdorur në tekstet udhëzuese; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve. <ul style="list-style-type: none"> • Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Flasim Dita pa makina		Situata e të nxënit Dita pa Makina në qytetin tonë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • diskuton në grupe për temën “Dita pa Makina”; • bën një prezantim të thjeshtë të kësaj dite, kur ka filluar ajo të mbahet në nivel ndërkombëtar përfshirë edhe vendin tonë; • demonstroi siguri kur flet në klasë; • shpreh opinionet, mendimet dhe ndjesitë e tij/saj rreth rëndësisë që ka kjo ditë në promovimin e alternativave mjedisore në transport, me një gjuhë të saktë e të kuptueshme; • nxit të tjerët të bashkëbisedojnë për ndërgjegjësimin që bën kjo ditë për pasojat negative që shkakton përdorimi i automjeteve në mjedis dhe ngrohjen globale; • përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës; • respekton rregullat e të folurit gjatë komunikimit me të tjerët; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. 		Fjalët kyçe: -Dita pa Makina; -qarkullim me biçikletë; -korsi;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -pamje nga qytetet me një trafik të rënduar të makinave; -foto që nxënësit/et kanë bërë me biçikleta në Ditën pa Makina; -informacione nga interneti për Ditën pa Makina; -videoprojektor; -material i shkurtër filmik ku jepet një rrugë me trafik të rënduar nga makinat; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës; -teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -vendimmarrja morale; -bashkëjetesa paqësore.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - shikim i organizuar;
 - imagjinatë e drejtuar;
 - diskutim paraprak;
 - vëzhgo-diskuto;
 - trego-diskuto;
 - lexo-diskuto;
 - bashkëbisedim;
 - krijim i një posteri;
 - punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Shikim i organizuar: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shikojnë njëvideo ku të ketë një rrugë me shumë trafik dhe zhurma borish. (Në mungesë, një foto që e zëvendëson).

*Zhvillohet një diskutim me nxënësit/et.

-Çfarë vutë re në materialin filmik që ndoqët?

-Si ndiheni pasi patë këto pamje?

Imagjinatë e drejtuar: -Mbyllni sytë dhe imagjinoni sikur me një përplasje duarsh, makinat u zhdukën, rruga është bosh dhe e qetë. Si ndihesh? Cila është dëshira jote më e madhe në këtë çast? (të vrapoj, të eci, të ngas biçikletën, të pedaloj, etj)...

- **Veprimtaria e dytë**

Diskutim paraprak: Mësuesi/jafton nxënësit/et të tregojnë mbresat e tyre nga Dita pa Makina, duke i drejtuar pyetjet:

-Ç’ dini rreth Ditës pa Makina? Kur ka filluar të mbahet ajo?

-A keni marrë pjesë në veprimtaritë që zhvillohen gjatë javës pa makina që finalizohet më 22 shtator të çdo viti?

-Çfarë keni vënë re gjatë kësaj dite në bulevardin kryesor të Tiranës, apo nëpërmjet mediave, në shumë qytete të botës?

-Çfarë synon të sensibilizojë kjo ditë?

-Pse konsiderohet jetike mbrojtja e mjedisit nga ndotësit teknologjikë, siç janë edhe makinat?

-Cilat janë pasojat negative që shkakton përdorimi i automjeteve në mjedis?

*Nxiten nxënësit/et të cilët mund të kenë bërë foto në këtë ditë për t’i komentuar ato.

*Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit.

- **Veprimtaria e tretë**

Vëzhgo-diskuto: Ushtrimin 1. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të vëzhgojnë fotot në libër.

Ata/ato diskutojnë në fillim në dyshe rreth tyre, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxiten nxënësit/et të punojnë në grupe për të treguar të përbashkëtat dhe ndryshimet midis dy fotove, nëpërmjet një diagrami Veni. Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e tyre para klasës.

- **Veprimtaria e katërt**

Trego-diskuto: Ushtrimi 2. Orientohen nxënësit/et të tregojnë se çfarë dinë për Ditën pa Makina dhe për aktivitetet që zhvillohen në këtë ditë. Përgjigjet e nxënësve/eve, mësuesi/ja i paraqet me anë të një kllasteri në tabelë.

- **Veprimtaria e pestë**

Lexo-diskuto: Ushtrimi 3. Nxënësit/et lexojnë materialin që Jehona gjeti në internet për Ditën pa Makina dhe diskutojnë rreth tij duke iu përgjigjur pyetjeve:

-Si mendon pse Dita pa Makina është kulmi i kësaj jave?

-Cilat janë aktivitetet që organizohen në vendin ku ti banon?

- **Veprimtaria e gjashtë**

Bashkëbisedim: Ushtrimi 4. Nxiten nxënësit/et të tregojnë se çfarë do t’i sjellë qytetit të Tiranës, nisma për ndërtimin korsive të posaçme për qarkullimin me biçikletë.

- **Veprimtaria e shtatë**

Krijim i një posteri: Ushtrimi 5. Nxënësit/et diskutojnë në grupe se çfarë mund të bëjnë për të rralluar përdorimin e makinës. Mendimet e tyre, i shkruajnë në postera, duke i shoqëruar me vizatime. Ata/ato shkruajnë mesazhe sensibilizuese për nxitjen e prindërve të tyre, për uljen e përdorimit të makinave dhe promovimin e alternativave mjedisore në transport, siç janë: biçikleta, autobusi, ecja në këmbë, etj...

Përfaqësuesi/ja e secilit grup prezanton posterin, duke e komentuar atë.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-diskutimin në grupe për temën “Dita pa Makina”;

-demonstrimin e sigurisë kur flet në klasë;

-shprehjen e opinionëve, mendimeve dhe ndjesive të tij/saj rreth rëndësisë që ka kjo ditë në promovimin e alternativave mjedisore në transport, me një gjuhë të saktë e të kuptueshme;

-nxitjen e të tjerëve të bashkëbisedojnë për ndërgjegjësimin që bën kjo ditë për pasojat negative që shkakton përdorimi i automjeteve në mjedis dhe ngrohjen globale;

-përdorimin e një fjalori të përshtatshëm rreth temës;

-respektimin e rregullave të të folurit gjatë komunikimit me të tjerët;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore T'i vijmë në ndihmë Tokës!		Situata e të nxënit Nga se kërcënohet natyra dhe mjedisi ynë?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin udhëzues duke dalluar elementet kryesore të tij; • dallon tekstin udhëzues nga tekstet e tjera; • vë në dukje rëndësinë që ka kultivimi i bimëve dhe i drurëve për mbrojtjen e Tokës dhe mjedisit në përgjithësi; • tregon shembuj nga jeta e përditshme për mbrojtjen e mjedisit dhe të natyrës; • vlerëson përgjegjësitë që kemi në familje dhe komunitet, për mbrojtjen e mjedisit dhe të natyrës; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -Toka; -ndotje; -mbrojtje; -respekt ndaj mjedisit dhe natyrës; -përgjegjësi.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -pamje të ndryshme të planetit tonë; -informacione nga interneti për kërcënimet që i vijnë mjedisit dhe natyrës nga ndotësit e ndryshëm; -postera sensibilizues për mbrojtjen e mjedisit; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -shkencat e natyrës; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi; -të drejtat e njeriut; -vendimmarrja morale.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -stuhi mendimesh; -lexo-diskuto; -mendo-nxirr përfundimin; -analizë; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Stuhi mendimesh:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et t'i përgjigjen pyetjes: -Si mendoni nga se është e kërcënuar natyra dhe mjedisi ynë? Përgjigjet e nxënësve/eve i paraqet me anë të një kllasteri në tabelë.</p> <div style="text-align: center;"> <pre> graph TD A((Natyra dhe mjedisi kërcënohen)) --> B[nga hedhja e mbeturinave dhe e plehrave] A --> C[shpyllëzimet] A --> D[nga mbetjet teknologjike] A --> E[gazrat, tymrat e fabrikave e uzinave] A --> F[nga derdhja e kimikateve, detergjenteve] A --> G[betonizimet pa kriter] </pre> </div> <p>Nxënësit/et tregojnë dhe diskutojnë rreth fotove të ndryshme të pamjes së Tokës, ku vihet re ndotja e saj. Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Lexo-diskuto:</i> Nxiten nxënësit/et të komentojnë fotot në libër dhe të diskutojnë rreth tyre. Lexim i tekstit nga nxënësit/et dhe diskutim rreth secilit paragraf të tekstit. Nxiten ata/ato të tregojnë llojin e tekstit (tekst udhëzues).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <p><i>Mendo-nxirr përfundimin:</i> Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et përzgjedhin alternativën e saktë për mënyrën e jetesës që krijojmë, duke ndjekur këshillat e tekstit. Ata/ato punojnë për plotësimin e fjalive të paplotësuara dhe i lexojnë para klasës.</p>			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <p><i>Analizë:</i> Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et analizojnë gjuhën e përdorur në tekst duke gjetur alternativën e saktë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e pestë <p><i>Bashkëbisedim:</i> Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxënësit/et të tregojnë se çfarë bëjnë ata/ato dhe familja e tyre për të respektuar natyrën.</p> <p>*Lexohen informacione të marra nga interneti për veprimtaritë që zhvillohen me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës (22 Prill), në muajin e pyllëzimit (dhjetor), por edhe në ditë të tjera të vitit për t’i ardhur në ndihmë Tokës.</p> <p>Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <p>-leximin e tekstit udhëzues duke dalluar elementet kryesore të tij;</p> <p>-vënien në dukje të rëndësisë që ka kultivimi i bimëve dhe i drurëve për mbrojtjen e Tokës dhe mjedisit në përgjithësi;</p> <p>-tregimin e shembujve nga jeta e përditshme për mbrojtjen e mjedisit dhe të natyrës;</p> <p>-vlerësimin e përgjegjësisë që kemi në familje dhe komunitet për mbrojtjen e mjedisit dhe të natyrës;</p> <p>-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;</p> <p>-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Detyrë shtëpie <p>Shkruaj një tekst të shkurtër me temë “Si kontribuoj unë në mbrojtje të Tokës dhe mjedisit”.</p>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Në mbrojtje të mjedisit (ora I)		Situata e të nxënit Si të shkruajmë një plan javor për një veprimtari të caktuar.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • ndërton fjali për mbrojtjen e mjedisit, duke zgjedhur nga fjalët dhe grupet e fjalëve të dhëna si dhe duke u mbështetur në foto; • zbaton udhëzimet e dhëna për të shkruar një plan javor për mbrojtjen e mjedisit; • plotëson tabelën e një plani javor “Në mbrojtje të mjedisit”; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalët kyçe: -plan javor; -veprimtari; -”Mbrojtja e mjedisit”; -kontribut; -përgjegjësi; -ndërgjegjësim.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor, -foto që pasqyrojnë ndotjen e mjedisit nga faktorë të ndryshëm; -foto, postera që evidentojnë rolin e fëmijëve në mbrojtjen e mjedisit; -video, informacione nga interneti; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkenca e natyrës.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim paraprak;
 - rishikim në dyshe;
 - shkrim i drejtuar;
 - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim paraprak: Mësuesi/ja u drejton nxënësve/eve pyetjen:

-Çfarë duhet të kemi parasysh për të shkruar një plan veprimtarie njëjavore?

Merren mendimet e nxënësve/eve lidhur me këtë pyetje.

*Tregohet dhe diskutohet si veproi klasa e Eltonit për të shkruar një plan javor.

- **Veprimtaria e dytë**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të vërejnë fotot në tekst dhe të diskutojnë rreth tyre. Nxënësit/et diskutojnë në dyshe, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxiten nxënësit/et të punojnë individualisht për të shkruar nga një fjali për çdo foto, duke përzgjedhur nga fjalët dhe grupet e fjalëve të dhëna.

Në përfundim të punës shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, kontrollojnë njëri-tjetrin dhe lexojnë fjalitë para klasës.

- **Veprimtaria etretë**

Punë në grupe; Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 2. Mësuesi/ja fton nxënësit/et që bazuar në planin javor për mbrojtjen e mjedisit që ka hartuar klasa e Eltonit, të ndërtojnë një plan të ngjashëm duke renditur të gjithë hapat e nevojshëm dhe udhëzimet e përshtatshme, të cilat do ta bëjnë më të lehtë dhe më të efektshëm organizimin e fëmijëve për mbrojtjen e mjedisit.

Së pari, nxënësit/et do të japin idetë e tyre në lidhje me veprimtarinë që do të kryejnë gjatë javës.

Së dyti, të përzgjedhin idetë më të përshtatshme.

Së treti, të caktojnë vendin, ditën dhe orën e kryerjes së secilës prej veprimtarive.

Së katërti, të përfshijnë bashkëpunimin me më të rriturit në planin e tyre.

Së pesti, e shkruajnë planin javor të arritur me konsensus dhe e vendosin atë në një vend të dukshëm në klasë.

Tabela duhet të jetë e shkruar qartë dhe t'i pasqyrojë të gjitha rubrikat e renditura më lart.

*Mësuesi/ja sqaron nxënësit/et se fjalitë që ata ndërtuan për secilën foto në ushtrimin 1, janë njëkohësisht edhe tematikat e veprimtarive që mund të kryhen në mbrojtje të mjedisit. Udhëzohen nxënësit/et, të zgjedhin 5 prej tyre, të cilat u duken më të rëndësishme për planin e veprimtarisë që do të zhvillohet gjatë një jave (nga një veprimtari për çdo ditë).

*Udhëzohen nxënësit/et plotësojnë në grupe tabelën e planit javor “Në mbrojtje të mjedisit”, duke u bazuar në udhëzimet e dhëna.

Përfaqësuesit/et e secilit grup prezantojnë tabelën e plotësuar të planit javor në mbrojtje të mjedisit.

Më poshtë po japim një variant përfundimtar të një plani javor “Në mbrojtje të mjedisit”.

PLAN JAVOR		“NË MBROJTJE TË MJEDISIT”		
Nr.	Veprimtaritë që do kryejmë	Vendi ku do të kryhet veprimtaria	Koha kur do të kryejmë veprimtaritë	Personat që do të na ndihmojnë
1.	Krijimi i fletëpalosjeve për të ndërgjegjësuar komunitetin.	Klasa	E hënë, në orën e artit pamor	Mësuesja dhe nxënësit e klasave të më të larta
2.	Shpërndarja e fletëpalosjeve.	Shkolla dhe zona rreth saj	E martë, pas mësimt	Prindërit dhe mësuesja
3.	Mbjellja e luleve dhe pemëve.	Oborri i shkollës, parku pranë shkollës, kodrat e liqenit.	E mërkurë, në orën e diturisë së natyrës	Nxënësit e klasave më të larta
4.	Riciklimi i mbetjeve (përgatitja e koshave)	Klasa dhe korridoret e shkollës	E enjte, në orën e kurrikulës me zgjedhje	Mësuesja, prindërit, nxënësit e klasave më të larta
5.	Prezantimi i veprimtarive të kryera	Salla e aktiviteteve	E premte, në orën 10 ⁰⁰	Mësuesja, prindërit, nxënësit e klasave më të larta, komuniteti

• **Vlerësimi bëhet për:**

- ndërtimin e fjalive për mbrojtjen e mjedisit, duke zgjedhur nga fjalët dhe grupet e fjalëve të dhëna si dhe duke u mbështetur në foto;
- zbatimin e udhëzimeve të dhëna për të shkruar një plan javor për mbrojtjen e mjedisit;
- plotësimin e tabelës së një plani javor “Në mbrojtje të mjedisit”;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Në mbrojtje të mjedisit (ora II)		Situata e të nxënit Shkruajmë një plan javor për një temë të caktuar.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • tregon hapat për realizimin e një plani javor; • zbaton udhëzimet e dhëna për të shkruar një plan javor për një temë të caktuar; • shkruan një plan javor për një temë të caktuar, duke u bazuar në modele; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalët kyçe: -plan javor.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; -teksti shkollor; - modeli i një plani javor; -mjete shkrimi, tabakë letre, lapustilë, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; -shkencat e natyrës.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim; -shkrim i drejtuar; -konkurs; -punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve • Veprimtaria e parë <p><i>Diskutim paraprak:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et, që të tregojnë, se cilat janë hapat që duhet të ndiqen për hartimin e një plani javor të një veprimtarie me një temë të caktuar të karakterit social, kulturor, shoqëror, apo kombëtar, duke u bazuar në planin javor të hartuar për mbrojtjen e mjedisit.</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.</p> <p>Përgjigjet e nxënësve mësuesi/ja i shkruan në tabelë.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nxënësit/et japin idetë e tyre në lidhje me temën që kanë zgjedhur. 2. Përzgjedhin idetë më të përshtatshme për realizimin e planit javor për temën e përzgjedhur. 3. Caktojnë vendin, ditën dhe orën e kryerjes së veprimtarisë. 4. Ftojnë për të bashkëpunuar më të rriturit për realizimin e planit të parashikuar. 5. Shkruajnë planin javor të arritur me konsensus si dhe e vendosin atë në një vend të dukshëm në klasë. <p>Tabela duhet të jetë e shkruar qartë dhe t’i pasqyrojë të gjitha rubrikat e renditura më lart.</p>			

- **Veprimtaria e dytë**

Punë në grupe: Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 3. Bazuar në planin javor të hartuar për mbrojtjen e mjedisit dhe në përvojën e fituar nga debati që shoqëroi hartimin e planit javor të mësipërm, nxënësit/et në grupe do të hartojnë një plan javor për një nga temat e propozuara.

Mësuesi/ja mbikqyr punën e grupeve dhe i sqaron ata/ato për paqartësitë që mund të kenë.

Përfaqësuesit e secilit grup paraqesin planin e hartuar ta paraqitur në tabelë, duke komentuar shkurtimisht se pse e kanë zgjedhur kryerjen e kësaj veprimtarie.

Me ndihmën e mësuesit/es korrigjohen gabimet drejtshkrimore.

- **Veprimtaria e tretë**

Konkurs: Një juri e përbërë nga 2 nxënës/e dhe mësues/ja, përzgjedhin planin javor më të realizuar.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-tregimin e hapave për realizimin e një plani javor;

-zbatimin e udhëzimeve të dhëna për të shkruar një plan javor për një temë të caktuar;

-shkrimin e një plani javor për një temë të caktuar, duke u bazuar në modele;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;

-qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie**

Secili nxënës/e shkruan një plan javor, për një nga temat e dhëna në ushtrimin 3, të cilën nuk e ka zhvilluar gjatë punës në grup në klasë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Dëgjojmë Sjelljet e mira		Situata e të nxënësve Çfarë e dallon një sjellje të mirë?	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon, duke mbajtur shënime për çështjet më interesante; • demonstroi të dëgjuar të qëllimshëm në kryerjen e detyrave; • diskuton rreth pjesës që dëgjon, duke u mbështetur në shënime të mbajtura prej tij/saj; • tregon për rregullën më të lehtë dhe më të vështirë për t'u zbatuar që të ndihesh mirë, duke argumentuar mendimin e tij/saj; • krijon librin e rregullave të klasës, duke ndjekur udhëzimet; • vlerëson rëndësinë e zbatimit të rregullave në shtëpi, shkollë, komunitet, shoqëri etj; • pranon dhe tregon respekt ndaj ideve dhe mendimeve të shokëve rreth pjesës që dëgjojnë; • bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. 		Fjalë kyçe: -rregulla; -sjellje e mirë; -libri i rregullave të klasës.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -rregullorja e shkollës dhe e klasës; -CD, magnetofon; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore; -vendimmarrja morale.	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

- **Metodologjia:**

- diskutim paraprak;
- veprimtari e dëgjimit dhe e mendimit të drejtuar;
- diskuto-argumento;
- krijim;
- debat i argumentuar;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.


- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- **Veprimtaria e parë**

Diskutim paraprak: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të tregojnë çfarë kanë mësuar rreth disa rregullave “të sjelljes së mirë”, në familje, në klasë, në komunitet.

Nxënësit/et nxiten të tregojnë disa nga sjelljet e kulturuar që i bëjnë ata/ato të jetojnë në harmoni me të tjerët, disa rregulla, ose sjellje të mira dhe korrekte që i kanë mësuar nga prindërit, mësueset dhe më të rriturit, të cilat i kanë bërë ata më të respektuar prej të tjerëve.

Mësuesi/ja shkruan në tabelë disa nga sjelljet e mira që tashmë janë bërë një rregull për nxënësit/et.



Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit “Sjelljet e mira”.

- **Veprimtaria e dytë**

Veprimtari e dëgjimit dhe e mendimit të drejtuar: Mësuesi/ja fton nxënësit/et (ushtrimi 1), të dëgjojnë nga magnetofoni tekstin dhe gjatë dëgjimit, të mbajnë shënime për çështjet që u duken interesante.

Nxiten nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve rreth tekstit:

- Çfarë është Galateo?
- Kush e shkroi këtë libër?
- Në ç’kohë është shkruar ai?
- Çfarë përmban ky libër?
- Pse është i rëndësishëm Galateo?
- Cilat janë disa nga rregullat që mund të përmbajë Galateo? Diskuto me shokët.

- **Veprimtaria e tretë**

Diskuto-argumento: Ushtrimi 2. Ftohen nxënësit/et të dëgjojnë pesë rregullat themelore të shkëputura nga Galateo, duke mbajtur shënime rreth tyre. Nxiten ata/ato të tregojnë dakordësinë e tyre me to, duke argumentuar përgjigjet e tyre.

- **Veprimtaria e katërt**

Krijim: Punë në grupe: Ushtrimi 3. Nxënësit/et punojnë për të krijuar librin e rregullave të klasës së tyre, duke ndjekur udhëzimet e dhëna të cilat do t’i dëgjojnë një nga një nga magnetofoni, ose nga leximi i mësuesit/es. Pas leximit të çdo rregulli, nxënësit/et veprojnë për të krijuar librin, duke u drejtuar edhe nga figurat në tekst. Ata/ato mund të lidhin me vijë çdo rregull me një nga figurat e tekstit.

*Prezantohet libri para klasës. Përfaqësuesit/et e çdo grupi, prezantojnë kontributin e tyre në këtë libër dhe vendoset ai në bibliotekën e klasës.

- **Veprimtaria e pestë**

Debat i argumentuar: Nxiten nxënësit/et të debatojnë, se cila është rregulla më e lehtë dhe më e vështirë për t’u zbatuar që të ndihesh më mirë me të tjerët, duke argumentuar përgjigjet e tyre.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- ndjekjen me vëmendje të tekstit që dëgjon, duke mbajtur shënime për çështjet më interesante;
- demonstrimin e të dëgjuarit të qëllimshëm në kryerjen e detyrave;
- diskutimin rreth pjesës që dëgjon, duke u mbështetur në shënimet e mbajtura prej tij/saj;
- tregimin për rregullën më të lehtë dhe më të vështirë për t’u zbatuar që të ndihesh mirë, duke argumentuar mendimin e tij/saj;
- krijimin e librit të rregullave të klasës, duke ndjekur udhëzimet;
- vlerësimin e rëndësishëm të zbatimit të rregullave në shtëpi, shkollë, komunitet, shoqëri etj;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Stafeta		Situata e të nxënësve Diskutim: Rëndësia e rregullave të lojës.	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin duke dalluar elementet kryesore të tij; • demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth organizimit dhe zhvillimit të lojës së stafetës; • shpjegon se pse në fund të lojës së stafetës, njëra skuadër është më e shpejtë se tjetra; • demonstroi në praktikë përdorimin e një teksti udhëzues, gjatë ekzekutimit të lojës së stafetës; • vlerëson rëndësinë e zbatimit të rregullave për një lojë korrekte të ndershme dhe konkurruese; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -tekst udhëzues; -përmbajtja e tekstit udhëzues; -gjuha në tekstin udhëzues; -lojë; -stafetë; -rregulla.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -foto të fëmijëve duke zhvilluar stafetë; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -edukim fizik, sporte dhe shëndet; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi; -vendimmarrja morale.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -pyetja sjell pyetjen; -lexo-komento; -lexo-përmbledh në dyshe; -rishikim në dyshe; -analizë; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Pyetja sjell pyetjen:</i> Mësuesi/ja u drejton pyetjet nxënësve/eve: -Cila është loja juaj e preferuar? -Pse e keni zgjedhur atë? -Cilat janë rregullat e lojës suaj të preferuar? -Pse mendoni se rregullat janë kaq të rëndësishme për lojën dhe garën e ndershme në lojë? -A ju ka ndodhur të luani lojën e stafetës? -Si luhet ajo? Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit “Stafeta”. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Lexo-komento:</i> Ftohen nxënësit/et të lexojnë tekstin udhëzues për lojën e stafetës. Ata /ato diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth tij. • Veprimtaria e tretë <i>Lexo-përmbledh në dyshe:</i> Nxënësit/et lexojnë dhe përmbledhin në dyshe informacionin për lojën e stafetës dhe nxiten të vendosin numrat në figura, që u korrespondojnë veprimeve të garës nga vijëzimi i pistës deri në përfundim të garës. • Veprimtaria e katërt <i>Rishikim në dyshe:</i> Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxiten nxënësit/et të dallojnë pohimet e vërteta dhe të gabuara. Nxënësit/et këmbëjnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim në klasë rreth ushtrimit nën drejtimin e mësuesit/es. • Veprimtaria e pestë <i>Analizë:</i> Punohet rubrika “Analizoj”, ku nxënësit/et shpjegojnë me fjalët e tyre se si e kuptojnë që njëra skuadër është më e shpejtë se tjetra. 			

- **Veprimtaria e gjashtë**

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit/et të tregojnë nëse e kanë luajtur ndonjëherë lojën e stafetës dhe të tregojnë nëse i kanë zbatuar në mënyrë korrekte rregullat.

Ata/ato vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.

- **Veprimtaria e shtatë**

Veprimtari: Në 10 minutat e fundit, nxënësit/et ndahen në grupe dhe zhvillojnë lojën e stafetës, duke zbatuar rregullat e lojës.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e tekstit udhëzues duke dalluar elementet kryesore të tij;

-demonstrimin e të kuptuarit të përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth organizimit dhe zhvillimit të lojës së stafetës;

-shpjegimin e domethënies së fjalëve “njëra skuadër është më e shpejtë se tjetra”;

-demonstrimin në praktikë të përdorimit të një teksti udhëzues, gjatë ekzekutimit të lojës së stafetës;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie:** Rubrika “Sh

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Dialektet e gjuhës shqipe		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar dialektet e gjuhës shqipe.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon dialektet e gjuhës shqipe nga gjuha standarde shqipe (gjuha e njësuar letrare); • shndërron fjalë nga njëri dialekt në tjetrin; • bën lidhjen e gjuhës së folur në familjen e tij/të saj me njërin prej dialekteve të gjuhës shqipe; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson dialektet si pasuri e gjuhës shqipe; • vlerëson punën e të tjerëve; • demonstroi besim në forcat e veta, respekt dhe tolerancë brenda grupit. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -gjuhë letrare; -dialekti gegë; -dialekti toskë; -shqiptoj; -shndërroj; 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -magnetofon; -inçizime të pjesëve nga tekste letrare në dialekte të ndryshme dhe në gjuhën letrare; -mjete shkrimi, lapustilë, fisha, fletore, tabakë letre, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. 	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - dëgjim i drejtuar;
 - diskutim në dyshe;
 - dallo-emërto-lidh;
 - rishikim në dyshe;
 - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Dëgjim i drejtuar: Nxënësit/et ftohen të dëgjojnë inçizime të shkurtra të poezive, apo pjesëve letrare, në gjuhë letrare dhe në dialekt. Diskutohet me nxënësit rreth ndryshimit midis tyre. (Në pamundësi të një materiali të incizuar, mësuesi/ja lexon vetë poezi, ose fragmente pjesësh letrare në të dy dialektet dhe në gjuhë letrare).

- **Veprimtaria e dytë**

Diskutim në dyshe: Lexohen dhe komentohen vargjet e Fishtës, të shkëputura nga poezia e tij me titull “Gjuha shqipe”, në tekst. Zbërthehet kuptimi i tyre. Veçohen fjalët e përdorura në dialekt. Diskutohet rreth ndryshimit që kanë ato fjalë me të folurën e ditëve të sotme.

Nxënësit/et lexojnë informacionin e dhënë në rubrikën “Mbaj mend”. Ata/ato bëjnë pyetje rreth këtij informacioni. Mësuesi/ja tregon se gjuha shqipe ka dy dialekte: gegë dhe toskë, që i përkasin pjesës veriore dhe jugore të Shqipërisë, duke konkretizuar me shembuj, shqiptimin e disa fjalëve në këto dy dialekte dhe në gjuhën letrare.

- **Veprimtaria e tretë**

Dallo-emërto-lidh: Ushtrimi 1 do të punohet në dyshe. Nxënësit/et do të diskutojnë për të dalluar kujt dialekti i përkasin fjalët. Më pas bëjnë ngjyrosjen individualisht. Bëhet korrigjimi kolektiv i kësaj detyre. Kërkohet nga nxënësit/et të bëjnë lidhjen e gjuhës së përdorur në shtëpinë e tyre me njërin prej dialekteve. Punohet individualisht ushtrimi 2, diskutohet me gjithë klasën pyetja e ushtrimit 2.

- **Veprimtaria e katërt**

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 3, punohet nëpërmjet diskutimit në dyshe. Mësuesi/ja ndihmon nxënësit/et të përcaktojnë kuptimin e fjalëve që nuk ua dinë kuptimin dhe më pas kërkon që t’i përdorin në fjali ato. Për ushtrimin 4 nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Në përfundim të punës, shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e dy dialekteve të gjuhës shqipe dhe lidhjen e tyre me zonën që i përkasin;
- shndërrimin e fjalëve nga njëri dialekt në tjetrin;
- lidhjen e gjuhës së folur nga familja e ti/saj me njërin nga dialektet, apo gjuhën standarde shqipe;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- vlerësimin e dialekteve si pasuri e gjuhës shqipe;
- vlerësimin e punës së të tjerëve;
- demonstrimin e besimit në forcat e veta, respektit dhe tolerancës brenda grupit.

- **Detyrë shtëpie**

Ushtrimi 5. Nxënësit/et do të lexojnë poezinë e Ndre Mjedës “Gjuha shqype” dhe të nënvizojnë fjalët e dialektit gegë, duke shpjeguar kuptimin e secilës prej tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Rregullat e detit		Situata e të nxënët Diskutim me nxënësit/et për rëndësinë e zbatimit të rregullave në jetën e përditshme.	
Rezultatet e të nxënët Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • plotëson fjalët mungesore në tekst; • lexon rregullat në tekst me intonacionin e duhur; • diskuton rreth rregullave të plazhit; • vlerëson rëndësinë e zbatimit të rregullave kur je në plazh; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • demonstron aftësi të bashkëpunimit në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -rregulla; -det -plazh -krahasim	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -sport; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -imagjinatë e drejtuar-diskutim; -vëzhgo-komento; -ditar dypjesësh; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Imagjinatë e drejtuar-Diskutim:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të imagjinojnë me sy mbyllur për një minutë një botë pa rregulla. Ata/ato tregojnë ç'panë me sytë e mendjes dhe më pas japin mendimin e tyre në lidhje me rëndësinë e zbatimit të rregullave në jetën e përditshme. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Vëzhgo-komento:</i> Mësuesi/ja paraqet temën e mësimin dhe fton nxënësit/et të vërejnë ilustrimet. Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën, diskutojnë rreth tyre. <i>*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin dhe ta plotësojnë atë me fjalët që mungojnë, duke u mbështetur edhe në ilustrimet e tij. Rilexojnë tekstin duke nënvizuar dhe mbajtur shënime.</i> <i>*Pas leximit të çdo rregulli, nxënësit/et diskutojnë në dyshe rreth rëndësisë së secilit prej rregullave të shkruar në tekst dhe pasojës që sjell moszbatimi i tyre.</i> <i>*Nxënësit/et tregojnë llojin e tekstit, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij (tekst udhëzues). Plotësohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”.</i> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Ditar dypjesësh:</i> Nxënësit/et plotësojnë një ditër dypjesësh në lidhje me pyetjen e dytë të rubrikës “Reflektoj” <i>*Nxënësit/et krahasojnë përgjigjet dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.</i> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -leximin e rregullave të tekstit me intonacionin e duhur; -plotësimin e fjalëve mungesore në tekst; -diskutimin rreth rregullave të plazhit; -vlerësimin e rëndësisë së zbatimit të rregullave kur je në plazh; -paraqitjen e komunikimit e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj; -demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup; -vlerësimin që i bëjnë punës së shokëve e të shoqeve. 			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Bora e parë		Situata e të nxënësve Ndërtimi i një historie duke u mbështetur në terma paraprake.	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; • shpreh mendimet personale rreth një teksti-ditar, me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es; • tregon llojin e tekstit që lexon, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit; • rendit sipas rrjedhës së shkrimit të ditarit, fjalitë përmbledhëse të tekstit; • lidh tregimin me ngjarje nga jeta e tij/saj, kur ai është ndodhur në situata të vështira, duke treguar se si e ka zgjidhur atë; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalët kyçe: -ditar -shkrim personal -ngjarje të rëndësishme -bora e parë	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, flete A4		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte; Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -parashikim me terma paraprakë; -diskutim për njohuritë paraprake; -lexim dhe pyetje; -diskutim; -hulumtim; -bashkëbisedim; -punë individuale; punë me gjithë klasën; punë në dyshe; punë në grup • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Parashikim me terma paraprakë:</i> Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët: <i>borë, oborr, fëmijë, luaj</i>. Kërkon nga nxënësit/et të ndërtojnë në dyshe një tregim të shkurtër me katër fjali, ku të përdorin fjalët e dhëna. Disa nga dyshet e nxënësve/eve lexojnë tregimet e tyre. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Nxënësit/et njihen me temën e pjesës dhe me llojin e saj (ditar). Diskutohet me nxënësit rreth termit “ditar”. Mësuesi/ja, shkruan mendimet e nxënësve/eve në tabelë dhe plotëson e saktëson ato në lidhje me një tekst-ditar. <i>Lexim dhe pyetje:</i> Punohet teksti nëpërmjet teknikës “Lexim dhe pyetje”. *Punohet rubrika “Fjalë të reja”. Shpjegohen fjalët e reja, nxënësit/et krijojnë fjali me to. *Lexim zinxhir nga nxënësit/et. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Diskutim:</i> Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et bashkëbisedojnë në dyshe dhe më pas diskutojnë me gjithë klasën për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth pjesës. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Hulumtim:</i> Punohet rubrika “Analizoj” në mënyrë të pavarur nga nxënësit/et dhe më pas diskutohet në dyshe. Duke kërkuar në tekst, nxënësit/et do të duhet të gjejnë ndryshimet e shkollës sonë sot, me kohën kur është shkruar ditari (te data: <i>e shtunë...</i> sot nuk bëjmë mësim ditë të shtunë; te paragrafi i fundit: <i>mësuesja ime e klasës së parë...</i> sot mësuesja e klasës së parë, e ndjek shkollën deri në klasë të katërt, ose të pestë; po te ky paragraf thuhet: <i>me qindra vajza nga shkolla femërore...</i> sot djemtë dhe vajzat, mësojnë në të njëjtën shkollë e jo veç e veç). 			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e pestë <i>Bashkëbisedim:</i> Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit/et të tregojnë rastet kur ata/ato, janë ndodhur në një situatë të ngjashme me atë që përshkruhet në tekst. *Nxënësit/et diskutojnë në grupe dhe më pas me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es, për të përshkruar emocionet nëse secili prej tyre do të ishte autori i këtij ditari. Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve. • Vlerësimi bëhet për: -shprehjen e mendimeve personale rreth një teksti-ditar; -renditjen sipas rrjedhës së shkrimit të ditarit të fjalive përmbledhëse të tekstit; -leximin e tekstit në mënyrë të rrjedhshme dhe me intonacionin e duhur; -shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve rreth ditarit; -tregimin e llojit të tekstit që lexon, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij; -përgjigjet për pyetjet rreth përmbajtjes së ditarit; -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve. • Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”
--

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Shkrimi i fjalëve mohuese (ora I)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të shkruar drejt fjalët mohuese.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon fjalët mohuese në fjali; • korrigjon fjalët mohuese të shkruara gabim; • shkruan saktë fjalët mohuese; • përdor drejt në fjali fjalët mohuese; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e të tjerëve; • demonstroi besim në forcat e veta, respekt dhe tolerancë brenda grupit. 		Fjalë kyçe: -fjalë mohuese; -kurrkush, askush, kurrkund, etj...; -drejtshkrim	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustilë, fisha, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -tryezë rrethore; -diskutim në dyshe; -rishikim në dyshe; -diskutim; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Tryezë rrethore:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimin. Ftohen ata të shkruajnë në një fletë që e kalojnë dorë më dorë në grup duke e palosur si fizarmonikë një fjalë mohuese. Më pas përfaqësuesi i grupit, i lexon fjalët dhe i vendos te organizuesi grafik, që mësuesi/ja ka shkruar në tabelë: Fjalë mohuese <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Diskutim në dyshe:</i> Orientohen nxënësit/et, që në dyshe, të lexojnë fjalët mohuese në tekst dhe të diskutojnë rreth drejtshkrimit të tyre. Punohet rubrika “Mbaj mend”. Mësuesi/ja shpërndan fletët e plotësuara në veprimtarinë 1 dhe kërkon nga nxënësit/et të verifikojnë drejtshkrimin e tyre dhe të shkruajnë edhe fjalë të tjera mohuese në fletën e tyre. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Rishikim në dyshe:</i> Nxënësit/et të pavarur plotësojnë Ushtrimin 1. Më pas këmbëjnë librat me njëri-tjetrin për të verifikuar dhe korrigjuar drejtshkrimin e tyre. Kërkohet të përdorin në fjali këto fjalë. fjalët mohuese të ushtrimit 1. 			

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Diskutim:</i> Ushtrimi 2, synon që nxënësit/et të gjejnë dhe nënvizojnë fjalët mohuese. Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Në përfundim të punës, shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -dallimin e fjalëve mohuese në fjali; -drejtshkrimin e fjalëve mohuese; -përdorimin drejt të fjalëve mohuese në fjali; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së të tjerëve; -demonstrimin e besimit në forcat e veta, respektit dhe tolerancës brenda grupit. • Detyrë shtëpie Shkruaj në fletore fjali ku të përdorësh

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Shkrimi i fjalëve mohuese (ora II)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të shkruar drejt fjalët mohuese.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • plotëson një tekst me fjalë mohuese; • korrigjon fjalët mohuese të shkruara gabim; • shkruan saktë fjalët mohuese; • përdor drejt në fjali fjalët mohuese; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e të tjerëve; • demonstroi besim në forcat e veta, respekt dhe tolerancë brenda grupit. 		Fjalë kyçe: -fjalë mohuese; -kurrkush, askush, kurrkund, etj...; -drejtshkrim	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustilë, fisha, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -lexim-diskutim; -rishikim në dyshe; -diskutim; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Lexim-diskutim:</i> Nxënësit/et ftohen të lexojnë detyrat e shtëpisë. Diskutohet rreth tyre. Mësuesi/ja shpërndan fisha ku ka shkruar fjali, në të cilat ka përdorur fjalë mohuese. Nxënësit/et do të verifikojnë drejtshkrimin e tyre, do të bëjnë korrigjimet e duhura në rastet e shkruara gabim dhe më pas, do të tregojnë punën e tyre. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Nxënësit/et, të pavarur, plotësojnë Ushtrimin 3. Më pas, shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin për të verifikuar dhe korrigjuar drejtshkrimin e tyre. Kërkohej të lexojnë tekstin e plotësuar. • Veprimtaria e tretë <i>Diskutim:</i> Ushtrimi 4 kërkon që nxënësit/et të gjejnë fjalët mohuese të shkruara gabim dhe t'i korrigjojnë ato. Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Në përfundim të punës, shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -dallimin e fjalëve mohuese në fjali; -drejtshkrimin e fjalëve mohuese; -përdorimin drejt të fjalëve mohuese në fjali; -respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimin e punës së të tjerëve; -demonstrimin e besimit në forcat e veta, respektit dhe tolerancës brenda grupit. • Detyrë shtëpie: Ushtrimi 5 			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Duhet kohë për të qenë fëmijë		Situata e të nxënit Si e kaloni kohën e lirë? Si e mbushni atë?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; • tregon se si ndikojnë ilustrimet për ta kuptuar më mirë përmbajtjen e tekstit; • tregon llojin e tekstit që lexon duke vënë në dukje disa karakteristika të tij; • shpjegon fjalët e reja, duke i përdorur në fjali ato; • përshkruan personazhin, duke e ilustruar me pjesë nga teksti; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj në lidhje me aktivitetet në kohën e lirë; • vlerëson përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: -ditar; -vizitë mjekësore; -rezultatet e analizave; -reagimi ndaj stresit; -kohë e lirë.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim paraprak; -lexo-përmbledh në dyshe; -diskutim; -harta e personazheve; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim paraprak:</i> Mësuesi/ja u drejton nxënësve/eve pyetjet për diskutim: -Si e kaloni kohën e lirë? -Në cilat veprimtari merrni pjesë? -Shkoni me dëshirë, apo prindërit kanë këmbëngulur të shkoni në to? -Si ndiheni kur shkoni në këto veprimtari? <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Lexo-përmbledh në dyshe:</i> Mësuesi/ja njuh nxënësit/et me temën e mësimit. *Ftohen nxënësit/et të komentojnë ilustrimin në libër. Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën, diskutojnë rreth tij, duke treguar si i ndihmon ai për të kuptuar më mirë tekstin. *Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në paragrafë, duke nënvizuar fjalët e reja dhe ato që i bëjnë përshtypje. *Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et diskutojnë në dyshe rreth përmbajtjes së tij. *Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit/et. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <i>Diskutim:</i> Nxënësit/et punojnë individualisht në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj”. Ata/ato krahasojnë përgjigjet me njëri-tjetrin dhe ndalen në diskutimin e shkakut të sëmundjes së personazhit dhe rekomandimit të mjekes. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <i>Harta e personazheve:</i> Punohet rubrika “Analizoj”, pasi nxënësit/et dikutojnë në grupe dyshe kërkesat e saj. Ata/ato në dyshe do ndërtojnë fjali përmbledhëse për çdo paragraf. Lexohen dhe krahasohen ato. Kërkohet të analizojnë personazhin e kësaj pjese duke evidentuar dy cilësi të saj, si dhe fragmentin në tekst ku shfaqen këto cilësi. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e pestë <i>Bashkëbisedim:</i> Nxiten nxënësit/et të ndajnë eksperiencat e tyre në lidhje me shkrimin e një ditari. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. 			

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: -leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; -tregimin se si ndikojnë ilustrimet për ta kuptuar më mirë përmbajtjen e tekstit; -tregimin e llojit të tekstit që lexon duke vënë në dukje disa karakteristika të tij; -shpjegimin e fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to; -përshkrimin e personazhit, duke e ilustruar me pjesë nga teksti; -paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj; -vlerësimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup; -vlerësimet që i bëjnë njëri-tjetrit. • Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Plaku dhe mbreti (ora e I)		Situata e të nxënit Flasim për teatrin.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët dhe shprehjet që i duken interesante, më të rëndësishme; • tregon llojin e pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj; • u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit; • demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit teatror, duke dalluar alternativat e vërteta dhe të gabuara; • dallon ndryshimet midis dy personazheve të pjesës teatrale; • lexon tekstin teatror sipas roleve; • vlerëson rolin e brezave për krijimin e të mirave materiale dhe investimin për brezat e ardhshëm. 		Fjalë kyçe: -pjesë teatrale; -personazhe; -batuta; -plaku; -mbreti.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tekste teatrale të ndryshme; -mjete shkrimi, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore; -vendimmarrja morale.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim paraprak; -ndërveprim me tekstin; -rishikim në dyshe; -analizë; -lexim sipas roleve; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. 			

- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim paraparak: Mësuesi/ja u drejton pyetje nxënësve/eve:

-A keni ndjekur pjesë teatrale në teatër, apo televizor?

-Cilën pjesë teatrale pëlqeni më shumë? Cilat janë personazhet kryesore të saj? A ju ka mbetur në mendje ndonjë batutë mes personazheve?

-A keni lexuar ndonjë pjesë teatrale për fëmijë?

-Çfarë ju vjen në mendje kur themi “teksti teatror”?

Përgjigjet e nxënësve/eve, mësuesi/ja i riformulon dhe i paraqet në tabelë në formën e një kllasteri.

Teksti zhvillohet në formë dialogu mes personazheve. Emrat e personazheve shkruhen para batutave dhe tregojnë se kush duhet t’i interpretojë ato.

Pranë emrave të personazheve, shkruhen batutat që janë në tekstin që do të interpretojnë aktorët. Mes batutave gjenden shpjegimet.

- **Veprimtaria e dytë**

Ndërveprim me tekstin. Mësuesi/ja njeh nxënësit/et me titullin e pjesës. Komentohe figura në libër nga nxënësit/et. Orientohen nxënësit/et të lexojnë në heshtje pjesën dhe të nënvizojnë fjalët dhe shprehjet që u duken më interesante më të rëndësishme.

Nxënësit/et tregojnë llojin e pjesës, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj (tekst teatror).

Nxënësit/et e rilexojnë pjesën për të kuptuar më mirë dialogjet mes personazheve.

Nxiten ata t’u përgjigjen pyetjeve:

-Cilët janë personazhet që marrin pjesë?

-Përse e pyeti mbreti plakun?

-Çfarë po bënte plaku?

-Ç’përgjigje i dha plaku mbretit?

-Pse mbreti u largua i menduar?

- **Veprimtaria e tretë**

Rishikim në dyshe: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxiten nxënësit/et të dallojnë pohimet e vërteta dhe të gabuara. Nxënësit/et shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Zhvillohet një diskutim në klasë rreth ushtrimit nën drejtimin e mësuesit/es.

- **Veprimtaria e katërt**

Analizë: Punohet rubrika “Analizoj”, ku nxënësit/et tregojnë personazhet dhe numrin e batutave që thuhet nga secili personazh. Nxiten nxënësit/et që duke u nisur nga toni i batutave të tregojnë llojin e tekstit teatror, duke përzgjedhur alternativën e duhur.

Nxënësit/et diskutojnë dhe gjykojnë rreth ndryshimeve midis dy personazheve.

- **Veprimtaria e pestë**

Lexim sipas roleve: Nxënësit/et të organizuar në grupe lexojnë tekstin teatror sipas roleve (tregimtari, mbreti, plaku). Vihet theksi te intonacioni gjatë leximit.

Nxënësit/et japin mendime rreth leximit sipas roleve të shokëve/shoqeve.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët dhe shprehjet që i duken interesante, më të rëndësishme;

-tregimin e llojit të pjesës që lexon, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj;

-përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;

-demonstrimin e të kuptuarit të përmbajtjes së tekstit teatror, duke dalluar alternativat e vërteta dhe të gabuara;

-dallimin e ndryshimeve midis dy personazheve të pjesës teatrale;

-leximin e tekstit teatror sipas roleve.

- **Detyrë shtëpie**

Mësuesi/ja u ndan rolet nxënësve/eve dhe atyre u jepet detyrë të mësojnë përmendësh fjalët e rolit përkatës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Plaku dhe mbreti (ora e II)		Situata e të nxënit Nxënësit/et lexojnë në role pjesën.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin sipas roleve; • tregon përmbajtjen e pjesës duke u mbështetur në pyetjet në tekst; • analizon personazhet mbi bazën e veprimeve të tyre; • interpreton një prej roleve në pjesën teatrore; • vlerëson rolin e brezave për krijimin e të mirave materiale dhe investimin për brezat e ardhshëm; • lidh kontributin e plakut me shembuj nga jeta e tij/saj, kur ka bërë diçka që do t' u vlejë edhe të tjerëve. • vlerëson interpretimet e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -pjesë teatrore; -personazhe; -batuta; -plaku; -mbreti.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -veshje të përshtatura për personazhet; -mjete shkrimi, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -lexim sipas roleve; -harta e personazheve; -ditari dypjesësh; -bashkëbisedim; -lojë në role; <p>-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Lexim sipas roleve.</i> Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të organizuar në grupe me 3 anëtarë, të lexojnë pjesën sipas roleve. Vihet theksi te intonacioni gjatë leximit. *Nxënësit/et diskutojnë në dyshe rreth përmbajtjes së tekstit teatror. *Disa nxënës/e tregojnë ngjarjen.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Harta e personazheve.</i> Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të analizojnë personazhet. Ata/ato do të gjejnë dy cilësi për secilin personazh dhe do të gjejnë në tekst, fragmentin (fjalinë) që tregon këto cilësi. (mbreti, plaku)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <p><i>Ditari dypjesësh:</i> Punohet rubrika “Reflektoj”. Nëpërmjet ditarit dypjesësh, nxënësit/et në grupe, komentojnë fjalët që plaku i tha mbretit.</p>			
Fjalja		Komenti	
Dikur mbollën të tjerët e hëngra unë; tani po mbjell unë, që të hanë të tjerët!		Në jetë, secili brez ka detyrimet e tij për të krijuar të mira materiale për vazhdimësinë e jetës. Këtë mesazh e përcjell edhe historia e plakut të mençur. Ai megjithëse në moshë të thyer, mbjell një dru ulliri që do të bëjë fruta për nipërit dhe stërnipërit e tij. Kjo na motivon edhe ne për të qenë të përgjegjshëm dhe për të kryer detyrimet ndaj brezave të ardhshëm.	
<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <p><i>Bashkëbisedim:</i> Nëpërmjet një bashkëbisedimi nxënësit/et ndajnë me të tjerët përvojat e tyre, kur kanë bërë diçka që do t' u vlejë edhe të tjerëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e pestë <p><i>Lojë në roleve.</i> Nxënësit/et të organizuar në grupe me nga tre anëtarë, luajnë pjesën në role. Mësuesi/ja ndihmon në veshjen e personazheve si dhe në improvizimin e skenës. Nxënësit/et japin mendime rreth interpretimit të shokëve/shoqeve.</p>			

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: -leximin e tekstit sipas roleve; -tregimin e përmbajtjes së pjesës, duke u mbështetur në pyetjet në tekst; -analizën e personazheve mbi bazën e veprimeve të tyre; -interpretimin e pjesës në role; -vlerësimin e rolit të brezave për krijimin e të mirave materiale dhe investimin për brezat e ardhshëm; -lidhjen e kontributit të plakut me shembuj nga jeta e tij/saj, kur ka bërë diçka që do t' u vlejë edhe të tjerëve; -vlerësimet për interpretimet e shokëve/shoqeve. • Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Plotësojmë pyetësorë (ora I)		Situata e të nxënit Plotësimi dhe diskutimi i pyetësorëve të thjeshtë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • plotëson pyetësorë duke zgjedhur disa prej alternativave; • plotëson pyetësorë duke shpjeguar me shkrim zgjedhjen e bërë; • vë në dukje preferencat dhe aftësitë në lidhje me të lexuarit dhe të folurit; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • vlerëson punën e shokëve dhe të shoqeve. 		Fjalët kyçe: -pyetësor -preferencë -aftësi -të lexuarit -të folurit	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; -teksti shkollor; pyetësorë të ndryshëm; -mjete shkrimi, lapustilë, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte;	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -shkrim i drejtuar-diskutim; -shkrim i lirë; -diskutim; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Shkrim i drejtuar:</i> Mësuesi/ja shpërndan për çdo grup fletë ku ka shkruar një pyetësor të thjeshtë me dy pyetje. Njëra nga pyetjet plotësohet vetëm me zgjedhje ndërsa tjetra plotësohet edhe me shpjegim. Të pëlqen të shkosh në: _____ Të pëlqen të luash vetëm: Teatër _____ Po, sepse _____ Kinema _____ Jo, sepse _____ Bibliotekë _____ <p>Nxënësit/et diskutojnë në grup dhe plotësojnë pyetësorët. Një përfaqësues/e grupi, del para klasës dhe prezanton punën e bërë. Mësuesi/ja kërkon të gjejnë ku ndryshojë dy pyetjet. Diskutohet me nxënësit/et rreth kësaj dhe mënyrës së plotësimit të përgjigjes për secilën nga pyetjet.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Shkrim i lirë:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të plotësojnë pyetësorët e ushtrimit 1, 2. Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim të punës shkëmbejnë fletoret ndërmjet tyre, kontrollojnë dhe i vënë në dukje njëri-tjetrit gabimet drejtshkrimore. Edhe me ndihmën e mësuesit/es korrigjohen gabimet drejtshkrimore. • Veprimtaria e tretë <i>Diskutim:</i> Lexojnë detyrën para klasës. Diskutohet rreth zgjedhjeve të bëra nga nxënësit/et. Vihen në dukje të përbashkëtat dhe ndryshimet. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. 			

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: -plotësimin e pyetësorëve duke zgjedhur disa prej alternativave; -plotësimin e pyetësorëve duke shpjeguar me shkrim zgjedhjen e bërë; -vënien në dukje të preferencave dhe aftësive në lidhje me të lexuarit dhe të folurit; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit; -qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es; -vlerësimin e punës së shokëve dhe të shoqeve. • Detyrë shtëpie Shkruani një pyetësor të thjeshtë me dy pyetje. (vetëm të shkruhet, të mos e plotësohet)

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Plotësojmë pyetësorë (ora II)		Situata e të nxënit Plotësimi dhe diskutimi i pyetësorëve të thjeshtë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • plotëson pyetësorë duke zgjedhur disa prej alternativave; • plotëson pyetësorë duke shpjeguar me shkrim zgjedhjen e bërë; • vë në dukje preferencat dhe aftësitë në lidhje me të dëgjuarin dhe të shkruarin; • respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; • shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; • bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; • vlerëson punën e shokëve dhe të shoqeve. 		Fjalët kyçe: -pyetësor; -preferencë; -aftësi; -të lexuarit; -të folurit.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; -teksti shkollor; pyetësorë të ndryshëm; -mjete shkrimi, lapustilë, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte;	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -diskutim; -shkrim i lirë; -shkrim i drejtuar-diskutim; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit të këmbëjnë me shokun/shoqen pranë, detyrat e shtëpisë (fletët ku kanë shkruar pyetësorët). Ata/ato do t'i plotësojnë dhe përsëri do t'i këmbëjnë. Kontrollojnë dhe diskutojnë zgjedhjet, apo shpjegimet e bëra gjatë plotësimit të pyetësorëve. Disa prej tyre lexohen para klasës. <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <i>Shkrim i lirë:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të plotësojnë pyetësorët e ushtrimit 3, 4. Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim të punës, shkëmbejnë fletoret ndërmjet tyre, kontrollojnë dhe i vënë në dukje njëri-tjetrit, gabimet drejtshkrimore. Edhe me ndihmën e mësuesit/es, korrigjohen gabimet drejtshkrimore. • Veprimtaria e tretë <i>Diskutim:</i> Lexojnë detyrën para klasës. Diskutohet rreth zgjedhjeve të bëra nga nxënësit/et. Vihen në dukje të përbashkëtat dhe ndryshimet. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin. • Veprimtaria e katërt <i>Shkrim i drejtuar-diskutim:</i> Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të bëjnë një përshkrim me 6-7 fjali, të preferencave dhe aftësive të tyre duke u mbështetur në pyetësorët që plotësuan. Nxënësit/et do të punojnë individualisht, të pavarur. Në përfundim, do të lexojnë shkrimet e tyre. Diskutohen ato. Vlerësojnë njëri-tjetrin. 			

<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <p>-plotësimin e pyetësorëve duke zgjedhur disa prej alternativave; -plotësimin e pyetësorëve duke shpjeguar me shkrim zgjedhjen e bërë; -vënien në dukje të preferencave dhe aftësive në lidhje me të lexuarit dhe të folurit; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit; -qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es; -vlerësimin e punës së shokëve dhe të shoqeve.</p>
--

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe; • tregon se si ndikojnë ilustrimet për ta kuptuar më mirë përmbajtjen e tekstit; • lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante; • u përgjigjet pyetjeve rreth pjesës teatrore; • lexon me intonacion pjesën teatrore; • dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -pjesë teatrore; -lexim në role; -interpretim në role; -bisedë telefonike; -batuta;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësuesor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -bashkëjetesa paqësore;	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -parashikim me anë të titullit dhe ilustrimeve; diskutim; -veprimtari e leximit të drejtuar; -shkrim i shpejtë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë Parashikim me anë të titullit dhe ilustrimeve; diskutim; Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin dhe shtron pyetjen “Pse mund të jetë mërziur telefoni?” Nxënësit/et shohin ilustrimet, lexojnë titullin për një minutë dhe bëjnë parashikimin për përmbajtjen e pjesës, duke punuar në grup. Ata/ato japin përgjigje për pyetjen duke e argumentuar parashikimin e tyre. Diskutohet dhe për llojin e kësaj pjese. Nxënësit/et përcaktojnë llojin e saj duke treguar ku mbështeten për këtë përcaktim. • Veprimtaria e dytë Veprimtari e leximit të drejtuar: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et për leximin me ndalesa të pjesës. Ndalesa e parë: Zoti Pino... deri te... pas disa minutash telefoni ra sërish. Këtë radhë shkoi zonja Pina të përgjigjej. Pasi kanë lexuar pjesën e parë mësuesi/ja drejton pyetje rreth fjalorit, përmbajtjes, personazheve dhe përfundon me pyetjen: -Si mendoni se do të vazhdojë ngjarja? Ndalesa e dytë: Zonja Pina: Alo, kush flet?...deri teuleni receptorin. Pasi kanë lexuar pjesën e dytë mësuesi/ja drejton pyetje rreth fjalorit, përmbajtjes, personazheve dhe përfundon me pyetjen: -Si mendoni se do të vazhdojë ngjarja? 			

Ndalesa e tretë: Alo zonja Pina?... deri në fund. Pasi kanë lexuar pjesën e tretë, mësuesi/ja drejton pyetje rreth fjalorit, përmbajtjes, personazheve dhe përfundon me pyetjet:

- Çfarë ju bëri përshtypje në këtë pjesë?
- A ju pëlqeu mbyllja?
- Si mund të ishte një mbyllje tjetër?

*Ushtrohen nxënësit/et në lexim.

- **Veprimtaria e tretë**

Shkrim i shpejtë: Punohet rubrika “Reflektoj”.

Nxënësit/et udhëzohen të bëjnë një shkrim të shpejtë për t’iu përgjigjur pyetjes së kësaj rubrike. Lexohen shkrimet e disa prej nxënësve/eve.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

- parashikimin rreth përmbajtjes së pjesës duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe pyetja fillestare;
- leximin e përrallës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- dallimin e llojit të pjesës mbi bazën e karakteristikave të saj;
- përgjigjet e pyetjeve rreth pjesës;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

- **Detyrë shtëpie**

Ngjyros me ngjyra të ndryshme fjalët e personazheve dhe të tregimtarit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Telefoni i mërzhitur (ora II)		Situata e të nxënit Diskutim rreth karakteristikave të interpretimit të një pjese teatrore.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij; • u përgjigjet pyetjeve rreth pjesës teatrore; • lexon sipas roleve pjesën teatrore; • interpreton një prej roleve në pjesën teatrore; • paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; • demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup; • vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -pjesë teatrore; -lexim në role; -interpretim në role; -batuta; 	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -veshje të përshtatura për personazhet; telefon; etj...; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -bashkëjetesa paqësore;	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - diskutim rreth njohurive paraprake;
 - veprimtari e leximit në role;
 - pyetje-përgjigje;
 - lojë në role:
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Diskutim rreth njohurive paraprake: Mësuesi/ja shkruan në tabelë grupin e fjalëve: **pjesë teatrore**. Nxënësit/et japin mendimet e tyre, të cilat shkruhen në tabelë nga mësuesi/ja. Diskutohet rreth mendimeve që ata/ato kanë dhënë. Plotësohen dhe saktësohen ato nga mësuesi/ja duke u ndalur në karakteristikat e interpretimit të një pjese teatrore.

- **Veprimtaria e dytë**

Veprimtari e leximit në role: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për leximin në role. Bëhet ndarja e roleve duke respektuar zgjedhjen e roleve prej vetë nxënësve/eve. Vihet theksi te intonacioni gjatë leximit.

- **Veprimtaria e tretë**

Pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et punojnë në dyshe për t’iu përgjigjur pyetjeve të kësaj rubrike. Diskutohen ato me gjithë klasën.

- **Veprimtaria e katërt**

Lojë në role: Interpretohet pjesa nga nxënësit/et. Mësuesi/ja ndihmon në veshjen e personazheve si dhe në improvizimin e skenës. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-dallimin e llojit të tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;
 -diskutimet rreth pjesës teatrore;
 -leximit sipas roleve të pjesës teatrore;
 -interpretimit sipas roleve të pjesës teatrore;
 -demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
 -vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Shenjat e pikësimit në dialog		Situata e të nxënët Manipulime me fjalë e fjali për të përdorur drejt shenjat e pikësimit në dialog.	
Rezultatet e të nxënët Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • dallon fjalët e folësve dhe të autorit në një dialog; • dallon shenjat e pikësimit në dialog; • vendos ku duhet shenjat e pikësimit në dialog; • respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; • vlerëson punën e të tjerëve; • demonstroi besim në forcat e veta, respekt dhe tolerancë brenda grupit. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -dialog; -shenja pikësimi; -drejtshkrim; -fjalët e folësve; -fjalët e autorit; 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustilë, fisha, fletore, tabakë letre, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. 	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - vëzhgo-zbulo-diskuto;
 - lexo, përmbledh në dyshe;
 - rishikim në dyshe-diskutim;
 - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Vëzhgo-zbulo-diskuto: Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. Mësuesi/ja ka shkruar për çdo grup në fletë të vogla të njëjtin dialog të shkurtër (një pyetje dhe një përgjigje). Kërkon të ngjyrosin me ngjyra të ndryshme fjalët e folësve dhe të autorit si dhe të lexojnë, të nënvizojnë, ose qarkojnë shenjat e pikësimit në dialogun e shkruar. Ndërkohë mësuesi/ja e paraqet të njëjtin dialog në tabelë. Diskutohet me nxënësit/et rreth rregullave të shkrimit të një bashkëbisedimi midis dy, apo më shumë personave (dialogut).

- **Veprimtaria e dytë**

Lexo, përmbledh në dyshe: Orientohen nxënësit/et që në dyshe, të lexojnë dhe shqyrtojnë faqen e parë të këtij mësimi në tekst, duke u ndalur te rubrika “Mbaj mend”. Nxënësit/et, diskutojnë përsëri në dyshe dhe pyesin për paqartësitë. Mësuesi/ja qartëson dhe saktëson pyetjet e nxënësve në lidhje me dialogun dhe rregullat e shkrimit të tij. Më pas, përmbledhin në dyshe, rregullat e shkrimit të dialogut.

- **Veprimtaria e tretë**

Rishikim në dyshe: Nxënësit/et të pavarur plotësojnë Ushtrimin 1, 2. Më pas, shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin për të verifikuar dhe korrigjuar vendosjen e shenjave të pikësimit. Bëhet korrigjimi kolektiv i punës.

- **Veprimtaria e katërt**

Ushtrimi 3, synon që nxënësit/et të gjejnë dhe nënvizojnë me ngjyra fjalët e folësve dhe të autorit.

Nxënësit/et punojnë individualisht në libër.

Në përfundim të punës, shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es (korrigjim kolektiv).

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Veprimtaria e pestë**

Ushtrimi 4, synon që nxënësit/et të gjejnë dhe nënvizojnë me ngjyra fjalët e folësve e të autorit, si dhe të vendosin aty ku duhet shenjat e pikësimit.

Nxënësit/et punojnë individualisht në libër.

Në përfundim të punës, shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es (korrigjim kolektiv).

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-dallimin e fjalëve të folësve dhe të autorit në një dialog;

-dallimin e shenjave të pikësimit në dialog;

-vendosjen drejt të shenjave të pikësimit në dialog;

-përdorimin drejt, të fjalëve mohuese në fjali;

-respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

-vlerësimin e punës së të tjerëve;

-demonstrimin e besimit në forcat e veta, respektit dhe tolerancës brenda grupit.

- **Detyrë shtëpie**

Do të shkruajnë në fletore një dialog të shkurtër, ku do ngjyrosin fjalët e autorit, të folësve dhe shenjat e pikësimit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Çufoja gëzon shokët dhe mësuesen (ora e I)		Situata e të nxënit Shikim i disa sekuencave nga seriali vizatimor “Ndodhitë e Çufos”, me skenar të Gaqo Bushakës.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekstin teatror duke mbajtur shënime për dialogjet që i duken interesante; • tregon se si ndikojnë ilustrimet për ta kuptuar më mirë përmbajtjen e tekstit; • u përgjigjet pyetjeve rreth pjesës teatrore; • tregon llojin e pjesës që lexon, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj; • lexon me intonacion pjesën teatrore; • demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së pjesës teatrore, duke dalluar alternativat e vërteta dhe të gabuara; • gjykon rreth veprimit të personazheve. 		Fjalë kyçe: -tekst teatror; -personazhe; -batuta; -Mjellma; -Çufoja; -Tipi; -Kaçurreli.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -libri “Çufoja dhe Bubi kaçurrel” i autorit Gaqo Bushaka; -videoprojektor; -material filmik nga seriali vizatimor “Ndodhitë e Çufos”; -mjete shkrimi, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore; -vendimmarrja morale.	
<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: -shikim i organizuar; -ndërveprim me tekstin; -rishikim në dyshe; -analizë; -lexim sipas roleve; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <i>Shikim i organizuar:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shikojnë sekuenca nga seriali vizatimor “Ndodhitë e Çufos”, me skenar të Gaqo Bushakës. Në mungesë të videoprojektorit, nxënësit/et komentojnë rreth ngjarjeve të serialit vizatimor dhe personazheve të tij, të bazuara në romanin “Çufoja dhe Bubi Kaçurrel” të këtij autori. • Veprimtaria e dytë <i>Ndërveprim me tekstin.</i> Mësuesi/ja njeh nxënësit/et me titullin e tekstit teatror. Komentohet ilustrimet në libër nga nxënësit/et. Orientohen nxënësit/et të lexojnë në heshtje tekstin dhe të nënvizojnë dialogjet që i duken interesante. Nxënësit/et tregojnë llojin e tekstit, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij (tekst teatror). Nxënësit/et e rilexojnë tekstin për të kuptuar më mirë dialogjet mes personazheve. Nxiten ata/ato t’u përgjigjen pyetjeve: -Cilët janë personazhet që marrin pjesë? -Për çfarë e pyeti mësuesja Çufon? -A ishte përgatitur Çufoja për përsëritjen e tremujorit? -A iu përgjigj ai saktë të gjitha pyetjeve të mësueses? -Kush e kishte ndihmuar Çufon që të përgatitej kaq mirë? -Po Tipi a ishte përgatitur? -A ishin të sakta përgjigjet që i dha Tipi mësueses? -Ç’premtim bëri Tipi para klasës? • Veprimtaria e tretë <i>Rishikim në dyshe:</i> Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxiten nxënësit/et të dallojnë pohimet e vërteta dhe të gabuara. Nxënësit/et shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim në klasë rreth ushtrimit nën drejtimin e mësuesit/es. 			

- **Veprimtaria e katërt**

Analizë: Punohet rubrika “Analizoj”, ku nxënësit/et tregojnë numrin e batutave që thuhet nga secili personazh. Nxiten nxënësit/et, që duke u nisur nga toni i batutave, të tregojnë se si u duket ky tekst teatror, duke përzgjedhur alternativën e duhur.

- **Veprimtaria e pestë**

Lexim sipas roleve. Nxënësit/et të organizuar në grupe, lexojnë tekstin teatror sipas roleve. (Mësuese Mjellma, Çufoja, Tipi, Bubi Kaçurrel, Maçoku Sabo, Ketrushi)

Vihet theksi në leximin me intonacion.

Nxënësit/et japin mendime rreth leximit sipas roleve të shokëve/shoqeve dhe vlerësojnë njëri-tjetrin

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e tekstit duke mbajtur shënime për dialogjet që i duken interesante;

-tregimin se si ndikojnë ilustrimet për ta kuptuar më mirë përmbajtjen e tekstit;

-përgjigjet e pyetjeve rreth pjesës teatrore;

-tregimin e llojit të pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj;

-leximin me intonacion të pjesës teatrore;

-demonstrimin e të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit teatror, duke dalluar alternativat e vërteta dhe të gabuara

- **Detyrë shtëpie**

Mësuesi/ja ndan rolet nxënësve dhe u jepet detyrë të mësojnë përmendësh fjalët e rolit përkatës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Lexojmë Çufoja gëzon shokët dhe mësuesen (ora e II)		Situata e të nxënësve Nxënësit/et lexojnë në role pjesën.	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • lexon pjesën teatrore sipas roleve; • tregon përmbajtjen e pjesës me fjalët e tij; • analizon personazhet mbi bazën e veprimeve të tyre; • interpreton një prej roleve në pjesën teatrore; • lidh pjesën që lexon me ngjarje nga jeta e tij/saj, kur shokët apo shoqet e klasës, i kanë ofruar ndihmë, apo u ka dhënë ndihmë atyre; • vlerëson interpretimet e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -teksti teatror; -personazhe; -batuta; -Mjellma; -Çufoja; -Tipi; -Kaçurreli; -Maçoku Sabo. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësve/es; -teksti mësimor; -veshje të përshtatura për personazhet; -mjete shkrimi, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore; -vendimmarrja morale. 	

- **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Metodologjia:**
 - veprimtari e leximit me role;
 - harta e personazheve;
 - bashkëbisedim;
 - lojë në role;
 - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- **Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- **Veprimtaria e parë**

Veprimtari e leximit me role: Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të organizuar në grupe të lexojnë pjesën sipas roleve. *Nxënësit/et diskutojnë në dyshe rreth përmbajtjes së pjesës, të ndihmuar edhe nga pyetjet që u drejton mësuesi/ja. Disa nxënës/e tregojnë ngjarjen.

- **Veprimtaria e dytë**

Harta e personazheve. Mësuesi/ja, orienton nxënësit/et të tregojnë, se cilët janë personazhet kryesore dhe t'i analizojnë ato. Ata/ato do të gjejnë dy cilësi për secilin personazh dhe do të gjejnë në tekst, fragmentin (fjalinë) që tregon këto cilësi.

- **Veprimtaria e tretë**

Bashkëbisedim: Nëpërmjet një bashkëbisedimi nxënësit/et ndajnë me të tjerët përvojat e tyre, kur shokët, apo shoqet e klasës, u kanë ofruar ndihmë atyre, apo kur ata i kanë ndihmuar.

- **Veprimtaria e katërt**

Lojë sipas roleve. Nxënësit/et të organizuar në grupe, luajnë pjesën sipas roleve. Mësuesi/ja ndihmon në veshjen e personazheve, si dhe në improvizimin e skenës. Nxënësit/et japin mendime rreth interpretimit të shokëve/shoqeve. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

- **Vlerësimi bëhet për:**

-leximin e pjesës teatrore sipas roleve;
 -tregimin e përmbajtjes së pjesës teatrore me fjalët e tij/saj;
 -analizën e personazheve mbi bazën e veprimeve të tyre;
 -lidhjen e pjesës teatrore që lexon, me ngjarje nga jeta e tij/saj, kur shokët, apo shoqet e klasës, u kanë ofruar ndihmë atyre, apo kur ata u kanë dhënë ndihmë;
 -interpretimin e pjesës teatrore në role;
 -vlerësimet për interpretimet e shokëve/shoqeve.

- **Detyrë shtëpie:** Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Diktim 3		Fjalë kyçe -drejtshkrim; -diktim; -shkronjë e madhe; -shenjë pikësimi; -thonjëza.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: -shkruan një tekst me të diktuar; -përdor shenjat e pikësimit (pikë, pikëpyetje dhe pikëçuditëse në fund të fjalisë); -përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë, si dhe për emrat e përveçëm; -shkruan saktë emrat e përgjithshëm dhe ato të përveçëm, emrat e numrit njëjës dhe ato të numrit shumës; -shkruan saktë mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm; -shkruan saktë përemrat vetorë dhe pronorë; -shkruan saktë foljet në kohët e mësuara; -shkruan saktë ndajfoljet; -shkruan saktë fjalët dialektore; -bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es.		Situata e të nxënit Shkrimi i një pjese me të diktuar	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -fletore, mjete shkrimi.		Lidhja me fushat e tjera	

<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -stuhi mendimesh; -diskutim; -punë individuale. • Veprimtaritë e nxënësve/eve <ul style="list-style-type: none"> *<i>Stuhi mendimesh:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et për të treguar rregullat drejtshkrimore që dinë. (fillimi i fjalisë me shkronjë të madhe, shenjat e pikësimit në fund të fjalive, shkronja e madhe për emrat e përveçëm, etj...). *Mësuesi/ja dikton pjesën. *Bëhet korrigjimi i diktimit me ndihmën e mësuesit/es. *Qortohen gabimet e bëra, duke i shkruar përsëri saktë. • Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> -shkrimin e një teksti me të diktuar; -përdorimin e shenjave të pikësimit (pikë, pikëpyetje dhe pikëçuditëse në fund të fjalisë); -përdorimin e shkronjës së madhe në fillim të fjalisë si dhe për emrat e përveçëm; -shkrimin e saktë të emrave të përgjithshëm dhe ato të përveçëm, emrave të numrit njëjës dhe ato të numrit shumës; -shkrimin e saktë të mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm; -shkrimin e saktë të përemrave vetorë dhe pronorë; -shkrimin e saktë të foljeve në kohët e mësuara; -shkrimin e saktë të ndajfoljeve; -shkrimin e saktë të fjalëve dialektore; -qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es. • Detyrë shtëpie <p>Mësoni 5 fjali përmendësh nga pjesa “Bora e parë” dhe bëjeni vetë diktim.</p>
--

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa IV	Data:
Tema mësimore Dëgjojmë Gazmore		Situata e të nxënësve A ju pëlqejnë gazmoret?	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon, duke mbajtur shënime të shkurtra për fjalitë që i bëjnë më shumë përshtypje; • demonstroi të dëgjuar të qëllimshëm në kryerjen e detyrave; • përdori fjalorin e gjuhës shqipe për të gjetur kuptimin e fjalëve të reja të tekstit; • zgjedh një prej gazmoreve për të interpretuar duke shpjeguar zgjedhjen e tij/saj; • interpretoi në role një prej gazmoreve; • tregoi gazmore; • diskutoi rreth pjesës që dëgjon, duke u mbështetur në shënime të mbajtura prej tij/saj; • pranoi dhe tregoi respekt ndaj ideve dhe mendimeve të shokëve/shoqeve rreth pjesës që dëgjojnë; • bashkëpunoi në grup për kryerjen e një detyre. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -gazmore; -interpreto; -kënaqësi; -gëzim; 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fjalor i gjuhës shqipe; -pamje nga një ditë me shi; -CD, magnetofon; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -shkencat e natyrës; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> -të drejtat e njeriut; -mjedisi; -bashkëjetesa paqësore. 	

<ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve • Metodologjia: <p>-diskutim për njohuritë paraprake; -dëgjim i drejtuar; -lojë në role; -bashkëbisedim; -punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaritë e nxënësve/eve • Veprimtaria e parë <p><i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të japin mendimet e tyre për të plotësuar organizuesin grafik në tabelë: Gazmore Mësuesi/ja diskuton me nxënësit/et rreth pyetjes: A ju pëlqejnë gazmoret?</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e dytë <p><i>Dëgjim i drejtuar:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et (ushtrimi 1), të dëgjojnë një nga një gazmore në magnetofon. Orientohen nxënësit/et, që gjatë dëgjimit, të mbajnë shënime për fjalët e reja dhe për fjalitë që u bëjnë më shumë përshtypje. Komentojnë nga dyshet e nxënësve, fotot në libër si dhe përmbajtja e gazmoreve duke u ndalur në pyetjet e ushtrimit 1.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e tretë <p>Ushtrimi 2, synon që nxënësit/et të veçojnë gazmoren që u pëlqeu më shumë dhe të shpjegojnë zgjedhjen e tyre. Ushtrimi 3, synon që nxënësit/et, t'u tregojnë një gazmore që dinë, shokëve të tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria e katërt <p><i>Lojë në role:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et (ushtrimi 4) të zgjedhin një shok, ose shoqe, si dhe gazmoren që i pëlqeu më shumë, për ta luajtur në role. Pasi praktikohen për pak minuta, do të dalin para klasës për të shfaqur interpretimin e tyre. Nxënësit/et vlerësojnë njëri tjetrin.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bëhet për: <p>-ndjekjen me vëmendje të tekstit që dëgjon, duke mbajtur shënime të shkurtra për fjalitë që i bëjnë më shumë përshtypje; -demonstrimin e të dëgjuarit të qëllimshëm në kryerjen e detyrave; -përdorimin e fjalorit të gjuhës shqipe për të gjetur kuptimin e fjalëve të reja të tekstit; -tregimin e një gazmoreje; -zgjedhjen dhe interpretimin e njëres prej gazmoreve; -bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre; -vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.</p>

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa IV	Data
Tema mësimore Vlerësim njohurish 3		Fjalë kyçe: -vlerësim njohurish; -test; -përcakto; -kthe; -shkruaj.	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: - plotëson kërkesat e ushtrimeve në tekst; - shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; - respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.		Situata e të nxënësve Vlerësim njohurish 3	
Burimet dhe materialet didaktike - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; - fletët e testit, mjetet e shkrimit.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi.	

<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia: bisedë, punë individuale e pavarur. <p>Veprimtaritë e nxënësve/eve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësuesi/ja shpërndan fletët e vlerësimit të njohurive. Fton nxënësit/et të lexojnë kërkesat dhe të pyesin për paqartësitë. Udhëzon për punë të pavarur. • Në përfundim të testit, mblidhen fletët dhe bëhet zgjidhja e tij në tabelë duke diskutuar me nxënësit/et. <p>Vlerësimi bëhet për:</p> <p>-plotësimin e kërkesave të ushtrimeve në tekst; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.</p>

PLANIFIKIMI METODIK I PROJEKTIT					
Titulli i projektit	Teatri ynë	Kohëzgjatja	1 orë -- gjuhë shqipe (të folurit)		
			1 orë -- gjuhë shqipe (të lexuarit)		
Lënda: Gjuhë shqipe	Mësuesi:		1 orë -- gjuhë shqipe (të lexuarit)		
			1 orë -- gjuhë shqipe (të lexuarit)		
Lidhja fushat e tjera:	Arte, Teknologjia dhe TIK-u, Shoqëria dhe mjedisi	Klasa:	E katërt		
Ideja e projektit:	<p>Fëmijët pëlqejnë të lexojnë libra e të shohin teatër. Kështu që bashkohen këto dy pjesë (libri dhe teatri), në një projekt, që do jetë nxitje e mëtejshme për të lexuar dhe për t'u argëtuar duke krijuar.</p> <p>Në këtë projekt, nxënësit përdorin aftësitë hulumtuese për të kërkuar e gjetur pjesë nga librat që kanë lexuar; aftësitë krijuese për t'i përshtatur e për t'i interpretuar në një teatër për fëmijë.</p>				
Ngjarjet hyrëse që frymëzojnë kërkimin dhe angazhimin e nxënësve:	<p>Dëshira për t'u argëtuar duke marrë kënaqësi nga leximi, nga shfaqjet për fëmijë (teatri i kukullave dhe shfaqje të tjera), shfrytëzohen si nxitje për zotërimin e disa kompetencave.</p> <p>Njohuritë paraprake të nxënësve si dhe përvojat e mëparshme të tyre në lidhje me këtë temë, shfrytëzohen si nxitje për angazhimin e tyre në zotërimin e disa kompetencave.</p>				
Kompetencat kyçe që zhvillohen:	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.	x	Kompetenca personale	x	
	Kompetenca e të menduarit	x	Kompetenca qytetare	x	
	Kompetenca e të nxënësve	x	Kompetenca digjitale	x	
	Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.	x			
Temat e njohurive kryesore lëndore të cilat do të rimerren në sajë të projektit:	Lexojmë sipas roleve pjesë teatrore		Interpretojmë sipas roleve pjesë teatrore		
	Interpretojmë sipas roleve pjesë teatrore		Diskutojmë rreth personazheve, ngjarjes, interpretimeve të shokëve		
Rezultatet e të nxënësve:	<ul style="list-style-type: none"> nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme; pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti, ose rreth fjalëve të panjohura për të; ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit; shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, u përgjigjet pyetjeve; pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij/saj; lidh pjesën që lexon me përvoja personale; lexon sipas roleve; luan me role pjesën; përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të folurit; paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij; demonstron siguri, kur flet në klasë; demonstron pavarësi në mendime dhe veprime; demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; demonstron besim në forcat e veta, respekt e tolerancë brenda grupit. 				
Metodologjia:	(Individuale, në grup, ose e gjithë klasa)	Diskutim	x	Hulumtim	x
		Bisedë	x	Lojë me role	x
		Punë në grup	x	Tryeza rrethore	x
Burimet e nevojshme:	Njerëzit e përfshirë	Mësuesi/ja, nxënësit/et, prindërit.			
	Mjetet:	Maska, ose veshje për personazhet, bllok shënimesh, foto videoprojektor, karton letër, lapustilë, CD, magnetofon, skenë e improvizuar.			
	Materiale dhe burime	Libra për fëmijë, filmime nga shfaqje me kukulla.			
Pyetja kërkimore:	Si mund të luajmë një pjesë teatrore?				
	<p>Mësuesja i ka udhëzuar nxënësit të marrin informacione në lidhje me teatrin për fëmijë dhe pjesë nga këto shfaqje.</p> <p>Gjuhë shqipe</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxitet diskutimi për librat dhe teatrin për fëmijë. Analizohen librat dhe shfaqjet teatrore. Përgjatë diskutimeve, mësuesi/ja e orionton diskutimin, te lidhja e këtyre dy gjinive me njëra-tjetrën. Mësuesja ndan për çdo grup një pjesë letrare që është përshtatur për teatër. Mund të përdoret një nga pjesët e librit, ose një pjesë tjetër, e zgjedhur nga mësuesi/ja, apo vetë nxënësit/et. Nëpërmjet leximit të drejtuar diskutohet përmbajtja e kësaj pjese dhe fjalët e reja. 				

Përmbledhja e çështjeve, investigimi, kërkimi dhe zgjidhja e problemit:	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit të ndarë nëpër grupe me aq nxënës/e sa janë edhe personazhet e pjesës, ndajnë rolet dhe përgatiten duke e lexuar sipas roleve pjesën. Secili nxënës/e, mëson të interpretojë pjesën e tij të rolit. Bëhen shumë prova, në të cilat nxënësit përmirësojnë lojën e tyre në role. Me ndihmën e prindërve bëhet i mundur improvizimi i një skene, përgatitja e maskave, ose veshjeve të personazheve të pjesës dhe vija melodike që do të shoqërojnë shfaqjen. Jepet shfaqja. Të ftuar janë prindër, mësues/e e drejtues/e të shkollës dhe nxënës/e të klasave të tjera. Nëpërmjet intervistave të thjeshta “aktorët” dhe spektatorët e shfaqjes, pyeten për personazhin që interpretuan, lojën në role, lidhjen e kësaj pjese me jetën e tyre, mesazhin e shfaqjes si dhe vlerësimin që kanë për interpretimin e shokëve. 	
Produktet kryesore:	Në grup:	Teatri për çdo grup
	Individualisht:	Loja e personazhit të tyre
Vendi dhe pjesëmarrësit e prezantimit:	Shkollë	X
	Klasë	X
Vlerësimet:	Vlerësimet formuese (Gjatë projektit)	Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> leximin sipas roleve; interpretimin e pjesës sipas roleve; përzgjedhjen e fjalorit të duhur gjatë të folurit; shprehjen saktë dhe kuptueshëm të mendimit; bashkëpunimin në grup.
	Vlerësimet përmbledhëse (Në fund të projektit)	<ul style="list-style-type: none"> Realizimin e teatrit për çdo grup.
Buxheti:	Buxheti i detajuar Përse? Nga kush?	<ul style="list-style-type: none"> Në bashkëpunim me prindërit, mund të shpenzohet një fond prej 200 lekësh, për blerjen e materialeve të ndryshme dhe letrave, tabakëve dhe lapustilëve me ngjyra për maskat, veshjet dhe skenën.

Shënim: Mësuesi mund të përdorë edhe të njëjtën pjesë për secilin grup. Më poshtë, po japim një pjesë për model. Mësuesi, është i lirë të përdorë pjesë të tjera që i zgjedh vetë nga teksti mësimor, apo nga libra artistikë. Pjesët mund t'i zgjedhin edhe vetë nxënësit/et.

Kolombi te mbretëresha

Mbretëresha Izabelë (me ton urdhërues) – Heshtje!

Kolombi: – Nëse më lejoni... Unë e kam parë atë det. Kam qenë në tokat më të largëta të quajtura Thule.

Dijetari: – E çfarë ke parë atje?

Kolombi: – Kam parë gjithçka. (Ndërsa Kolombi fliste, hyri një dijetar me mjekër të kreshpëruar dhe vështrim të tmerrshëm. Kolombi u tremb). Thuajse gjithçka... Në ato toka kam parë njëkëmbëshat!

Izabela: – Njëkëmbëshat? E kush janë këta?

Kolombi: – Janë burra, Zonjë, me një shputë dhe një këmbë të vetme.

Dijetari: – Po gratë?

Kolombi: – Edhe gratë, për fat të keq... U ngjajnë paksa sirenave, vetëm se në vend që të mbarojnë me bisht peshku dhe pendë notimi, mbarojnë me një shputë të madhe këmbë dhe gishtat përkatës... ndjesë, gishta të mëdhenj!

Dijetari: – Dhe si ecin?

Kolombi: – Ecin... Nuk ecin, kërcëjnë, si fëmijët në lojën me kërcime.

Dijetari (ironik dhe tallës): – Pa na e tregoni pak këtë lojën me kërcime...

Kolombi: (duke e goditur me bastun në këmbë): – Kështu! – (Dijetari lëshoi një ulërimë dhe nisi të kërcente mbi njëren këmbë). Ja, pikërisht kështu... Përgëzime!

Të gjithë qeshën.

Test 3

Luani është një kafshë e egër, gjitare, e madhe e mishngrënëse, me lesh të shkurtër e të verdhemë, me një tufë qimesh në fund të bishtit. Luanët meshkuj kanë një kreshtë, a kurorë qimesh të gjata në qafë e rreth kokës. Ata gjenden në disa vise të Afrikës, të Azisë, Indisë etj. Zakonisht jetojnë në savana dhe lëndina, edhe pse ata mund të shkojnë në shkurre dhe pyje.

Një tufë luanësh përbëhet nga femra, të quajtura luanesha, nga këlyshët e tyre, si dhe nga një numër i vogël i meshkujve të rritur. Luanët janë grabitqarë, gjahtarë. Luani mbahet si kafsha më e fortë në përleshje me të tjerat. Luanët flenë kryesisht gjatë ditës. Prandaj, ata janë aktivë kryesisht gjatë natës, si dhe ndonjëherë gjatë muzgut.

Qarko përgjigjen e saktë.**1. Teksti është:** (1 pikë)

- a) informues
- b) ditar
- c) udhëzues

2. Luani është një kafshë:

(1 pikë)

- a) e egër
- b) e butë
- c) e vogël

3. Luani është një kafshë: (1 pikë)

- a) mishngrënëse
- b) barngrënëse
- c) të dyja

4. Luanët meshkuj kanë një kurorë qimesh të gjata: (1 pikë)

- a) në qafë e rreth kokës
- b) në fund të bishtit
- c) në këmbë

5. Luanët janë aktivë kryesisht gjatë:

(1 pikë)

- a) natës
- b) ditës
- c) të dyja

6. Një tufë luanësh përbëhet nga:

(1 pikë)

- a) luaneshat dhe këlyshët e tyre
- b) luanët e rritur
- c) të dyja

7. Shkruaj një karakteristikë të ditarit.

(1 pikë) _____

8. Plotëso fjalinë:

(2 pikë)

Zakonisht një tekst udhëzues shoqërohet me _____, _____ që na ndihmojnë për ta kuptuar më mirë atë.

9. Përdor në fjali ndajfoljen *mjaft*. (1 pikë)**10. Në fjalinë e mëposhtme gjej foljen dhe analizoje atë.** (4 pikë)

“Ata janë aktivë kryesisht gjatë natës”.

Folja	Koha	Veta	Numri

11. Përdor në fjali foljen:

(4 pikë)

mësoj – në kohën e ardhme, veta e tretë, numri njëjës**mbjell** – në kohën e kryer të thjeshtë, veta e dytë, numri shumës**12. Vendos shenjat e duhura të pikësimit në dialogun e mëposhtëm:**

(3 pikë)

Poeti u tha fëmijëve __ Ju lumtë, që lexoni kaq shumë libra __

13. Korigjo fjalët e shkruara gabim.

(2 pikë)

As kush nuk u vonua atë ditë.

Çdo mëngjes unë pij qumësht.

14. Shkruaj fjalët me kuptim të kundërt të fjalëve: ditë, qaj, i pastër, lart dhe fjalët me kuptim të njëjtë të fjalëve: apartament, përfundoj, picirruk, nxitimthi. Vendosi në tabelë. (8 pikë)

	Emra	Folje	Mbiemra	Ndajfolje
Sinonime	-	-	-	-
Antonime	-	-	-	-

15. Formo fjali me fjalën “luani” duke e përdorur në dy kuptime të ndryshme. (2 pikë)

16. Përshkruaj lulen e preferuar.

(5 pikë)

Vlerësimi	AP	ANP	AK	ASHK	ASH
Pikët	0-10	11-22	23-28	29-35	36-38